



RAPORT I GJENDJES NË MJEDIS 2022



RAPORT I GJENDJES NË MJEDIS

2 0 2 2

Publikuar nga :

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Përgatitur nga :

Sektori i Vlerësimit të Gjendjes Mjedisore
Drejtoria e Menaxhimit dhe Edukimit Mjedisor

Kontribuan:

Sektori i Mostrimit dhe Analizave Laboratorike
Sektori i Informacionit, GIS dhe Regjistrave Mjedisore
Drejtoria e Regjistrave Mjedisore, Inovacionit dhe Analizave Laboratorike

Sektori i Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve
Drejtoria e Lejeve Mjedisore dhe Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)

Znj. Ornela Shapo, Projekt i GIZ Menaxhim i Modernizuar dhe Miqësor ndaj
Klimës i Mbetjeve dhe Riciklimit në Shqipëri

PhD Oriana Hanxhari, EIONET/EEA NFP/ Asistent Koordinatore, Shqipëri
Autore e Kapitullit 9 “Ndikimi i Mega Trendeve Globale në Shqipëri”

SHKURTIME

AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
BE	Bashkimi Evropian
KE	Komisioni Evropian
DKU	Direktiva Kuadër e Ujit
EC	European Commission
EEA	European Environment Agency
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë
TSIC	Trophic State Index, Carlson
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
UN	Ujëra Nëntokësore
Mp	Mineralizim i Përgjithshëm
Fp	Fortësi e Përgjithshme
PRTR	Pollutant Release and Transfer Register
ISHTI	Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial
PCB	Poliklorurbifenile
GIZ/DKTI	Shoqëria Gjermane për Zhvillim/Menaxhimi i Modernizuar dhe Miqësor ndaj Klimës i Mbetjeve dhe Riciklimit

IKPK	Inventari Kombëtar i Pyjeve dhe Kullotave
SEIZP	Sistemi Evropian i Informacionit të Zjarreve në Pyje
S.Gj.N	Sfondi Gjeokimik Natyror
BLV	Baseni i Lumit Vjosë
GMT/MTG	Global Mega Trend/Megatrende Globale
AEM	Agjencia Europiane e Mjedisit
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
PBB	Prodhim i Brendshëm Bruto
NKO	Nevoja Kimike për Oksigjen
NBO5	Nevoja Biokimike për Oksigjen 5 ditore
NFP	National Focal Point
EIONET	Environmental Information and Observation Network
WHO	World Health Organization/Organizata Botërore e Shëndetësisë
UNEP	United Nations Environment Program/ Programi për Mjedisin i
HEC	Kombeve të Bashkuara Hydro Energy Central (Hidrocentral)

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
ÇËSHTJET EMERGJENTE TË GJETURA	6
PROFILI I VENDIT	7
KAPITULLI 1 MJEDISI BREGDETAR.....	13
KAPITULLI 2 ZHURMAT MJEDISORE	51
KAPITULLI 3 UJËRAT.....	62
KAPITULLI 4 AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE.....	136
KAPITULLI 5 MENAXHIMI I MBETJEVE	156
KAPITULLI 6 PYJET DHE BIODIVERSITETI	176
KAPITULLI 7 TOKA	208
KAPITULLI 8 AKTIVITETET INDUSTRIALE	226
KAPITULLI 9 NDIKIMI I MEGATRENDEVE GLOBALE	234
PËRMBLEDHJE	250
ANEKSI 1. TË DHËNAT SIPAS SEKTORËVE	256

HYRJA

Mjedisi mund të jetojë pa Ne , por Ne jo pa atë

Mjedisi është ai në të cilin njeriu zhvillon veprimtarinë e tij jetësore dhe pa të, ai nuk do të mund të ekzistonte. Duke u fokusuar tek mënyra se si të fitojë më shumë të mira materiale, njeriu po e anashkalon kujdesin ndaj ekuilibrave natyrorë. Me ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit, dëmtohen, e gradualisht shkatërrohen ekosistemet dhe habitatet natyrore të kafshëve dhe bimëve. Dëmtimi i florës dhe faunës, njëkohësisht sjell përkeqësimin e gjëndjes së mjedisit dhe cilësisë së jetës.

Jo të gjithë veprojnë njëllë ndaj mjedisit. Disa zhvillojnë veprimtari mbrojtëse ndërsa disa të tjerë e shfrytëzojnë mjedisin duke ndikuar negativisht.

Ruajtja dhe kujdesi për mjedisin nuk është vetëm një detyrim shoqëror, por mbi të gjitha është dhe një përgjegjësi individuale. Duke parë rëndësinë e mjedisit, lind nevoja e

madhe për mbrojtjen e tij nëpërmjet:

- Monitorimit të treguesve mjedisorë
- Vlerësimit të gjëndjes së mjedisit dhe rolit të aktivitetit njerëzor
- Dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e gjëndjes së mjedisit
- Marrjes së masave nga politikëbërësit

Pikërisht këtë realizon Raporti i Gjëndjes në Mjedis 2022 :

Të nxjerrë në pah ndryshime pozitive që janë arritur në komponentët kryesor të mjedisit krahasuar me vitet e mëparshme, problematikat që vazhdojnë të jenë prezente, ndikimin e aktivitetit njerëzor në mjedis si dhe masat që duhet të ndërmerren lidhur me përmirësimin e treguesve të mjedisit.

Raporti i Gjëndjes në Mjedis jep një vështrim të përgjithshëm, për njohjen e publikut

ÇËSHTJET EMERGJENTE TË GJETURA

me gjëndjen e komponentëve të mjedisit si; ujë, tokë, ajër, treguesve të ndikimit dhe presioneve që ushtrohen nga aktivitetet njerëzore apo ato natyrore.

Trajtimi i shkarkimeve të ujërave urbane të ndotura para se të derdhen në ujërat pritëse sipërfaqësore.

Zvogëlimi i sipërfaqeve ranore për shfrytëzim publik në zonat bregdetare gjatë sezonit veror turistik.

Zhvillimi i metodave parandaluese për trajtimin të efluentëve të derdhura në lagunat Butrint, Nartë dhe Karavasta, për uljen e nivelit të ndotjes nga metalet e rënda Kadmium dhe Plumb.

Mungesa e infrastrukturës rrugore dhe transportit urban krijojnë fluks automjetesh duke sjellë si pasojë rritje të nivelit të zhurmave. Faktorë të tjerë janë dhe gjendja motorike e automjeteve, ndërtime.

Ndikimi i faktorëve artificialë në regjimin e ujërave nëntokësore, për shkak të vënies në shfrytëzim të shpimeve pa leje të cilët

PROFILI I VENDIT



Territori

Territori i Republikës së Shqipërisë ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 28.748 km². Gjatësia e vijës kufitare është 1094 km, nga të cilat 657 km vijë kufitare tokësore, 316 km vijë bregdetare, 48 km vijë ndarëse përmes lumenjve dhe 73 km përmes liqeneve. Territori i Shqipërisë ndahet në 4 krahina të mëdha natyrore (fiziko-gjeografike): Alpet Shqiptare, Krahina malore qendrore, Krahina malore jugore dhe ultësira bregdetare.

shfrytëzojnë rezerva të konsiderueshme. Shfrytëzimi i akuiferëve porozë në disa raste mbi kapacitetin ujëdhënës të tyre. Shfrytëzimi pa kriter i zhavorreve në shtretërit e lumenjve për materiale ndërtimi. Të tre këta faktorë së bashku kanë krijuar probleme në burimet ujore nëntokësore si:

Ulje e nivelit të ujërave nëntokësore, si rrjedhojë edhe zvogëlim të prurjeve në pusët e shpimit dhe të disa burimeve.

- Tharje pjesore të disa akuiferëve.
- Prishje të cilësisë së ujërave nëntokësore

Referuar matjes së prurjeve, lumenjtë Bunë, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosë paraqesin shkallë të lartë të rrezikut për përmbytje.

Evidentimi i fenomeneve të erozionit të pranishme në shtratin e lumit Erzen dhe Ishëm të cilat shfaqin problematika të ndryshme.

Elementi i Kromit (**Cr**) referuar analizave gjeokimike, është në nivele të larta në thellësinë e tokës 10-15 cm, duke shkaktuar ndotje të vijës bregdetare Kanali i Hoxharës - Porti i Vjetër Vlorë dhe përbën risk për njerëzit, prandaj duhet monitoruar në vazhdimë

Klima

Klima e Shqipërisë, me pozicionin e saj të favorshem,, përballë deteve Adriatik dhe Jon, si dhe malësitë e mbështetura mbi pjesën e ngritur të Ballkanit, ka një numër të madh zonash klimaterike, krahasuar kjo me sipërfaqen e saj modeste. Ultësirat bregdetare kanë klimë tipike mesdhetare, me dimër të butë dhe verë të lagësht. Temperaturat mesatare variojnë nga 7°C në dimër e deri në 24°C në verë. Pjesa malore karakterizohet nga një klimë mesdhetare-kontinentale, e shkaktuar kjo nga masat ajrore që mbizotërojnë Evropën lindore dhe Ballkanin. Veçori kryesore të kësaj zone janë erërat e fuqishme me drejtimin verior dhe veri-lindor si dhe temperaturat mesatare disi më të ulëta.

Reshjet

Sasia e reshjeve është mesatarisht e lartë,ësi rezultat i

kombinimit të dy rrymave ajrore, ato mesdhetare dhe kontinentale. Niveli i reshjeve varion nga 600 mm në vit në fushëgropën e Korçës, në 3100 mm në vit në Bogë, të Alpeve Shqiptare. Gjithashtu, vlen për t'u theksuar se rreth 95% e shirave të të gjithë vendin bien në sezonin dimëror.

Relievi

Relievi i Shqipërisë është kryesisht malor. Vargmalet e para alpine u formuan nga mbarimi i jurasikut, ndërsa gjatë erës kenozoike u shpejtua procesi malformues në tërësinë e Albanideve, që tani përbëjnë tokën e nëntokën e Shqipërisë. Lartësia mesatare e relievit është 708 metra, ose 2 herë më e lartë se mesatarja e Evropës. Lartësitë më të mëdha gjenden në Alpet shqiptare dhe në malet e Lindjes.

Pyjet

Fondi pyjor dhe kullosor i Shqipërisë shtrihet në një sipërfaqe të përgjithshme prej 1.716.824 (ha) duke përfaqësuar 59,7 % të sipërfaqes gjithsej të vendit.

Në 2021 pyjet shtrihen në një sipërfaqe 1.146.724 (ha) që përfaqëson 66,8 % të fondit pyjor dhe kullosor. Kullotat dhe livadhet zënë një sipërfaqe 448.750 (ha) ose 26,1 % të fondit pyjor dhe kullosor. Sipërfaqet me bimësi pyjore dhe joproductive që janë pjesë e fondit pyjor zënë një sipërfaqe 121.350 (ha) ose 7,0 % të këtij fondi. Në vitin 2021, janë përfshirë edhe sipërfaqet e pyjeve që ndodhen në zonat e mbrojtura dhe si rezultat ka një rritje prej 94.882 ha, krahasuar me vitin 2020.

Zonat e mbrojtura

Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vendin tonë, janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ato ofrojnë. Zonat e mbrojtura në vitin 2021 zënë një sipërfaqe të përgjithshme prej 523.831/ha duke zënë 30,0 % të sipërfaqes së fondit pyjor dhe rreth 18,0 % të sipërfaqes së përgjithme të vendit. Në vitin 2021 nuk ka patur ndryshime në numrin dhe sipërfaqen e zonave të mbrojtura.

Në vitin 2021 sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e zënë parqet kombëtare me 44,0 % të sipërfaqes gjithësej, ndjekur nga rezervatet natyrore të menaxhuara me 32,3 %, pejsazhet e mbrojtura me 18,6 %, zonat e mbrojtura të menaxhuara 3,5 %, rezervatet natyrore 0,9 % dhe monumente natyrore 0,7 %.

Ujërat

Vendi dallohet për pasuri të shumta dhe të shumëllojshme ujore. Pasuria ujore lidhet me kushtet klimatike, relievin, dhe përbërjes gjeologjike të Shqipërisë.

Detet

Deti Adriatik dhe deti Jon kanë rëndësi të madhe gjeografike dhe ekonomike. Ato ndikojnë në zbutjen e klimës, në ujërat e tyre gjuhet një sasi e madhe peshku dhe në laguna nxirret kripë. Këto dete shërbejnë edhe si rrugë lidhëse të Shqipërisë me shtetet e tjera fqinje.

Lumenjtë

Lumenjtë janë një nga potencialet më të mëdha dhe më të rëndësishme ujore të vendit, të cilët dallohen për një shkallë të lartë të ujëshmërisë dhe dendësisë. Të gjithë lumenjtë e vendit kanë një prurje të përgjithshme mesatare vjetore prej 1308 m³/sek, që i përgjigjet një vëllimi vjetor prej rreth 41.25 km³. Në rrjetin kryesor lumor të Shqipërisë përfshihen lumenjtë e Drinit, Bunës, Matit, Ishmit, Erzenit, Shkumbinit, Devollit, Osumit, Semanit, Vjosës, Drinosit, Bisticës dhe Pavllës. Këta janë lumenjtë më kryesorë të Shqipërisë, të cilët përshkojnë vendin me orientim nga lindja në drejtim të perëndimit, me derdhje kryesisht në detet Adriatik dhe Jon. Lumenjtë e vendit tonë dallohen për vlera të larta të koeficientit të rrjedhjes, ku vlera mesatare e tij është 0.64, pra 64% e sasisë së ujit që rezulton nga reshjet futet në rrjedhjet e rrjetit hidrografik.

Ujërat nëntokësore

Ujërat nëntokësore janë të gjithë ujërat që gjenden nën sipërfaqen e tokës. Ato dalin në sipërfaqe të tokës në dy mënyra: artificiale dhe natyrore. Artificiale janë kur njeriu i nxjerr nëpërmjet shpimit të puseve. Natyrore janë kur ato dalin në formë burimi ose kur janë burime të fuqishme që i quajmë gurra. Ujërat nëntokësorë janë krijuar si rezultat i qarkullimit të pandërprerë të ujit në natyrë

Popullsia

Popullsia e Shqipërisë më 1 Janar 2022 rezulton 2.793.592 banorë, duke pësuar një rënie me 1,3 %, krahasuar me 1 janar 2021. Gjatë vitit 2021 shtesa natyrore e popullsisë (lindje-vdekje) ishte 3.296 banorë, duke shënuar për herë të parë shtesë natyrore negative. Në vitin 2021 numri i emigrantëve ishte 42.048 persona dhe numri i imigrantëve ishte 9.195 persona.

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB)

Produkti i Brendshëm Bruto përfaqëson vlerën totale në para, të të gjithë të mirave dhe shërbimeve të prodhuara gjatë një periudhe specifike nga njësitë prodhuese rezidente brenda territorit ekonomik të një vendi.

Në vitin 2020, në ekonominë shqiptare, PBB-ja me çmime korrente u vlerësua 1.644.077 milion Lekë (13,3 miliardë euro), ndërsa PBB për frymë arriti në 579 mijë Lekë (ose 4.681 €).

KAPITULLI 1
MJEDISI BREGDETAR



MJEDISI BREGDETAR

1.1 Çështjet që trajtohen

Monitorimi mikrobiologjik i ujërave bregdetarë të larjes për plazhet e Velipojës, Shëngjinit, Tales, Durrësit, Gjiri i Lalzit, Kavajës, Divjakës, Semanit, Vlorës, Palasës, Dhërmiut, Himarës, Jalë, Borshit, Qeparoit, Lukovë, Ksamilit, Sarandës, Pogradecit, Linit është kryer nga Instituti i Shëndetit Publik për treguesit baktereologjikë *Enterococcus intestinal* (IE) dhe *Escherichia Coli* (E.Coli)

Monitorimi i cilësisë së ujërave bregdetare në Dhërmi, Borsh, Lukovë, Zvërnec, Ksamil, Shëngjin dhe Velipojë është kryer nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për parametrat oksigjeni i tretur, amoniak, nitrite dhe ortofosfate.

Monitorimi i cilësisë së lagunës së Butrintit kryhet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për parametrat klorofila- **a** dhe indeksi i gjendjes trofike TSIC (Karlson).

Monitorimi i cilësisë së lagunës së Butrintit, Karavastasë dhe Nartës kryhet nga Universiteti Bujqësor i Tiranës për metalet e rënda, Cd, Pb, Cu, As, Hg.

Ndikimi i shkarkimeve të lëngëta urbane në zonat bregdetare Durrës, Vlorë dhe Sarandë është monitoruar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për parametrat nevoja kimike për oksigjen, nevoja biokimike për oksigjen, lënda e ngurtë pezull dhe fosfori total.

Agjencia Kombëtare e Bregdetit është institucioni përgjegjës për mbrojtjen dhe zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm të zonës bregdetare, nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të zonës bregdetare në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit. Ky institucion monitoron sipërfaqet ranore bregdetare të shfrytëzuara për sezonin turistik.

1.2 Gjendja dhe tendenca

1.2.1 Mjedisi bregdetar

Flora dhe fauna

Bregdeti shqiptar shquhet për pasuri dhe potenciale të mëdha të turizmit balnear. Në brendësi ka një natyrë malore dhe të thyer e cila dukshëm tërheq vëmendjen e gjithë vizitorëve.

Flora gjatë bregdetit shqiptar është mjaft e pasur. Përgjatë vijës bregdetare të Adriatikut vijon me një pyllëzim me pisha duke filluar nga Velipoja, Shëngjini, Durrësi, Divjaka. Këto stacione plazhi pikasin për pyllëzim të pishave dhe shkurreve mesdhetare si: shqopa, shelgu dhe dunat. Përsa i përket faunës ujore jetojnë shumë lloje peshqish, ku ndër ta mund të përmendim Sardelen, Levrekun, Qefullin, Barbunin, Shozen, Merlucin, Kocën dhe Dentalin, etj. Fauna tokësore karakterizohet nga kafshë të buta dhe të egra. Bregdeti Jon, i njohur ndryshe si Riviera shqiptare formon një nga brigjet më piktoresk të pellgut të Mesdheut. Bimësia në këtë zonë është e përfaqësuar kryesisht nga makiet mesdhetare, ku mund të përmendim; helmesi, pambuku i egër, mertja, murrizi, shqopa, dafina, thana, sherebeli, bajamja e egër, etj. Gjithashtu njihet edhe për prodhimin e agrumeve dhe ullirit.

Në këtë Rivier mund të përmendim faunën, e cila ka një shumëllojshmëri peshqish dhe shpendësh. Llojet më të përhapura të peshqve janë: sardejla, levreku, koca, dentali, si dhe butakë detar (midhja). Shpendët përfaqësohen kryesisht nga dallëndyshja e detit, shaptorja, pëllumbat e egër, thëllëza e malit etj.

Zonat e mbrojtura

Parku kombëtar Butrint

Ndodhet në rrethin e Sarandës. Sipërfaqja aktuale është 9,424.40 ha. Zona është e mbrojtur dhe mjaft tërheqëse e shlodhëse në pikëpamje turistike. Ishujt përbëjnë një oaz të peizazheve të mrekullueshëm detare dhe tokësore, të mbuluar me një bimësi tipike mesdhetare. Nën ujin detar takohet një faunë e florë mjaft e pasur, ku vlen të veçohet fanerogami (*Halophyla stipulacea*) dhe bivalvori (*Pinna nobilis*), lloje të mbrojtur nga konventat ku Shqipëria aderon. Liqeni i Butrintit është i rëndësishëm në mënyrë të

veçantë për iktiofaunën/akuakulturen dhe avifaunën e tij, duke përfshirë dhe liqenin e Rrëzës (Bufit), me të cilin komunikon në lindje. Brënda zonës ruhen specie drunore të pyllit tipik mesdhetar, i përbërë me ilqe (*Quercus ilicis*), rrënjë (*Q. robur*), vërrri (*Alnus glutinosa*), vidh (*Ulmus campestris*), frashër (*Fraxinus angustifolia*) etj, të klasës Quercio-Ilicis. Faunë e pasur veçanërisht në zvarranikë dhe insekte, mjaft lloje ku disa prej të cilëve janë të mbrojtur. Duke patur brënda kufijve të saj qytetin antik të Butrintit-objekt i UNESCO-s, parku përbën një zonë mjaft tërheqëse për vizitorët dhe turistët.

Parku kombëtar detar Karaburun-Sazan

Ndodhet në rrethin e Vlorës. Sipërfaqja e përgjithshme e "Parkut Kombëtar Detar" Karaburun-Sazan është 12428.00 ha rreth Ishullit të Sazanit, në një largësi 1 milje detare (1852m) nga vija bregdetare, është identifikuar nga ekspertët vendas dhe të huaj si zona me vlera të larta të trashëgimisë natyrore. Kjo zonë konsiderohet me larmi të pasur peizazhesh nënujore, habitatesh dhe të llojeve të florës e faunës detare si; vendstrehimi, ushqimi e shumimi për një numër të madh llojesh me rëndësi kombëtare, rajonale dhe globale.

Ato përbëjnë gjithashtu një substrakt të përshtatshëm për rritjen e shumë organizmave bimore e shtazore nënujore, duke filluar me algat detare, sfungjerët, knidarët, molusqet, krustacet, lëkurëgjëmborët, koralin e kuq, reptilët, gjitarët dhe habitate të mundshme për Fokën e Mesdheut.

Një nga karakteristikat dalluese të biodiversitetit të kësaj zone janë livadhet nënujore të posidonias (*Posidonia oceanica*), që cilësohen si lloj i përkeqësuar i Detit Mesdhe. Shtrirja e tyre varet nga natyra dhe përbërja e funddetit, nga karakteristikat e ujit, si transparenca, pastërtia, etj, të cilat plotësohen më së miri rreth Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit. Veç të tjerash, kjo zonë banohet ose vizitohet edhe nga lloje globalisht të rrezikuara në shkallë kritike, të cilat janë listuar edhe në konventat ndërkombëtare ku aderon

Shqipëria, siç janë disa lloje peshqish, peshkaqenësh, breshkash deti, delfinësh dhe Foka e Mesdheut.

Parku kombëtar Divjakë

Ndodhet në rrethet Lushnjë, Fier e Kavajë. Sipërfaqja aktuale 22,230 ha. Është pa dyshim zona më e rëndësishme përgjatë zonës bregdetare të vendit dhe nga më të rëndësishmet në Mesdhe. Takohen një sërë habitatesh si: delta lumenjesh, laguna, duna ranore, bimësi të ndryshme pylli me pishë të butë dhe të egër dhe me prani të dëllënjës kokërrmadhe (*Juniperus monocarpa*). Takohen 3 lloje endemike salepesh të gjinisë Orchis dhe lloji endemik Aster albanicus. Përgjatë deltave takohet gjitari globalisht i kërcënuar lundërza (*Lutra lutra*). Përhapje ka dhe çakalli, dhelpira, baldosa, etj. Parku dhe zona rreth tij ka vlera historike, kulturore, arkeologjike me potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit.

Parku i Llogarasë

Ndodhet në Bashkinë Vlorë, ka një sipërfaqe totale prej 1010 ha. Është një zonë e rëndësishme për shpendët dhe si habitat për shpendët migratore. Bimësia që rritet në këtë park është e shumëllojshme dhe veçohen pyjet e pishës së zezë, me bush, pyjet e rrobullit, grumbujt e bredhit të Maqedonisë.

Shfrytëzimi i zonës bregdetare

Sipërfaqet ranore bregdetare të shfrytëzuara për plazh publik dhe plazh privat, sipas bashkive për sezonin turistik veror 2022 paraqiten në tabelat e mëposhtme

Tabela 1: Numri i parcelave të shfrytëzuara sipas përdorimit

2022					
		Publike	Investim	Të menaxhuara	Total parcela sipas bashkisë
BASHKIA	SHKODËR	14	28	181	223
	LEZHË	24	0	513	537
	DURRËS	161	27	632	820
	KAVAJË	41	0	197	238
	RROGOZHINË	18	0	70	88
	DIVJAKË	10	0	28	38
	POGRADEC	17	0	45	62
	FIER	19	0	155	174
	VLORË	18	0	310	328
	HIMARË	54	17	226	297
	SARANDË	4	0	157	161
	Total parcela sipas përdorimit	380	72	2514	2966

Tendenca



Vlerësohet se kemi një tendencë në rritje të sipërfaqeve të menaxhuar për sezonin turistik 2022 krahasuar me 2021 për bashkitë Lezhë, Kavajë, Rogozhinë, Vlorë dhe Himarë. Përsa i përket shfrytëzimit të sipërfaqeve ranore për përdorim publik, vërehet se për vitin 2022 kemi tendencë në ulje pothuajse në të gjitha bashkitë, duke përjashtuar bashkinë Divjakë, Fier dhe Pogradec që ruajnë të njëjtën sipërfaqe.

Tabela 2: Sipërfaqet e parcelave të shfrytëzuara sipas tipologjisë

Viti 2022		
BASHKIA	Parcela tipologjia	Sipërfaqja në m ²
SHKODËR	Menaxhuar	146,438
	Investim Strategjik	18,546
	Publike	43,984
	Totali	208,968
LEZHË	Menaxhuar	417,899
	Publike	143,969
	Totali	561,868
DURRËS	Menaxhuar	492,801
	Investim Strategjik	201,348
	Publike	489,748
	Totali	1,183,897
KAVAJË	Menaxhuar	191,257
	Publike	88,883
	Totali	280,140
RROGOZHINË	Menaxhuar	373,413
	Publike	62,824
	Totali	436,237
DIVJAKË	Menaxhuar	138,907
	Publike	37,890
	Totali	176,797
POGRADEC	Menaxhuar	96,474
	Publike	48,097
	Totali	144,571
FIER	Menaxhuar	415,355
	Publike	104,718
	Totali	520,073
VLORË	Menaxhuar	569,863
	Publike	133,663
	Totali	703,526
HIMARË	Menaxhuar	304,559
	Investim Strategjik	123,777
	Publike	119,641
	Totali	547,977
SARANDË	Menaxhuar	100,152
	Publike	11,354
	Totali	111,506

Tabela 3. Sipërfaqet publike dhe të menaxhuara 2021-2022

Nr.	Bashkia	2021 Sipërfaqe e menaxhuar, m ²	2022 Sipërfaqe e menaxhuar, m ²	2021 Sipërfaqe publike, m ²	2022 Sipërfaqe publike, m ²
1	SHKODËR	155.343	146,438	53.626	43,984
2	LEZHË	397.730	417,899	164.149	143,969
3	DURRËS	512.592	492,801	524.539	489,748
4	KAVAJË	175.160	191,257	104.978	88,883
5	RROGOZHINË	315.629	373,413	94.897	62,824
6	DIVJAKË	138.907	138,907	37.890	37,890
7	POGRADEC	96.490	96,474	48.106	48,097
8	FIER	415.368	415,355	104.717	104,718
9	VLORË	550.044	569,863	160.310	133,663
10	HIMARË	272.801	304,559	140.048	119,641
11	SARANDE	104.256	100,152	12.126	11,354



1.2.2 Cilësia e ujërave bregdetare të larjes



Efektet direkte ose indirekte të nutrienteve në mjediset ujore dhe sasia e tyre ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e ujërave larëse bregdetarë. Pjesa më e madhe e ndotësve mikrobiologjik e kanë origjinën nga aktivitetet njerëzore dhe shkarkimi i ujërave urbane të pa trajtuara. Shkarkimet nga impiantet e trajtimit të ujërave urbane që nuk plotësojnë kriteret e përmbajtjes brenda normave të parametrave kimik dhe mikrobiologjik.

Inspektimi higjieno sanitar, është kryer për përcaktimin e burimeve të ndotjes në plazhe, përcaktimi i burimeve pikësore ose difuze të ndotjes (shkarkimeve të lëngëta dhe/ose të ujërave të larta, që derdhen direkt ose indirekt në plazhe si dhe pastërtia e plazheve). Monitorimi mikrobiologjik është kryer në tre sezona, në muajin Maj para sezonit të larjes, gjatë sezonit të larjes Qershor-Shtator dhe pas sezonit të larjes.

Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes për parametrat mikrobiologjik *Escherichia Coli* (EC) dhe *Intestinal Enterococce* (IE), kryhet bazuar mbi standarte të WHO/UNEP, BE për kategorizimin sipas vlerave 90- 95%-tile

Tabela 4: Kategorizimi për cilësinë e ujërave bregdetarë të larjes

Kategoria	A	B	C	D
Vlera Limit e	< 100 *	101-200 *	185**	> 185 **
Cilësia e ujit	Cilësi e shkëlqyer	Cilësi e mirë	Cilësi e mjaftueshme	Cilësi e keqe/ Masa të menjëhershme
* - 95 - th percentile <i>Intestinal Enterococci</i> /100 ml ** - 90 - th percentile <i>Intestinal Enterococci</i> /100 ml				

Plazhet e Velipojës, Shëngjinit dhe Tales

Plazhi i Velipojës

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	B-R Belavista	114	76	7 stacione Kategoria A	100% cilësi e shkëlqyer
2	Hotel Adriatik	33	26		
3	B-R Fantazia	60	31		
4	Hyrja Plazh	123	75		
5	Pallatet e Reja	101	53		
6	Dolce Vita	46	34		
7	Pranë Lagunës Vilunit	73	33		

Nga vlerësimi mikrobiologjik të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal tregon se ujërat e Plazhit të Velipojës nuk kanë ngarkesë mikrobike, dhe janë ujëra të cilësisë së shkëlqyer Temperatura varion nga 18 -25.50C.

Tabela 5. Plazhi i Velipojës: Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare të larjes sipas kategorive, për periudhën 2016 -2022 (e shprehur në %)

Kategoritë	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A-Cilësi e shkëlqyer	57%	100%	100%	100%	100%	71.4%	100%
B - Cilësi e mirë	43%	0%	0.8%	0%	0%	28.5%	0%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%

Për Plazhin e Velipojës për vitin 2022, numri i stacioneve që i përkasin Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave është e barabartë me vitin 2017,2018,2019 dhe 2020 dhe më e lartë se vitet 2016 dhe 2021.

Numri i stacioneve të kategorisë B- Cilësisë së mirë të ujërave, për vitin 2022 është e barabartë me vitin 2017, 2018, 2019 dhe 2020 dhe është më e ulët në krahasim me vitet

2016 dhe 2021.

Numri i stacioneve të kategorisë C- Cilësisë së mjaftueshme të ujërave për vitin 2022 është e barabartë me vitet, 2016, 2017 , 2018, 2019 2020 dhe 2021.

Numri stacioneve të kategorisë D- Cilësisë së keqe të ujërave, për vitin 2022 është e barabartë më vitet, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Plazhi i Shëngjinit

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Ish kabinat	63	49	A	100% cilësi e shkëlqyer
2	Hotel "Doro"	47	44	A	
3	Hotel "Kristian"	39	31	A	
4	B-R Gjahtari	88	49	A	
5	Kune	104	62	A	

Për plazhin e Shëngjinit për vitin 2022, A-Cilësi e Shkëlqyer u vlerësuan 5 stacionet e monitorimit, 100% e tyre. Temperatura e ujit varjon nga 24-28°C.

Tabela 6. Plazhi i Shëngjinit. Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetarë të larges sipas kategorive, për periudhën 2016 – 2022 (e shprehur në %)

Kategoritë	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A - Cilësi e shkëlqyer	60%	80%	80%	100%	80%	40%	100%
B - Cilësi e mirë	40%	20%	20%	0%	20%	60%	0%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%

Për Plazhin e Shëngjinit për vitin 2022, numri i stacioneve që i përkasin Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave është e barabartë me vitin 2019 dhe më e lartë se vitet 2016, 2017, 2018, 2020 dhe 2021.

Numri i stacioneve të kategorisë B- Cilësisë së mirë të ujërave, për vitin 2022 është e barabartë me vitin 2019 dhe është më e ulët në krahasim me vitet 2016, 2017, 2018, 2020

dhe 2021.

Numri i stacioneve të kategorisë C- Cilësisë së mjaftueshme të ujërave për vitin 2022 është e barabartë me vitet, 2016, 2017, 2018, 2019 2020 dhe 2021.

Numri stacioneve të kategorisë D- Cilësisë së keqe të ujërave, për vitin 2022 është e barabartë me vitet, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Plazhi i Tales

Për plazhin e Tales për vitin 2022, nuk ka ngarkesa mikrobiale. A-Cilësi e Shkëlqyer u vlerësuan 3 stacionet e monitorimit. Temperatura varion nga 24-28°C.

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Hyrja qendrore, djathtas, tek Palmat	46	17	A	100%- Cilësi e shkëlqyer
2	Në qendër të hyrjes, tek Antena	45	28	A	
3	Majtas hyrjes qendrore, Bar-Restorant USA	81	53	A	

Tabela 7. Plazhi e Tales. Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes sipas kategorive, për periudhën 2020 – 2022 (e shprehur në %)

Kategoritë	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A - Cilësi e shkëlqyer	100%	100%	100%
B - Cilësi e mirë	0%	0%	0%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%

Plazhin e Tales për tre vitet e fundit, 2020, 2021 dhe 2022, të gjitha stacionet i përkasin Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave, pa ngarkesa mikrobike.

Plazhi i Durrësit

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Plazhi Currila 1	137	209	C	28.5%-Cilësi e shkëlqyer
2	Plazhi Currila 2	1210	71	A	
3	Plazhi Zhiron	685	1210	D	
4	Ura e Dajlanit	230	165	B	
5	Plazhi Filadelfia	111	104	B	
6	Plazhi Teuta	161	129	B	48 %-Cilësi e mira
7	Plazhi Gostivar	134	143	B	
8	Apollonia	114	170	B	
9	Hekurudha (Policia)	152	123	B	
10	Hotel Adriatik	128	106	B	
11	Plazhi Iliria (pista)	166	128	B	9.5-Cilësi e mjaftueshme
12	Iliria pranë Bllokut	175	130	B	
13	Iliria pranë Bllokut	127	94	A	
14	Tropikal	253	200	A	
15	Pas kanalit (Plepa)	2370	2879	D	
16	Shkëmbi i Kavajës	307	352	D	14 %-Cilësi e keqe
17	Bar Hotel Hoti	68	54	A	
18	Plazhi Benilva	76	49	A	
19	Plazhi, Hotel Andi	91	84	A	
20	Hotel Xixa	140	122	B	
21	Kompleksi Xhardino	309	268	C	

Plazhet e Durrësit për vitin 2022, sipas rezultateve bakteriologjike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), vlerësohen të Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave për 6 pika monitorimi, të kategorisë B- Cilësisë së mirë për 10 pika monitorimi, të Kategorisë C- Cilësisë së mjaftueshme për 2 pika monitorimi, dhe të kategorisë D- Cilësisë së keqe për 3 pika monitorimi. Temperatura varion nga 22-28.50C Nga strukturat përkatëse shtetërore dhe pushteti vendor në Durrës, kërkohet marrja e masave, me qëllim ndalimin e ndotjes nga ujërat e ndotura urbane dhe mbetjet urbane që vijnë në këto plazhe.

Për Plazhin e Durrësit numri stacioneve të monitorimit që i përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave për vitin 2022 është e rritur në krahasim me 2016, dhe është ulur në

krahasim me 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Numri stacioneve të kategorisë B – Cilësia e mirë e ujërave për vitin 2022 është rritur në krahasim me 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Numri stacioneve të kategorisë C – Cilësia e mjaftueshme e ujërave, për vitin 2022 është e rritur në krahasim me 2018, 2020 dhe 2021 dhe më e ulët se në vitet 2016, 2017 dhe 2019. Vërehet një përmirësim i dukshëm i cilësisë së ujërave të larjes në plazhin e Durrësit në krahasim me vitet e mëparshme.

Numri stacioneve të kategorisë D- Cilësia keqe/ Masa të menjëherëshme, për vitin 2022 është ulur në krahasim me vitin 2016, dhe është rritur në krahasim me vitet 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Tabela 8. Plazhi i Durrësit. Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare të larjes sipas kategorive, për periudhën 2016- 2022 (e shprehur në %)

Kategoritë	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A-Cilësi e shkëlqyer	5%	33%	66.7%	71.5%	90.5%	38%	28.5%
B - Cilësi e mirë	33%	33%	23.8%	0%	0%	47.7%	48%
C - Cilësi e mjaftueshme	19%	24%	0%	19%	0%	4.8%	9.5%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	43%	10%	9.5%	9.5%	9.5%	9.5%	14%

Plazhi Gjiri i Lalzit

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Kepi i Rodonit	60	76	A	60% cilësi e shkëlqyer
2	Fshati Turistik Lura	216	26	B	
3	Plazhi Publik pas Lurës	153	31	A	
4	Gjiri Lalzit (Kompleksi Alioma)	137	75	A	
5	Gjiri Lalzit (Fshati Turistik Lura 3)	84	53	B	40% cilësi e mirë

Sipas rezultateve mikrobiologjike, plazhet e Gjirit të Lalzit, sipas rezultateve bakteriologjike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), vlerësohen të Kategorisë

A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave për 3 pika monitorimi dhe të kategorisë B- Cilësisë së mirë për 2 pika monitorimi. Temperatura varion nga 24- 28°C

Tabela 9. Plazhi i Lalzit. Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes sipas kategorive, për periudhën 2020 – 2022 (e shprehur në %)

Kategoritë	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A - Cilësi e shkëlqyer	100%	100%	100%
B - Cilësi e mirë	0%	0%	0%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%

Për Plazhin e Lalzit në tre vitet e fundit 2020, 2021, 2022, të gjitha stacionet i përkasin Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave, pa ngarkesa mikrobike.

Plazhi i Kavajës (Golem)

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Majami	96	184	B	67%-Cilësi e shkëlqyer
2	Vjena	56	73	A	
3	Golem-Kosmira	60	41	A	33%-Cilësi e mirë
4	Vapori mbytur	87	62	A	
5	Kompleksi FAFA (ish Piceri Jurgen)	45	29	A	
6	Piceri Argjëndi	55	53	A	
7	Mak Albania	115	132	B	
8	Lokali Reshatit	109	168	B	
9	Bunkerit i Bardhë	48	38	A	

Plazhet e Kavajës (Golemit) në vitin 2022, sipas rezultateve bakteriologjike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), vlerësohen të Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave për 6 pika monitorimi dhe të kategorisë B- Cilësisë së mirë të ujërave, për 3 pika monitorimi. Temperatura varion nga 18-28°C.

Tabela 10: Plazhi I Kavajës.Vlerësimi i cilësisë së ujërave sipas kategorive për plazhin Kavajë, vlerësimi në përqindje

Kategoritë	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A - Cilësi shumë e mirë	33%	100%	78%	100%	100%	0%	67%
B - Cilësi e mirë	33%	0%	22%	0%	0%	66.7%	33%
C - Cilësi e mjaftueshme	33%	0%	0%	0%	0%	22.3%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%	0%	0%	11%	0%

Për plazhin e Kavajës, numri stacioneve të monitorimit që i përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave për vitin 2022 është ulur në krahasim me 2017, 2018, 2019 dhe 2020 dhe është rritur në krahasim me vitet 2016 dhe 2021.

Numri stacioneve të kategorisë B – Cilësia e mirë e ujërave për vitin 2022 është e barabartë me vitin 2016, është ulur në krahasim me vitin 2021 dhe është rritur në krahasim me vitet

2017, 2018, 2019 dhe 2020.

Numri stacioneve të kategorisë C – Cilësia e mjaftueshme e ujërave, për vitin 2022 është e barabartë me vitet 2017, 2018, 2019, 2020 dhe është ulur në krahasim me 2016 dhe 2021.

Numri stacioneve të kategorisë D- Cilësia keqe/ Masa të menjëherëshme, për vitin 2022 është e barabartë me vitet 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 dhe është shumë më e ulët se në vitin 2021.

Plazhi i Qerretit

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Qerret, Ish Fusha Sportit	60	39	A	67%- Cilësi e shkëlqyer
2	Kompleksi Belavista	109	109	B	33%- Cilësi e mirë
3	Qerret, Bar-Kafe Holliday	114	92	A	

Plazhet e Qerretit në vitin 2022, sipas rezultateve bakteriologjike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), vlerësohen të Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave për 2 pika monitorimi dhe të kategorisë B-Cilësisë së mirë të ujërave, për 1 pikë monitorimi. Temperatura varion nga 18-28°C.

Tabela 11. Plazhi i Qerretit. Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes sipas kategorive, për periudhën 2020 – 2022 (e shprehur në %)

Kategoritë	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A - Cilësi e shkëlqyer	100%	100%	67%
B - Cilësi e mirë	0%	0%	33%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%

Numri stacioneve të monitorimit që përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave për vitin 2022 është ulur në krahasim me 2021 dhe 2020.

Plazhi i Spillesë

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Spille Djathtas, Bar-Restorant Martini	23	20	A	100%-Cilësi e shkëlqyer
2	Spille Qendër, Hotel Basana	66	75	A	
3	Greth i Mesëm, Palmat e fundit	69	54	A	

Për plazhin e Spilles vlerësohen të kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave të gjitha pikat e monitorimit, 100% e tyre. Krahasur me vitin 2021 ka rritje të cilësisë së ujërave për këto plazhe për vitin 2022. Temperatura varion nga 18-28°C.

Tabela 12: Plazhi i Spilles. Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes sipas kategorive, për periudhën 2020 – 2022 (e shprehur në %).

Kategoritë	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A - Cilësi e shkëlqyer	100%	0%	100%
B - Cilësi e mirë	0%	34%	0%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	66%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%

Krahasur me vitin 2021 ka rritje të cilësisë së ujërave për këto plazhe për vitin 2022. Plazhet janë kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave. Ky plazh monitorohet në tre vitet e fundit.

Plazhet e Semanit, Darzezës dhe Divjakës

Plazhi i Semanit dhe Darzezës

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Hyrja në plazh, tek Policia, Bunkeri	36	16	7 stacione Kategoria A	100% cilësi e shkëlqyer
2	Kulla e Ujit	48	64		
3	Plazhi Darzezë	20	12		
4	Lokali Gjermanit Seman	14	26		
5	Bar restorant 4 Flamuj Seman	49	56		
6	Lokali Ilir Lani Darzez	49	56		
7	Ish reparti ushtarak Pish Poro	51	48		

Në plazhin e Semanit dhe Darzezës janë shtuar 4 pika monitorimi si pasojë e frekuentimit të këtyre plazheve gjatë sezonit veror të një viti më parë. Në të gjitha pikat e monitorimit të analizuara në plazhin e Semanit

dhe Darzezës, sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) këto plazhe vlerësohen të Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave për vitin 2022. Temperatura varion nga 26-28°C.

Tabela 13 :Plazhi i Semanit dhe Darzezës .Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes sipas kategorive, për periudhën 2020 – 2022 (e shprehur në %).

Kategoritë	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A - Cilësi e shkëlqyer	100%	100%	100%
B - Cilësi e mirë	0%	0%	0%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%

Në tre vitet e fundit 2020, 2021, 2022 të gjitha pikat e monitorimit të analizuara, vlerësohen të Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave.

Plazhi i Divjakës

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Hyrja në plazh, tek Policia	83	58	A	100%- Cilësi e shkëlqyer
2	Hyrja kryesore në plazh	57	41	A	
3	1000 m larg dhe majtas pikës 2	36	35	A	

Plazhi i Divjakës, gjatë 2022 pas përpunimit e të dhënave (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), vlerësohet se i përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave. Temperatura varion

nga 24-28.5°C.

Tabela 9: Plazhi i Divjakës.Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes sipas kategorive, për periudhën 2020 – 2022 (e shprehur në %).

Kategoritë	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A - Cilësi e shkëlqyer	100%	100%	100%
B - Cilësi e mirë	0%	0%	0%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%

Plazhet e Divjakës gjatë tre viteve të fundit 2020, 2021 dhe 2022, pas vlerësimit për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal,

rezultuan se i përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer në të gjitha stacionet e monitorimit.

Plazhet e Zvërnecit ,Vlorës dhe Orikumit

Plazhi i Zvërnecit

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Para Xhemalit (djathtas)	97	96	A	100%-Cilësi e shkëlqyer
2	Bar-Restorant Olsi (në mes)	121	78	A	
3	Bar-Restorant Kapiteni (majtas)	115	81	A	

Plazhet e Zvërnecit, gjatë 2022 pas përpunimit të rezultateve për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), vlerësohen se i përkasin

kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave. Temperatura varion nga 23-28°C.

Kategoritë	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A - Cilësi e shkëlqyer	100%	0%	100%
B - Cilësi e mirë	0%	33.3%	0%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	66.7%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%

Tabela 15 : Plazhi i Zvërnecit. Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes sipas kategorive, për periudhën 2020 – 2022 (e shprehur në %).

Për plazhin e Zvërnecit, për vitin 2021 nuk ka asnjë stacion që i përket kategorisë A -Cilësi e shkëlqyer ujërave, krahasuar me vitin 2020.

Kurse në vitin 2022 kemi një përmirësim të dukshëm të cilësisë, të gjitha stacionet janë të kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave.

Plazhet e Vlorës

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Plazhi i Vjetër, Kampi i Pionierëve	250	187	B	60 % - Cilësi e shkëlqyer
2	Plazhi i Vjetër, Kabinat	234	248	C	
3	Shkolla e Marinës	1621	2396	D	10 %- Cilësi e mjaftueshme
4	Plazhi i Ri	669	634	D	
5	Ish Vilat, Blloku	75	66	A	10%-Cilësi e mirë
6	Jonufer	103	89	A	
7	Plazhi Paradisë	33	33	A	20%-Cilësi e keqe
8	Plazhi Lame Borshi	45	55	A	
9	Radhimë, Hotel Grand	55	75	A	
10	Lokali Boja 1	121	96	A	

Duke vlerësuar të dhënat, vihet re ngarkesa mikrobiologjike të *E.Coli* dhe *dhe S-Fecal* në pikën 1 të monitorimit (Plazhi i Vjetër Kampi i Pionerëve) dhe në pikën 2 (Plazhi i Vjetër, Kabinat). Kurse në pikën 3, Shkolla e Marinës ngarkesa mikrobiologjike është akoma më e

madhe. Në pikat e tjera (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal) nuk vërehet ngarkesë mikrobike e ujërave në këto plazhe. Temperatura e ujit varion nga 23-29 °C.

Tabela 16: Plazhet e Vlorës.Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare të larjes sipas kategorive, për periudhën 2016 -2022 (e shprehur në %)

Kategoritë	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A - Cilësi shumë e mirë	50%	80%	70%	80%	60%	60%	60%
B - Cilësi e mirë	10%	10%	0%	0%	30%	0%	10%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	10%	10%	10%	0%	10%	10%
D - Cilësi e keqe/Masa menjëherëshme	40%	0%	20%	10%	10%	30%	20%

Për plazhin e Vlorës, për vitin 2022 , ujërat e kategorisë A -Cilësi e shkëlqyer, janë në rritje krahasuar me vitin 2016, në ulje krahasuar me 2017, 2018, 2019 dhe në vlera të barabarta me vitet 2020 dhe 2021.

Numri i stacioneve të kategorisë B- Cilësisë së mirë të ujërave, për vitin 2022 janë rritur krahasuar me vitet 2018, 2019 dhe 2021, janë në vlera të barabarta me vitet 2016, 2017, është në vlera më të ulta krahasuar me vitin 2020.

Numri i stacioneve të kategorisë C- Cilësisë së mjaftueshme të ujërave për vitin 2022 është rritur në krahasim me vitet 2016 dhe 2020, në vlera të barabarta me vitet 2017, 2018, 2019 dhe 2021.

Numri stacioneve të kategorisë D- Cilësisë së keqe të ujërave, për vitin 2022 është e ulur në krahasim me vitin 2016 dhe 2021, në vlera të barabarta me vitin 2018, është rritur në krahasim me vitet 2017, 2019 dhe 2020.

Plazhi i Orikumit

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Kompleksi Orikum	68	75	A	66.7%- Cilësi e shkëlqyer
2	Bar- Restorant Aleksandër	66	54	A	
3	Para Repartit Pashaliman	72	106	B	33.3%-Cilësi e mirë

Sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), këto plazhe vlerësohen të Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave për 2 pika monitorimi dhe të kategorisë B- Cilësi e mirë, 1 pikë monitorimi. Për plazhin e Orikumit

gjatë 2022 kanë rezultuar 67% plazhe të kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer të ujërave, 33% plazhe të kategorisë B- Cilësi e mirë të ujërave. Temperatura e ujit varion nga 23.5-29°C

Tabela 17: Plazhi i Orikumit. Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes sipas kategorive, për periudhën 2020 – 2022 (e shprehur në %).

Kategoritë	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A - Cilësi e shkëlqyer	100%	67%	66.7%
B - Cilësi e mirë	0%	33%	33.3%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%

Në Plazhet e Orikumit gjatë dy viteve të fundit 2021 dhe 2022, është ulur numri i stacioneve të kategorisë A - Cilësi e shkëlqyer të ujërave krahasuar me vitin 2020, ku të gjitha stacionet i përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer.

Plazhi i Palasës

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Plazhi i Palasës 1	8	5	A	100%- Cilësi e shkëlqyer
2	Plazhi i Palasës 2	9	4	A	

Për plazhin e Palasës të dy pikat e monitorimit nuk kanë ngarkesa mikrobiale, janë të kategorisë A -Cilësi e shkëlqyer të ujërave. Temperatura e ujit varion 23-28°C.

Kategoritë	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A - Cilësi e shkëlqyer	100%	100%	100%
B - Cilësi e mirë	0%	0%	0%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%

Tabela 18: Plazhi i Palasës. Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes sipas kategorive, për periudhën 2020 – 2022 (e shprehur në %).

Plazhi i Palasës në tre vitet e fundit 2020, 2021 dhe 2022, të gjitha stacionet i përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave. Në të gjitha stacionet e monitorimit.

Plazhet e Dhërmiut dhe Drimadhes

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Plazhi te Lisi	16	24	A	100%- Cilësi e shkëlqyer
2	Hotel Anastasia	43	23	A	
3	Kampi i Punëtorëve	22	16	A	
4	Plazhi Drimadhes 1	14	93	A	
5	Plazhi Drimadhes 2	67	98	A	

Plazhet e Dhërmiut dhe Drimadhes gjatë 2022 pas përpunimit (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), nuk kanë ngarkesa mikrobiale dhe vlerësohen të kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave. Temperatura e ujit varion 22-28°C.

Tabela 19: Plazhet e Dhërmiut dhe Drimadhes.Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare të larges sipas kategorive, për periudhën 2016 - 2022 (e shprehur në %).

Kategoritë	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A - Cilësi e shkëlqyer	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
B - Cilësi e mirë	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%

Plazhi e Dhërmiut dhe Drimadhes për vitin 2022, cilësia e ujërave i përket kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave, në 100 % të rezultateve, dhe është e njëjtë me periudhën e viteve më parë krahasuar me vitin 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Këto plazhe vlerësohen të kategorisë A-Cilësi e shkëlqyer.

Plazhi i Jalës

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Plazhi Jalë Djabat	15	12	A	100%- Cilësi e shkëlqyer
2	Plazhi Jalë Majtas	32	18	A	

Plazhet e Jalës gjatë 2022 pas përpunimit (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), vlerësohen se i përket kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave, nuk kanë ngarkesa mikrobiale. Temperatura varion nga nga 22-28°C.

Kategoritë	2020	2021	2022
A - Cilësi e shkëlqyer	100%	100%	100%
B - Cilësi e mirë	0%	0%	0%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%

Tabela 20: Plazhet e Jalës.Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare të larges sipas kategorive, për periudhën 2016 - 2022 (e shprehur në %).

Plazhet e Jalës në tre vitet e fundit 2020,2021 dhe 2023, i përket kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave.

Plazhi Livadhes

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Livadhe 1	26	31	A	100%- Cilësi e shkëlqyer
2	Livadhe 2	14	9	A	
3	Livadhe 3	19	20	A	

Plazhet e Livadhes gjatë 2022 pas vlerësimit për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal, rezulton se i përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave, pra pa ngarkesa mikrobiale. Temperatura varion 22-28°C.

Tabela 21: Plazhi i Livadhes : Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare të larjes sipas kategorive, për periudhën 2020 – 2022 (e shprehur në %).

Kategoritë	Viti 2021	Viti 2022
A-Cilësi shumë e mirë	100%	100%
B - Cilësi e mirë	0%	0%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%

Plazhet e Livadhes në dy vitet e fundit 2021, 2022 që monitorohen, janë të Kategorisë A-Cilësi e shkëlqyer. Pa ngarkea mikrobiale.

Plazhi i Himarës

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Himarë qendër	131	186	B	50% Cilësi e Shkëlqyer
2	Pas Shkëmbit	67	130	B	
3	Potam Alqi	29	16	A	50%-Cilësi e mirë
4	Hotel Likoka	18	14	A	

Sipas rezultateve analitike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), këto plazhe vlerësohen të Kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave për 2 pika monitorimi dhe të kategorisë B- Cilësi e mirë, 2 pika monitorimi. Temperatura varion 23-28°C.

Tabela 22: Plazhi i Himarës: Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare të larjes sipas kategorive, për periudhën 2016 – 2022 (e shprehur në %).

Kategoritë	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A - Cilësi e shkëlqyer	100%	100%	100%	100%	100%	75%	50%
B - Cilësi e mirë	0%	0%	0%	0%	0%	25%	50%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%

Për plazhin e Himarës për vitin 2022, 50 % e ujërave i përket kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave, pra ka ulje në krahasim me periudhën e viteve më parë vitet 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe kategorisë B – Cilësia e mirë e ujërave, në 50 % të tyre.

Plazhi i Qeparoit

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Qeparo majtas	44	40	A	100%- Cilësi e mirë
2	Qeparo djathtas	62	51	A	

Plazhet e Qeparoit gjatë 2022 pas përpunimit të rezultateve (për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), vlerësohen se i përkasin kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave, pa ngarkesa mikrobiale. Temperatura varion 23-28.5°C.

Tabela 23: Plazhi Qeparo. Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare të largjes sipas kategorive, për periudhën 2020 – 2022 (e shprehur në %).

Kategoritë	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A-Cilësi shumë e mirë	100%	100%	100%
B - Cilësi e mirë	0%	0%	0%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%

Në tre viet e fundit 2020, 2021 dhe 2022, të gjitha stacionet e plazhit të Qeparoit janë të Kategorisë A-Cilësi e shkëlqyer.

Plazhi i Borshit

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Borshi Djathtas	97	99	A	100%- Cilësi e shkëlqyer
2	Borshi në mes	164	95	A	
3	Borshi Majtas	138	98	A	

Cilësia e ujrave (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), për pikat në plazhin e Borshit për vitin 2022, vlerësohet A-Cilësi e shkëlqyer për të gjitha pikat e monitorimit. Temperatura varion nga 23-28.5°C.

Tabela 24: Plazhi i Borshit: Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare të largjes sipas kategorive, për periudhën 2016 – 2022 (e shprehur në %).

Kategoritë	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A - Cilësi shumë e mirë	100%	100%	100%	100%	100%	66.7%	100%
B - Cilësi e mirë	0%	0%	0%	0%	0%	33.3%	0%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%

Për plazhin e Borshit edhe për vitin 2022, cilësia e ujërave i përket kategorisë A-Cilësi e shkëlqyer 100%, pa ngarkesa mikrobiale. Vërehet rritje e cilësisë së ujërave të plazheve Borsh në krahasim me vitin e kaluar.

Plazhi i Lukovës

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Lukova Djathtas	49	49	A	100%- Cilësi e shkëlqyer
2	Lukova në mes	77	77	A	
3	Lukova Majtas	80	74	A	

Plazhet e Lukovës gjatë 2022 (pas vlerësimit për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), rezultojnë se i përket kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave. Temperatura varion nga 23-28.5°C.

Tabela 25: Plazhi i Lukovës. Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare të larjes sipas kategorive për periudhën 2020 – 2022 (e shprehur në %).

Kategoritë	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A-Cilësi shumë e mirë	100%	100%	100%
B - Cilësi e mirë	0%	0%	0%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	0%

Plazhi i Lukovës për periudhën 2020 -2022 vlerësohet se i përket kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave.

Plazhi i Sarandës

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Plazhi Limion	200	119	B	50% - Cilësi e mirë
2	Plazhi Pllaka	226	124	B	
3	Plazhi i Ri	227	294	D	
4	Plazhi i Fëmijëve	234	196	B	50%-Cilësi e keqe
5	Hotel Grand	499	344	D	
6	Kanali i Çukës	436	277	D	

Në Plazhin e Sarandës, për vitin 2022, numri i stacioneve të kategorisë B- Cilësi e mirë të ujërave, është 3 pika monitorimi që përfaqësojnë 50% e tyre, dhe në kategorinë D- Cilësi e keqe të ujërave ,3 pika monitorimi 50% e tyre. Temperatura varion nga 24-28.5°C.

Tabela 26: Plazhi i Sarandës. Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare të larjes sipas kategorive, për periudhën 2016-2022 (e shprehur në %)

Kategoritë	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A - Cilësi e shkëlqyer	50%	83%	83%	83%	83%	33.4%	0%
B - Cilësi e mirë	33%	0%	17%	0%	17%	50%	50%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%	0%	17%	0%	16.6%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	17%	17%	0%	0%	0%	0%	50%

Për plazhin e Sarandës, për vitin 2022, ujërat e kategorisë A -Cilësi e shkëlqyer janë në ulje krahasuar me 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Numri i stacioneve të kategorisë B- Cilësisë së mirë të ujërave, për vitin 2022 është e rritur në krahasim me vitin 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 dhe e barabartë me vitin 2021.

Numri i stacioneve të kategorisë C - Cilësi e mjaftueshme, për vitin 2021 është e ulur në krahasim me vitin 2019 dhe 2021 dhe është njësoj me 2016, 2017, 2018 dhe 2020.

Numri i stacioneve të kategorisë D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme, për vitin 2022 është rritur në krahasim me vitin 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Plazhi i Ksamilit

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 250	IE 95% - Norma 100	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Plazhi Rilindja	183	98	A	67%-Cilësi e shkëlqyer
2	Plazhi Bora-Bora	204	289	D	
3	Plazhi Kështjella	159	87	A	33%- Cilësi e keqe

Sipas rezultateve bakteriologjike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), këto plazhe vlerësohen të kategorisë A- e shkëlqyer 2 pika monitorimi dhe të Kategorisë D- Cilësisë së keqe pra me ngarkesë mikrobiale.1 pikë monitorimi (plazhi Bora Bora). Temperatura varion nga 24-28.5°C.

Tabela 27: Plazhi i Ksamilit. Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare të larjes sipas kategorive, për periudhën 2020-2022 (e shprehur në %)

Kategoritë	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A-Cilësi shumë e mirë	100%	100%	67%
B - Cilësi e mirë	0%	0%	0%
C - Cilësi e mjaftueshme	0%	0%	0%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	0%	33%

Plazhin e Ksamilit për vitin 2022, ujërat e kategorisë A -Cilësi e shkëlqyer janë në ulje krahasuar me 2020 dhe 2021.

Numri i stacioneve të kategorisë D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme, për vitin 2022 është rritur në krahasim me vitin 2020 dhe 2021.

Plazhi Lin dhe Pogradec

Nr. Stacioneve	Vendi	FC 90% - Norma 500	IE 95% - Norma 200	Kategoria	Përqindja e stacioneve %
1	Lin Hotel-Resort Relaks	30	23	A	38%- Cilësi e shkëlqyer
2	Resort Komplex Lyhnida	535	447	C	
3	Dogana – pika e Molit	107	161	A	13% - Cilësi e mirë
4	Hotel Enkelana (Ish Turizmi i vjetër)	654	504	D	
5	Hotel 1 Maj	696	753	D	25% - Cilësi e mjaftueshme
6	Tushemisht Hotel Millenium	152	126	A	
7	Hotel Depo (Kompleksi Ermano)	399	278	B	25%-Cilësi e keqe
8	Voloreka	408	409	C	

Sipas rezultateve bakteriologjike (vlerësimi për prani të mikroorganizmave E. Coli dhe S. Fecal), këto plazhe vlerësohen të kategorisë:

A- Cilësi e shkëlqyer 3 pika monitorimi,

B- Cilësi e mirë 1 pikë monitorimi,

C- Cilësi e mjaftueshme 2 pika monitorimi,

D- Cilësi e keqe 2 pika monitorimi, Hotel

Enkelana (Ish Turizmi i vjetër) dhe Hotel 1 Maji.

Numri i stacioneve të kategorisë D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme, për vitin 2022 është ulur ndjeshëm në krahasim me vitin 2021. Temperatura varion nga 18-25,5°C.

Tabela 28: Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare të larjes sipas kategorive, për periudhën 2016-2022 (e shprehur në %) Plazhi Lin, Pogradec

Kategoritë	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A-Cilësi shumë e mirë	50%	12.5%-	38%
B - Cilësi e mirë	37.5	12.5%-	13%
C - Cilësi e mjaftueshme	12.5	12.5%-	25%
D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	0%	62.5%-	25%

Plazhi i Ksamilit për vitin 2022, ujërat e kategorisë A -Cilësi e shkëlqyer, janë në rritje krahasuar me 2021 por në ulje krahasuar me 2020.

Numri i stacioneve të kategorisë B- Cilësisë së mirë të ujërave, për vitin 2022 është e rritur lehtësisht në krahasim me vitin 2021, por është ulur në krahasim me 2020.

Numri i stacioneve të kategorisë C - Cilësi e mjaftueshme, për vitin 2021 është e rritur në

krahasim me vitin 2020 dhe 2021 dhe 2021 dhe është njësoj me 2016, 2017, 2018 dhe 2020.

Numri i stacioneve të kategorisë D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme, për vitin 2022 është ulur në krahasim me vitin 2021.

Tabela 29: Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes, numri i stacioneve për secilën kategori.

KATEGORIA	A-Cilësi e shkëlqyer	B-Cilësi e mirë	C-Cilësi e mjaftueshme	D-Cilësi e keqe Masa të menjëherëshme
STACIONE	83	24	5	11
%	67.5%	19.5%	4.1%	8.9%

Tendenca në vite

Numri i stacioneve të kategorisë A- Cilësisë shumë të mirë, për plazhet e monitoruara për vitin 2022 është ulur në krahasim me vitet 2017, 2018, 2019 dhe 2020 por është rritur në krahasim me vitet 2016 dhe 2021.

Numri i stacioneve të kategorisë B- Cilësisë së mirë për vitin 2022 është ulur në krahasim me vitet 2016 dhe 2021 por është rritur në krahasim me vitet 2017, 2018, 2019 dhe 2020.

Numri i stacioneve të kategorisë C- Cilësisë së mjaftueshme për vitin 2022 është rritur në krahasim me vitet 2018, 2020 por është ulur në krahasim me vitet 2016, 2017, 2019 dhe 2021.

Numri stacioneve të kategorisë D- Cilësisë e keqe për vitin 2022 është rritur në krahasim me 2018, 2019 dhe 2020 por është më e ulur në krahasim me 2016, 2017 dhe 2021.

Tabela 30: Tabela 4. Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare të larjes sipas kategorive, për periudhën 2016-2022 (e shprehur në %)

Cilësia	2016		2017		2018		2019		2020		2021		2022	
	%	Stacione	%	Stacione	%	Stacione	%	Stacione	%	Stacione	%	Stacione	%	Stacione
A-Cilësi e shkëlqyer	53	52	68	53	82.4	89	89	106	89.9	107	51	60	67.5	83
B-Cilësi e mirë	23	23	15	12	13	14	2.5	3	5	6	32	38	19.5	24
C-Cilësi e mjaftueshme	9	9	6	5	0.9	1	6	7	0.9	1	8	10	4.1	5
D-Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	15	15	10	8	3.7	4	2.5	3	4.2	5	9	11	8.9	11

1.2.3 Ndikimi i shkarkimeve urbane në cilësinë e ujërave bregdetare

Vlerësimi i ndikimit të shkarkimeve urbane në cilësinë e ujërave bregdetare në qytetet Durrës, Vlorë dhe Sarandë, është kryer sipas normave të shkarkimeve të lëngëta urbane nga impiantet e trajtimit, të përcaktuara në Legjislacionin Shqiptar VKM Nr.177 datë 31.03.2005, që janë të njëjta me ato të Direktivës së Komunitetit Evropian.




Tabela. 31 Normat e shkarkimeve të lëngëta urbane

Nr	Parametrat	Perqendrimi
1	Nevoja biokimike per oksigjen (NBO5)	25 mg/l O2
2	Nevoja kimike per oksigjen (NKO)	125 mg/l O2
3	Lenda totale ne suspension	35 mg/l
4	Fosfori total	1 mg P/l

Përzgjedhja e stacioneve të monitorimit është bazuar sipas skemës ku kolektori shkarkues përfaqëson burimin ndotës dhe pas shkarkimit në mjedisin pritës, në det në distancën 10 m. Sipas kësaj skeme vlerësohet cilësia e ujërave të shkarkimeve në pikën e shkarkimit (kolektorë ose stacione pompimi) dhe impakti i tyre në cilësinë e ujërave bregdetare

Stacionet e monitorimit janë paraqitur në formë tabelare si më poshtë:

Nr.	Kodi i kampionit	Zona bregdetare	Vendndodhja	Pika e shkarkimit
1.	Dr1	Durrës	Porto Romano	Në qytetin e Durrësit dhe Vlorës ujërat urbane shkarkohen nëpërmjet stacioneve të pompimit. Ujërat urbane shkarkohen në det, në zonën e Porto Romanos (Spitalle),
2.	Dr3	Durrës	Curilat	
3.	Dr4	Durrës	Kanali Plepa-Shkëmbi i Kavajës	
4.	V1	Vlorë	Hidrovori Vlorë-Pylli i Sodës	Në qytetin e Vlorës ujërat urbane shkarkohen nëpërmjet stacioneve të pompimit. Ujërat urbane shkarkohen në det në zonën e Pyllit të Sodës
5.	V3	Vlorë	Plazhi i Ri - Vlorë	
6.	V4	Vlorë	Shkolla e Marinës	
7.	S1	Sarandë	Plazhi i qytetit-Tek porti	Në qytetin e Sarandës,ujërat urbane shkarkohen në kanalën e Çukës e më pas në det.
8.	S2	Sarandë	Bar Riviera në qendër të qytetit	

Nevoja Biokimike për Oksigjen dhe Nevoja Kimike për Oksigjen



Nevoja Biokimike për Oksigjen është një nga treguesit më të rëndësishëm në vlerësimin e ndotjes organike të ujërave sipërfaqësore si pasojë e shkarkimeve urbane të patrajuara.

Përmbajtja e Nevojës Biokimike për Oksigjen tejkalon normën e lejuar sipas VKM 177 datë 31.03.2005 në stacionet Dr1 - Hidrovori, V1 - Në det pas hidrovorit tek Pylli i Sodës



Siç vihet re edhe nga grafiku përmbajtja e NKO është nën vlerën e lejuar, për të gjitha stacionet e monitorimit, ku vlera më e lartë është matur në stacionin Dr1 - Hidrovori Durrës në vlerën 93 mg/l por nën normën e lejuar (< 125mg/l).

Përmbajtja e fosforit total është vlerësuar mbi normën e lejuar vetëm në stacionin hidrovori Vlorë- Pylli i Sodës

Lënda e ngurtë pezull dhe përmbajtja e fosforit total



Përmbajtja e lëndës së ngurtë pezull rezulton mbi normën e lejuar në të gjitha stacionet e monitoruara në Durrës, Vlorë dhe Sarandë.



Referuar rezultateve, vlerësohet se stacioni në hidrovorin Vlorë-Pylli i Sodës klasifikohet me ndotje më të lartë. Kjo tregon se ndikimi i shkarkimeve urbane në këtë zonë është më i lartë.

Tendenca ndër vite

Për stacionin Dr1 kemi tendencë në rritje krahasuar me vitin 2021 për parametrat NBO_5 ,

NKO dhe lënda pezull, ndërsa përmbajtja e P-total është ulur. Në stacionin Dr3 kemi rritje të përmbajtjes së lëndës pezull, P-total dhe vihet re ulje e parametrave NKO dhe NBO_5 . Referuar rezultateve për stacionin Dr4 shihet një tendencë në ulje e përmbajtjes së NBO_5 , NKO dhe P-total ndërsa lënda pezull ka një rritje të lehtë.

Tabela 32. Tendencat në vite 2020-2022

Kodi	Viti 2020				Viti 2021				Viti 2022			
	NBO ₅ mg/l	NKO mg/l	Lënda pezull mg/l	P-to- t a l mg/l	NBO ₅ mg/l	NKO mg/l	Lënda pezull mg/l	P-to- t a l mg/l	NBO ₅ mg/l	NKO mg/l	Lënda pezull mg/l	P-to- t a l mg/l
Dr1	29	48	71.2	0.64	44	81	22.7	2.4	55	93	63.9	0.84
Dr3	33	55	200	0.017	5	9	8.2	0.007	4	8	43.2	0.008
Dr4	20	31	60.4	0.16	25	42	22.33	0.814	22	36	24.8	0.33
V1	38	64	25.6	2.57	52	90	62.9	0.85	41	68	91.8	1.66
V2	23	38	53.66	0.94	32.5	55.5	53.1	0.63	-	-	-	-
V3	15	25	78.44	0.016	11	19	71.6	0.016	3	5	60.4	0.013
V4	10	17	103.76	0.022	4	8	244	0.008	3	5	52.6	0.001
S1	4	8	48.1	0.084	29	48	44.6	0.015	5	7.5	56	0.084
S2	6	9	64.58	0.018	25	41	48.0	0.015	5	8.5	57.4	0.017
Norma	25	125	35	1	25	125	35	1	25	125	35	1

Në stacionin e Vlorë- Pylli i Sodës vlerësohet përmirësim i përmbajtjes së P-total, NBO₅ dhe NKO gjatë 2022 krahasuar me 2021, ndërsa për lënda pezull vihet re tendencë në rritje. Në stacionet V3 dhe V4 kemi tendencë në ulje për të gjithë parametrat e matur. Përsa


i përket stacioneve të Sarandës S1 dhe S2 vlerësohet tendencë në ulje për parametrat NKO dhe NBO₅ dhe vihet re tendencë në rritje për parametrat lënda pezull dhe P-total.

1.2.4 Cilësia e ujërave bregdetare në Dhërmi, Borsh, Lukovë, Zvërnec dhe Ksamil




Vlerësimi i gjendjes së cilësisë të ujërave në zonat bregdetare është kryer sipas Direktivës Kuadër të Ujit, nëpërmjet përcaktimit të përmbajtjes së parametrave fiziko - kimikë në zonat bregdetare si; oksigjeni i tretur, nitritet, amonjaku, orto - fosfatet.

Nr.	Kodi i kampionit	Emërtimi i stacionit	Vendndodhja	Koordinatat gjeografike
1.	Dhe	Zonë bregdetare	Në mes të plazhit kryesor	N40.083187 E19.380408
2.	Hi	Zonë bregdetare	Plazhi në mes të qytetit të Himarës	N40.060153 E19.443742
3.	Bo	Zonë bregdetare	Në det 100 m larg bregut	N40.023901 E19.503488
4.	Lu	Zonë bregdetare	Në det 100 m larg bregut	N39.582651 E19.543780
5.	Ks	Zonë bregdetare	Në det 100 m nga bregu, në mes të plazhit	N39.462753 E20.000157
6.	Zv	Zonë bregdetare	Në det 100 m nga bregu, në mes të plazhit	N40.294703 E19.251227
7.	Shgj1	Zonë bregdetare	Tek porti jashtë argjinaturës	N41.4841 E19.3533
8.	Shgj2	Zonë bregdetare	Në fund të plazhit, afër Kunes	N41.4741 E19.3680
9.	Ve1	Zonë bregdetare	Kompleksi "La Maroja"	N41.5653 E19.3615
10.	Ve2	Zonë bregdetare	100 m larg ujë këmbimit det - lagunë	N41.5435 E19.2625




Ky parametër është matur in - situ dhe nga vlerat mesatare të ekspeditave të realizuara ujërat janë të ngopura me oksigjen të cilat variojnë nga 10.3 – 13 mg/l.


Siç vihet re edhe nga grafiku, ku janë paraqitur vlerat mesatare të ekspeditave të realizuara



Prania e nitriteve në ujërat bregdetare të monitoruara në këto stacione është vlerësuar në vlera shumë të ulëta, nën limitin e dedektimit.



Siç vihet re edhe nga grafiku, ku janë paraqitur vlerat mesatare të ekspeditave të realizuara vihet re përmbajtje në vlera shumë të ulëta që variojnë nga 0.06 – 0.33 mg/l (< 1 mg/l).



Në stacionet e monitoruara vlerësojmë një cilësi të mirë të ujërave bregdetare për të gjithë parametrat fiziko - kimikë.

Tendenca

Vlerësohet përmirësim krahasuar me vitin 2021, i cilësisë të ujërave bregdetare të Dhërmiut, Himarës, Borshit, Lukovës, Ksamilit dhe Zvernecit. Ndërkohë që vihet re

përkeqësim i cilësisë të ujërave të Shëngjinit dhe Velipojës referuar vlerave të përmbajtjes së amonjakut. Megjithatë krahasuar me vitin 2020 kemi një tendencë të përmirësimit të gjendjes gjatë viteve 2021-2022.

Tabela 33. Vlerësimi i gjendjes për periudhën 2020-2022

Nr.	Kodi	Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022		
		Parametrat (mg/l)			Parametrat (mg/l)			Parametrat (mg/l)		
		O ₂ i tretur	N-NH ₄	P-PO ₄	O ₂ i tretur	N-NH ₄	P-PO ₄	O ₂ i tretur	N-NH ₄	P-PO ₄
1.	Dhe	11.33	0.56	0.01	12	0.12	0.013	12	0.13	0.004
2.	Hi	11.77	0.11	0.01	12	0.27	0.01	12.7	0.08	0.004
3.	Bo	11.60	0.30	0.04	12	0.25	0.006	12	0.11	0.00
4.	Lu	12	0.17	0.012	12	0.14	0.007	12	0.13	0.002
5.	Ks	12	0.35	0.008	12	0.18	0.006	13	0.11	0.001
6.	Zv	10.7	0.35	0.013	11.7	0.30	0.004	13	0.06	0.008
7.	Shgj1	11.5	0.38	0.025	11	0.18	0.004	11	0.26	0.006
8.	Shgj2	10.8	0.41	0.027	11	0.18	0.005	11	0.33	0.006
9.	Ve1	11.5	0.43	0.009	13	0.19	0.007	10	0.25	0.006
10.	Ve2	9.5	0.65	0.028	13	0.09	0.012	11	0.24	0.006

1.2.5 Cilësia e ujërave të Lagunës së Butrintit, Nartës dhe Karavastasë

Lagunat të cilat kanë komunikim me detin janë habitate me kripshmëri të lartë dhe karakteristikat e lagunave bregdetare janë si vijon:

Lagunat e kripura bregdetare janë trupa ujore me hidrodinamikë të ulët.

Habitati kryesor i lagunave bregdetare është

sub - litoral.

Kushtet e mjedisit janë ekstremisht të ndryshueshme, në kohë dhe hapësirë, ku ndryshime të tilla janë unike për lagunat.

Sipas direktivës kuadër të ujit, vlerësimi për Lagunat i referohen normave limite të liqeneve.

Tabela 34. Vlerat limite të cilësisë së ujërave të liqeneve sipas DKU

Parametrat	Njësia matëse	Vlerat limite për përcaktimin e gjendjes		
		Oligotrofik	Mezotrofik	Eutrofik
Transparenca	m	5-10 (max 15-20)	1-2 (max.5-10)	<1 (max 2-3)
Nevoja Kimike për Oksigjen (NKO)	mg O ₂ /l	1-2	8-9	20-65
Nevoja Biokimike për Oksigjen(NBO ₅)	mg O ₂ /l	<3	3-5,5	5,5-14
Nitrate (NO ₃ -N)	mg N/l	<1	<1	>2
Fosfor total (P- total)	µg P/l	4-10	10-35	35-100

Tabela 35. Klasifikimi i ujërave për metalet e rënda

Nr.	Parametri i matur	Simboli	Njësia	Klasifikimi Direktiva e Kuadër të Ujit (75/440/EEC)		
				A1 E mirë	A2 E moderuar	A3 E keqe
1.	Arsenik	As	µg/l	<50	50	>100
2.	Kadmium	Cd	µg/l	<5	5	>5
3.	Bakër	Cu	µg/l	<50	100	>1000
4.	Plumbi	Pb	µg/l	<50	50	>50
5.	Mërkuri	Hg	µg/l	<1	1	>1

Laguna e Butrintit

Ndodhet në juglindje të Sarandës dhe në afërsi të Parkut Kombëtar të Butrintit, me një sipërfaqe prej rreth 16.3 km². Kjo lagunë është zonë e cila përdoret për kultivimin e midhjeve. Vlerësimi kryhet në një stacion kampionimi me dy thellësi, përkatësisht 0 m dhe 5 m thellësi për parametrat fiziko-kimike, gjendjes trofike dhe metaleve të rënda për të parë ndikimet që mund të ketë dheu, sedimentet dhe/ose faktorë të tjerë në çlirimin dhe transportin e metaleve të rënda.

Metalet e rënda hyjnë në laguna përmes disa rrugëve, kryesisht për shkak të proceseve pedogjeologjike si dhe aktivitetit njerëzor. Vlerësimi i gjendjes së synon të përcaktojë sasinë e origjinës, shpërndarjes hapësinore dhe nivelin e ndotjes së shkaktuar nga metalet e rënda në tokë, sedimente, ujë dhe midhje të lagunës së Butrintit.

Temperatura e ujit varion nga 16.2 – 30.2°C dhe oksigjeni i tretur i matur in – situ varion

nga 7.2 – 10 mgO/l ku dëshmon që ujërat janë të pasura me oksigjen. Vlera mesatare e transparencës së matur është 4.3 m dhe referuar këtij treguesi vlerësojmë se cilësia është mezotrofike. Përsa i përket përmbajtjes së nitrateve, vlera mesatare e dy stacioneve të monitorimit është 0.45 mg/l (<1 mg/l) duke i klasifikuar ujërat me cilësi oligotrofike. Vlerat mesatare të matura të parametrave, nevoja kimike për oksigjen 8.5 mg/l dhe nevojës biokimike për oksigjen 5 mg/l, e klasifikojnë lagunën me cilësi mezotrofike. Vlera mesatare e përmbajtjes së fosforit total në të dy stacionet me thellësi të ndryshme përkatësisht 0 m dhe 5 m thellësi është 0.019 mg/l ku i klasifikojnë këto ujëra me cilësi mezotrofike

Referuar të dhënave vlerësojmë se ujërat e lagunës së Butrintit bazuar në parametrat e mësipërm janë me cilësi mezotrofike.

Toksiciteti i metaleve të rënda në mjediset

ujore ndikohet nga cilësia e ujit, si temperatura, fortësia e ujit, pH, përqendrimi i lëndës organike të tretur etj.
Rezultate e vlerësuara të metaleve të rënda

në Lagunën e Butrintit dhe krahasimi me normat e përcaktuara për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 36. Klasifikimi i cilësisë të ujërave sipas DKU

Nr.	Parametri imatur	Simboli	Njësia	Klasifikimi Direktiva e Kuadër të Ujit (75/440/EEC)			Stacionet	
				A1 E mirë	A2 E moderuar	A3 E keqe	Laguna Butrintit 0 m	Laguna Butrintit 5 m
1.	Arsenik	As	µg/l	<50	50	>100	3	5
2.	Kadmium	Cd	µg/l	<1	5	>5		
3.	Bakër	Cu	µg/l	<50	100	>1000	8.0185	7.5875
4.	Plumbi	Pb	µg/l	<50	50	>50		
5.	Mërkuri	Hg	µg/l	<1	1	>1	n.d	n.d

Shënim: n.d-nuk dedektohet

Komponimet e Pb mund të hyjnë në mjedis gjatë proceseve të përpunimit të minierave, rafinimit etj, duke dëmtuar më pas organizmat e gjallë nga bioakumulimi ose biozmadhimi përmes zinxhirit ushqimor. Vlerat e gjetura të **Cd** dhe **Pb** janë më të larta se vlera referuese sipas DKU, dhe kjo vjen për shkak të burimeve antropogjene duke përfshirë pesticidet plehëruese të përdorura në aktivitetet bujqësore, dhe rrjedhjet që vijnë nga zona urbane e Ksamilit. Vlerat shumë të larta, dëshmojnë një shkallë ndotjeje të lartë duke e klasifikuar lagunën e Butrintit në **Klasën A3**

- **Gjendje e keqe**, ku duhet të merren masa të menjëhershme.

Laguna Nartë dhe Karavasta

Laguna e Nartës, një ndër lagunat më të mëdha në vendin tonë, ndodhet në veri-perëndim të qytetit të Vlorës. Po ashtu, Laguna e Karavastës është një nga lagunat më të mëdha në detin Mesdhe dhe një nga zonat më të rëndësishme ekonomike dhe ekologjike në pjesën jugore të Shqipërisë. Rezultatet e vlerësuara të metaleve të rënda në Vlorë-Karavasta dhe krahasimi me normat e përcaktuara nga DKU për vitin 2022 paraqiten si vijon:

Tabela 37 : Klasifikimi i cilësisë të ujërave të lagunave Nartë dhe Karavasta sipas DKU

Parametri	Simboli	Njësia	Klasifikimi Direktiva e Kuadër të Ujit (75/440/EEC)			Stacionet			
			A1 E mirë	A2 E moderuar		Ura e Manastir-it- Nartë	Kanali lidhës det-lagunë Nartë	Laguna Karavastas	Kanali lidhës det-lagunë Karavasta
Arsenik	As	µg/l	<50	50		n.d.	n.d.	n.d.	n.d.
Kadmium	Cd	µg/l	<1	5					
Bakër	Cu	µg/l	<50	100		13.97	9.24	12.22	5.6375
Plumbi	Pb	µg/l	<50	50					
Mërkuri	Hg	µg/l	<1	1		n.d.	n.d.	n.d.	n.d.

Shënim: n.d- nuk dedektohet

Në stacionet e monitoruara u vërejt tejkallim të vlerës limit për parametrat **Kadium dhe Plumb**.

Niveli mesatar i **Kadiumit** në mostrat e ujit varion nga 209.8 – 265 µg/l. Një vlerë shumë e lartë që dëshmon një shkallë ndotjeje të lartë duke e klasifikuar në **Klasën A3- Gjendje e keqe**, ku duhet të merren masa të menjëhershme (> 5 µg/l).

Tejkallim të normës kemi edhe për treguesin e

Plumbit në të katërt stacionet e monitorimit të lagunave Nartë dhe Karavasta, ku gjendja paraqitet me një ndotje të lartë e klasifikuar **Klasa A3- Gjendje e keqe**, ku vlerat e Pb variojnë nga 3827.83 – 4152.365 µg/l ndikuar nga aktivitetet e peshkimit dhe Kanali i Zharneçit, pra shkarkimi i të gjitha ujërave të zeza.

Niveli i Plumbit duhet të monitorohet gjithmonë sepse është një helm akumulues toksik për organizmat e gjallë.

Tendenca në vite

Kemi përmirësim të gjendjes trofike në Lagunën e Butrintit duke kaluar nga cilësi eutrofike në vitin 2021 në cilësi mezotrofike në vitin 2022.

	2020	2021	2022
Laguna e Butrintit	Cilësi mezotrofike me tendencë eutrofie	Cilësi eutrofike	Cilësi mezotrofike

1.3. Vlerësimi i gjendjes

1.3.1 Monitorimi mikrobiologjik i plazheve

Gjatë sezonit veror të vitit 2022 u konstatua se ka pasur një fluks të shtuar pushuesish pothuajse gjatë gjithë bregdetit të Shqipërisë, veçanërisht në muajt Korrik e Gusht. Në mënyrë të veçantë në Ksamil ka pasur pushues të shumtë gjatë gjithë sezonit turistik.

Sipas rezultateve mikrobiologjike vlerësohen të cilësisë A- Cilësi e shkëlqyer, plazhet e Velipojës, Shëngjinit, Tales, Spilles, Semanit, Darëzezës, Divjakës, Zvërnecit, Lukovës, Borshit, Qeparoit, Livadhes, Jalës, Dhërmiut, Drimadhes dhe Palasës.

- 1) Problematike mbeten disa pika monitorimi në Durrës, që përfaqësojnë plazhet Zhiron, tek Plepat pas kanalit dhe Shkëmbi i Kavajës. Në Vlorë, 2 pika monitorimi, që përfaqësojnë plazhet Shkolla e Marinës dhe Plazhi i Ri. Në Sarandë, 4 pika monitorimi që përfaqësojnë zonat Plazhi i Ri, Hotel Grand, Kanali i Çukës dhe plazhi Bora Bora në Ksamil. Në Pogradec 2 pika monitorimi që përfaqësojnë zonat

Hotel Enkelana (ish Turizmi) dhe Hotel 1 Maji.

- 2) Në këto pika konstatohen vlera të ndotjes mikrobike veçanërisht në seritë e katërt, të pestë, të gjashtë dhe të shtatë, që përfaqësojnë pikun e sezonit turistik. Në këto pika monitorimi nga vlerësimi higjieno-sanitar u konstatua prani e shkarkimeve të ujërave urbane të pa trajtuara në ujërat pritëse në mënyrë direkte. Gjatë ekspertizave u konstatua prezencë e afishimit të rregullave për zbatim nga pushuesit, dhe ky është një përmirësim i cili vihet re në plazhet tona gjatë këtij sezoni turistik.
- 3) Shkaktar kryesor të ndotjes në ujërat bregdetar të larjes mbeten shkarkimet e ujërave urbane të patrajtuara në ujërat pritëse bregdetare në mënyrë direkte dhe indirekte, të cilat shkaktajnë ndotje të këtyre ujërave.
- 4) Gjatë inspektimeve higjieno-sanitare në terren, u konstatua se në Velipojë tek Laguna e Vilunit është kanali i lagunës. Në Durrës ka shkarkime në det nga kanali Plepa. Në Pogradec u konstatuan rrjedhje ujërash të

kanaleve në zona afër "Hotel 1 Maji" dhe shkarkim i ujërave të trajtuara në liqen në Volorekë. Gjithashtu pranë Hotel Enkelana (skena e koncerteve) u konstatuan rrjedhje ujërash në kanal in që derdhet në liqen. Në Vlorë tek Shkolla e Marinës, vazhdon të jetë problematik prezenca e kanaleve të derdhjeve urbane.

- 5) Një kanal i hapur që përshkon rërën e derdhet në det ndodhet edhe në zonën afër Plazhit të Ri. Vazhdon të derdhë ujërat e tij në det kanali i Çukës

në Sarandë.

- 6) Subjektet private në vazhdimësi kanë marrë masa në drejtim të pastrimit të rërës së plazheve, vendosjen e nyjeve higjieno-sanitare, vendosjen e dusheve publike dhe kullave të vrojtimit.
- 7) Në disa plazhe të vendit (Seman, Darëzezë, Divjakë) duhet të përmirësohen kushtet higjieno-sanitare si në plazhet publike dhe në plazhet që administrohen nga privatët.

Vlerësimi i mëposhtëm është kryer duke marrë parasysh vlerën mesatare për secilin plazh.

Cilësi e keqe



e kuqe

Cilësi e mirë



blu

Cilësi e mjaftueshme







e verdhe

Cilësi e shkëlqyer



jeshile

Plazhi	Vlerësimi	Shënime
Velipojë		
Shëngjin		
Tale		
Spille		
Seman		
Darëzezë		
Divjakë		
Durrës		Problematiche janë pikat: Zhiron, Plepat (pas kanal-it), Shkëmbi i Kavajës
Kavajë (Golem)		
Gjiri i Lalzit		
Qerret		
Zvërnec		
Lukovë		
Vlorë		Problematiche janë pikat : Shkolla e Marinës dhe Plazhi i Ri.
Orikum		
Borsh		
Qeparo		
Livadhe		
Jalë		
Sarandë		Problematiche janë pikat, Kanali i Çukës, Plazh i Ri, Hotel Grand
Dhërmi		
Drimadhe		

Palasë		
Ksamil		Problematic plazhi Bora-Bora
Himarë		
Lin, Pogradec		Problematiche janë pikat: Hotel Enkelana (ish Turizmi) dhe Hotel 1 Maji

1.3.2 Ndikimi i shkarkimeve urbane në cilësinë e ujërave bregdetare

Referuar rezultateve, vlerësohet se stacioni në hidrovorin Vlorë-Pylli i Sodës klasifikohet

Vlerësimi i mëposhtëm është kryer referuar vlerave mesatare për çdo stacion krahasuar në normat e shkarkimeve urbane.

me ndotje më të lartë duke vijuar me stacionin në Durrës në zonën e Porto-Romanos. Kjo tregon se ndikimi i shkarkimeve urbane në këto zona është më i lartë.

Cilësi e keqe



e kuqe

Cilësi e mirë



blu

Cilësi e mjaftueshme



e verdhë

Cilësi e shkëlqyer



jeshile

Kodi i kampionit	Zona bregdetare	Vendndodhja	Vlerësimi	Shënim
Dr1	Durrës	Porto Romano		
Dr3	Durrës	Currilat		
Dr4	Durrës	Kanali Plepa-Shkëmbi i Kavajës		
V1	Vlorë	Hidrovorin Vlorë-Pylli i Sodës		
V3	Vlorë	Plazhi i Ri - Vlorë		Kanë përmbajtje të lartë të lëndës pezull. Parametrat e tjerë janë brenda normave
V4	Vlorë	Shkolla e Marinës		
S1	Sarandë	Plazhi i qytetit-Tek porti		
S2	Sarandë	Bar Riviera në qendër të qytetit		

1.3.3 Cilësia e ujërave bregdetare në Dhërmi, Borsh, Lukovë, Zvernec dhe Ksamil

Në stacionet e monitoruara vlerësojmë një cilësi të mirë të ujërave bregdetare për të gjithë parametrat fiziko - kimikë.

Cilësi e keqe



e kuqe

Cilësi e mirë



blu

Cilësi e mjaftueshme



e verdhë

Cilësi e shkëlqyer



jeshile

Zona bregdetare	Vlerësimi	Shënime
Dhërmi		
Borsh		
Lukovë		
Zvernec		
Ksamil		

1.3.4 Cilësia e ujërave të Lagunës së Butrintit, Nartës dhe Karavastasë




Ujërat e lagunës së Butrintit janë me cilësi mezotrofike, e vlerësuar kjo për përmbajtjen e lartë organike.




Në lagunat e Butrintit, Nartës dhe Karavastasë, niveli i kadmiumit dhe plumbit është shumë i lartë. Kjo për shkak të ndikimit të ndotjes, hedhja e mbeturinave urbane, derdhja e ujërave të zeza të qytetit,

veprimtaritë industriale dhe bujqësore, që e rritin sasinë e kadmiumit dhe plumbit.

Ekziston mundësia e kontaminimit në këto ujëra në Laguna. Disa përqëndrime të larta të Pb, Cd, në ndarje të ndryshme të mjedisit të lagunave i atribuohen burimeve antropogjene duke përfshirë pesticidet e plehrave të përdorura në aktivitetet bujqësore dhe rrjedhjet që vijnë nga zonat urbane.

Vlerësimi i mëposhtëm është kryer referuar klasifikimit të lagunave për përmbajtjen e metaleve të rënda.

Cilësi e keqe		e kuqe
Cilësi e mjaftueshme		e verdhë
Cilësi e mirë		jeshile

Lagunat	Vlerësimi	Shënime
Butrint		Për shkak të përmbajtjes shumë të lartë të Cd dhe Pb. Parametrat Cu, As, Hg janë nën normë.
Nartë		
Karavasta		

1.4 Forcat shtytëse, presioni, gjendja, ndikimi dhe reagimi (DPSIR)

Duke përdorur kuadrin DPSIR i cili është propozuar dhe rekomanduar nga Agjencia Evropiane e Mjedisit (/AEM/EEA), tashmë jemi në gjendje të dallojmë forcat lëvizëse, presionet, gjëndjet, ndikimet dhe reagimet të cilat përmbyllin të gjithë kuadrin e lëvizjes dhe shpërndarjes së ujit në funksion të faktorëve natyrorë dhe atyre njerëzorë me të gjitha ndikimet e përfuara si rezultat i këtyre faktorëve. Kuadri DPSIR (**Driver-Pressure-State-Impact-Response**) ka filluar të adoptohet gjerësisht duke vepruar si një qasje e integruar për raportime mbi çështje të ndryshme.

Sipas DPSIR ka një zinxhir të lidhjeve shkakësore duke filluar me **“forcat lëvizëse/shtytëse” (D)** (sektorët ekonomikë, aktivitetet njerëzore) përmes **“presioneve” (P)** (emetimeve, mbeturinave) në **“gjëndjet” (S)** (fizike, kimike dhe biologjike) dhe

“impaktet” (I) në ekosistemet, shëndetin dhe funksionet e njeriut, që eventualisht çojnë në politikat e **“reagimit” (R)** (prioritetet, caktimin e objektivave, treguesit).

1.5 Kuadri ligjor

VKM Nr 1189 date 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit”

VKM Nr. 1172, datë 24.12.2020 Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 171, datë 27.03.2019, Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit, i ndryshuar.

VKM Nr.177 datë 31.03.2005, Normat e lejuara të shkarkimeve urbane nga impiantet e trajtimit.

1.6 Rekomandime:

Ujërat bregdetare


- ❖ Informimi i publikut mbi cilësinë e ujërave bregdetarë të larjes dhe vendosja e tabelave informuese në kohë reale në çdo pikë monitorimi.
- ❖ Rekomandohet informimi me shkrim i Pushtetit Lokal (Sarandë, Durrës, Vlorë, Pogradec) për praninë e kanaleve dhe derdhjen e tyre në det.
- ❖ Rekomandohet marrja e masave nga Pushteti Lokal për trajtimin e ujërave urbane para se ato të shkarkohen në det, kudo ku ka ujëra larës në zonat e kategorizuara të ndotura.
- ❖ Marrja e masave nga Pushteti Lokal për vendosjen e tualeteve publike si edhe shtimin e koshave të mbeturinave në plazhet publike.
- ❖ Marrja e masave nga Pushteti Lokal për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave inerte si

dhe mbeturinave urbane në plazhe.

- ❖ Vënia në funksionim me efikasitet të plotë dhe zgjerimi i kapaciteteve të Impianteve të Trajtitit të Ujërave Urbane që janë në efikasitet, dhe/ose ngritja e Impianteve të Trajtitit të Ujërave në zona të vogla banimi.

Lagunat

- ❖ Bazuar në rezultatet e këtij studimi, ne rekomandojmë metoda parandaluese të cilat do të përfshijnë, kontrollin dhe/ose aplikimin e trajtimit të efluentëve të derdhura në lagunë.
- ❖ Plani i veprimit duhet të jetë mjaftueshëm kompetent për të çliruar lagunën nga problemet me të cilat po përballë aktualisht, duke pasur parasysh rëndësinë e saj të madhe për komunitetet përreth.



KAPITULLI 2
ZHURMAT
MJEDISORE



KAPITULLI 2

NDOTJA NGA ZHURMAT

2.1.Çështjet që trajtohen

Zhurma shkaktohet nga një numër i madh burimesh të cilat janë natyrore por edhe të shkaktuara nga aktivitetet e shumta njerëzore. Sipas legjislacionit të OBSH (Organizata Botërore e Shëndetësisë), zhurma mjedisore përcaktohet si:

“Një tingull i jashtëm i padëshiruar dhe i dëmshëm, i shkaktuar kryesisht nga veprimtaritë njerëzore por edhe natyrore”

Zhurmat emetohen kryesisht nga:

1. Trafiku rrugor
2. Trafiku hekurudhor
3. Trafiku ajror
4. Veprimtaritë industriale
5. Fenomenet natyrore

Nga të gjitha këto veprimtari, njerëzit janë të ekspozuar në veçanti në zonat e banimit, në parqet publike, pranë shkollave, spitaleve, zonave dhe ndërtesave të tjera të ndjeshme nga zhurmat.

Ndotja nga zhurma përcaktohet si hyrja e zhurmës në ambientet e banuara, të brendshme ose ambientet e jashtëme, e tillë që të provokojë bezdi apo shqetësim gjatë pushimit dhe aktivitetëve të tjera njerëzore, e cila shkakton rrezik për shëndetin e njeriut, prishje të ekosistemit, prishje të të mirave materiale, interferon në përbërjen normale të ambientit.

Në vendin tonë shkaktari kryesor i emetimit të zhurmave është trafiku rrugor. Për këtë arsye është kryer monitorimi i zhurmave në trafik rrugor në disa nga qytetet kryesore të vendit tonë.

Monitorimi i zhurmave urbane është kryer nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në 43 pika monitorimi në qytetet Tiranë, Vlorë, Fier, Sarandë, Korçë, Berat, Kukës, Pogradec, Shkodër, Lezhë dhe Gjirokastrë. Në këto qytete është realizuar matja e nivelit të zhurmave LAeq, i cili është niveli i vazhduar ekuivalent i presionit akustik të ponderuar (A), të prodhuar nga të gjithë burimet e zhurmave

që ekzistojnë në një vënd të caktuar dhe gjatë një kohe të caktuar.

Trafiku rrugor është një fenomen i karakterit të rastësishëm, monitorimi i zhurmave të prodhuara prej tij është kryer për një kohë matje 24 orëshe. Niveli ekuivalent i presionit akustik LAeq ditën llogaritet nga ora 06⁰⁰-23⁰⁰ dhe LAeq për periudhën e natës nga ora 23⁰⁰- 06⁰⁰. Matjet janë kryer në përputhje me kushtet meteorologjike dhe me normat e CEI 29-10 dhe EN 60804/1994.

2.2 Gjendja dhe tendenca

Vlerësimi i gjendjes së ndotjes nga zhurmat kryhet sipas normave të rekomanduara referuar Ligjit Nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” të cilat janë në përputhje me standartet e OBSH

Ligji ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit nga zhurmat, duke përcaktuar mënyrën e shmangies, masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë.

Vlerat limite të zhurmave janë përcaktuar për çdo efekt të shëndetit, duke përdorur nivelin më të ulët të zhurmës që prodhon një efekt të dëmshëm në shëndet (dmth efektin kritik shëndetësor). Koha bazë për LAeq gjatë ditës është 13-17 orë dhe gjatë natës është 7 orë.





Qyteti Tiranë

Vlerësimi i gjendjes së nivelit të zhurmave në Tiranë për vitin 2022 është kryer në 15 pika monitorimi.



Tabela 1. Normat e nivelit të zhurmave sipas ligjit shqiptar dhe OBSH

Matja e nivelit të zhurmave	Norma
LAeq Ditën	55 dB(A)
LAeq Natën	45 dB(A)

Vlerësimi i zhurmave urbane është kryer në 43 pika monitorimi në qytetet Tiranë, Vlorë, Fier, Gjirokastrë, Kukës, Pogradec, Sarandë, Korçë, Berat, Shkodër, Lezhë.

Në të gjitha pikat e monitorimit të qytetit të Tiranës kemi nivel zhurme për Ditën dhe Natën më të larta se standarti i OBSH dhe Ligjit Shqiptar. Tejkalinin më të lartë të normës ditën për vitin 2022 e ka pika e monitorimit "21 Dhjetori" me 25.45% dhe "Laparak" me 25.47%. Tejkalimi më i lartë i normës për periudhën e natës vërehet tek pika e monitorimit "Ish Banka Amerikane" me 30.51%

Tabela .2. Vlera mesatare e nivelit të zhurmave për Ditën dhe Natën në Tiranë

Pikat e monitorimit	LAeq/Ditën dB (A)	Tejkalimi i normës ditën, %	LAeq/Natën dB (A)	Tejkalimi i normës natën, %
21 Dhjetor	69.90	25.45%	52.68	17.06%
Drejtorja e Policisë	61.18	11.23%	51.84	15.2%
Kryqezimi Vasil Shanto	60.14	9.34%	49.15	9.22%
Rruga e Elbasanit	62.68	13.7%	50.96	13.24%
Shkolla e Bashkuar	60.69	10.34%	49.4	9.77%
Stadiumi Dinamo	63.0	14.54%	45.74	1.64%
Sheshi Skënderbej	66.06	20.1%	51.59	14.64%
Stacioni i trenit	66.02	20.03%	51.68	14.84%

Partizani i panjohur	67.65	23.0%	57.01	26.68%
Kryqëzimi tek Selvia	67.92	23.5%	46.23	2.73%
Laprak	69.01	25.47%	54.07	20.15%
Pallati i kongreseve	65.54	19.16%	55.83	24.06%
Farmacia Nr.10	63.23	14.96%	54.21	20.46%
Shkolla Edit Durham	61.73	12.23%	56.49	25.53%
Ish Banka Amerikane	64.99	18.16%	58.73	30.51%
Standarti Shqiptar dhe OBSH	55		45	

Qyteti Vlorë

Matja e nivelit të zhurmave në Vlorë për 2022 është kryer në 4 pika monitorimi. Vlerësohet se në të gjitha pikat e monitorimit të qytetit të Vlorë nivel i zhurmës gjatë ditës është më i lartë se standarti i OBSH dhe Ligjit Shqiptar. Tejkalmi më i lartë i normës vërehet në pikën e monitorimit "Xhamia" me 17.65%.

Tabela .3. Vlera mesatare e nivelit të zhurmave për Ditën dhe Natën

Pikat e monitorimit	LAeq/Ditën dB (A)	Tejkalmi i normës ditën, %	LAeq/Natën dB (A)	Tejkalmi i normës natën, %
Hotel Bolonja	62.01	12.74%	51.52	14.48%
Hyrja e Qytetit	61.76	12.29%	50.78	12.84%
Xhamia	64.71	17.65%	42.36	0.0%
Uji i Ftohtë	62.85	14.27%	45.59	1.31%
Standarti Shqiptar dhe OBSH	55		45	

Ndërsa niveli i zhurmave natën e tejkalon normën e Ligjit Shqiptar dhe OBSH në 3 pika monitorimi, duke përjashtuar pikën e monitorimit "Xhamia" që rezulton brenda normës. Tejkalmi më i lartë vërehet në pikën "Hotel Bolonja" me 14.48% .

Qyteti Fier

Vlerësimi i ndotjes nga zhurmat në Fier është kryer në 4 pika monitorimi, ku rezulton se kemi tejkalm të normës për LAeq/Ditën dhe LAeq/Natën në të gjitha pikat e monitorimit. Tejkalmi më i lartë për periudhën e ditës dhe të natës rezulton në pikën "Kryqëzimi i Vlorës".

Tabela 4. Vlera mesatare e nivelit të zhurmave, për Ditën dhe Natën.

Pikat e monitorimit	LAeq/Ditën dB (A)	Tejkalmi i normës ditën, %	LAeq/Natën dB (A)	Tejkalmi i normës natën, %
Kryqëzimi i Hyrjes në Unazë	60.33	9.7%	48.81	8.46%
Prefektura	58.33	6.05%	46	2.22%

Kryqezimi i Vlorës	62.91	14.38%	52.66	17.02%
Fier Tregu Banka	61.59	12%	50.87	13.04%
Standarti Shqiptar dhe OBSH	55		45	

Qyteti i Gjirokastrës

Gjatë vitit 2022 niveli zhurmave për Ditën dhe Natën në Gjirokastrë tejkalon standartin e OBSH dhe Ligjit Shqiptar në të dy pikat e monitorimit.

Tabela.5. Vlera mesatare e nivelit të zhurmave, për Ditën dhe Natën, Gjirokastrë

Pikat e monitorimit	LAeq/Ditën dB (A)	Tejkalimi i normës ditën, %	LAeq/Natën dB (A)	Tejkalimi i normës natën, %
Kryqëzimi i Hyrjes në Qytet	60.59	10.16%	52	15.55%
Rrethrotullimi tek Stadiumi	58.85	7%	47.96	6.57%
Standarti Shqiptar dhe OBSH	55		45	

Tejkalimin më të lartë për periudhën e ditës e ka pika e monitorimit "Kryqëzimi i Hyrjes në Qytet", me 10.16 % pasi fluksi i automjeteve është më i lartë sepse kjo është rrugë nacionale. Për periudhën e natës vërehet tejkalim më i lartë në pikën e monitorimit "Kryqëzimi i Hyrjes në Qytet" me 15.55%.

Qyteti i Kukësit

Referuar matjeve të nivelit të zhurmave në 2 pikat e monitorimit në Kukës, rezulton se kemi tejkalim të normës LAeq/Ditën në pikën "Bashkia" me 0.76%. Në pikën tjetër të monitoruar në këtë periudhë nuk kemi tejkalim. Ndërsa për LAeq/Natën nuk kemi tejkalim në asnjë nga pikat e monitoruara.

Tabela.6. Vlera mesatare e nivelit të zhurmave për Ditën dhe Natën, Kukës

Pikat e monitorimit	LAeq/Ditën dB (A)	Tejkalimi i normës ditën, %	LAeq/Natën dB (A)	Tejkalimi i normës natën, %
Bashkia	55.42	0.76%	43.94	0.00%
Stacioni i Autobuzave	53.71	0.00 %	44.13	0.00%
Standarti Shqiptar dhe OBSH	55		45	

Qyteti Pogradec

Kemi tejkalim të standartit për LAeq/Ditën dhe LAeq /Natën në të dy pikat e monitorimit në qytetin e Pogradecit. Tejkalimi më i lartë për periudhën e ditës vërehet në pikën "Kryqezimi tek Terminali", ndërsa gjatë natës në pikën "Hyrja e Qytetit".

Tabela.7. Vlera mesatare e nivelit të zhurmave për Ditën dhe Natën, Pogradec

Pikat e monitorimit	LAeq/Ditën dB (A)	Tejkalimi i normës ditën, %	LAeq/Natën dB (A)	Tejkalimi i normës natën, %
Hyrja e Qytetit	57.21	4.01%	47.93	4.51%
Kryqezimi tek Terminali Autobuzave	57.7	4.9%	46.08	2.4%
Standarti Shqiptar dhe OBSH	55		45	

Qyteti Sarandë

Nga vlerësimi i nivelit të zhurmave në 4 pikat e monitorimit të qytetit të Sarandës, rezulton se, në të gjitha pikat e monitorimit të qytetit të Sarandës kemi nivel zhurme për ditën dhe natën më të larta se standarti i OBSH dhe Ligjit Shqiptar.

Tabela.8. Vlera mesatare e nivelit të zhurmave, për Ditën dhe Natën, Sarandë

Pikat e monitorimit	LAeq/Ditën dB (A)	Tejkalimi i normës ditën, %	LAeq/Natën dB (A)	Tejkalimi i normës natën, %
Lagjja Koder	60.28	9.6%	46.7	3.77%
Bashkia	63.09	14.7%	47.88	6.4%
Tregu i valutes	60.19	9.43%	47.75	6.11%
Hotel Butrint	61.57	11.94%	51.47	14.37%
Standarti Shqiptar dhe OBSH	55		45	

Tejkalimin më të lartë të standartit për periudhën e ditës e ka pika e monitorimit "Bashkia" me 14.7%. Për periudhën e natës, tejkalmi më i lartë shihet tek pika "Hotel Butrint" me 14.37% .

Qyteti Shkodër

Nga të dhënat e tabelës së mëposhtme vërejmë se, në të 2 pikat e monitorimit të qytetit të Shkodrës, kemi nivel zhurme që tejkalojnë standartin si për periudhën e ditë ashtu dhe të natës. Tejkalimi më i lartë për LAeq Ditën shihet tek pika "Universiteti (Hotel Rozafa)" me 19%, ndërsa për LAeq Natën vërehet tek pika "Hyrja e Qytetit" me 14.93 %.

Tabela.9. Vlera mesatare e nivelit të zhurmave, për Ditën dhe Natën, Shkodër

Pikat e monitorimit	LAeq/Ditën dB (A)	Tejkalimi i normës ditën, %	LAeq/Natën dB (A)	Tejkalimi i normës natën, %
Universiteti (Hotel Rozafa)	64.87	17.94%	51.72	14.93%
Hyrja e qytetit	65.61	19%	50.39	12%
Standarti Shqiptar dhe OBSH	55		45	

Qyteti Berat

Në të gjitha pikat e monitoruara në qytetin e Beratit kemi nivel zhurme për ditën, më të larta se standarti i OBSH dhe Ligjit Shqiptar, ku pika e monitorimit "Bashkia" vlerësohet me tejkalimin më të lartë me rreth 12. %. Për periudhën e natës, nuk kemi tejkalim të standardit.

Tabela.10. Vlera mesatare e nivelit të zhurmave, për Ditën dhe Natën, Berat

Pikat e monitorimit	LAeq/Ditën dB (A)	Tejkalimi i normës ditën, %	LAeq/Natën dB (A)	Tejkalimi i normës natën, %
Bashkia	61.61	12%	43.55	0.00%
Kryqezimi i Spitalit	57.35	4.27%	43.49	0.00%
Standarti Shqiptar dhe OBSH	55		45	

Qyteti Korçë

Për vitin 2022, niveli i zhurmave LAeq/Ditën në katër pikat e monitoruara në qytetin e Korçës e tejkalon standardin. Tejkalimi më i lartë i standartit të OBSH dhe Ligjit Shqiptar për periudhën e ditës dhe natës rezulton tek "Kryqezimi i Spitalit".

Tabela.11. Vlera mesatare e nivelit të zhurmave për Ditën dhe Natën, Korçë

Pikat e monitorimit	LAeq/Ditën dB (A)	Tejkalimi i normës ditën, %	LAeq/Natën dB (A)	Tejkalimi i normës natën, %
Kryqezimi i Spitalit	62.31	13.3%	51.65	14.7%
Telekomi	61.07	11%	49.46	9.91%
Kryqezimi i hyrjes së qytetit	61.34	11.52%	44.41	0.00%
Tregu i shumicës	59.56	8.3%	44.09	0.00%
Standarti Shqiptar dhe OBSH	55		45	

Qyteti Lezhë

Në dy pikat e monitoruara në qytetin e Lezhës, niveli i zhurmave LAeq/Ditën dhe LAeq Natën e tejkalojnë standardin e OBSH dhe Ligjit Shqiptar. Tejkalimi më i lartë si për periudhën e ditës ashtu dhe të natës vërehet tek pika e monitorimit "11 Janari".

Tabela.12. Vlera mesatare e nivelit të zhurmave për Ditën dhe Natën, Lezhë

Pikat e monitorimit	LAeq/Ditën dB (A)	Tejkalimi i normës ditën, %	LAeq/Natën dB (A)	Tejkalimi i normës natën, %
Lagjja Gurra	60.66	10.3%	48.44	7.64%
11 Janari	63.13	14.8%	49.87	10.82%
Standarti Shqiptar dhe OBSH	55		45	

Gjendja e nivelit të zhurmave gjatë vitit 2022 për LAeq Ditën dhe LAeq Natën si dhe tejkalimet nga standarti për të gjitha qytetet e monitoruara paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela.13. Vlera mesatare e nivelit të zhurmave të qyteteve të monitoruara, për Ditën dhe Natën,

Qytetet	LAeq Ditën dB(A)	Tejkalimi i normës ditën, %	LAeq Natën dB(A)	Tejkalimi i normës natën, %
Tirana	64.65	17.54%	52.37	16.37%
Vlorë	62.83	14.23%	47.56	5.7%
Lezhë	61.89	12.52%	49.15	9.22
Sarandë	61.28	11.4%	48.45	7.66
Pogradec	57.45	4.45%	47	4.44
Fier	60.79	10.52%	49.58	10.2
Kukës	54.56	0.00%	44.03	0.00
Shkodër	65.24	18.6%	51.05	13.44
Berat	59.48	8.14%	43.52	0.00
Korcë	61.07	11%	47.4	5.33
Gjirokastër	59.72	8.6%	49.98	11.06

Për vitin 2022, kemi tejkallime standartit të OBSH dhe Ligjit Shqiptar për LAeq/Ditën në të gjitha qytetet duke përjashtuar qytetin e Kukësit ku, nuk kemi tejkallim të standartit. Tejkallimin më të lartë e ka qyteti i Shkodrës dhe Tiranës.

Përsai i përket periudhës së natës vërehet se në qytetet e Beratit dhe Kukësit nuk kemi tejkallim të standartit të OBSH dhe Ligjit Shqiptar LAeq/Natën për vitin 2022. Qytetet e tjera vlerësohen me vlera të larta të nivelit të

zhurmave. Tejkallimin më të lartë të standartit e ka qyteti i Tiranës me 16.37% , duke vijuar me qytetin e Shkodrës, Gjirokastrës.

2.2.1 Tendenca

Në të gjitha qytete e monitoruara nga viti 2018-2022 kemi tejkallim të standartit për LAeq ditën. Tejkallimin më të lartë ndër vite kemi në qytetet e Tiranës, Shkodrës, Vlorës dhe Lezhës. Ndërsa tejkallimet më të ulta i kemi në qytetin e Kukësit, Pogradecit dhe Beratit.

Tabela .14. Vlerat mesatare të ditës, për të gjitha qytetet e monitoruara , vitet 2018-2022.

LAeq/Ditën dB(A)	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Norma
Tiranë	66.1	67.15	62.47	63.36	64.65	55
Fier	60.17	58.16	60.47	62.07	60.79	55
Vlorë	63.34	64.6	60.47	61.82	62.83	55
Sarandë	61.66	65.16	60.1	62.36	61.28	55
Korçë	61	60.96	58.05	59.99	61.07	55
Berat	60.95	62.25	57.1	58.26	59.48	55
Gjirokastër	59.57	61	58.34	59.83	59.72	55
Pogradec	57.44	56.78	56.33	58.07	57.45	55
Shkodër	63.47	59.36	63.15	62.01	65.24	55
Kukës	55.99	56.42	54.76	53.88	54.56	55
Lezhë	61.23	60.69	62.12	62.64	61.89	55

Tabela .15. Vlerat mesatare të natës, për të gjitha qytetet e monitoruara , vitet 2018-2022.

LAeq/Natën dB(A)	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Norma
Tiranë	57.94	57.49	56	53.05	52.37	45
Fier	47.99	49.36	52.89	51.62	49.58	45
Vlorë	53.41	53.44	51.1	49.05	47.56	45
Sarandë	50.12	50.6	48.7	50.39	48.45	45
Korçë	51.13	51.02	52.89	47.72	47.4	45
Berat	50.25	52.17	48.6	47.07	43.52	45
Gjirokastër	50.09	53	49.89	50.8	49.98	45
Pogradec	45	46.08	45.52	46.6	47	45
Shkodër	51.1	52.14	53.83	50.84	51.05	45
Kukës	45.46	45.24	43.35	42.41	44.03	45
Lezhë	49.38	48.44	48.5	49.83	49.15	45

Vlerësohet se nga viti 2018-2022, në të gjitha qytetet e monitoruara kemi tejkalim të standartit për LAeq natën . Tejkallim më të lartë ndër vite kemi në qytetet e Tiranës , Shkodrës, Vlorës dhe Lezhës. Ndërsa tejkallimet më të ulta rezultojnë ne qytetet e Kukësit, Pogradecit dhe Beratit

2.2.2 Efektet në shëndet

Udhëzimi Nr.8, datë 27/11/2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” merr parasysh të gjitha efektet negative shëndetësore të identifikuar për mjedise specifike. Një efekt negativ i zhurmës i referohet çdo dëmtimi të përkohshëm ose afatgjatë të funksionit fizik, psikologjik ose social, që është i lidhur me ekspozimin në zhurmë.

Tabela.1. Efektet specifike të zhurmës së trafikut rrugor mbi shëndetin dhe ambientet.

Mjedisi specifik	Efektet kritike në shëndet	LAeq dB(A)	Koha bazë (orë)	LAmix Fast
Zona e jashtme e banimit	Shqetësim serioz gjatë ditës dhe mbrëmjes.	55	16	-
	Shqetësimi moderuar gjatë ditës dhe mbrëmjes	50	16	-
Në brendësi të banesave	Kuptueshmëri e fjalëve dhe shqetësime të lehta gjatë ditës dhe mbrëmjes	35	16	-
	Në brendësi të dhomës së fjetjes	30	8	-
Nga ana e jashtme e dhomës së fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur	45	8	-
Klasa mësimi, kopështe fëmijësh (brënda)	Kuptueshmëri e fjalëve, vështirësi në shpjegim, komunikim, bashkëbisedim	35	Gjatë mësimi	-

Dhomat e fjetjes në kopshte (brënda)	Prishje e gjumit	30	Koha e gjumit	-
Ambjente pushimi (shlodhjeje)	Bezdisje,shqetësim (burime të jashteme)	55	Koha e pushimit	-
Spitale, salla/dhoma (brënda)	Prishja e gjumit natën	30	8	40
	Prishja e gjumit ditën dhe në mbrëmje	30	16	-
Spitale, salla trajtimi (brënda)	Interferencë (ndërfutje) në pushim, çlodhje	#1		
Zona industriale, tregtare, qarkullimi (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Humbje dëgjimi	70	24	110
Ceremoni, festivale, qendra argëtimi	Humbje dëgjimi (klientet < 5 herë/ vit)	100	4	110
Fjalime, ligjërata, manifestime të jashtme apo të brendshme	Humbje dëgjimi	85	1	110
Muzikë dhe tinguj difuze në kufjet e dëgjimit	Humbje dëgjimi	85# 4	1	110
Impulsione zanore nga lodrat, plasjet artificiale e armët e zjarrit	Humbje dëgjimit (të rriturit)Humbje dëgjimit (fëmijët)			140#2 120#2
Parqet natyrore, zonat e mbrojtura	Prishje e qetësisë	#3		

$LA_{eq} dB(A)$ = Niveli ekuivalent i zhurmës i matur në shkallën A

Koha bazë (orë) = koha bazë e ekspozimit

$LA_{max} Fast$ = Niveli i matur në shkallën A në mënyrën *fast* (të shpejtë).

1 = Sa më poshtë (e ulët) që të jetë e mundur

2 = Presioni akustik maksimal (LA_{AF} , maximum) matur 100 qm larg veshit

3 = Zonat e jashtme qetësuese duhet të mbrohen dhe raporti i zhurmës me

zhurmën bazë duhet të ruhet sa më i ulët që të jetë e mundur.

4 = Poshtë (nën) kufjet e dëgjimit, përshtatur me vlerat në ambjent të hapur.

2.3 Vlerësimi i gjendjes

Nga monitorimi i zhurmave urbane për vitin 2022 rezulton se në qytetin e Kukësit nuk kemi tejkalim të nivelit të zhurmave ditën dhe natën. Në qytetin e Beratit nuk kemi tejkalim të normës natën. Në të gjitha qytetet e tjera rezulton se kemi nivel të lartë të zhurmave për ditën dhe natën krahasuar me normat e Ligjit Shqiptar dhe OBSH.

Faktorët që kontribuojnë në rezultatet e marra nga monitorimi i zhurmave:

1. Fluksi i madh i automjeteve në akset rrugore ku u vendos aparati i monitorimit të zhurmave.
2. Gjendja motorrike e automjeteve në qarkullim lë shumë për të dëshiruar, mosha e vjetër e tyre sjell uljen e parametrave optimale të certifikatës teknike të automjetit, lidhur me emetimin e zhurmës.
3. Punime ndërtimesh në pika të ndryshme, të cilat rritin artificialisht nivelin e zhurmave urbane.
4. Mos funksionimi i korsive të bicikletave, sjell si rrjedhojë shtimin e numrit të makinave në qarkullim dhe si pasojë rritjen e nivelit të zhurmave.
5. Mungesa e brezit mbrojtës të gjelbër midis zonave të banuara dhe rrugëve kryesore.
6. Mos zbatimi i teknikave për minimizimin e zhurmave në ndertimin e rrugëve.

7. Mungesa e "Zonave të Qeta" në qytete.
 8. Mungesa e theksuar e vendparkimeve është një tjetër faktor i cili ndikon në rritjen e niveleve të ndotjes nga zhurmat.
 9. Mungesa e rrugëve dytësore të cilat do të ulnin ndjeshëm trafikun në kryqëzimet kryesore dhe si rrjedhojë uljen e nivelit të

zhurmave.

Në tabelën e mëposhtme jepet një vlerësim përsa i përket gjendjes së nivelit të zhurmave për periudhën e ditës dhe natës duke i krahasuar me normat e ligjit shqiptar dhe OBSH.

- Tejkalojnë shumë normën ■ e kuqe
 Tejkalojnë më pak normën ■ e verdhe
 Nuk tejkalojnë normën ■ jeshile

Qytetet e monitoruara	Laeq Ditën dB(A)	Vlerësimi	Laeq Natën dB(A)	Vlerësimi
Tiranë	64.65		52.37	
Vlorë	62.83		47.56	
Lezhë	61.89		49.15	
Sarandë	61.28		48.45	
Pogradec	57.45		47	
Fier	60.79		49.58	
Kukës	54.56		44.03	
Shkodër	65.24		51.05	
Berat	59.48		43.52	
Korcë	61.07		47.4	
Gjirokastër	59.72		49.98	

2.4 Forcat shtytëse , presioni, gjendja ndikimet, reagimi

2.5. Kuadri ligjor

- Ligji Nr.9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis".
- Udhëzimi Nr.8, datë 27/11/2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara"
- Vendimi Nr. 587, datë 07.07. 2010 "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike".

2.6.Rekomandime

- ❖ Sigurimi i brezit mbrojtës të gjelbër dhe hapësirave të mbjella me pemë midis zonave të banuara dhe rrugës kryesore, si një nga masat më eko - miqësore për të reduktuar nivelin e ndotjes.
- ❖ Të përcaktohen me rregullore distancat midis rrugëve dhe banesave.

- ❖ Të bëhen projekte për zvogëlimin e zhurmës, që në projektimin e ndërtimeve të reja (institucione, shkolla, spitale, rrugë etj.)
- ❖ Të sigurohet kontrolli periodik i mjeteve të transportit që gjenerojnë zhurmë.
- ❖ Të parashikohen ndërhyrjet në sinjalistikën rrugore, ku të përfshihen në të sinjalet që lidhen me zhurmat si dhe vendosjen e tyre në pika të caktuara.
- ❖ Vendim - marrja për efektet negative që shkakton zhurma në shëndetin fizik dhe mendor të popullsisë.
- ❖ Edukimi i publikut është kërkesa më e rëndësishme. Programet e ndërhyrjes për zvogëlimin e zhurmës mund të mos kenë sukses pa pjesëmarrjen e publikut.

KAPITULLI 3

UJERAT



KAPITULLI 3

UJËRAT

3.1 Çështjet që trajtohen

Vlerësimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore të Shqipërisë në lumenj, liqene kryhet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për parametrat fiziko- kimike në lumenjtë e baseneve Drini-Bunë, Mat, Ishëm- Erzen, Shkumbin, Vjosë dhe Seman. Tributarët (Lumi i Pogradecit, Lumi Vërdovë, Lumi Tushemisht) ujërat e të cilëve derdhen në liqenin e Ohrit dhe ndikojnë në cilësinë e tij. Ndërsa për liqenin e Ohrit dhe të Shkodrës monitorimi kryhet për parametra fiziko-kimike, klorofila -a dhe indeksi i gjendjes trofike TSI. (Karlson). Gjithashtu në këto lumenj dhe liqene nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, kryhet vlerësimi i gjendjes së metaleve të rënda Cd, Pb, Cu, As, Hg.

Monitorimi sasior, hidrodinamik dhe i cilësisë së ujërave nëntokësore është kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për basenet kryesore ujëmbajtëse të Shqipërisë; Drin, Mat, Erzen-Ishëm, Shkumbin, Seman, Vjosa dhe Zona Jonike.

Vlerësimi i prurjeve ujore në lumenjtë, Drin, Bunë, Mat, Erzen, Ishëm, Shkumbin, Seman,

Vjosë, është kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar në dy periudha të ndryshme stinore, në të verës (Qershor-Korrik) dhe atë të vjeshtës (Shtator-Tetor). Parametri kryesor që matet është sasia e prurjes ujore (Q). Është një e dhënë shumë e rëndësishme pasi shërben për administrimin e pasurive ujore sipërfaqësore në periudha të ndryshme të vitit për përdorime të ndryshme industriale dhe komunitare, por gjithashtu, shërben edhe për përcaktimin e rreziqeve potenciale që këto prurje mbartin në vetvete në raste të veçanta. Një tregues tjetër që lidhet direkt me veçoritë gjeometrike të kanalit lumor është Rrezja Hidraulike. Ajo na tregon kapacitetin apo efikasitetin e kanalit të rrjedhës për të lejuar kalimin e sasive të ujit dhe përcaktohet si raport i sipërfaqes së lagur me perimetrin e lagur. Sa më e madhe rrezja hidraulike, aq më efikas është kanali dhe volumi që ai mund të përcjellë

1.2 Gjendja dhe tendenca

3.2.1 Cilësia e ujërave sipërfaqësore

Rrjeti i monitorimit është i shtrirë në lumenj, liqene dhe vlerësimi i cilësisë së tyre përcaktohet në bazë të parametrave fiziko-kimik duke i krahasuar me normat e lejuara të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit të BE



Liqenet, pellgjet, lumenjtë dhe përrenjtë shërbejnë për shumë funksione kritike për mjedisin dhe jetën e njeriut. Këto ujëra të freskëta sipërfaqësore mbështesin ekosistemet dhe sigurojnë habitat për shumë specie bimore dhe shtazore. Ata gjithashtu mbështesin një mori përdorimesh njerëzore, duke përfshirë ujin e pijshëm, ujitjen, trajtimin e ujërave të zeza, blegtorinë, përdorimet industriale, hidrocentralet dhe rekreacionin.

Ujërat e ëmbla sipërfaqësore gjithashtu ndikojnë në shtrirjen dhe gjendjen e burimeve të tjera ujore, duke përfshirë ujërat nëntokësore, ligatinat dhe sistemet bregdetare.

Monitorimi i cilësisë së ujit është i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujërave, identifikimin e shkaktarëve të ndotjes deri në dhënie të rekomandimeve përkatëse sipas problematikave të identifikuara.

Tabela 1. Vlerat limite të parametrave kimike në lumenj sipas DKU

	Njesia	Vlerat limite te parametrave kimike				
		Gjendje e Lartë Kl.I	Gjendje e Mirë Kl.II	Gjendje e Moderuar Kl.III	Gjendje e Varfër K.IV	Gjendje e Keqe Kl.V
Oksigjen i tretur	mgO/l	>7	>6	>5	>4	<3
NBO ₅	mg/l	<2	<3.5	<7	<18	>18
pH (acid)			>6.5	>6		
pH (alkalin)			<8.5	<9		
NH ₄	mgN/l	<0.05	<0.3	<0.6	<1.5	>1.5
NO ₂	mgN/l	<0.01	<0.06	<0.12	<0.3	>0.3
NO ₃	mgN/l	<0.8	<2	<4	<10	>10
PO ₄	mgP/l	<0.05	<0.10	<0.2	0.5	>0.5
P-total	mgP/l	<0.1	<0.20	<0.4	<1	>1

Temperaturat e ujërave variojnë në varësi të stinës dhe pozicionimin e stacioneve të kampionimit, ku në rrjedhat e sipërme ujërat e lumenjve karakterizohen nga temperatura më të ulëta, pasi janë ujëra që burojnë nga zonat malore. Ujërat e lumenjve vlerësohen alkaline me pH nga 7.47-8.39.

Baseni i Drinit

Vlerësimi i cilësisë për parametrat fiziko-kimik është kryer në 6 stacione kampionimi që nga stacioni i referencës, burimi i tij, deri para derdhjes në det.

Tabela 2. Stacionet e basenit Drin








Nr.	Kodi i kampionit	Emërtimi i Lumit	Vendndodhja	Koordinatat gjeografike
1.	D1	Drini i Zi	Topojan-Ura Burrel Peshkopi	N41.580626 E20.434238
2.	D2	Drini	Bahçallek-Ura Bahçallek	N42.041771 E19.490806
3.	D3	Drini i Bardhë	Luma - Kukës	N42.040408 E20.274955
4.	Bu1	Buna	Muriqan - afër fshatit, në kufi	N42.009313 E19.411012
5.	Bu2	Buna	Ura e vjetër Shkodër - Shirokë	N42.045851 E19.487121
6.	DLe	Drini Lezhë	Kune-Vain para derdhjes në det	N41.753554 E19.593363

Të gjitha stacionet janë të ngopura me oksigjen me vlera > 7 (Klasa I - Gjendje e lartë).

Përsa i përket NBO₅, ujërat paraqesin cilësi të mirë në lidhje me këtë parametër në rrjedhën e sipërme duke u klasifikuar në **Klasën II - Gjendje e mirë**, ndërsa në stacionet pranë zonave të banuara klasifikimi i cilësisë së ujërave është në **Klasën III - Gjendje e moderuar**.

Drini Lezhë ka një përmbajtje më të lartë të amonjakut në vlerën 0.238 mg/l por brenda normës së lejuar duke u klasifikuar në **Klasën II- Gjendje e mirë**.

Përmbajtja e nitriteve është nën normën e lejuar në vlerat 0.001 - 0.0068 mg/l duke i klasifikuar të gjitha stacionet në **Klasën I - Gjendje e lartë**.



Përmbajtja e nitrateve , orto - fosfateve dhe fosforit total në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më të ulëta se norma e lejuar, duke i klasifikuar të gjitha stacionet në **Klasën I - Gjendje e lartë**.

Referuar rezultateve të gjithë parametrave kimik të DKU të paraqitura edhe më sipër, vlerësojmë cilësinë e ujërave të Basenit të Drinit në Klasën III – Gjendje e moderuar, duke nënvizuar përmirësimin nga 2021 ku ky basen ka qënë në cilësi të varfër nga ndotja e vlerësuar në stacionin DLe – Drini Lezhë, si pasojë e sistemimit të Drinit në qytetin e Lezhës dhe e sistemit të kanalizimeve përfaq.



Vlerësimi i gjendjes së metaleve të rënda në ujërat sipërfaqësore kryhet duke u bazuar mbi normat e klasifikimit të Direktivës Kuadër të Ujit (DKU) 75/440/EEC. Rrjeti i monitorimit është i shtrirë në lumenj, liqene dhe vlerësimi i cilësisë së këtyre ujërave sipërfaqësor përcaktohet në bazë të përmbajtjes së nivelit të metaleve të rënda duke i krahasuar me normat e lejuara të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit të BE-së. Metalet nëpërmjet të cilëve vlerësohet cilësia e ujërave sipërfaqësore janë: Arsenik (As), Kadmium (Cd), Bakër (Cu), Plumb (Pb), dhe Mërkur (Hg). Janë kryer dy ekspedita të realizuara në periudhën Qershor-Korrik dhe Shtator-Nëntor 2022

Tabela 3. Normat e përcaktuara nga DKU

Nr.	Parametri i matur	Simboli	Njësia	Klasifikimi Direktiva e Kuadër të Ujit (75/440/EEC)		
				A1 E mirë	A2 E moderuar	A3 E keqe
1.	Arsenik	As	µg/l	<50	50	>100
2.	Kadmium	Cd	µg/l	<1	5	>5
3.	Bakër	Cu	µg/l	<50	100	>1000
4.	Plumbi	Pb	µg/l	<50	50	>50
5.	Mërkuri	Hg	µg/l	<1	1	>1

Prania e metaleve të rënda në sipërfaqen e ujit mund të jetë për shkak të aktiviteteve natyrore ose antropogjene. Në aktivitetet natyrore, mund të përfshihen gërryerja e shkëmbinjve që përmbajnë metale, zjarret në pyll dhe proceset natyrore të motit. Nga këto aktivitete, metali hyn në seksione të ndryshme të mjedisit. Disa shembuj të tjerë të burimit natyror përmes të cilit metalet e rënda ndotin ujin janë, depozitimi i lagësht dhe i thatë i kripërave atmosferike, ndërveprimi ujë- material shkëmbor ose ndërveprimi i ujit me tokën. Ndërsa rritja e papritur e urbanizimit dhe industrializimit janë një shembull i burimeve antropogjene përmes të cilave uji kontaminohet.

Tabela 4. Burimet e metaleve të rënda në mjedis

Jon i metalit të rëndë	Burimet e zakonshme
Bakër (Cu)	Plehra, rrezitje (Veprimi ose procesi i shndërrimit të lëkurës së kafshëve në lëkurë duke e njomur atë në një lëng që përmban acid tanik ose duke përdorur kimikate të tjera), vend shfrytëzimet minerale dhe qeliza fotovoltaike.
Arsenik (As)	Shtyllat e energjisë elektrike prej druri që trajtohen me konservues me bazë arseniku, pesticide, plehra, çlirimi i rrjedhjeve të patrajuara, oksidimi i piritit (FeS) dhe arsenopyritit (FeAsS).
Mërkur (Hg)	Djegia e qymyrit, djegia e mbetjeve të ngurta komunale dhe emetimet vullkanike.
Kadmium (Cd)	Bojëra, pigmente, pjesë të elektrizuara, bateri, plastikë, gomë sintetike, proces fotografik dhe gdhendje, fotopërçues dhe qeliza fotovoltaike
Plumb (Pb)	Tuba PVC në kanalizime, bujqësi, bojëra plumbi të ricikluara PVC, bizhuteri, bateri plumbi, kuti etj.

Rezultatet për metalet e rënda në ujërat e basenit Drin paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5. Klasifikimi i cilësisë të ujërave të basenit Drin, 2022

Parametri i matur	Simboli	Njësia	Klasifikimi Direktiva e Kuadër të Ujit (75/440/EEC)			Stacionet				
			A1 E mirë	A2 E moderuar	A3 E keqe	Ura e mesit-Lumi Drin	Murriqan	Ura Baçallëk	Ura Topojanit-Shupenza	Ura Mat-Burrel-Maqellarë
Arsenik	As	µg/l	<50	50	>100	n.d.	2.5	4	6	8.6
Kadmium	Cd	µg/l	<1	5	>5	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.
Bakër	Cu	µg/l	<50	100	>1000	1.875	1.02	1.77	0.417	0.545
Plumbi	Pb	µg/l	<50	50	>50	3.15	6.325	5.545	2.565	2.23
Mërkuri	Hg	µg/l	<1	1	>1	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.

Shënim: n.d - nuk dedektohet

Duke u nisur nga rezultatet e mësipërme, Kadmium dhe Mërkuri ngelen të pa identifikuar në të gjithë stacionet. Përmbajtja e metaleve As, Cu, Pb është brenda normave të lejuara duke i klasifikuar ujërat e basenit Drin **të Klasës së parë A1- Gjendje e mirë..**



Baseni Ishëm - Erzen

Monitorimi i këtij baseni për parametrat kimik realizohet në 10 stacione kampionimi në të gjithë gjatësinë e tij, të cilat janë paraqitur në formë tabelare si vijon:

Tabela 7. Stacionet e basenit Ishëm-Erzen:

Nr.	Kodi i kampionit	Emërtimi i Lumit	Vendndodhja	Koordinatat gjeografike
1.	T1	Lumi i Tiranës	Ura e Brarit	N41.372595 E19.855204
2.	T2	Lumi i Tiranës	Kamëz – poshtë urës	N41.354077 E19.773338
3.	L1	Lumi i Lanës	Lanabregas 200 -300 m sipër gurores Dajti	N41.3293 E19.8788
4.	L2	Lumi i Lanës	Ish dogana Kashar: autostradë 200 m poshtë urës, 700-800m nga kryqëzimi i Coca-Colës	N41.3385 E19.7762
5.	Ish1	Lumi Ishëm	Ura Rinas	N41.435932 E19.696267
6.	Ish2	Lumi Ishëm	Ura e Gjolës	N41.467270 E19.691924
7.	Ish3	Lumi Ishëm	Ura Salmer	N41.541421 E19.610609
8.	Er1	Lumi Erzen	Pëllumbas	N41.245533 E19.936300
9.	Er2	Lumi Erzen	Ura e Beshirit	N41.292176 E19.755325
10.	Er3	Lumi Erzen	Sallmone – Fshati Rinia	N41.360944 E19.549134

Lumi Erzen rezulton me ujëra të pasur me oksigjen duke u klasifikuar në **Klasën I - Gjendje e lartë**. Lumi Ishëm klasifikohet në **Klasën IV - Gjendje e Varfër** për shkak të përmbajtjes së ulët të oksigjenit të tretur.





Tejkalim të vlerës limite për parametrin nevoja biokimike për oksigjen kemi në stacionet T2 – Kamëz poshtë urës , L2 – Ish Dogana Kashar ku vlera mesatare është 47 mgO/l, një vlerë shumë e lartë që dëshmon një shkallë ndotjeje shumë të lartë duke e klasifikuar në **Klasën V - Gjendje e keqe, ku duhet të merren masa të menjëhershme (>**

18 mg/l).



Tejkalim të normës kemi edhe në tre stacionet e monitorimit të Lumit Ishëm ku gjendja paraqitet me një ndotje të lartë e klasifikuar në **Klasën IV - Gjendje e varfër**.

Lumi Erzen paraqitet të jetë mbi normën e lejuar vetëm në stacionin Er2 – Ura e Beshirit.



Në stacionet e monitoruara kemi tejkalim të vlerës limite për përmbajtjen e amoniakut në stacionin T2 – Ura Kamëz, L2 – Lanabregas me vlerën mesatare më të lartë 24.3 mg/l duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën V – Gjendje e keqe, si dhe në të tre stacionet


e Ishmit të cilat klasifikohen në Klasën V – Gjendje e keqe. Përmbajtja e nitriteve është nën normën e lejuar në të gjitha stacionet e këtij baseni. Stacionet e Lumit Erzen referuar përmbajtjes së nitriteve klasifikohen në Klasën II – Gjendje e mirë.



Përmbajtja e nitrateve në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më të ulëta se norma e lejuar. Referuar të dhënave mesatare vjetore, vlerësohet se ka tejkalim të vlerës limite të përmbajtjes së orto – fosfateve në stacionin T2 – Ura e Kamzës, L2 – Lanabregas në vlerën 1.4 mg/l duke e

klasifikuar këtë stacion në Klasën V – Gjendje e keqe.

Tejkalim të vlerës limite kemi edhe në të tre stacionet e Ishmit duke e klasifikuar këtë lumë në Klasën e IV – Gjendje e varfër. Stacionet e Lumit Erzen nuk kanë përmbajtje të fosforit.



Stacioni L2 –Lanabregas tejkalon vlerën limite duke u klasifikuar në Klasën V – Gjendje e keqe. Gjithashtu, është vlerësuar se ka prani të fosforit total në të tre stacionet e Lumit Erzenit në vlera të larta. Lumi i Erzenit nuk ka përmbajtje të fosforit total.

Duke marrë në konsideratë të gjithë parametrat, vlerësohet se në stacionet e referencës lumenjtë janë të pastër, ndërsa duke kaluar afër zonave të banuara, ndikimi i shkarkimeve urbane të cilat derdhen direkt të patrajuara, sjell ndotje të lartë, duke e klasifikuar Basenin Ishëm - Erzen në Klasën V - Gjendje e keqe.

Shpërndarja e metaleve të rënda në ujërat e lumit të Tiranës për vitin 2022 është paraqitur në tabelën përmbledhëse.

Tabela 8. Rezultate e vlerësuara të metaleve të rënda në Lumin e Tiranës

Parametri i matur	Simboli	Njësia	Klasifikimi Direktiva e Kuadër të Ujit (75/440/EEC)			Stacionet				
			A1 E mirë	A2 E moderuar	A3 E keqe	Ura e Brarit	Lanabregas	Ish- Dogana	MbrapaCoca Colës	Ura Kamzës
Arsenik	As	µg/l	<50	50	>100	3	3	n.d	3	4
Kadmium	Cd	µg/l	<5	5	>5	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.
Bakër	Cu	µg/l	<50	100	>1000	0.92	0.86	0.84	1.2	1.335
Plumbi	Pb	µg/l	<50	50	>50	11.42	12.04	19.915	19.915	20.505
Mërkuri	Hg	µg/l	<1	1	>1	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.

Shënim: n.d – nuk dedektohet

Në këto ujëra nuk u identifikua prania e Kadmium dhe Mërkur, pra janë poshtë limitit të dedektimit. Kurse elementet Arsenik, Bakër dhe Plumb janë identifikuar si element gjurmë.

Arseniku në këto ujëra është në nivele të ulëta, ku uji është i sigurt për t'u përdorur

ngakomuniteti **si ujë i pastër.**

Lumi i Tiranës rezulton të jetë lum me ujëra të pastër duke u klasifikuar në Klasën **A1 - Gjendje e mirë.**

Përmbajtja e metaleve të rënda në ujërat e lumit Ishëm -Erzen për vitin 2022 është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 9 . Rezultate e vlerësuara të metaleve të rënda në Lumin Ishëm-Erzen

Parametri i matur	Simboli	Njësia	Klasifikimi Direktiva e Kuadër të Ujit (75/440/EEC)			Stacionet					
			A1 E mirë	A2 E moderuar	A3 E keqe	Pëllumbas	Ura e Beshirit	Ura Salmer	Fshati Rinia	Ura Rinas	Ura Gjoles
Arsenik	As	µg/l	<50	50	>100	n.d.	1.5	2.2	5	n.d.	2.5
Kadmium	Cd	µg/l	<5	5	>5	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.
Bakër	Cu	µg/l	<50	100	>1000	0.855	0.87	1.825	1.13	2.08	2.18
Plumbi	Pb	µg/l	<50	50	>50	10.404	11.615	15.665	20.845	17.925	18.255
Mërkuri	Hg	µg/l	<1	1	>1	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.

Shënim: n.d – nuk dedektohet

Arseniku në stacionet Pëllumbas dhe Ura e Rinasit nuk u identifikua, kurse tek Ura Beshirit, Ura Salmer, Fshati Rinia dhe Ura e Golës ai varion nga 1.5-5 µg/l. Kampionet e ujit të lumenjve që nuk janë në kontakt me pusët e banimit u zbuluan me një nivel arseniku nën standardin e cilësisë së ujit të pijshëm.

Përmbajtja e Bakrit dhe Plumbit në të gjitha stacionet e monitoruara rezultojnë në vlera më të ulëta se norma e lejuar. Nuk është



identifikuar përmbajtje e Kadmiumit dhe Mërkurit.

Lumi Ishëm-Erzen rezultojnë të jetë me ujëra të pastër duke u klasifikuar Klasa A1 - Gjendje e mirë



Baseni i Matit




Ky basen monitorohet në 4 stacione kampionimi në gjithë gjatësinë e vet. Stacionet janë paraqitur në formë tabelare si vijon:

Nr.	Kodi i kampionit	Emërtimi i Lumit	Vendndodhja	Koordinatat gjeografike
1.	Ma1	Fani i Madh	Ndërfushë, ndërmjet urave Milo-Kukës dhe Milot - Rrëshen	N41.775874 E19.859456
2.	Ma2	Fani i Vogël	Bukemirë-Ura e Vjetër Milot -Kukës që të lidh me Rrugën e Kombit	N41.779305 E19.855054
3.	Ma3	Lumi Mat	Klos - Darsë	N41.506614 E20.083041
4.	Ma4	Lumi Mat	Ura e Re Tiranë - Shkodër	N41.685437 E19.671641



Ujërat janë të ngopura me oksigjen. Përsa i përket NBO₅ (Nevoja Biokimike për Oksigjen), stacionet rezultojnë me cilësi të mirë, të klasifikuara në **Klasën II - Cilësi e mirë**.





Përmbajtja e nitriteve, nitrateve, amoniakut, ortofosfateve dhe fosforit total është nën normën e lejuar, duke i klasifikuar këto stacione në **Klasën I – Gjendje e lartë**.

Duke vlerësuar të gjithë parametrat bazë të Direktivës Kuadër të Ujit, vlerësojmë se ujërat e Basenit të Matit klasifikohen në **Klasën II – Gjendje e mirë.**

Metalet e rënda të matura në kampionet e ujërave të basenit Mat janë paraqitur në tabelën përkatëse.

Tabela 10: Rezultate e vlerësuar të metaleve të rënda në Basenin e Matit dhe krahasimi me normat e përcaktuara nga DKU për vitin 2022

Nr.	Parametri i matur	Simboli	Njësia	Klasifikimi Direktiva e Kuadër të Ujit (75/440/EEC)			Stacionet				
				A1 E mirë	A2 E moderuar	A3 E keqe	Ura Milot-Rrëshen	Ura e vjeter Milot-Kukës	Ura e re Tirane - Shkodër	Kune Vaini para derdhjes ne det	Darse
1.	Arsenik	As	µg/l	<50	50	>100	n.d.	n.d.	1	n.d.	n.d.
2.	Kadmi-um	Cd	µg/l	<1	5	>5	n.d.	n.d.	n.d.	0.44	n.d.
3.	Bakër	Cu	µg/l	<50	100	>1000	0.875	0.54	1.755	1.3785	4.015
4.	Plumbi	Pb	µg/l	<50	50	>50	47.16	2.67	13.125	17.96	5.63
5.	Mërkuri	Hg	µg/l	<1	1	>1	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.

Shënim: n.d – nuk dedektohet

Përqëndrimi i metaleve të rënda rritet natyrshëm nga proceset litogjenike si dhe nga aktivitetet antropogjene (p.sh. depozitimi atmosferik, largimi i ujërave të zeza, rrjedhjet, mbetjet industriale dhe rrjedhjet bujqësore).

Nga tabela e mësipërme vërehet se niveli i metaleve të rënda është poshtë limitit të dedektimit, me përjashtim të **Kadmiumit**, që u gjend në stacionin e Kune Vain, por që është poshtë nivelit të rekomanduar sipas

direktivës, duke e klasifikuar në **Klasën A1 - Gjendje e mirë**.

Plumbi dhe bakri u gjend në të gjitha stacionet por rezulton poshtë nivelit të rekomanduar sipas direktivës. Referuar rezultateve për metalet e rënda, ujërat e basenit Mat klasifikohen në **Klasën A1 - Gjendje e mirë**.

Baseni i Shkumbinit

Monitorimi i këtij baseni është kryer në 4 stacione kampionimi në të gjithë gjatësinë e tij, të cilat janë paraqitur në formë tabelare si vijon.

Nr.	Kodi i kampionit	Emërtimi i Lumit	Vendndodhja	Koordinatat gjeografike
1.	Sh1	Lumi i Shkumbinit	Qukës-500 mbi fshatin Qukës	N41.070265 E20.467855
2.	Sh2	Lumi i Shkumbinit	Ura Toplias	N41.097940 E20.081447
3.	Sh3	Lumi i Shkumbinit	Ura e Paprit	N41.052378 E19.942619
4.	Sh4	Lumi i Shkumbinit	Ura Rrogozhinë	N41.062902 E19.645174

Vlerat mesatare vjetore të ekspeditave të realizuara janë paraqitur në formë grafike si vijon:

Stacionet dëshmojnë për ujëra të ngopura me oksigjen duke i klasifikuar ujërat e Basenit të Shkumbinit në **Klasën I - Gjendje e lartë**.

NBO5, ky parametër është i rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve si një tregues i shkallës së ndotjes. Tejkallim të vlerës limite për këtë parametër nuk ka në asnjë nga stacionet e monitoruara.

Përqëndrimi i amoniakut paraqitet të jetë nën normën e lejuar për të gjitha stacionet duke u klasifikuar në **Klasën II - Gjendje e mirë**.

Përmbajtja e nitriteve, nitrateve, orto - fosfateve dhe fosforit total është nën normën e lejuar duke i vlerësuar të katër stacionet e monitorimit të këtij baseni në **Klasën I - Gjendje e lartë**.

Duke marrë në konsideratë të gjithë parametrat e DKU, vlerësojmë se ujërat e Basenit të Shkumbinit klasifikohen në Klasën e III - Gjendje e moderuar.

Përsa i përket përmbajtjes së metaleve të rënda, Baseni ujor i Shkumbinit, me qendër në Elbasan është monitoruar në 5 stacione, vendndodhja e të cilave paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 12. Rezultate e vlerësuara të metaleve të rënda në Basenin e Shkumbinit dhe krahasimi me normat e përcaktuara nga DKU, për vitin 2022

Parametri i matur	Simboli	Njësia	Klasifikimi Direktiva e Kuadër të Ujit (75/440/EEC)			Stacionet				
			A1 E mirë	A2 E moderuar	A3 E keqe	Qafe -Pllloc	Quk s	Ura Toplias	Ura Paprit	Ura Rrogozhine
Arsenik	As	µg/l	<50	50	>100	2.2	n.d.	2.2	3.5	2.5
Kadmium	Cd	µg/l	<1	5	>5	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.
Bakër	Cu	µg/l	<50	100	>1000	1.735	0.335	0.47	0.505	1.475
Plumbi	Pb	µg/l	<50	50	>50	19.275	9.615	8.235	12.915	13.75
Mërkuri	Hg	µg/l	<1	1	>1	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.

Vihet re se ka prezencë të **Arsenikut, Plumbit dhe Bakrit**. Niveli i këtyre elementeve në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më të ulëta se norma e lejuar, duke i klasifikuar ujërat e basenit Shkumbin në **Klasën A1 - Gjendje e mirë**.



Baseni Vjosë


Baseni i Vjosës monitorohet në 5 pika monitorimi të cilat paraqiten në formë tabelare si vijon:

Nr.	Kodi i kampi-onit	Emërtimi i Lumit	Vendndodhja	Koordinatat gjeografike
1.	Vj1	Lumi i Vjosës	Çarshovë-pas fshatit Petran	N40.206037 E20.42145
2.	Vj2	Lumi i Vjosës	Ura e qytetit	N40.234072 E20.354869
3.	Vj3	Lumi Drino	Ura e Leklit - Tepelenë	N40.259037 E20.055159
4.	Vj4	Lumi i Vjosës	Ura Memaliaj	N40.351397 E19.972733
5.	Vj5	Lumi i Vjosës	Ura e Mifolit - Vlorë	N40.634750 E19.461599

Vlerësojmë se ujërat e këtyre 5 stacioneve të monitoruara janë ujëra të pasura me oksigjen duke i klasifikuar në Klasën I - Gjendje e lartë.

Nevoja Biokimike për oksigjen për të gjithë stacionet është brenda vlerës limite të lejuar duke i klasifikuar stacionet me cilësi të mirë.





Përmbajtja e nitrateve është brenda normës së lejuar.

Përmbajtja e nitriteve dhe nitrateve në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera shumë më të ulëta se norma e lejuar duke i klasifikuar në Klasën I – Gjendje e lartë të gjitha stacionet e monitoruara.

Referuar të dhënave mesatare, vlerësojmë se nuk kemi tejkallim të vlerës limite të përmbajtjes së orto – fosfateve dhe fosforit total duke i klasifikuar këto stacione në Klasën I – Gjendje e lartë përse i përket përmbajtjes së fosforit.



Duke marrë në konsideratë të gjithë parametrat e DKU, vlerësojmë se stacionet e Basenit të Vjosës klasifikohen si ujëra me cilësi të mirë të cilat renditen në Klasën II – Gjendje e mirë.

Baseni Seman



Baseni i Semanit monitorohet në 8 pika monitorimi në të gjithë gjatësinë e tij të cilat paraqiten në formë tabelare si vijon:

Nr.	Kodi i kampionit	Emërtimi i Lumit	Vendndodhja	Koordinatat gjeografike
1.	Dv0	Lumi i Semanit	Bilisht-Ura e Treshit	N40.4101 E21.0056
2.	Dv1	Lumi Devoll	Kuçovë-Ura Kuçovë Kozarë	N40.828639 E19.910801
3.	Os1	Lumi Osum	Ura Lapan	N40.254252 E20.171348
4.	Os2	Lumi i Osumit	Fshati Uznovë	N 40.689065 E19.973427
5.	Os3	Lumi i Osumit	Ura Vajgurore	N40.774274 E19.874563
6.	Gj4	Lumi Gjanicë	Ura e Qytetit Fier	N40.73383 E19.572400
7.	Se5	Lumi Seman	Ura e Mbrostarit	N40.750471 E19.579492
8.	Se6	Lumi Seman	Mujalli, Libofshë	N40.785391 E19.564659


Vlerat mesatare vjetore të ekspeditave të realizuara janë paraqitur në formë grafike si vijon;



Ujërat paraqiten të jenë të ngopura me oksigjen. Stacioni Gj4 – Ura e qytetit ka një përmbajtje të lartë të NBO_5 duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën IV – Gjendje e Varfër, pasi impakti i shkarkimeve urbane dhe industriale të qytetit është i ndjeshëm.



Përmbajtja e nitriteve është nën normën e lejuar duke i vlerësuar në cilësi të mirë, Klasa I – Gjendje e Lartë. Në stacionin Gj4 – Ura e qytetit Fier me një përmbajtje të lartë të amonjakut duke e klasifikuar në Klasën V – Gjendje e keqe, ndotje e cila kërkon marrjen e masave të menjëhershme.



Përmbajtja e nitrateve është brenda normës së lejuar.

Referuar të dhënave mesatare, vlerësojmë se nuk kemi tejkalim të vlerës limite të përmbajtjes së orto – fosfateve duke i klasifikuar këto stacione në cilësi të mirë dhe të moderuar për stacionin Gj4 – Ura e qytetit.

Referuar vlerave mesatare vjetore vlerësojmë se stacionet nuk e tejkalojnë vlerën e lejuar, përmbajtja e të cilave varion nga 0.007 mg/l – 0.19 mg/l, ku vlera më e lartë është matur në stacionin Gj4 – Ura e qytetit Fier.

Duke marrë në konsideratë të gjithë parametrat e DKU, vlerësojmë se Baseni i Semanit klasifikohet në Klasën V- gjendje e keqe me një ndotje të lartë në stacionin Gj4 – Ura e qytetit Fier ku impakti i shkarkimeve urbane dhe industriale është shumë i madh.

Përmbajtja e metaleve të rënda në ujërat e basenit Vjosë-Seman është relativisht e ulët dhe në përgjithësi nuk paraqet kërcënim për biotën ujore.

Lumi Vjosë dhe Seman

Tabela 13: Rezultatet e vlerësuara të metaleve të rënda në Tepelenë – Vjosë, Gjanicë, Seman dhe krahasimi me normat e përcaktuara nga DKU për vitin 2022

Nr.	Parametri i matur	Simboli	Njësia	Klasifikimi i Direktivës Kwadër të Ujit (75/440/EEC)			Stacionet							
				A1 E mirë	A2 E moderuar	A3 E keqe	Ura Leklit- Tepelenë	ParaÇarshovës, pas fshatit Petran	Ura në qytetin e Përmetit	Ura Memaliaj	Ura e MifolitVlorë	Ura e qytetit Fier	Ura Mbrostarit	Libofsh
1.	Arsenik	As	µg/l	<50	50	>100	1.5	4.5	7.5	5.5	7.5	5	5	7.5
2.	Kadmium	Cd	µg/l	<1	5	>5	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.
3.	Bakër	Cu	µg/l	<50	100	>1000	0.47	0.685	0.875	0.73	1.685	1.731	0.79	0.825
4.	Plumbi	Pb	µg/l	<50	50	>50	10.574	6.539	8.987	12.62	12.73	14.655	14.925	15.865
5.	Mërkuri	Hg	µg/l	<1	1	>1	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.

Bazuar këtyre vlerave vërehet se niveli i metaleve të matura është brenda normave të lejuara duke i klasifikuar këto ujëra të nivelit **A1- ujëra të mira**. Referuar tabelës së mësipërme, duket qartë që është identifikuar prezencë e **Arsenikut**. Por bazuar këtyre vlerave vërehet, se niveli i metaleve të matura është brenda normave të lejuara, duke i klasifikuar këto ujëra në **Klasa A1-ujëra të mira**.

Lumi i Osumit

Monitorimi në basenin ujqor të Osumit, është realizuar në 3 stacione kampionimi me frekuencë 2 herë në vit.

Tabela 14. Rezultate e vleresuara të metaleve të rënda në Basenin e Osumit dhe krahasimi me normat e përcaktuara nga DKU,për vitin 2022

Nr.	Parametri imatur	Simboli	Njësia	Klasifikimi Direktiva e Kwadërtë Ujit (75/440/ EEC)			Stacionet		
				A1 E mirë	A2 E moderuar	A3 E keqe	Ura Lapan	Ura Uznove	Ura Vajgurore
1.	Arsenik	As	µg/l	<50	50	>100	2.5	3	2.5
2.	Kadmium	Cd	µg/l	<1	5	>5	n.d.	n.d.	n.d.
3.	Bakër	Cu	µg/l	<50	100	>1000	0.3425	0.3335	0.7745
4.	Plumbi	Pb	µg/l	<50	50	>50	7.7	11.87	6.53
5.	Mërkuri	Hg	µg/l	<1	1	>1	n.d.	n.d.	n.d.

Referuar tabelës përmbledhëse, duket qartë që janë identifikuar prezencë të **Arsenikut**, **Bakrit** dhe **Plumbit**. Niveli i metaleve të matura është brenda normave të lejuara duke i klasifikuar këto ujëra të **Klasa A1-ujëra të mira**.

Lumi Devoll





Gjatë këtij monitorimi u vërejt prania e **elementit As ,Cu dhe Pb**. Por pavarësisht këtyre gjetjeve gjurmë vërehet, se niveli i metaleve të matura është brenda normave të lejuara duke i klasifikuar këto ujëra të **Klasa A1 -ujëra të mira**.




Tabela 15. Rezultatet e vlerësuara të metaleve të rënda në lumin Devoll dhe krahasimi me normat e përcaktuara nga DKU, për vitin 2022

Parametri i matur	Simboli	Njësia	Klasifikimi Direktiva e Kuadër të Ujit (75/440/EEC)			Stacionet	
			A1 E mirë	A2 E moderuar	A3 E keqe	Kozar	Miras
Arsenik	As	µg/l	<50	50	>100	4.5	5.5
Kadmium	Cd	µg/l	<1	5	>5	n.d.	n.d.
Bakër	Cu	µg/l	<50	100	>1000	0.4	n.d.
Plumbi	Pb	µg/l	<50	50	>50	12.28	10.685
Mërkuri	Hg	µg/l	<1	1	>1	n.d.	n.d.

Vlerësimi i lumenjve sipas parametrave

Në grafiket e mëposhtëm paraqitet vlerësimi i lumenjve për secilin parametër në mënyrë që të kemi një vështrim të përgjithshëm mbi gjendjen e cilësisë të ujërave referuar rezultateve për vitin 2022.





Përsa i përket përmbajtjes së **oksigjenit të tretur** lumenjtë klasifikohen në Kl I-Gjendje e lartë duke përjashtuar lumin Ishëm i cili vlerësohet në Kl III- Gjendje e moderuar.

Lidhur me përmbajtjen e **NBO_{5'}** lumenjtë Drin, Mat, Vjosa, Devoll klasifikohen në Kl II- Gjendje e mirë, lumenjtë Buna, Kir, lumi Tirana, Erzen, Shkumbin, Osum dhe Seman në Kl III-Gjendje e moderuar. Lumi Gjanica dhe Ishmi vlerësohen në Kl IV- Gjendje e varfër ndërsa Lumi Lana në Kl V-Gjendje e Keqe.

Për përmbajtjen e **nitrateve** të gjithë lumenjtë vlerësohen në Kl I- Gjendje e lartë me përjashtim të lumit Gjanica në Kl II - Gjendje e mirë. Referuar rezultateve për përmbajtjen e **nitriteve** vlerësohet se lumenjtë Mat, Lana, Ishmi dhe Erzen klasifikohen në Kl II- Gjendje e mirë, ndërsa lumenjtë e tjerë janë në Kl I-Gjendje e lartë.

Përsa i përket përmbajtjes së **amonjakut** vlerësohet se ujërat e lumenjve Kir, Mat, Shkumbin, Vjosa, Devoll, Osum dhe Seman janë në Kl I- Gjendje e lartë. Lumenjtë Buna, Drin dhe Erzen klasifikohen në Kl II- Gjendje e Mirë. Ujërat e lumit Gjanica vlerësohen në Kl IV- Gjendje e varfër, ndërsa të lumit Ishmi, Lana dhe lumi Tirana në Kl V- Gjendje e keqe.

Referuar përmbajtjes së **ortofosfateve** rezulton se ujërat e lumi Tirana, Ishmi dhe Gjanica i përkasin Kl III- Gjendje e moderuar

ndërsa ujërat e lumi Lana vlerësohen në Kl V-Gjendje e keqe. Lumenjtë e tjerë vlerësohen në Kl I-Gjendje e lartë.

Përmbajtja më e lartë e **fosforit total** vihet re në lumin Lana duke i klasifikuar ujërat në Kl IV- Gjendje e varfër duke vijuar me Lumi Ishëm në Kl III- Gjendje e moderuar dhe lumi Gjanica në Kl II- Gjendje e mirë. Ujërat e lumenjve të tjerë vlerësohen në Kl I- Gjendje e lartë.

Tendenca në vite


Bazuar mbi të dhënat e tendencës në vite, vërehet se kemi përmirësim të cilësisë të ujërave të basenit Drinit-Bunë në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021, duke kaluar nga Klasa IV- Gjendje e varfër, në Klasa III-Gjendje e moderuar.

Viti	Baseni Drini-Bunë	Baseni Ishëm- Erzen	Baseni i Shkumbinit	Baseni i Semanit	Baseni i Vjosës	Baseni i Matit
2018	Klasa III	Klasa V	Klasa IV	Klasa V	Klasa II	Klasa III
2019	Klasa IV	Klasa V	Klasa III	Klasa V	Klasa III	Klasa II
2020	Klasa IV	Klasa V	Klasa III	Klasa V	Klasa II	Klasa III
2021	Klasa IV	Klasa V	Klasa II	Klasa V	Klasa II	Klasa III
2022	Klasa III	Klasa V	Klasa III	Klasa V	Klasa II	Klasa II

Po ashtu edhe në Basenin e Matit kemi përmirësim duke kaluar nga ujëra të cilësisë së moderuar-Klasa III, në Klasa II- Gjendje e mirë e ujërave. Kurse Baseni i Shkumbinit ka një përkeqësim të cilësisë së ujërave duke kaluar nga Klasa II-gjendje e mirë, në Klasa III -gjendje e moderuar. Dy basenet e tjera si ai i Ishëm-Erzen dhe i Semanit i përkasin të njejtës cilësi si në 2021 dhe në 2022

- **Tributarët (Lumi i Pogradecit, Lumi Vërdovë, Lumi Tushemisht)**

Cilësia e Tributarëve të cilët derdhen në liqen




Referuar vlerave mesatare të amoniakut, Lumi i Pogradecit paraqitet në gjendje të mirë me një vlerë mesatare 0.016 mg/l, në Lumini e Vërdovës përmbajtja mesatare është 0.35mg/l duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën III – Gjendje e moderuar dhe Lumi i

Në të tre stacionet e monitoruara nuk ka përmbajtje të nitriteve.

ndikon në cilësinë e liqenit të Ohrit.


- ✓ Temperaturat mesatare të ujërave variojnë në përputhje me ndryshimet sezonale.
- ✓ Ujërat e këtyre tre lumenjve vlerësohen alkaline me pH < 8.5, me vlera që variojnë nga 7.87 – 7.98.

Përmbajtja mesatare e nevojës biokimike për oksigjen në Lumini e Pogradecit dhe në Lumini e Tushemishtit klasifikohen në Klasën II – Gjendje e mirë ndërsa Lumi Vërdovës klasifikohet në Klasën IV – Gjendje e varfër.



Tushemishtit plotëson kushtet për ujëra me cilësi të lartë.

Prania e nitrateve në ujërat e lumenjve vjen kryesisht nga përdorimi i plehrave kimike në bujqësi në tokat rreth zonës së kampionimit.



Referuar rezultateve mesatare të monitorimit për përmbajtjen e fosforit, Lumi i Pogradecit dhe Tushemishtit klasifikohen në Klasën I – Gjendje e lartë dhe Lumi i Vërdovës klasifikohet në Klasën IV – Gjendje e varfër

Kurse për përmbajtjen e fosforit total në stacionet Lumi i Pogradecit dhe Tushemishtit vlerësohen brenda normës së lejuar, ndërsa në stacionin e Vërdovës është në vlerën 0.62 mg/l duke u klasifikuar në Klasën IV - Gjendje e varfër

Lumi i Pogradecit

Nr.	Parametri	Vlera mesatare vjetore	Norma	Klasifikimi
1.	NBO ₅	3.3 mg/l	< 7	Gjendje e mirë – Klasa II
2.	Përmbajtja e amonjakut	0.016 mg/l	< 0.6	Gjendje e lartë – Klasa I
3.	Përmbajtja e nitriteve	0.0024 mg/l	< 0.12	Gjendje e lartë – Klasa I
4.	Përmbajtja e nitrateve	1.42 mg/l	< 4	Gjendje e mirë – Klasa II
5.	Përmbajtja e orto-fosfateve	0.023 mg/l	< 0.2	Gjendje e lartë – Klasa I
6.	Përmbajtja e fosforit total	0.028 mg/l	< 0.4	Gjendje e lartë – Klasa I

Lumi i Pogradecit referuar rezultateve të monitorimit rezulton të jetë lumë i cilësisë së mirë dhe klasifikohet në Klasa II.

Lumi Vërdovë

Nr.	Parametri	Vlera mesatare vjetore	Norma	Klasifikimi
1.	NBO ₅	11.3 mg/l	< 7	Gjendje e varfër – Klasa IV
2.	Përmbajtja e amonjakut	0.35 mg/l	< 0.6	Gjendje e moderuar – Klasa III
3.	Përmbajtja e nitriteve	0.0024 mg/l	< 0.12	Gjendje e lartë – Klasa I
4.	Përmbajtja e nitrateve	0.65 mg/l	< 4	Gjendje e lartë – Klasa I
5.	Përmbajtja e orto-fosfateve	0.53 mg/l	< 0.2	Gjendje e varfër – Klasa IV

Lumi i Vërdovës referuar gjithë parametrave të mësipërm klasifikohet në një lumë **me cilësi të varfër** ku nevoja biokimike për oksigjen dhe përmbajtja e lartë e amonjakut dëshmojnë për shkarkime urbane të cilat derdhen direkt pa asnjë trajtim paraprak

Lumi Tushemishtit

Nr.	Parametri	Vlera mesatare vjetore	Norma	Klasifikimi
1.	NBO ₅	3 mg/l	< 7	Gjendje e mirë – Klasa II
2.	Përmbajtja amonjakut	0.028 mg/l	< 0.6	Gjendje e lartë – Klasa I
3.	Përmbajtja e nitriteve	0.0022 mg/l	< 0.12	Gjendje e lartë – Klasa I
4.	Përmbajtja e nitrateve	0.32 mg/l	< 4	Gjendje e lartë – Klasa I
5.	Përmbajtja e orto-fosfateve	0.015 mg/l	< 0.2	Gjendje e lartë – Klasa I
6.	Përmbajtja e fosforit total	0.019 mg/l	< 0.4	Gjendje e lartë – Klasa I

Lumi i Tushemishtit referuar parametrave të statusit kimik vlerësohet në ujëra me cilësi të mirë në **Klasën II**.

Metalet e rënda

Vlerësimi për metalet e rënda në lumenjtë e Pogradecit, Verdovës dhe Tushemishtit paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela: 16 Rezultatet e vlerësuar të metaleve të rënda për tributarët dhe krahasimi me normat e përcaktuara nga DKU për vitin 2022

Parametri i matur	Simboli	Njësia	Klasifikimi Direktiva e Kuadër të Ujit (75/440/EEC)					
			A1 E mirë	A2 E Moderuar	A3 E keqe	Lumi Pogradecit	Lumi Verdovës	Lumi i Tushemishtit
Arsenik	As	µg/l	<50	50	>100	5	6.5	7
Kadmium	Cd	µg/l	<1	5	>5	n.d.	n.d.	n.d.
Bakër	Cu	µg/l	<50	100	>1000	0.795	0.86	0.55
Plumbi	Pb	µg/l	<50	50	>50	11.03	23.535	5.855
Mërkuri	Hg	µg/l	<1	1	>1	n.d.	n.d.	n.d.

Referuar vlerave shihet se nuk kemi prani të elementëve kadmium dhe mërkur në të tre lumenjtë. Përmbajtja e metaleve arsenik, bakër dhe plumb nuk tejkalon vlerat limite të DKU duke i vlerësuar ujërat e lumenjve në **Klasën A1- cilësi e mirë**

Tendenca në vite

Vërehet se kemi përmirësim të cilësisë të ujërave të Lumit të Verdovë në vitin 2022 krahasuar me vitet e mëparshme. Lumi i Pogradecit ka një përkeqësim të cilësisë, nga Klasa I- Gjendje e lartë në vitin 2021, në Gjendje të mirë-Klasa II të klasifikimit të ujërave për vitin 2022.

Po kështu për Lumin e Tushemishtit nga Klasa I -Gjendje e lartë, në Klasa II-Gjendje e mirë.


Viti	Lumi i Pogradecit	Lumi i Verdovës	Lumi i Tushemishtit
2018	Klasa II- Gjendje e mirë	Klasa V- Gjendje e keqe	Klasa II- Gjendje e mirë
2019	Klasa II- Gjendje e mirë	Klasa V- Gjendje e keqe	Klasa II- Gjendje e mirë
2020	Klasa II- Gjendje e mirë	Klasa V- Gjendje e keqe	Klasa I - Gjendje e lartë
2021	Klasa I - Gjendje e lartë	Klasa V- Gjendje e keqe	Klasa I - Gjendje e lartë
2022	Klasa II-Gjendje e mirë	Klasa IV-Gjendje e varfër	Klasa II- Gjendje e mirë

Liqenet

Liqeni i Prespës, është njëri ndër liqenet me ujëra të freskëta në Evropë që u takon tre shteteve Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë dhe Greqisë me një sipërfaqe të përgjithshme prej 318.9 km² nga të cilat 38.8 km Shqipërisë. Prespa është liqeni më i lartë tektonik në Ballkan me 853 metra mbi nivelin e detit. Liqenet e Prespës janë një pellg me dy liqene të ndërlidhur: Prespa e vogël (i ndarë midis Shqipërisë dhe Greqisë) dhe Prespa e madhe (i ndarë midis Shqipërisë, Greqisë dhe Maqedonisë). Liqeni ka pësuar shumë presione në dyzet vitet e

fundit, me efekte të dëmshme në shëndetin e ujit, si rritja e shpejtë e biomasës që rrjedh nga praktikat bujqësore, erozioni, mbetjet e patrajuara dhe ujërat e zeza.

Për vlerësimin e cilësisë së ujërave të liqeneve bazohemi në vlerat limite të parametrave kimikë të DKU të BE, për përcaktimin e gjendjes së liqenit.



Liqeni i Shkodrës është liqeni më i madh në Gadishullin Ballkanik dhe llogaritet si një nga liqenet më të vjetra në botë. Gjithashtu edhe Drini është lumi më i gjatë i trojeve shqiptare me 335 km gjatësi në total. Drini formohet afër qytetit të Kukësit me bashkimin e dy degëve kryesore të tij: Drinit të Bardhë që buron afër Pejës, Kosovë, dhe Drinit të Zi që buron në Strugë, Maqedonia e Veriut, nga pjesa veriore e Liqenit të Ohrit.

Liqeni i Ohrit llogaritet si një nga liqenet më të vjetra në mbarë botën. Ai gjendet në një lartësi mbidetare prej 695 metrash dhe ka një sipërfaqe prej 349 km. Pika më e thellë e liqenit është 289 metra. Pjesa më e madhe e liqenit i përket Maqedonisë së Veriut, kurse pjesa tjetër i përket Shqipërisë. Në bregun e liqenit shtrihen tre qytete të mëdha: Ohri dhe Struga në Maqedoninë e Veriut dhe Pogradeci në Shqipëri.

Vlerat limite të cilësisë së ujërave të liqeneve sipas DKU

Parametrat	Njësia matëse	Vlerat limite për përcaktimin e gjendjes		
		Oligotrofik	Mezotrofik	Eutrofik
Transparenca	m	5-10 (max 15-20)	1-2 (max.5-10)	<1 (max 2-3)
Nevoja Kimike për Oksigjen (NKO)	mg O ₂ /l	1-2	8-9	20-65
Nevoja Biokimike për Oksigjen(NBO ₅)	mg O ₂ /l	<3	3-5,5	5,5-14
Nitrate (NO ₃ -N)	mg N/l	<1	<1	>2
Fosfor total (P- total)	µg P/l	4-10	10-35	35-100

Indeksi i gjendjes trofike Karlson (TSI)

Indeksi TSI	Përshkrimi
TSI <30	Oligotrofi klasike; ujëra të qarta, oksigjen gjatë gjithë vitit në shtresën lipolimnion, peshq në thellësi.
TSI 30-40	Liqenet e thellë paraqiten oligotrofe klasike, por ujërat e cekta bëhen anoksike gjatë verës.
TS 40-50	Ujëra akoma të qarta, por rritet probabiliteti i anoksisë në shtresën hipolimnom gjatë verës.
TS 50-60	Nivel i ulët i eutrofisë klasike: reduktim i transparencës, anoksi në hipolimnion gjatë verës, makrofite të pranishme, peshq të ujërave të ngrohta.
TSI 60-70	Predomonojnë algat blu-të gjelbërta, shkuma e algave e mundshme, prani e vlerësueshme e makrofiteve.
TSI 70-80	"Bloom" i algave gjatë verës, shtresë e dëndur makrofite, po me shtrirje të kufizuar për shkak të depërtimit të dritës. Shpesh gjendja mund të klasifikohet si hipereutrofike.
TSI > 80	Shkumë algash, peshq të ngordhur gjatë verës, makrofitet, dominojnë peshq rezistentë.

Vlerësimi i cilësisë të liqeneve për përmbajtjen e metaleve të rënda bazohet mbi vlerat limite të DKU për lumenj (tabela 3 e këtij kapitulli).

Liqeni i Shkodrës

Monitorimi i Liqenit të Shkodrës realizohet në tre stacione në Koplik (Stërbec), Shirokë dhe Zogaj, ku në çdo pikë monitorimi janë kampionuar mostra në 2 thellësi të ndryshme: 0 m dhe 10m.



Liqeni i Shkodrës është një liqen me thellësi relativisht të vogël, ku mungon fenomeni i shtresëzimit, përzierjes së ujit.

Vlerat mesatare të transparencës së ujit variojnë nga 0.85 m – 1.1 m duke i klasifikuar ujërat me cilësi eutrofike.




Referuar vlerave mesatare të përmbajtjes kimike për oksigjen në të tre stacionet e Liqenit të Shkodrës vlerësojmë se ujërat e liqenit janë të cilësisë mezotrofike.

Nevoja biokimike për oksigjen paraqitet me vlera të cilat i klasifikojnë ujërat e liqenit në cilësi mezotrofike në stacionin e Shirokës dhe oligotrofike në Koplik dhe Zogaj.



Përmbajtja e Nitateve rezulton të plotesojë kushtet për cilësi oligotrofike, pasi vlerat mesatare të monitorimit janë < 1 mgN/l.



Përmbajtja mesatare e Fosforit total në stacionet e monitorimit të Liqenit të Shkodrës është 0.005 mg/l, duke i klasifikuar këto ujëra me cilësi oligotrofike.

Duke u nisur nga rezultatet e marra, **Kadmium** ngelet i pa identifikuar në të gjithë stacionet, me përjashtim të stacionit Zogaj zero metra. Burimet për këtë nivel të elementit Cd, mund të vijnë në mjedis përmes ajrit nga minierat dhe shkrirja e tij, si dhe nga rrugët e tjera të krijuara nga njeriu, përdorimi i plehrave fosfatike, prania në llumrat e ujërave të zeza, dhe përdorime të ndryshme industriale si bateritë me Ni, Cd, veshje, pigmente dhe plastika. Në stacionet e tjera përmbajtja e metaleve të rënda është brenda normave. Kështu që këto pika kampionimi mund të klasifikohen si ujëra të klasës së parë **A1-Cilësi e mirë**.

Kurse ujërat sipërfaqësorë tek stacioni Zogaj, duke u nisur nga niveli i Kadmiumit (Cd) mund të klasifikohen në klasën e dytë -A2 si ujëra me cilësi të moderuar

Liqeni i Ohrit

Monitorimi i Liqenit të Ohrit është realizuar në dy pika, ku stacioni i parë është stacion referencë në thellësi 150 metra, dhe mostrat merren në 8 thellësi nga sipërfaqja deri në


fund të liqenit e përkatësisht 0, 20, 40, 60, 80, 100, 120, 150 m, kurse stacioni nr.2 është 200 m nga bregu, përballë qytetit, në thellësi mbi 5 metra.

Liqeni i Ohrit karakterizohet nga fenomeni i shtresëzimit, për shkak të thellësisë së tij, gjë që duket qartë nga ndryshimet e vlerave të temperaturës nga sipërfaqja deri në thellësi.

Përgjatë këtij viti, monitorimi në stacionin e referencës është realizuar vetëm një herë, nga tre ekspedita që duhet të realizohen dhe kjo për shkak të varkës e cila është në varësi të Ministrisë së Bujqësisë. Në stacionin litoral monitorimi është realizuar në të tre ekspeditat.



Transparenca e matur në stacionin e referencës ka një vlerë mesatare 7.6 m i cili është një tregues i oligotrofisë së këtij liqeni, ndërsa në stacionin litoral transparenca është në vlerën 4.6 m.

Ujërat e liqenit janë të ngopura me oksigjen me vlera që variojnë 7.58 -13mgO/l.



Liqeni i Ohrit për parametrin e transparencës paraqet gjendje oligotrofike në stacionin e referencës, ndërsa në stacionin litoral transparenca është e ulët.

Përmbajtja e nevojës kimike për oksigjen në stacionin e referencës paraqet vlerën 4.25 mg/l, ndërsa në stacionin litoral në vlerën 7 mg/l duke e klasifikuar me cilësi mezotrofike.





Përmbajtja e nevojës biokimike për oksigjen për stacionin e referencës është në vlerën 2.1mgO/l, ndërsa në stacionin litoral është 2.6mg/l duke e vlerësuar në cilësi oligotrofike stacionin litoral.

Liçeni i Ohrit referuar gjithë parametrevë të mësipërm klasifikohet si ujëra me cilësi të mirë, **Klasa A1- Gjendje e mirë.**

Liçeni i Prespës



Vlera mesatare e transparencës për ujërat e liçenit të Prespës së Madhe janë 3.3 m duke e klasifikuar Prespën e Madhe me cilësi mezotrofike dhe në Prespën e Vogël vlera e transparencës është 0.4 m duke e klasifikuar këtë liçen në cilësi eutrofike.

- 1.Prespa e Madhe - cilësi mezotrofike
- 2.Prespa e Vogël - cilësi eutrofike



Përmbajtja e nitrateve

Ky parametër është vlerësuar brenda normës së lejuar < 1mg/l për të gjitha stacionet.



Në të tre stacionet e monitorimit të cilësisë së ujërave të Liçenit të Prespës së Madhe kemi një klasifikim në cilësi mezotrofike të ujërave, ndërsa Prespa e Vogël klasifikohet në cilësi eutrofike.

Përsa i përket nevojës biokimike për oksigjen në të tre stacionet e monitorimit vlerat mesatare variojnë 3 – 3.8 mg/l, në Prespën e Vogël vlera e matur është 5.5 mg/l.

Referuar përmbajtjes mesatare të fosforit total ujërat e monitoruar nuk kanë përmbajtje të fosforit total.

Të dhënat e klorofilës-a për tre stacionet e **Liqenit të Prespës së Madhe dhe stacioni i monitorimit të Prespës së Vogël** paraqiten në formë tabelare si vijon:

Parametri	KL-a (mg/m ³)			
Stacionet	Liqenas	Goricë	Gollomboç	Prespa e Vogël
Vlerat mesatare	4.01	9.23	11.6	1.47

Indeksi trofik për Liqenin e Prespës Madhe dhe Liqenin e Prespës së Vogël

Parametri	TSCI (Indeksi Karlson)			
Stacionet	Liqenas	Goricë	Gollomboç	Prespa e Vogël
Vlerat mesatare	41.94	49.61	51.23	34.42

Bazuar në vlerat e indeksit trofik liqeni i Prespës së Madhe vlerësohet si ujëra akoma të qarta por me një cilësi mezotrofike.

Duke u nisur nga vlerësimi i të gjithë parametrave bazë të mësipërm, vlerësojmë se ujërat e Liqenit të Prespës së Madhe janë të cilësisë mezotrofike, ndërsa ujërat e Prespës së Vogël të cilësisë eutrofike.

Përmbajtja e metaleve

Rezultatet për shpërndarjen e metaleve të rënda në ujërat e liqenit të Prespës janë paraqitur në tabelën e mëposhtme ku është vlerësuar variacioni hapësinor i përqendrimit të secilit element në të gjitha pikat e marrjes së mostrave.


Tabela 18. Rezultate e vlerësuara të metaleve të rënda në liqenin e Prespës dhe krahasimi me normat e përcaktuara nga DKU për vitin 2022

Nr.	Parametri i matur	Simboli	Njësia	Klasifikimi Direktiva e Kuadër të Ujit (75/440/EEC)			Stacionet				
				A1 E mirë	A2 E moderuar	A3 E keqe	Goricë	Gollombocë	Liqenas-Puctec	Prespë	Lumi i Ohrit
1.	Arsenik	As	µg/l	<50	50	>100	2.5	2	4	2.5	5.5
2.	Kadmium	Cd	µg/l	<1	5	>5	n.d	n.d	n.d	n.d	n.d
3.	Bakër	Cu	µg/l	<50	100	>1000	0.345	0.885	0.835	0.9	1.12
4.	Plumbi	Pb	µg/l	<50	50	>50	5.23	4.715	4.685	5.355	12.11
5.	Mërkuri	Hg	µg/l	<1	1	>1	n.d	n.d	n.d	n.d	n.d

Niveli i treguesve është brenda normave të lejuara. Ky liqen klasifikohet në një liqen me cilësi të mirë. **Klasa A1- Gjendje e mirë.**

Tendenca në vite

Referuar rezultateve ndër vite të parametrave kimik dhe biologjik të cilësisë së ujërave të liqeneve, vlerësohet se këto ujëra paraqesin të njëjtën cilësi mezotrofike për periudhën 2018-2022.




3.2.2 Ujërat nëntokësore

Ujërat nëntokësore në gjithë botën janë pasuria më e madhe dhe jetike e secilit vend. Ujërat nëntokësore janë objekt shfrytëzimi i vazhdueshëm, me intensitet të lartë në rritje dhe rrisht të përhershëm ndotje kryesisht të karakterit njerëzor. Pikërisht për këto arsye, kjo pasuri natyrore kombëtare në çdo vend vlerësohet, menaxhohet dhe monitorohet me prioritet dhe ka karakter të përhershëm. Ujërat nëntokësore janë gjithmonë në lëvizje të vazhdueshme. Sasia e ujërave nëntokësore

shtohet (ushqehet) nga rreshjet atmosferike, pra nga rritja e infiltrimit, apo edhe nga akuiferë të tjerë fqinjë. Monitorimi i ujërave nëntokësore synon vlerësimin në sasi dhe cilësi të tyre, sipas një rrjeti të shpërndarë në të gjithë akuiferët e baseneve që shtrihen brenda territorit të vendit. Ky rrjet është përqëndruar kryesisht në akuiferët porozë që kanë edhe shfrytëzimin më të madh për ujë të pijshëm. Monitorimi i ujërave për periudhën 2020-2022 është kryer në dy faza përkatësisht:





Vlerësimi i cilësisë të ujërave nëntokësore kryhet bazuar mbi VKM nr 379 datë 25.05.2016 , Për miratimin e rregullore “Cilësia e ujit të pijshëm”

Parametrat	pH	NH ₄ mg/l	NO ₃ mg/l	NO ₂ mg/l	Mineralizim Përgjithshëm mg/l	Fortësia e përgjithshme °gj	Klor mg/l	Na mg/l	Mg mg/l
Norma VKM 379 (25.05.2016)	6.5-9.5	0.1 (0.5)	50	0.5	1200	10-20(25)	250	200	50

Baseni i Drinit

Monitorimi hidrodinamik dhe hidrokimik i ujërave nëntokësore në akuiferët e basenit të Drinit është kryer dy herë në vit. Në Basenin e Drinit shfrytëzohen rezervat e ujërave nëntokësore për furnizimin me ujë të pijshëm të qyteteve të Shkodrës, Malësisë së Madhe, Tropojës, Pukës, Kukësit, Peshkopisë, Pogradecit si dhe të fshatrave që i përkasin këtyre bashkive.:

Tab. 19 Pikat e monitorimit hidrodinamik dhe hidrokimik për vitet 2020 - 2022 baseni i Drinit

Nr.	Vëndndodhja	X	Y	Baseni	Monitorimi Hidrokimik	Monitorimi Hidrodinamik
1	Bur."Syri i Sheganit" Bajze-M.Madhe (në vitin 2020)	4683311	4367766	Drinit	+	
2	Pusi Grudë-Fushë-M.Madhe (Lokali Brajan)	4670106	4374082	Drinit	+	+
3	St. Hot i Ri Shkodër	4663718	4380025	Drinit	+	
4/1	St. qendror Dobraç-Shkodër(pusi 1)	4662864	4375310	Drinit	+	
4/2	St. qendror Dobraç Shkodër (pusi 2) (në vitin 2021dhe faza e parë 2022)	4662707	4375506	Drinit	+	
4/3	St. qendror Dobraç-Shkodër (pusi 3) (në vitin 2021dhe faza e parë 2022)	4662479	4375666	Drinit	+	
5	Shpimi Kisha e Madhe-Shkodër (në vitin 2020)	4660043	4377626	Drinit	+	
6	St. Berdicë-Shkodër	4655363	4374212	Drinit	+	
7	Stacioni Velipojës, Ura e Gjolulit-Shkodër	4646423	4371249	Drinit	+	
8	Stacioni Blinisht-Lezhë	4638946	4386266	Drinit	+	
9	Stacioni Gocaj-Lezhë	4636628	4386424	Drinit	+	
10	Burim Lin -Pogradec	4548800	4468800	Drinit	+	
11	Burim Tushemisht -Pogradec	4530050	4476700	Drinit	+	
12	Shtoj i Vjetër-Shkodër	4666471	4377341	Drinit		+
13	St. qendror Dobraç-Shkodër	4662865	4375312	Drinit		+
14	Shpimi Karburanti Aliaj	4682391	4370586	Drinit		+

Akuiferi i Mbishkodrës**Vlerësimi sasior 2020-2022**

Qyteti i Shkodrës furnizohet me ujë nga zona e Dobraçit me anë të shpimeve hidrogjeologjike dhe konkretisht nga stacioni i pompimit Dobraç merret sasia e ujit $Q = 800 - 1100$ l/sek.

Shpime të tjera që shfrytëzohen për furnizimin me ujë të popullsisë së disa fshatrave të Shkodrës janë:

- Stacioni i pompimit të Bërdicës me prurje $Q = 100$ l/sek, 2 shpime.
- Stacioni i pompimit të Bahçallëkut me prurje $Q = 100$ l/sek.
- Stacioni i pompimit të Dajçit - Bunës me prurje $Q = 11$ l/sek
- Shpime të tjerë me prurje $Q = 80 - 100$ l/sek
- Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet nga akuiferi i MbiShkodrës është rreth 1200 -1300 l/s, sasi kjo që ka një rritje të lehtë krahasuar me vitet e mëparshme.
- Koeficienti i shfrytëzimit të akuiferit kuaternar zhavorror varion $K = 0.33 - 0.5$

Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet nga akuiferi i Nënshkodrës

- Stacioni i pompimit të Velipojës me prurje $Q = 200 - 300$ l/sek
- Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet nga akuiferi i Nënshkodrës është rreth $Q = 500 - 800$ l/s sasi kjo me një rritje të lehtë krahasuar me vitet e mëparshme.
- Koeficienti i shfrytëzimit $K = 0.3 - 0.4$

Për zonën e Tropojës: Në qytetin e Bajram Currit, furnizimi me ujë të pijshëm bëhet nga burimi Quku i Dunishës ku merret rreth 100 l/sek për qytetin dhe fshatrat për rreth.

Për zonën e Kukësit: Për furnizimi me ujë të pijshëm të qytetit të Kukësit përdoret Gurra e Kolosianit me sasi $Q = 100$ l/sek si dhe burimet e Lojmeve me prurje $Q = 50 - 100$ l/s.

Për Pogradecin: Për qytetin e Pogradecit furnizimi me ujë të pijshëm bëhet nga burimet e Tushemishtit, ku merret një sasi uji rreth 200 l/sek si dhe nga burimi i Linit, Pogradec merret një sasi uji rreth 20 l/s për doganën,

20 l/s për fshatin Lin, 80 l/sek merret për rezervatin e peshkut. Gjithsej $Q = 320$ l/s.

Për qytetin e Krumës Për furnizimin me ujë të pijshëm përdoret burimi Gurra e Krumës me sasi $Q = 100$ l/sek.

Monitorimi hidrodinamik i ujërave nëntokësore të basenit të Drinit gjatë viteve 2020 - 2022 është kryer në shpimet: Shtoj i Vjetër, Grudë Fushë, Dobraç si dhe në shpimin pranë karburat Aliaj. Nga kryerja e monitorimit për vitet 2020 - 2022, rezulton se amplituda e luhatjes së UN varion nga $A = 0.5 - 5.01$ m.

Vlerësimi Hidrokimik 2020-2022. Në bazë të këtij monitorimi rezulton që ujërat nëntokësore në përgjithësi janë të mira dhe brenda standartit të ujit të pijshëm. Fortësia e përgjithshme F_p , - Gjatë monitorimit tre vjeçar 2020 - 2022, vlerat e fortësisë së përgjithshme variojnë nga $F_p = 7.7 - 25.190$ gjermane. Në përgjithësi për akuiferët Shkodër - Nënshkodër, uji është brenda normës së ujit të pijshëm. Nuk ka tendencë rritje të fortësisë së përgjithshme F_p . Vërehen vetëm ndryshime të vogla *stinore*.

Mineralizimi i përgjithshëm M_p - Mineralizimi i përgjithshëm për periudhën 2020-2022 në akuiferin poroz të Shkodër - Nënshkodër, është brenda normës $M_p < 1$ gr/l. Janë ujëra të ëmbla. Vërehet qëndrueshmëri e treguesit të M_p , ndryshimet janë të karakterit *stinor*.

Përmbajtja e amonjakut NH_4 - Përmbajtja e amonjakut NH_4 , për akuiferin kuaternar, ka vlera nga 0 - 0.68 - 2.4 mg/l. Takohet përmbajtje e rritur e NH_4 në zonën e Nënshkodrës si Blinisht dhe Velipojë, si dhe në zonën Hot i Ri dhe Grudë Fushë - Koplik Shkodër. Kjo situatë ka lidhje me mos zbatimin e zonave sanitare dhe përmytjet.

Përmbajtja nitriteve NO_2 - Nitritet janë takuar në vazhdimësi me vlera 0 - 0.73 mg/l në Blinisht, dhe 0.53 në Velipojë. Nuk ka ndotje masive, ato janë shfaqje sporadike.

Përmbajtja e nitrateve NO_3 - varion nga 0 - 29.04 mg/l dhe është brenda standarteve të ujit të pijshëm. Duke përjashtuar stacionin në Grudë.

- **Akuiferi Karbonatik (çarje- karst)**

Monitorimi i cilësisë së ujëra nëntokësorë në akuiferin karbonatik për periudhën 2020 - 2022 është kryer në 3 burimet për vitin 2020 (në Shkodër burimi Syri i Sheganit, në Pogradec (Lin dhe Tushemisht) dhe në 2 burime për vitet 2021 dhe 2022, në Pogradec (Lin dhe Tushemisht), me frekuencë 2 herë në vit dhe konkretisht:

pH ujit - pH i ujit luhatet në vlerat $\text{pH} = 7.23 - 7.85$. Uji është brenda normës së ujit të pijshëm (norma e $\text{pH} = 6,5 - 8,5$). Sipas vlerës së pH (përqëndrimi i jonit të hidrogjenit), ujërat e këtij akuiferi janë alkaline të dobëta me $\text{pH} = 7 - 9$, në ujë mbizotëron joni hidrokarbonat. Në bazë të raportit në % ekuivalente të anioneve të forta (d) me kationet e forta (a) dhe të dobëta (b) për vlerësimin e alkalinitetit, uji i këtij akuiferi është i klasës së II, pra janë ujëra neutrale, në ujë mbizotëron joni hidrokarbonat.

Fortësia e përgjithshme:- Varion në vlera $7.98 - 11.34^0$ gjermane, ndërsa fortësia e përgjithshme mesatare është $F_{p_{mes}} = 9.37^0$ gjermane. Ndryshimet e F_p janë të vogla të karakterit stinor. Ujërat klasifikohen në ujëra të buta.

Mineralizimi i Përgjithshëm M_p - Mineralizimi i përgjithshëm në të dyja fazat e monitorimit gjatë viteve 2020 - 2022 është brenda normës së lejuar dhe varion $M_p = 195.20 - 311.84$ mg/l, pra janë ujëra të ëmbla, tipi i ujit është $\text{HCO}_3 - \text{Ca}$.

Përmbajtja e Nitriteve NO_2 - Në analizat e kryera për të tre vitet nuk vëhet re prania e joneve NO_2 , që tregon për sigurimin e zonave të mbrojtjes sanitare. Vlerat e NO_2 variojnë nga $0 - 0.01$ mg/l.

Përmbajtja e Amonjakut NH_4 , varion në sasinë nga $0 - 0.02$ mg/l. akuiferi karbonatik është i ekspozuar ndaj ndotjeve të freskëta në periudhën ujë shumtë.

Baseni i Matit

Monitorimi hidrodinamik dhe hidrokimik i ujërave nëntokësore ujërave nëntokësorë në akuiferët e basenit të Matit është kryer dy herë në vit. Në basenin e Matit shfrytëzohen rezervat e ujërave nëntokësore, për furnizimin me ujë të pijshëm të qyteteve të Lezhës, Durrës, Laç, Rrëshen, Burrel, etj. si dhe fshatrat që i përkasin këtyre bashkive.

Tab. 20 Rrjeti i monitorimit hidrokimik dhe hidrodinamik për vitin 2020-2022

Nr.	Vendodhja	Y	X	Baseni	Monitorimi Hidrokimik	Monitorimi Hidrodinamik
1	Stacioni Milot	4392925	4617412	Matit	+	
2	Shpimi 18 i Stacionit të Fushë-Kuqes	4386875	4613700	Matit	+	
3	Shpimi 19 i Stacionit të Fushë-Kuqes	4386875	4613700	Matit	+	
4	Shpimet. 26&23 i Stacionit të Fushë-Kuqes	4386125	4613200	Matit	+	
5	Shpimi 197 i Stacionit për fshatin Gurrës	4386625	4615350	Matit	+	
6	Shpimi 176 i Stacionit për Milotin	4390300	4616075	Matit	+	
7	Shp.502 Patok	4382645	4612270	Matit	+	
8	Shp.177, Patok	4382650	4612275	Matit	+	
9	Shpimi 509 i Stacionit për Laçin	4390300	4612675	Matit	+	
10	Shpimi Gorre	4387872	4612913	Matit	+	+
11	Milot puset e Durrësit	4391571	4616023	Matit	+	
12	Shpimi. 50, i stacionit Barbullonjë për Lezhën	4387568	4624812	Matit	+	
13	Shpimi. 52, i stacionit Barbullonjë për Lezhën	4387222	4624404	Matit	+	
14	Shp. 29, Ishull Lezhë, Stacioni i Shengjinit	4387250	4626030	Matit	+	
15	Shp. 62 Rrilë	4387240	4622330	Matit	+	
16	Shp. 6 V, Rrilë	4385305	4621535	Matit	+	
17	Shp. 46, Hoteli i Gjetisë	4388910	4624940	Matit	+	
18	Shp. 87 shpimi i Shënkollit (Kisha Shënkoll)	4386800	4613550	Matit	+	+
19	Pusi afër kompleks Kasmit	4391475	4616133	Matit		+

Vlerësimi sasior 2020-2022**Në akuiferin poroz të Lezhës :**

- Sasia e përgjithshme e ujit që është shfrytëzuar nga akuiferi i Lezhës për vitin 2020 - 2022 është $Q = 850 - 900$ l/sek, sasi kjo me një rritje të lehtë krahasuar me vitet e mëparshme.
- Koeficienti vjetor i shfrytëzimit të akuiferit kuaternar varion $K = 0.5 - 0.6$

Në akuiferin poroz Milot - Fushë-Kuqe:

- Sasia e përgjithshme që është shfrytëzuar nga ky akuifer është $Q = 1600-1700$ l/sek, sasi kjo që është rritur 600 l/s për shtimin e sasisë që furnizon qytetin e Durrësit dhe rrethinat e tij në krahasim me vitet e mëparshme.
- Koeficienti vjetor i shfrytëzimit të akuiferit poroz (kuaternar) varion $K = 0.6-0.7$.

Në akuiferët poroz aluvial të lumenjve Mat dhe Fan

- Sasia e përgjithshme që është shfrytëzuar nga ky akuifer është $Q = 75 - 100$ l/sek, kjo sasi nuk ka ndryshuar krahasuar me vitet e mëparshme.
- Koeficienti vjetor i shfrytëzimit në këtë akuiferit varion $K = 0.2 - 0.3$.

Në akuiferët karbonatikë:

- Sasia e përgjithshme që është shfrytëzuar nga ky akuifer është $Q = 350 - 500$ l/sek. Kjo sasi nuk ka ndryshuar krahasuar me vitet e mëparshme.
- Koeficienti vjetor i shfrytëzimit të akuiferit varion $K = 0.4 - 0.5$.

Vlerësimi hidrodinamik (akuiferët porozë Lezhë dhe Fushë-Kuqe).

Monitorimi hidrodinamik i ujërave

nëntokësorë të basenit të Matit gjatë viteve 2020 - 2022 është kryer në shpimet nr. 87 Shënkoll (pranë Kishës së Shënkollit) për akuiferin e Lezhës dhe në pusin Gorre - Laç për F. Kuqen si dhe pusin afër "Kompleksit Kasmi".

Nga kryerja e këtij monitorimi në këtë basen për vitet 2020 - 2022, rezulton se amplituda e luhatjes së ujërave nëntokësorë varion për akuiferin e Lezhës Kisha Shënkoll është 1.4 m, në Gorre 0.76 m dhe në Fushë Milot 0.44 m për akuiferin e Fushë- Kuqe.

Vlerësimi hidrokimik , 2020 - 2022.**- Në akuiferin poroz të Lezhës :**

Në bazë të këtij monitorimi rezulton që ujërat nëntokësorë në përgjithësi janë të mira dhe brenda standartit të ujit të pijshëm. Më poshtë po japim përshkrimin analitik të përmbajtjes së disa elementëve me të rëndësishëm dhe konkretisht:

Fortësia e përgjithshme Fp - Gjatë monitorimit tre vjeçar 2020 - 2022, vlerat e fortësisë së përgjithshme varion nga $Fp = 0.7 - 23.85^{\circ}$ gjermane. Në përgjithësi për akuiferin e Lezhës, uji është brenda normës së ujit të pijshëm. Në shpimet në Rilë, H. Gjuetisë, Shëngjin dhe në Barbullojë. kemi ujëra shumë të buta. Vlera e fortësisë së përgjithshme në të gjitha shpimet e akuiferit të Lezhës për vitin 2021 - 2022 është poshtë vlerës 10° gj.

Vlerat e pH për gjatë viteve 2020 - 2022 janë brenda normës së lejuar për ujë të pijshëm. Vlerat e pH variojnë nga 7.4 - 8.9 dhe sipas vlerës së pH (përqëndrimi i jonit të hidrogjenit) këto ujëra janë të tipit alkaline të dobët.

Mineralizimi i përgjithshëm Mp - Mineralizimi i përgjithshëm në të dyja fazat e monitorimit gjatë viteve 2020 - 2022 është brenda normës së lejuar me përjashtim të vlerave të vitit 2020 për shpimin Nr.6V ku rezulton mbi normën e lejuar. Mineralizimi i përgjithshëm në të gjitha shpimet e akuiferit të Lezhës për vitin 2022 është poshtë vlerës 1200 mg/l që është kufiri i lejuar, duke paraqitur një tendencë të lehtë në rënie e mineralizimit të përgjithshëm për 2022.

Përmbajtja e Na – Vlerat e Na në dy shpimet në Barbullojë luhatet nga 140.82 – 177 mg/l, si dhe vlerat e Na të shpimi H.Gjuetisë luhaten nga 198.4 - 225.3 mg/l, janë mbi normë në fazën e parë të monitorimit. Të gjitha shpimet e tjera janë brenda normës së lejuar. Referuar rezultateve kemi një ulje të lehtë të vlerave të Na për vitin 2022.

Përmbajtja e Klorit: Vlerat e klorit (Cl) në shpimet 50, 52 në Barbullojë, Shëngjin, 62 Rrilë, 6v dhe shpimit 87 varion nga 3.55 – 173.95 mg/l dhe janë brenda normës së lejuar. Tek shpimi Hoteli Gjuetisë, Cl, luhatet 250.28 – 218.33 mg/l, vërehet një ulje brenda normës në të dy matjet e kyera gjatë 2021 - 2022.

Përmbajtja Nitriteve NO₂ - Nitritet janë takuar në mënyrë sporadike në shpimin 46 Hoteli i Gjuetisë gjatë vitit 2022 ku vlerat kanë qënë mbi normën e lejuar. Po ashtu edhe në shpimin nr.50 në Barbullonjë vlera e NO₂ është mbi normën e lejuar. Vlerat e larta të NO₂ në shpimin 46 H. Gjuetisë, vijnë prej mosrespektimit të zonave sanitare, pasi shtëpitë e banimit ndodhen shumë afër me këto stacione.

Përmbajtja e Nitrateve (NO₃) – Vlerat e nitrateve në të gjitha fazat e monitorimit gjatë viteve 2020 - 2022 janë të vogla për akuiferin e Lezhës. Ajo varion nga 0.0 - 20.51mg/l, dhe ky tregues është brenda normës së lejuar për ujë të pijshëm. nga VKM 379.

Përmbajtja e amonjakut NH₄ – Përmbajtja e amonjakut NH₄ në akuiferin e Lezhës për periudhën tre vjeçare 2020 - 2022 variojnë nga 0.01 - 0.5 mg/l ku sipas VKM norma maksimalee lejuar është 0.1 mg/l. Vlera mbi normë u vërejtën për vitin 2021, në stacionet e Barbullojës 50, 52, në Shëngjin dhe tek Hoteli i Gjuetisë. Këto vlera janë zvogëluar duke rënë poshtë vlerave të lejuara, për të dy fazat e monitorimit të vitit 2022.

- **Akuiferi poroz të Milot - Fushë-Kuqes:**

Monitorimi i cilësisë së ujërave nëntokësore në akuiferin Fushë Kuqe është kryer në shpimet që ndodhen në depozitimet kuaternare si shpimi Nr.509 Laç, 18,19 dhe

23 dhe 26 Fushë-Kuqe, 177 dhe 502 Patok, 197 Gurrëz, stacioni i pompimit Milot, shpimi Nr.176 Fushe – Milot, Puset e Durrësit dhe në Gorre. Ujërat nëntokësore të këtij akuiferi në përgjithësi kanë veti të mira fiziko - kimike janë pa erë, pa ngjyrë, pa shije dhe transparente. Temperatura e ujit luhatet në kufinj të 15 - 18.5°C. Në bazë të rezultateve të analizave kimike na rezulton që uji në këtë akuifer është brenda standartit të ujit të pijshëm, me përjashtim të shpimit 177 dhe 502 Patok. Cilësia e ujërave nëntokësore të këtij akuiferi vjen duke u përmirësuar nga përditimi në lindje. Më poshtë po analizojmë elementët më kryesor të përbërjes kimike të këtij akuiferi:

Mineralizimi i përgjithshëm Mp – Mineralizimi i përgjithshëm në të dyja fazat e monitorimit gjatë viteve 2020 - 2022 është brenda normës së lejuar dhe luhatet në kufinj të 236.5 – 512.8mg/l me përjashtim të shpimit 502, në vitin 2020 dhe shpimin 177 në fazën e parë 2022, ku kemi mineralizim të lartë. Vlerat më të ulëta për të tre vitet, paraqiten në St. Pompimit Milot, shpimi 176 Milot, shpimi 197 Gurrëz, shpimet 18, 19, 23 – 26 F. Kuqe, Puset e Durrësit dhe Gorre. Këto ujëra janë të freskëta me kripshmëri të dobët ku mbizotërojnë anionet e HCO₃. Për vitin 2022, në shpimin 502 dhe 177 në Patok mineralizimi i përgjithshëm ka pësuar ulje në krahasim me vitet 2020, 2021.

Vlerat e pH gjatë viteve 2020 – 2022 janë brenda normës së lejuar për ujë të pijshëm Vlerat e pH variojnë nga 7.23-8.24 dhe këto ujëra janë të tipit alkaline të dobët.

Fortësia e përgjithshme Fp – Në akuiferin poroz të Fushë Kuqes në të dyja fazat e monitorimit gjatë viteve 2020 - 2022, vlerat e fortësisë së përgjithshme variojnë nga Fp = 4.48– 109.16° gjermane. Për vitin 2022, në bazë të vlerave nga analizat kimike të marra në të dy fazat, të gjitha shpimet e monitoruara, klasifikohen si *ujëra mesatarisht të forta* me vlera të cilat variojnë nga 4.48 – 13.02° gj. Për vitin 2021 të gjitha shpimet rezultuan me fortësi brenda standartit për ujë të pijshëm me vlera të Fp = 8.26 – 17.35 mg/l. Për vitin 2020 të gjithë shpimet në St. Pompimit Milot, shpimi 176 Milot, shpimi 197 Gurrëz, shpimi

509, shpimet 18, 19, 23 – 26 F.Kuqe, ishin brenda standartit, duke përjashtuar vetëm shpimin 502 Patok ku kishte vlera shumë të larta të $Fp= 109.16^{\circ}g$ në muajin Qershor dhe $68.58^{\circ}g$ në muajin Dhjetor të vitit 2020 ku këto ujëra kalsifikohen si shumë të fortë.

Përmbajtja e amonjakut NH_4 – Përmbajtja e amonjakut NH_4 në akuifein e Fushë - Kuqes për periudhën tre vjeçare 2020 - 2022 variojnë nga 0.00 - 0.25 mg/l. Vlerat mbi normë të NH_4 vërehen vetëm për vitin 2020 në shpimin 502 Patok dhe në shpimin 176 Milot ku ato luhet nga 0.12 - 0.25 mg/l. Përmbajtja mbi normë e NH_4 dhe mungesa ose përmbajtja në vlera shumë të ulëta të NO_2 , NO_3 dëshmon për ndotje të freskët të ujërave që vijnë nga vatra ndotjeje të afërta, për shkak të mos respektimit të zonave sanitare.

Përmbajtja Nitriteve NO_2 – Vlera e nitriteve gjatë viteve 2020 - 2022 luhet nga 0 - 0.06 mg/l Përjashtim bën vetëm shpimi 502 Patok ku NO_2 luhet nga 0.03 mg/l në Prill të vitit 2022 - 0.85mg/l në shtator të vitit 2022, duke i kaluar vlerat e vendosura nga VKM 379, për ujin e pijshëm. Në të gjitha shpimet e tjera vlerat e NO_2 janë brenda parametrave për të tre vitet 2020 - 2022.

Përmbajtja e Nitrateve (NO_3) – Vlerat e nitrateve në të gjitha fazat e monitorimit gjatë viteve 2020 - 2022 janë të vogla për akuiferin e Fushë Kuqes. Ajo varion nga 0.0 - 4.89 mg/l, dhe janë brenda normës së lejuar për ujë të pijshëm.

Përmbajtja e Natriumit Na – Në akuiferin e Fushë Kuqes vlerat e Na në të dyja fazat e monitorimit gjatë viteve 2020 - 2022 në përgjithësi janë brenda normës së lejuar dhe variojnë nga 3.27 - 2626 mg/l. Përjashtim bëjnë shpimet 177 dhe 502 Patok gjatë monitorimit për vitet 2020 - 2021.

Përmbajtja e Klorit: Vlerat e Cl për vitet 2020 - 2022 luhet nga 5.33 - 5005.5 mg/l. Në të gjitha shpimet vlerat janë brenda normës së lejuar me përjashtim të shpimit 177 dhe 502 për arsye se këto shpime janë pikat më ekstreme në drejtim të perëndimit dhe në breg të detit Adriatik. Në shpimin 502

Patok, klori pëson një rritje në fazën e dytë të 2022. Vlerat e klorit në këto 2 shpime mbeten shumë të larta mbi vlerën 250 mg/l që është standarti sipas VKM 379.

Baseni Erzen - Ishëm

Monitorimi hidrodinamik dhe hidrokimik i ujërave nëntokësore në akuiferët e basenit të Erzen - Ishëm është kryer dy herë në vit, sipas rrjetit monitorues si në tabelën e mëposhtme:

Tab. 21 Pikat e monitorimit hidrodinamik dhe hidrokimik për vitet 2020 - 2022 baseni i Erzen-Ishëm

Nr.	Vëndndodhja	X	Y	Baseni	Monitorimi Hidrokimik	Monitorimi Hidrodinamik
1	33 Laknas - Tiranë	4582048	4395181	Erzen - Ishëm	+	
2	2/97 Rinas	4591495	4391495	Erzen - Ishëm	+	
3	416 Bilaj (Fushë - Krujë)	4593912	4390064	Erzen - Ishëm	+	
4	Shpimi 1P Tiranë, Selitë	4576745	4399707	Erzen - Ishëm		+
5	Shpimi 2P. Selitë	4576950	4399465	Erzen - Ishëm		+
6	Shpimi 1 Unaza Re (buka)	4577758	4398424	Erzen - Ishëm		+
7	Shpimi 3/97 Valis - Rinas	4587700	4391900	Erzen - Ishëm		+
8	Shpimi 47 Bërxull - Tiranë	4582163	4394397	Erzen - Ishëm		+
9	Shpimi 6 Laknas	4580960	4395370	Erzen - Ishëm		+
10	Shpimi 16/97 Rr.Kavajës	4577710	4400260	Erzen - Ishëm		+
11	Shpimi 30/B Laknas (Shinat etrenit)	4581426	4395038	Erzen - Ishëm		+
12	Shpimi 2/97 Rinas	4591495	4391495	Erzen - Ishëm		+
13	Shpimi 160 Thumanë	4602800	4389300	Erzen - Ishëm		+
14	Shpimi 1 N Gramëz	4601025	4388250	Erzen - Ishëm		+
15	Shpimi 327 Fushë - Krujë	4594256	4390380	Erzen - Ishëm		+
16	Shpimi 59 Ura Gjolës	4593012	4390380	Erzen - Ishëm		+

Vlerësimi sasior 2020-2022

Në basenin Erzen - Ishëm shfrytëzohen këto rezerva të ujërave nëntokësore. a - Në akuiferin Kuarternar (poroz):
Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet varion $Q = 1620 - 2500$ l/sek.
Koeficienti vjetor i shfrytëzimit varion $K = 0.85 - 0.95$
b - Në akuiferin karbonatik:
Sasia e rezervave që shfrytëzohen për ujë të pijshëm arrin në $Q = 800 - 1000$ l/sek.
Koeficienti vjetor i shfrytëzimit varion $K =$

0.45 - 0.6

c - Në akuiferin ujëmbajtës - formacionet ultrabazike:

Sasia e ujit që shfrytëzohet është: $Q = 65$ l/sek

d - Në akuiferin ujëmbajtës të ranorëve - konglomerateve.

Sasia e përgjithshme që shfrytëzohet varion $Q = 100 - 200$ l/sek.

Koeficienti vjetor i shfrytëzimit të akuiferit varion $K = 0.75 - 0.85$

Vlerësimi hidrodinamik 2020-2022

Regjimi i ujrave nëntokësore lidhet kryesisht me faktorët natyrorë që janë reshjet atmosferike, temperatura, infiltrimi, avullimi dhe faktorët artificialë, si shfrytëzimi intensiv dhe ndryshimet në rrjetin hidrografik. Amplituda e luhatjes së nivelit të UN varion:

- Në Tiranë - Laknas në vitet 2020 - 2022:

Niveli maksimal Hs = - 2.54- 4.2 m,

Niveli minimal varion Hs = - 11.214 12.1 m
Amplituda e luhatjes së ujërave nëntokësore varion A = 7.0149.6 mb

Në Fushë - Krujë në vitet 2020 - 2022:

Niveli maksimal është Hs = - 5.4 m,

Niveli minimal është Hs = - 15.21 m

Amplituda e luhatjes së ujërave nëntokësore varion A = 9.81m

Vlerësimi hidrokimik 2020-2022

Ujërat nëntokësore të këtij baseni në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira. Ato përdoren për furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë dhe bizneseve.

- **Akuiferi Kuaternar i Tiranës:**

pH i ujërave nëntokësore në fazat e monitorimit varion pH = 6.83 - 7.64. Vlera mesatare e pH për vitet 2020 - 2022 është $pH_{mes} = 7.05$. Sipas normës së lejuar për ujë të pijshëm ky tregues është brenda normës (pH = 6.5 - 9.5). Sipas vlerës së pH (përqëndrimi i jonit të hidrogjenit) janë ujëra të tipit alkaline të dobët me pH = 6 - 8.

Fortësia e përgjithshme varion Fp = 17.5 - 29.68° gjermane duke tejkaluar normën e lejuar, pasi norma e ujit të pijshëm për këtë parametër është 10 - 20° gjermane dhe maksimale e lejuar 25° gjermane sipas VKM 379 (25. 05. 2016). Konkretisht duke studiuar rezultatet

e analizave të shpimeve arrijmë në përfundimin se:

Në shpimet 1P Selitë, 2P Selitë, në shpimin 1. Unaza e Re - Buka dhe shpimin 16/97 në Rr. e Kavajës, parametrat e fortësisë së përgjithshme janë brenda normës së lejuar.

Mbi normë Fp ka rezultuar në analizat e disa shpimeve si tek shpimi 3/97 Valias - Rinas, 47 Bërxull, 6 Laknas dhe në shpimin 30/B Laknas (shinat e trenit). Konkretisht, në shpimin 47 Bërxull ky parametër arrin vlerën maksimale Fp = 29.12° gjermane (në Qershor 2020) dhe Rinas 29.68° gjermane. Bazuar në rezultatet e analizave të kryera uji i akuiferit Tiranë është ujë i fortë deri shumë i fortë (16 - 30° gjermane).

Mineralizimi i përgjithshëm në fazat e monitorimit varion në vlerat Mp = 565.75 - 922.49 mg/l. Duke e krahasuar me normën për ujë të pijshëm, ujërat nëntokësore të këtij akuiferi janë brenda normës së lejuar (VKM 379 (25. 05. 2016) 1200 mg/l). Nuk vërehet tendencë rritje të Mp. Vlera mesatare e Mp për vitet 2020 - 2022 është $Mp_{mes} = 713.9$ mg/l. Ujërat nëntokësore të akuiferit Kuaternar në Tiranë janë me Mp nën 1 gr/l, pra janë ujëra të ëmbla. Uji është i tipit hidrokarbonat - kalcium - magnezi ($HCO_3 - Ca - Mg$) dhe hidrokarbonat - kalciumi ($HCO_3 - Ca$).

Amoniaku NH₄ për vitet 2020 - 2022 varion nga 0.0 - 0.11 mg/l. Përjashtim bën një shpim ku përmbajtja e amonjakut është mbi normën e lejuar. Konkretisht përmbajtja mbi normë është takuar vetëm në shpimin 1 Unaza e Re me vlerë 0.11 mg/l (Dhjetor 2020).

- **Akuiferi Kuaternar Fushë - Krujë:**

pH i ujërave nëntokësore në fazat e monitorimit varion nga 6.95 - 7.59. Vlera mesatare e pH për vitet 2020 - 2022 është $pH_{mes} = 7.2$. Sipas normës së lejuar për ujë të pijshëm ky tregues është brenda normës (pH = 6.5 - 9.5). Sipas vlerës së pH , janë ujëra të tipit alkaline të dobët me pH = 7-9.

Fortësia e përgjithshme e ujërave nëntokësore varion Fp = 20.74 - 29.53° gjermane. Siç shihet nga këto parametra Fp

është mbi normën e lejuar. Konkretisht duke studiuar rezultatet e analizave të shpimeve arrijmë në përfundimin se:

Në shpimin 2/97 Rinas, 160 Thumanë dhe 59 Ura e Gjolës fortësia e përgjithshme varion në vlerat $F_p = 21.28 - 24.5^\circ$ gjermane, pra parametra që janë brenda normës së lejuar. Mbi normë F_p është në shpimin 1N Gramëz dhe në shpimin 327 Fushë - Krujë dhe Stacioni i Fabrikës së Çimentos. Bazuar në rezultatet e analizave të kryera uji i akuiferit të Fushë - Krujës është ujë i fortë (16 - 29° gjermane)

Mineralizimi i përgjithshëm është brenda normës së lejuar dhe varion nga $M_p = 620.31 -$

837.18 mg/l, (sipas VKM 379 (25. 05. 2016) vlera maksimale është 1200 mg/l). Nuk ka tendencë rritje të M_p . Vlera mesatare e M_p për vitet 2020 - 2022 është $M_{p_{mes}} = 711.15$ mg/l. Ujërave nëntokësore të akuiferit Kuaternar në Fushë - Krujë janë me M_p nën 1 gr/l, pra janë ujëra të ëmbla. Uji është i tipit hidrokarbonat - kalcium - magnezi ($HCO_3 - Ca - Mg$).

Amoniaku (NH_4) për vitet 2020 - 2022 varion nga 0 - 0.16 mg/l, ku sipas VKM (norma VKM 379 (25. 05. 2016) maksimale e lejuar është 0.1 mg/l). Përrjashtim bëjnë dy shpime ku kemi përmbajtje mbi normë të amonjakut dhe konkretisht kjo vlerë mbi normë është takuar në shpimin 160 Thumanë në sasinë 0.14 mg/l. dhe 1N Gramëz në sasinë 0.16 mg/l (Dhjetor 2020). Në shpimin 2/97 Rinas dhe 327 Fushë - Krujë takohet përmbajtje e amonjakut në sasinë 0.0 - 0.03 mg/l. Në shpimin 59 Ura e Gjolës takohet përmbajtje e amonjakut në sasinë 0.0 - 0.05 mg/l.

Ndotjet e ujit me jonet NH_4 , NO_2 , NO_3 , janë ndotje lokale dhe lidhen me moszbatimin e zonave të rreptësisë dhe mbrojtjes sanitare. Rrezik i ndotjes së ujrave nëntokësore janë infiltrimet e ujrave të ndotura të lumenjve Tiranë, Lanë, Tërkuzë, Erzen në shtresat ujëmbajtëse.

Shfrytëzimi i shtresave zhavorrore ujëmbajtëse të tarracave lumore për materiale inerte të cilat janë jo vetëm burim i furnizimit me ujë të pijshëm të shumë fshatrave por

dhe ushqyesi kryesor i pellgut ujëmbajtës të Tiranës ka çuar në prishjen e ekuilibrave hidrodinamike e hidrokimike.

Baseni i Shkumbinit

Monitorimi hidrodinamik dhe hidrokimik i ujërave nëntokësore në akuiferët e basenit të Shkumbinit është kryer sipas rrjetit monitorues të mëposhtëm me frekuencë dy herë në vit.

Tab. 22 Pikat e monitorimit hidrodinamik dhe hidrokimik për vitet 2020 - 2022 baseni i Shkumbinit

Nr.	Vëndndodhja	X	Y	Baseni	Monitorimi Hidrokimik	Monitorimi Hidrodinamik
1	Stacioni qëndror Konjat	4541309	4386305	Shkumbinit	+	
2	Çermë - pusi 281- Lushnjë	4547371	4382919	Shkumbinit	+	
3	10 A. Vidhas - Elbasan	4549249	4415162	Shkumbinit	+	
4	Shp.2/ 90 Stacioni Krastë e madhe- Elbasan	4426424	4554520	Shkumbinit		+
5	Shp.3/70 Stacionis Krastë e Vogel- Elbasan	4425230	4552550	Shkumbinit		+
6	Shp.Bujqes-Mjeksi	4420363	4549715	Shkumbinit		+
7	Shp.10 A. Vidhas - Elbasan	4415162	4549249	Shkumbinit		+
8	St. Muriqan- Elbasan	4416051	4546365	Shkumbinit		+
9	St. Cerikut- Elbasan	4414050	4546336	Shkumbinit		+
10	Stacioni - Peqin	4394669	4545671	Shkumbinit		+
11	St. Rrogozhinë	4388350	4549422	Shkumbinit		+
12	Shp. 3 Konjat-Lushnje	4386305	4541309	Shkumbinit		+
13	Shp. 286 Çërme- Lushnje	4384850	4547350	Shkumbinit		+
14	Shp.1D(Divjake)-Lushnje	4380126	4546265	Shkumbinit		+
15	Burim Qafë Thanë	4459750	4548875	Shkumbinit		+
16	Pusi Nr.1. Stacioni Pompave Konjat (v. 2008)	4541634	4387018	Shkumbinit		+
17	Pusi Nr.2. Stacioni Pompave Konjat (v. 2008)	4541610	4386639	Shkumbinit		+
18	Pusi Nr.4. Stacioni Pompave Konjat (v. 2008)	4541838	4385880	Shkumbinit		+
19	Pusi Nr.5. Stacioni Pompave Konjat (v. 2008)	4541948	4385493	Shkumbinit		+
20	Pusi Nr.6. Stacioni Pompave Konjat (v. 2008)	4542053	4385109	Shkumbinit		+
21	Stacion Pompimi Çermë, pusi nr.5	4547428	4383027	Shkumbinit		+
22	Shp.2 Ujesjelles Kavajë	4561750	4379800	Shkumbinit		+
23	Shp.2/ 90 Stacioni Krastë e Madhe - Elbasan	4426424	4554520	Shkumbinit		+
24	Shp.3/70 Stacioni Krastë e Vogël- Elbasan	4425230	4552550	Shkumbinit		+

Vlerësimi sasior 2020-2022

Në basenin e Shkumbinit shfrytëzohen rreth 2300 – 2500 l/sek të shpërndara si më poshtë:

Në akuiferin poroz të Elbasanit

Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet nga akuiferi i Elbasanit arrin në $Q = 700 - 1250$ l/sek, sasi kjo pothuajse e pandryshueshme krahasuar me vitet e mëparshme. Koeficienti vjetor i shfrytëzimit varion $K = 0.25 - 0.3$

Në akuiferin poroz të zonës së Lushnjës (Çermë-Konjat).

Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet nga akuiferi i Lushnjës arrin në $Q = 650-700$ l/sek, sasi kjo që është rritur me 350 l/s me qëllim përmirësimin e furnizimit me ujë të qytetit të Kavajës dhe zonës së Golemit. Koeficienti vjetor i shfrytëzimit varion nga $K = 0.95 - 1$.

Në akuiferin karbonatik:

Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet nga akuiferët karbonatikë arrin në $Q = 500 - 700$ l/sek, sasi kjo pothuajse e pandryshueshme krahasuar me vitet e mëparshme. Koeficienti vjetor i shfrytëzimit varion $K = 0,4 - 0,6$.

Në akuiferin poro - çarje (konglomeratik):

Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet nga akuiferët konglomeratikë arrin në $Q = 100 - 200$ l/sek, sasi kjo pothuajse e pandryshueshme krahasuar me vitet e mëparshme. Koeficienti vjetor i shfrytëzimit varion $K = 0,75 - 0,85$.

Amplituda për këto matje rezulton $A = 4.2 - 4.4$ m, por kjo amplitudë referuar viteve të mëparshme është shumë më e madhe dhe shkon deri $A = 5.19 - 6.7$ m, kurse nga të dhënat e aparaturës vetëregjistruese amplituda shkon $A = 5.08$ m. Amplituda kaq e lartë, ka ardhur si rezultat i rritjes së shfrytëzimit të akuiferit dhe ndërhyrjeve në zonën e ushqimit nëpërmjet shfrytëzimit të zhavorreve.

Zona e ushqimit të akuiferit të Lushnjës ka pësuar ndryshime vitet e fundit e krahasuar me të dhënat e viteve të mëparshme. Në këtë zonë është vendosur në shfrytëzim edhe ujësjellësi i ri në profilin e Çermës me një shfrytëzim me $Q = 300 - 350$ l/s me 6 puse të rinj, për furnizim me ujë të zonës së Kavajës

- Golem.

Ky akuifer ka shfrytëzim maksimal që duket qartë edhe nga luhatja e madhe e nivelit të ujërave nëntokësore në zonën e Konjatit me amplitudë $A = 4.2 - 4.4$ m nga 2 m që ishte para viteve 2016.

Në akuiferin poroz të Elbasanit

Nivelet e ujërave nëntokësore në akuiferin Vidhas të Elbasanit luhaten në vlerat e mëposhtme: $N_{\min} = -7.74$ m, $N_{\max} = -3.8$ m. Amplituda shkon në vlera $A = 3.94$ m

Vlerësimi hidrokimik 2020-2022

Ujërat nëntokësore të këtij baseni në përgjithësi kanë veti fiziko-kimike të mira. Ato përdoren për furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë dhe bizneseve. Shfaqja e përmbajtjes së NO_2 , NO_3 dhe NH_4 lidhet me moszbatimin e zonave të rreptësisë dhe mbrojtjes sanitare të shpimeve.

Në akuiferin karbonatik:

- **Temperatura (T)** varion në vlera $9 - 15^\circ C$
- **pH** varion në vlera $7.41 - 7.82$, janë ujëra alkaline të dobëta
- **Fp** varion nga $9.52-10.92^\circ$ gjermane, pra janë ujëra mesatarisht të forta
- **Mp** shkon nga $283.61 - 312.21$ mg/l, pra janë ujëra të ëmbla, tipi i ujit është $HCO_3 - Ca$
- Nuk përmbajnë NH_4 dhe NO_2 .

Në akuiferin kuaternar të Elbasanit

- **T** = $14 - 17^\circ C$
- **pH** = $7.21-7.86$, janë ujëra alkaline të dobëta,
- **Fp** varion nga $11.2 - 13.72^\circ$ gjermane në stacionet e Krastave, $17.21-18.61^\circ$ gjermane në Cërrik, pra janë ujëra mesatarisht të forta. Në Vidhas - Muriqan, **Fp** varion nga $25.05 - 29.52^\circ$ gjermane, janë ujëra shumë të forta.
- **Mp** shkon nga $324.74 - 391.24$ mg/l, në Krastë dhe vjen e rritet në Vidhas dhe Muriqan në vlerat $775.52-848.95$ mg/l, kurse në Cërrik zbret në 524.08 mg/l, pra janë ujëra të ëmbla dhe të freskëta, tipi i ujit është $HCO_3 -$

- Mg – Ca.
- **NH₄** dhe **NO₂** janë në vlera të ulta brenda parametrave.
- **Fe** hekuri shkon deri në vlera 0.01 - 0.11 mg/l, ku 0.11 mg/l është kapur vetëm një herë në periudhë 2020-2021.

Në akuiferin kuaternar të Peqin - Rogozhinës

- T varion në vlera 15 - 17°C.
- pH varion në vlera 7.25 - 7.54 janë ujëra alkaline të dobëta.
- Fp varion nga 29.11 - 30.51° gjermane janë ujëra shumë të forta.
- Mp shkon nga 716.23 - 879.57 mg/l, pra janë ujëra të freskëta, tipi i ujit është HCO₃ - Mg - Ca.
- NH₄ amonjaku është në vlera të ulta nga 0.02 deri 0.1 mg/l. Konstatohet ndotje lokale gjatë periudhës ujë shumë.

Në akuiferin kuaternar të zonës së Lushnjës (Çermë - Konjat).

Temperatura e ujit varion në vlera 14-17°C

pH i ujërat nëntokësore varion nga 7.85-8.37 sipas normës së lejuar për ujë të pijshëm ky tregues është brenda normës (norma e Ph=6,5-9,5), pra janë ujëra alkaline të dobta deri alkaline

Fp varion nga 14.27 - 14.97° gjermane në stacionin e Divjakës, pra janë ujëra mesatarisht të forta. Në stacionet e Konjatit fortësia varion në vlera 20.29 - 38.84° gjermane, kurse në pusete Çermës varion në vlera 20.99- 29.25° gjermane pra janë ujëra të forta deri shumë të forta. Fortësia e ujit të këtij akuiferi ulet drejt perëndimit dhe jugut, pasi ulet përmbajtja e kalciumit dhe magnezit.

Stacionet e Çermës dhe Konjatit, kanë Mg në përmbajtje mbi normë, 93.63 - 117.95 mg/l (norma STASH 20 - 50 mg/l).

Mineralizimi i përgjithshëm (Mp) shkon nga 415.38 - 1233.48 mg/l, pra janë ujëra të ëmbla deri të freskëta, tipi i ujit është HCO-Mg-Ca dhe mineralizimi ulet drejt perëndimit.

NO₂ Nitritet kanë vlera që shkojnë nga 0.01 - 0.28 mg/l.

NH₄ amonjaku është në vlera të ulta 0.005 - 0.88 mg/l. Në stacionin e Konjatit konstatohet ndotje e vazhdueshme me NH₄.

Në akuiferin Konglomeratiko-Ranorë

T varion në vlera 13 - 17°C

pH varion në vlera 7.15 - 7.29, janë ujëra alkaline të dobëta

Fp varion nga 25.05 - 29.95° gjermane, janë ujëra shumë të forta.

Mp shkon nga 845 - 885 mg/l, pra janë ujëra të freskëta, tipi i ujit është HCO₃ - Mg - Ca

NH₄ janë në vlera të ulta 0.00 - 0.21 mg/l por ndotja shfaqet në periudha ujëshumtë.

Fe shkon deri në vlera 0.005 - 0.037 mg/l, vlera të cilat janë të pranueshme për këtë lloj akuiferi.

Baseni i Semanit

Në akuiferët e basenit të Semanit, shfrytëzohen rezerva të konsiderueshme të ujërave nëntokësore për furnizimin me ujë të pijshëm të zonave të banuara si qytete ashtu edhe fshatra të ndryshme. Monitorimi i ujërave nëntokësore në basenin e Semanit, për vitin 2020 - 2022, u krye në akuiferin poroz të Korçës, në akuiferin karbonatik dhe në akuiferin magmatikë (shpimi pranë H. Xhorxhos Korçë). Monitorimi hidrodinamik dhe hidrokimik i ujërave nëntokësore në akuiferët e basenit të Semanit është kryer dy herë në vit. Ky monitorim është kryer sipas rrejtimit monitorues si në tabelën e mëposhtme:

Tab.23 Pikat e monitorimit hidrodinamik dhe hidrokimik për vitet 2020 - 2022 baseni Semanit

Nr	Vendndodhja e Pikave të monitorimit.	X	Y	Baseni	Monitorimi Hidrokimik	Monitorimi Hidrodinamik
1	Shpimi Libonik	4408500	4477500	Semanit	+	
2	Burimi Mançurishtit	4407875	4494200	Semanit	+	
3	Shpimi Bulgarec	4403100	4478750	Semanit	+	+
4	Shpimi Turan 3A	4498250	4478250	Semanit	+	
5	Shpimi Turan 504	4499552	4478287	Semanit	+	
6	Shpimi Turan 505	4500020	4478332	Semanit	+	
7	Shpimi I.Terova.	4498650	4479150	Semanit	+	
8	Shpimi H. Xhorxho	4497200	4482850	Semanit	+	
9	Shp.1/293 Zvirinë-Korçë	4417675	4476720	Semanit	+	
10	Shpimi Sheqeras Korçë	4413250	4476350	Semanit	+	

Vlerësimi sasior 2020-2022

Në akuiferët e basenit të Semanit, shfrytëzohen rezervatë konsiderueshme të ujërave nëntokësore për furnizimin me ujë të pijshëm të zonave të banuara si qytete ashtu edhe në fshatra të ndryshëm.

Rezervat që shfrytëzohen nga çdo akuifer ujëmbajtës:

- 1- Akuiferi kuaternar i Korçës $Q = 500 - 550$ l/sek
 $K = 0.65 - 0.75$
- 2- Akuiferi kuaternar i Beratit $Q = 500 - 590$ l/sek
 $K = 0.65 - 0.75$
- 3- Kompleksi karbonatik $Q = 360 - 530$ l/sek
 $K = 0.3 - 0.5$
- 4- Kompleksi magmatik $Q = 20 - 30$ l/sek
 $K = 0.3 - 0.5$

Rezervat që shfrytëzohen për çdo akuifer janë më të vogla se ato që rekomandohen për shfrytëzim, që do të thotë se ka rezerva të lira të pashfrytëzuara që mund të përdoren për furnizimin me ujë të popullsisë, në rast nevoje.

Vlerësimi hidrodinamik

Monitorimi hidrodinamik i ujërave nëntokësore të basenit të Semanit gjatë viteve 2020 - 2022 është kryer në shpimin Bulgarec. Gjatë këtyre viteve janë bërë matje dhe ka rezultuar:

- Niveli minimal është $H_p = + 0.75$ m
- Niveli maksimal $H_p = + 1.09$
- Amplituda e luhatjes së nivelit të ujërave nëntokësore në akuiferin e Korçës është

Vlerësimi hidrokimik 2020-2022

Për vlerësimin dhe monitorimin e përbërjes kimike të ujërave nëntokësore të Basenit Seman për vitin 2020 - 2022 janë monitoruar akuiferi poroz i Kuaternarit në 6 shpime, akuiferi me çarje 1shpim, me një frekuencë 2 herë në vit (Mars dhe Shtator). Monitorimi hidrokimik i ujrave nëntokësore është realizuar për akuiferin kuaternar të Korçës, dhe në akuiferët karbonatik dhe magmatik në muajt Qershor dhe Dhjetor.

Rezultoni se ujërat në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira, nuk ka ndotje masive të akuifereve ujëmbajtëse. Në ndonjë rast vihet re prezenca e NO_2 , por në vlera të ulëta, e cila vjen nga mos zbatimi i zonave të rreptësisë sanitare.

Akuiferi Kuaternar i Korçës

Ujërat e këtij akuiferi janë me cilësi të mira fiziko - kimike.

pH i ujërave nëntokësore – pH i ujërave nëntokësore në fazat e monitorimit për vitin 2022 varion $\text{pH} = 7.4 - 8.3$. Gjatë monitorimit 2020 – 2022, vlera minimale e pH është 7.03 në shpimin Sheqeras në muajin Shtator 2021, ndërsa vlera maksimale prej 8.03 është në shpimin Bulgarec në muajin Shtator 2022. Ky tregues është brenda normës për ujë të pijshëm ($\text{pH} = 6.5-9.5$) dhe janë ujëra të tipit alkalini të dobët.

Mineralizimi i përgjithshëm luhartet në kufinj të larta nga **290.49 - 564.71 mg/l**. Ujërat e këtij akuiferi janë të ëmbla. Luhartet më të larta vërehen në shpimin Zvirinë, Sheqeras dhe 3A Turan. Uji është i tipit hidrokarbonat - magnez - kalciumi në Turan dhe hidrokarbonat - kalcium - magnezi në Sheqeras. Trendi i përgjithshëm nuk ka rritje, vërehen luhartet sezonale

Vlerat vjetore të **Fortësisë** së Përgjithshme (Fp) për periudhën 3 vjetore 2020 – 2022, Fp varion $7.28 - 20.01^\circ$ gjermane. Vlera minimale e Fp është 7.03° gj në shpimin Libonik në muajin Shtator 2020, ndërsa vlera maksimale prej 20.01° gj është në shpimin 1v Terova në muajin Shtator 2021. Vlerat e Fp krahasuar me standartin VKM 379 ($10 - 20, 25^\circ$ gj PML)

është brenda standartit, trendi i Fp nuk ka rritje të konsiderueshme, vërehet një trend pothuajse konstant në stacionet I. Terova, Turan, Sheqeras, Bulgarec, Zvirinë. Një trend i lehtë ulës vërehet në stacionin Libonik.

Përmbajtja e amonjakut (NH_4): Përmbajtja e amonjakut NH_4 për vitin 2022 varion nga $0.0 - 0.08$ mg/l. Vlerat janë nën përmbajtjen maksimale të lejuar sipas VKM 379 (25. 05. 2016), (norma maksimale e lejuar është 0.1 mg/l). Ndërsa për periudhën 3 vjetore 2020 – 2022, varion $0 - 0.32$ mg/l. Vlera maksimale prej 0.32 mg/l është takuar në shpimin Libonik në muajin Shtator 2021. Kjo tregon që kemi ndotje të freskët dhe duhen marrë masa për eliminimin e shkaktarëve si dhe klorifikimin e ujit.

Përmbajtja e nitriteve (NO_2): Përmbajtja e nitriteve NO_2 për periudhën 3 vjetore 2020 – 2022, varion $0 - 0.19$ mg/l. Vlera maksimale prej 0.19 mg/l është takuar në shpimin Libonik në muajin Shtator 2021. Përmbajtja e nitriteve NO_2 në fazat e monitorimit për vitin 2022 varion në vlerat $0 - 0.008$ mg/l, sipas normës së lejuar për ujë të pijshëm ky tregues është brenda standartit.

Përmbajtja e nitrateve (NO_3): - Përmbajtja e nitrateve për periudhën 2020 – 2022, varion $0 - 38.74$ mg/l. Vlera maksimale prej 38.74 mg/l është takuar në shpimin I.Terova në muajin Shtator 2022. Përmbajtja mesatare e NO_3 për vitin 2022 varion nga $0.58 - 20.55$ mg/l. Kjo përmbajtje shkaktohet nga plehërimi, pasi shpimi ndodhet në bazën prodhuese të Universitetit Bujqësor të Korçës.

Akuiferi magmatik

Përbërja kimike e ujërave të këtij akuiferi është e mirë.

Mineralizimi i përgjithshëm Mp - Mineralizimi i përgjithshëm në akuiferin me çarje - magmatik gjatë periudhës 2020 – 2022 luhartet në kufinj të larta nga $527.6 - 583.58$ mg/l, duke u klasifikuar si ujëra të freskëta. Ky tregues është brenda normës së lejuar. Vlerat mesatare të mineralizimit variojnë 563.79 mg/l. Mineralizimi i përgjithshëm është paraqitur grafikisht për

periudhën 2020 - 2022, trendi i përgjithshëm nuk ka rritje, ai është pothuajse konstant, me njëulje të lehtë në fazën e dytë të monitorimit, viti 2022.

Fortësia e Përgjithshme Fp - Fortësia e Përgjithshme në shpimin Hotel Xhorxho gjatë periudhës 2020 - 2022 është luhatur në vlera nga 16.83 – 20.02° gj, duke u klasifikuar si ujëra të forta. Fortësia e ujrave në këtë akuifer është tregues brenda normës së lejuar sipas VKM 379 (25.05. 2016) e BE. Ndryshimet e Fp në fazat e monitorimit janë të vogla në vitin 2022 variojnë në 2.77°gj. Vlerat mesatare të fortësisë variojnë 19.13 °gj. Trendi i Fp nuk ka rritje, vërehet një trend pothuajse konstant me një ulje në fazën e dytë të vitit 2022.

pH i ujërave nëntokësorë gjatë periudhës 2020 - 2022 është luhatur në kufinj të nga 7.11 – 7.86, sipas normës së lejuar për ujë të pijshëm ky tregues është brenda normës së lejuar (pH = 6,5 - 9,5). Sipas vlerës së

pH (përqëndrimi i jonit të hidrogjenit) janë ujra të tipit alkaline të dobët me pH = 7 - 9. Ndryshimet e vlerave të pH janë të vogla në fazat e monitorimit, variojnë në 0.58. Ujrat janë alkaline të dobët.

Përmbajtja e nitriteve - NO₂, gjatë periudhës 2020 - 2022 është takuar përmbajtje e nitriteve në kampionet e marra në vlerë 0.00 – 0.001 mg/l. Standarti Shtetëror i përcaktuar në VKM 379 (25.05. 2016) përcakton si vlerë max të lejuar për NO₂ vlerën 0.5 mg/l. Klorinimi i ujit duhet të jetë ivazhdueshëm si dhe mbajtja në monitorim të vazhdueshëm.

Përmbajtja e amoniakut NH₄, gjatë periudhës 2020 - 2022 është takuar në vlera shumë të ulta. Vlerat janë brenda standartit të lejuar, ato luhaten min – max 0.0 – 0.07 mg/l.

Përmbajtja e Nitrateve - NO₃, është prezente në vlera shumë të ulta, ato luhaten nga 0 -4.09 mg/l.

Baseni i Vjosës

Vlerësimi hidrodinamik dhe hidrokimik i ujërave nëntokësore në akuiferët e basenit të Vjosës është kryer në dy faza, sipas një rrjeti monitorues si në tabelën e mëposhtme:

Tab. 24. Rrjeti i monitorimit hidrodinamik dhe hidrokimik për vitet 2020-2022

Nr.	Vendndodhja	X	Y	Baseni	Monitorimi Hidrokimik	Monitorimi Hidrodinamik
1	Stacioni i pompave Novoselë	4499327	4370822	Vjosës	+	+
2	Stacioni i pompave Pish-Poro	4531000	4365325	Vjosës	+	
3	Stacioni i pompave Kafaraj, 4E	4500639	4373407	Vjosës	+	+
4	Stacioni i pompave Kafaraj, 3R	4501237	4373123	Vjosës	+	
5	Stacioni Kafaraj (Shpimi i ri)	4500597	4372428	Vjosës	+	+
6	Burimi Uji i Ftohtë. Tepelenë	4457909	4420543	Vjosës	+	
7	Stacioni i pompave Buduk	4437927	4429229	Drinosit	+	+
8	Shpimi Kthesa e Lazaratit	4436211	4429679	Drinosit	+	
9	Kakavi	4421075	4441616	Drinosit	+	+

Vlerësimi sasior 2020-2022

Në fushën e lumit Vjosa kemi këtë shfrytëzim sipas stacioneve:

- Stacioni i pompimit Kafaraj
 $Q = 720 - 900 \text{ l/s}$
- Stacioni i pompimit Novoselë
 $Q = 300 \text{ l/s}$
- Nga stacionet lokale të pompimit shfrytëzohen
 $Q = 60 \text{ l/s}$
- Shpime të tjera
 $Q = 100 \text{ l/s}$
- Shpime private rreth
 $Q = 200 \text{ l/sek}$
- Rezerva që shfrytëzohen në fushën e Vjosës
 $Q = 1480 \text{ l/sek}$
- Koeficienti i shfrytëzimit në këtë akuifer varion
 $K = 0.65 - 0.7$

Në fushën e lumit Drinos kemi këtë shfrytëzim sipas stacioneve:

- Stacioni i pompimit Buduk
 $Q = 100 \text{ l/sek}$
- Stacioni i pompimit Lazarat e Derviçan
 $Q = 30 \text{ l/sek}$
- Shpime të tjera
 $Q = 10-20 \text{ l/sek}$
- Rezerva që shfrytëzohen në luginën e Drinosit
 $Q = 145 \text{ l/s}$
- Koeficienti i shfrytëzimit të pellgut varion
 $K = 0.3 - 0.35$

Vlerësimet për monitorimet sasiore tregojnë se akuiferët nuk janë nën presionin e mbishfrytëzimit të rezervave ujore të tyre, koeficientët e shfrytëzimit në akuiferin e Vjosës variojnë nga 0.65 - 0.7 dhe në akuiferin e Drinosit nga 0.3 - 0.35.

Vlerësimi hidrodinamik 2020-2022

Monitorimi hidrodinamik i ujërave nëntokësore të këtyre akuiferëve gjatë viteve 2020 - 2022 është kryer në shpimet Buduk, Lazarat, Kakavi, Novoselë, Kafaraj 3/96 dhe Kafaraj pusi i ri.

Nga kryerja e këtij monitorimi në këta akuifer ujëmbajtës për vitin 2020 - 2022, rezulton se amplituda e luhatjes së ujërave nëntokësore varion nga $A = 0.36 - 4.4 \text{ m}$.

Vlerësimi hidrokimik 2020-2022

Monitorimi i cilësisë së ujërave nëntokësore në akuiferët poroz (Kuaternare) të Vjosës dhe Drinosit është kryer në stacionet si: Buduk, Kthesa e Lazaratit, Kafaraj 4E, Kafaraj 3R, Novoselë, Pish-Poro. Duke parë rezultatet e analizave të kryera gjatë viteve 2020-2022, kanë rezultuar se ujërat nëntokësore (UN) në këto akuiferë kanë veti fiziko - kimike të mira, janë pa erë, pa ngjyrë, pa shije dhe konkretisht:

Vlerat e pH gjatë vitet 2020 - 2022 janë brenda normës së lejuar për ujë të pishëm krahasuar me normat e VKM 379 (25.05.2016). Vlerat e pH variojnë nga 6.5-9.5 dhe sipas vlerës së pH (përqëndrimi i jonit të hidrogjenit) këto ujëra janë të tipit alkaline të dobët.

Fortësia e përgjithshme F_p - Në basenin e Vjosës në të dyja fazat e monitorimit gjatë viteve 2020 - 2022, vlerat e fortësisë së përgjithshme variojnë nga $F_p = 7.14 - 36.94^\circ$ gjermane. Në akuiferin kuaternar të Vjosës fortësia e ujit varion nga 17.77 deri në 36.94° gjermane, klasifikohen si UN mesatarisht të forta. Në shpimin në Kafaraj 4E fortësia e ujit varion nga 21 - 30.93° gjermane, në periudhën ujëpakët fortësia paraqet me vlera më të larta mbi normën maksimale të lejuar nga VKM 379 (25.05.2016). Në shpimin Pish Poro fortësia e ujit varion nga 32.19 - 36.94 gradë gjermane duke u klasifikuar në ujëra nëntokësore shumë të forta dhe me vlera mbi normën maksimale të lejuar. Në akuiferin e Gjirokastrës si dhe akuiferin karbonatik të Vjosës, fortësia e përgjithshme është brenda normës së përcaktuar.

Mineralizimi i përgjithshëm M_p -

Mineralizimi i përgjithshëm në të dyja fazat e monitorimit gjatë viteve 2020 - 2022 është brenda normës së lejuar dhe varion:

a) akuiferin Kuaternar të Vjosës në vlerat $M_p = 686.13 - 1074.18$ mg/l, duke u klasifikuar si ujra të freskët. b) akuiferin Kuaternar të Gjirokastrës $M_p = 281.7 - 418.46$ si dhe c) akuiferin karbonatik të Vjosës $M_p = 200.28 - 239.2$ ku trendi i përgjithshëm nuk ka rritje por vërehen luhate të lehta sezonale. Përfundimisht bën shpimin në Pish - Poro ku në të dyja fazat e monitorimit për të tre vitet, vlerat e M_p variojnë nga 1636.39 - 1907.43 janë mbi normën e lejuar për ujë të pijshëm. VKM 379 (25.05.2016) dhe klasifikohen si ujëra nëntokësorë të mineralizuara.

Përmbajtja e Natriumit Na – Në akuiferin kuaternar dhe karbonatik të Vjosës si dhe në akuiferin kuaternar të Gjirokastrës vlerat e Na në të dyja fazat e monitorimit gjatë viteve 2020 - 2022 janë brenda normës së lejuar dhe variojnë nga 18.78 - 104.1 mg/l. Përfundimisht bën vetëm shpimi Pish - Poro ku vlerat e Na janë mbi normën e lejuar në të gjitha fazat e monitorimit gjatë viteve 2020 - 2022.

Përmbajtja e Magnezit Mg – Në akuiferin e Drinosit si dhe në akuiferin karbonatik (burimi Uji i Ftohtë - Tepelenë) vlerat e Mg në të gjitha fazat e monitorimit janë brenda normës së lejuar, pra nën 50 mg/l që është norma e lejuar e VKM 379 për ujë të pijshëm.

Përmbajtja e amonjakut NH_4 – Përmbajtja e amonjakut NH_4 në akuiferët kuaternar të Vjosës për periudhën tre vjeçare 2020 - 2022 varion nga 0.01 - 1.83 mg/l ku sipas VKM norma maksimale e lejuar është 0.1 mg/l. Në shpimet Novosele dhe Kafaraj 4E kemi rritje të përmbajtjes së NH_4 në periudhën prill 2022 dhe kjo situatë ka lidhje me mos zbatimin e zonave sanitare. Në shpimin Pish - Poro vlerat e NH_4 luhaten nga 0.15 - 1.83 mg/l dhe janë mbi vlerën maksimale të lejuar. Në akuiferin Kuaternar të Drinosit si dhe në akuiferin karbonatik të Vjosës, në burimin Uji i Ftohtë - Tepelenë vlerat e Amonjakut NH_4 janë poshtë normës së lejuar.

Përmbajtja e Klorit Cl – Përmbajtja e klorit në akuiferin Kuaternar të Vjosës dhe Drinosit si dhe në burimin Uji i Ftohtë për vitet 2020

- 2022 në të gjitha pikat janë nën vlerat e lejuara nga VKM 379, përjashtim bën vetëm shpimi Pish - Poro. Ku vlerat e Cl luhaten nga 781 - 958.5 mg/l.

Përmbajtja e Nitrateve (NO_3) – Vlerat e nitrateve në të gjitha fazat e monitorimit gjatë viteve 2020 - 2022 janë të vogla për të gjithë akuiferët dhe janë brenda normës të lejuar për ujë të pijshëm .

Përmbajtja e Nitriteve (NO_2): Nitritet janë takuar në mënyrë sporadike dhe të përsëritur në shpimet e Kafaraj 4E si dhe në Pish Poro. Në shpimin Kafaraj vlerat e nitriteve variojnë nga 0-0.1mg/l dhe janë brenda normave të lejuara. Në shpimin Pish Poro në muajt Qershor 2020 dhe Shtator 2021, nitritet takohen në vlera 0.852 - 1.13 dhe mg/l. Përmbajtja e nitriteve lidhet me ndotjen nga uji i lumit, pasi stacioni është buzë tij dhe nga moszbatimi i zonave të mbrojtjes sanitare. Në akuiferin Kuaternar të Drinos dhe akuiferin karbonatik në burimin Uji i Ftohtë - Tepelenë vlerat e NO_2 për vitet 2020 - 2022 janë brenda normës të përcaktuar.

Baseni i zonës Jonike

Në akuiferët e Basenit të Zonës Jonike shfrytëzohen rezerva të konsiderueshme të ujërave nëntokësore për furnizimin me ujë të pijshëm të zonave të banuara, qytete dhe fshatra.

Tab. 25 Rrjeti i monitorimit hidrodinamik dhe hidrokimik për vitet 2020-2022

Nr	Vendndodhja	Y	X	Monitorimi	Monitorimi
				Hidrokimik	Hidrodinamik
1	"Uji i Ftohtë (galeria)	4371675	4477400	+	
2	"Uji i Ftohtë"(tuneli)	4371675	4477400	+	
3	Shpimi Orikum	4369779	4465848	+	
4	Shpimi Vrion nr -1.	4419734	4416731	+	
4	Shpimi Vrion nr - 2.	4419771	4416741	+	+
5	Shpimi Karahaxh	4416750	4422720	+	+
6	Shpimi Çukë nr -1, për Ksamilin	4411754	4418380	+	
7	Shpimi Çukë nr -2, për Ksamilin	4411661	4318573		
8	Burimi "Syri i Kaltër"	4431200	4421750	+	

Vlerësimi sasior 2020-2022

Në akuiferin kuaternar të Vurgut:

Sasia e përgjithshme e ujit që është shfrytëzuar nga akuiferi, për vitin 2020 - 2022 është $Q = 200-285$ l/sek, sasi kjo pothuajse konstante krahasuar me vitet e mëparshme. Koeficienti vjetor i shfrytëzimit të akuiferit kuaternar varion nga $K = 0.5 - 0.71$.

Në akuiferin kuaternar të Dukatit:

Nga shpimi që monitorohet shfrytëzohen rreth 20 l/sek, për ujë të pijshëm nga Bashkia Orikum.

Në akuiferin karbonatik të Tragjasit:

Sasia e përgjithshme e ujit që shfrytëzohet nga kaptazhet për furnizimin me ujë të qytetit nga akuiferi karbonatik i Tragjasit, për vitin 2020 - 2022 varion nga 1075 - 1415 l/sek, sasi kjo pothuajse konstante krahasuar me vitet e mëparshme. Burimi Uji i Ftohtë Vlorë - Sasia e ujit që shfrytëzohet, për përdorim për ujë të pijshëm është mesatarisht 1245 l/sek.

Në akuiferin Mursi - Vrinë

Burimi (keson) Mursi - Sasia e ujit që shfrytëzohet është rreth 20 l/sek për ujë të pijshëm nga Komuna Mursi. Sasia e ujit

të shfrytëzuar nga pellgu është rreth 40 l/sek. Resurset e shfrytëzimit të ujërave nëntokësore në pellg janë vlerësuar rreth 90 l/sek.

Vlerësimi hidrodinamik 2020-2022

Monitorimi hidrodinamik i ujërave nëntokësore të Zonës Jonike gjatë viteve 2020 - 2022 është kryer në shpimet Vrion dhe Karahaxh. Nga kryerja e këtij monitorimi në këtë basen gjatë viteve 2020 - 2022 rezulton se niveli maksimal është takuar në muajin Prill të vitit 2022 në Vrion ku $H_s = -2.4$ m, kurse niveli minimal është takuar në muajin Shtator në Vrion me nivel dinamik $H_d = -5.4$ m. Amplituda për këtë periudhë monitorimi për akuiferin kuaternar Jonik shkon në vlerën $A = 3$ m dhe për shpimin në Vrion dhe në vlerën $A = 2.5$ m për shpimin në Karahaxh.

Vlerësimi hidrokimik 2020-2022**Në akuiferin kuaternar të Vurgut**

Mineralizimi i përgjithshëm Mp – varion në vlerat 371.28 - 818.84 mg/l dhe klasifikohen si ujëra të freskëta dhe tipi hidrokimik i ujit në përgjithësi është HCO_3 - Ca.

Vlerat e pH gjatë vitet 2020 – 2022 janë brenda normës së lejuar për ujë të pijshëm. Vlerat e pH variojnë nga pH= 7.02 - 7.73 dhe klasifikohen si ujëra alkaline të dobët.

Fortësia e përgjithshme Fp – Fortësia e përgjithshme në zonën Jonike në akuiferin poroz gjatë viteve 2020 - 2022 varion nga 12.88 – 27.3° gjermane dhe klasifikohen si ujëra mesatarisht të forta. Vlen të theksohet se vetëm në shpimin në Karahaxh, janë takuar vlera mbi normën e lejuar nga VKM 379 (25.05.2016)

Përmbajtja e amonjakut NH_4 – Vlerat e amonjakut NH_4 për vitet 2020 - 2022 variojnë nga 0.0-0.25 mg/l ku sipas VKM norma maksimale e lejuar është 0.1 mg/l. Në muajin Prill të vitit 2022, në shpimet Çukë 2, Çukë 1, Vriion 1 dhe në shpimin në Karahaxh kemi vlera të amonjakut mbi normën e lejuar.

Përmbajtja e Nitriteve (NO_2): Vlerat e NO_2 variojnë nga 0.0 – 0.04 mg/ dhe janë brenda normës së lejuar.

Në akuiferin kuaternar të Dukatit

Nga shpimi i Orikumit shfrytëzohen rreth 20 l/sek i cili shkon për furnizimin me ujë të pijshëm të Bashkisë Orikum.

Mineralizimi i përgjithshëm Mp – Mineralizimi i përgjithshëm në të dyja fazat e monitorimit gjatë viteve 2020 - 2022 është brenda normës së lejuar dhe varion në vlera nga 425.69 – 491.64 mg/l dhe klasifikohen si ujëra të ëmbla.

Fortësia e përgjithshme Fp – Vlerat e Fp variojnë nga 15.26 – 17.22° gradë gjermane. Dhe klasifikohen si ujëra mesatarisht të forta.

Vlerat e pH gjatë vitet 2020 – 2022, variojnë nga pH= 7.07 - 7.5, janë brenda normës së lejuar për ujë të pijshëm dhe

klasifikohen si ujëra alkaline të dobët.

Përmbajtja e Nitriteve (NO_2): Vlerat e NO_2 variojnë nga 0.001 – 0.004 mg/ dhe janë brenda normës së lejuar.

Përmbajtja e Nitrateve (NO_3) – Vlerat e nitrateve në të gjitha fazat e monitorimit gjatë viteve 2020-2022 janë të vogla për akuiferin e Dukatit. Ajo varion nga 0.51-4.01 mg/l, dhe është brenda normës të lejuar .

Në akuiferin karbonatik të Tragjasit:

Mineralizimi i përgjithshëm Mp – Mineralizimi i përgjithshëm në të dyja fazat e monitorimit gjatë viteve 2020 - 2022 është brenda normës së lejuar dhe varion në vlera nga 300.45 – 393.3 mg/l dhe klasifikohen si ujëra të ëmbla, tipi hidrokimik i ujit është HCO_3 - Ca - Mg.

Fortësia e përgjithshme Fp – Vlerat e Fp variojnë nga 10.3 – 11.62 ° gradë gjermane dhe klasifikohen si ujëra mesatarisht të forta.

Vlerat e pH gjatë vitet 2020 – 2022 ,variojnë nga pH= 7.35 - 7.4 ,janë brenda normës së lejuar për ujë të pijshëm krahasuar me normat dhe klasifikohen si ujëra alkaline të dobët.

Përmbajtja e amonjakut NH_4 – Përmbajtja e amonjakut NH_4 në akuiferin e Tragjasit për periudhën tre vjeçare 2020 - 2022 variojnë nga 0.0 - 0.12 mg/l ku sipas VKM norma maksimalee lejuar është 0.1 mg/l. Në shpimet Syri i Kaltër dhe Uji i Ftohtë, Vlorë kemi një rritje të përmbajtjes së NH_4 në periudhën prill 2022 dhe kjo situatë ka lidhje me mos zbatimin e zonave sanitare.

Përmbajtja e Nitriteve (NO_2): Vlerat e NO_2 variojnë nga 0 – 0.15 mg/ dhe janë brenda normës së lejuar.

Përmbajtja e Nitrateve (NO_3) – Vlerat e nitrateve në të gjitha fazat e monitorimit gjatë viteve 2020 - 2022 janë të vogla për akuiferin e Tragjasit. Ajo varion nga 0 - 0.15 mg/l, dhe është brenda normës të lejuar .

Në akuiferin karbonatik të Malit të Gjerë:

Monitorimi hidrokimik për akuiferin karstik

të Malit të Gjerë, për vitet 2020 - 2022 është kryer në burimin e "Syrit të Kaltër". Prurja e burimit të Syrit të Kaltër është rreth 7.80m³/sek. Uji i këtij burimi është furnizuesi kryesor i lumit Bistrica, që përdoret për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentrali i Bistricës. Ai luan një rol të rëndësishëm për furnizimin e akuiferit ujëmbajtës kuaternar të Vurgut. Një pjesë e ujrave të tij po përdoret për pirje nga fshati Mesopotam dhe për vaditje për fushën e Vurgut.

Mineralizimi i përgjithshëm varion nga 387.29 - 514.94 mg/l, klasifikohet ujë i ëmbël. Tipi kryesor hidrokimik i ujit të burimit është HCO₃ - SO₄ - Ca - Mg dhe SO₄ - HCO₃ - Ca, Natriumi, luhatet nga vlera 7.85 - 11.39 mg/l, me përmbajtje mesatare 9.62 mg/l.

Kaliumi, luhatet nga vlera 0.50 - 1.05 mg/l, me përmbajtje mesatare 0.775 mg/l.

Kalciumi, luhatet nga vlera 92.18 - 110.22 mg/l, me përmbajtje mesatare 101.2 mg/l.

Magnezi, ka vlerën 12.16 - 13.98 mg/l, me përmbajtje mesatare 13.07 mg/l.

Kloruret luhatet nga vlera 14.2 - 23.08 mg/l, me përmbajtje mesatare 18.64 mg/l. **Sulfatet** luhaten nga vlera 120.16 - 155.98 mg/l, me përmbajtje mesatare 138.07 mg/l. **pH** luhatet nga vlera 7.19 - 7.54 me vlerë mesatare, 7.365 janë alkaline i dobët. Uji i burimit klasifikohet i fortë, **fortësia e përgjithshme** varion në vlerat 16.1 - 18.2 °gjermane. **Përmbajtje e nitriteve (NO₂)** - takohet në sasinë 0 - 0.001 mg/l, që është brenda normës së standartit të lejuar. Përbërja kimike e treguesve të tjerë të monitoruar të ujit të burimit është e mirë dhe i plotësojnë kushtet e VKM për ujë të pijshëm.

Përmbajtja e nitrateve (NO₃) në fazat e monitorimit për vitin 2020 - 2022 varion në vlerat 0.37 - 1.97 mg/l dhe sipas normës së lejuar për ujë të pijshëm ky tregues është brenda normës.

Në akuiferin Mursi - Vrinë:

Mp varion nga 530.79 - 647.59 mg/l. Klasifikohen si ujëra të ëmbla.

Fp varion nga 13.58 - 16.8 gradë gjermane.

Klasifikohen si ujëra mesatarisht të forta.

pH luhatet nga vlera 7.31 - 7.34. Klasifikohen si ujëra alkaline të dobët

3.2.3 Prurjet ujore në lumenj



Matja e vazhdueshme e prurjeve ujore në lumenjtë e Shqipërisë, konceptohet si një instrument që ndihmon në administrimin e pasurive ujore sipërfaqësore për përdorime të ndryshme industriale dhe komunitare, por gjithashtu, edhe të rreziqeve potenciale që ato mbartin në vetvete në raste të veçanta.. Ngjarjet e viteve të fundit na kanë treguar se lumenjtë tanë shpesh kanë dalë jashtë kontrolli, sasi të mëdha të ujërave që drenojnë në lumë vijnë nga rreshjet sipërfaqësore të cilat bien direkt si mbi pellgun ujëmbledhës ashtu edhe në vetë kanalën lumor. Sasia e këtyre prurjeve vitet e fundit është rritur ndjeshëm për shkak të rritjes së koeficientit të rrjedhës, si rezultat i shpyllëzimeve masive. Një pjesë tjetër e prurjeve në lumenj vjen nga ujërat nëntokësore, burimet e ndryshme dhe rrjedhat sipërfaqësore.

Lumi i Drinit

Nga pikpamja fiziko-gjeografike, sipërfaqja e përgjithshme e pellgut ujëmbledhës është 14173 km² ndërsa gjatësia 285 km. Ky lumë formohet nga bashkimi i Drinit të Zi, i cili buron nga Liqeni i Ohrit, në një kuotë 694m, duke përshkuar një rrugë 40 km jashtë territorit të vendit tonë. Sasia mesatare e reshjeve arrin në 990 mm/vit. Stratigrafia e luginës së lumit të Drinit është e lidhur ngushtë me stratigrafinë e zonës së Korabit dhe të marrëdhënieve të saj me zonën e Mirditës, me zonën e Alpeve Shqiptare dhe atë të Krasta-Cukalit. Vlerësimi i prurjeve në lumin Drin është kryer në 4 stacione Ura e Topojanit, Ura e Lumës, Bahçallëk, Ura e Mesit

Stacioni Ura e Topojanit




Matjet në stacionin Ura e Topojanit

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	D1	D1
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	14.1 m	14.3 m
Temperatura e ujit	14.8°C	15.5°C
Numri i nënseksioneve të ndara	8	8
Sasia e prurjeve	10.786 m ³ /sek	18.805 m ³ /sek
Rrezja hidraulike R _H	1.4 m	-

Sasia e prurjeve në këtë stacion është në funksion të prurjeve që dalin nga kaskada e HEC-it në tokën e Maqedonisë së Veriut. Nuk ekziston rreziku i përmbytjes në këtë segment pasi sasia e ujit që kalon është e kontrolluar dhe sipërfaqja e seksionit tërthor të kanalit deri në nivelin e urës përballon sasi të maksimale të prurjeve.

Stacioni Ura e Lumës



Matjet në stacionin Ura e Lumës, pellgu i Drinit.

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	D3	D3
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	14.2m	14.3 m
Temperatura e ujit	19.6° C	13.3° C
Numri i nënseksioneve të ndara	8	5
Sasia e prurjeve	0.6 m ³ /sek	0.327 m ³ /sek
Rrezja hidraulike R_H	Degëzimi 1 = 0.12 m Degëzimi 2 = 0.07 m	-

Sasia e prurjeve në këtë lumë kontrollohet nga HEC-i i ngritur fare pranë si dhe nga sasia e rreshjeve që bien në basenin ujëmbledhës. Praktisht, prania e HEC-it devijon sasi të konsiderueshme uji dhe shmang rrezikun e përmbytjes së zonës dhe objekteve që gjenden pranë.

Stacioni Ura e Bahçallëkut



Matjet në stacionin Ura e Bahçallëkut

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	D2	D2
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	8.0 m	8.0 m
Temperatura e ujit	16.1° C	17.6° C
Numri i nënseksioneve të ndara	20	19
Sasia e prurjeve	280.94 m ³ /sek	334.8 m ³ /sek
Rrezet hidraulike R_H sipas seksioneve të rrjedhës	$R_{H1} = 0.64$ m; $R_{H2} = 1.85$ m; $R_{H3} = 3.86$ m; $R_{H4} = 4.0$ m;	-

Vlera më e lartë e R_H është në seksionin e tretë dhe të katërt çka korespondon edhe me sasi më të mëdha të prurjeve në këto seksione. Vazhdimësia e lumit Drin është ndërprerë më sipër rrjedhës nga diga e HEC-it të Vaut të Dejës e cila kontrollon dhe dikton prurjet e ujit.

Stacioni Ura e Mesit, lumi Kirit



Matjet në stacionin Ura e Mesit, lumi i Drinit

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	D4	D4
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	-	15.8 m
Temperatura e ujit	-	14.0° C
Numri i nënseksioneve të ndara	-	5
Sasia e prurjeve	-	1.482 m³/sek
Rrezja hidraulike R_H	-	0.83 m

Në stacionin Ura e Mesit (lumi i Kirit, Drin) për fazën e parë nuk janë kryer matje për shkak të mungesës së ujit në shtrat. Për fazën e dytë sasia e prurjeve është $1.482 \text{ m}^3/\text{s}$ ndërsa $R_H = 0.83$. Lumi i Kirit ka karakter të theksuar stinor dhe torrencial.

Lumi i Bunës

Buna është lumi më fushor i vendit tonë me pjerrësi të shtratit $0,08 \%$, me gjatësi, nga burimi në liqenin e Shkodrës deri në det, rreth 44 km . Në Jug të grykëderdhjes së Bunës është formuar laguna e Vilunit, me sipërfaqe $1,6 \text{ km}^2$, që komunikon me detin nëpërmjet një kanali natyral në jug të Velipojës. Rreshjet janë kryesisht nga shiu dhe më pak dëborë. Sasia e tyre mesatare arrin deri në 2200 mm në vit. Stratigrafia e luginës së lumit të Bunës është e njëjtë me atë të Drinit në rrjedhën e poshtme të tij. Ajo është e lidhur ngushtë me stratigrafinë e zonës së Mirditës, me zonën e Krasta-Cukalit dhe atë të Krujës. Vlerësimi i prurjeve në lumin Buna është kryer në 2 stacione Ura e Bunës dhe Murriqan .

Stacioni Ura e Bunës



Matjet në stacionin Ura e Bunës

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Bu2	Bu2
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	5.2 m	5.05 m
Temperatura e ujit	27.2°C	20.7°C
Numri i nënseksioneve të ndara	18	18
Sasia e prurjeve	$77.89 \text{ m}^3/\text{sek}$	$92.454 \text{ m}^3/\text{sek}$
Rrezet hidraulike R_H sipas seksioneve të rrjedhës	$R_{H1} = 0.86 \text{ m}; R_{H2} = 2.21 \text{ m}; R_{H3} = 2.11 \text{ m}; R_{H4} = 2.01 \text{ m}; R_{H5} = 2.32 \text{ m}; R_{H6} = 1.26 \text{ m};$	-

Zona është vazhdimisht nën rrezikun e përmblytjeve pasi edhe disniveli i pasqyrës së ujit me vetë Urën dhe brigjet është shumë i vogël. Në raste reshjesh intensive, sasi të mëdha të ujit që shkarkohen nga diga e HEC-it të Vaut të Dejës rrisin ndjeshëm nivelin e ujit edhe në Bunë, ndonjëherë duke shkaktuar edhe bllokim të rrjedhjes normale të këtij lumi nga Liqeni i Shkodrës.

Matjet në stacionin e Murriqanit, lumi i Bunës.

Stacioni Murriqan



Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Bu1	Bu1
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	-	-
Temperatura e ujit	18.4°C	18.9°C
Numri i nënseksioneve të ndara	12	12
Sasia e prurjeve	$368.97 \text{ m}^3/\text{sek}$	$384.78 \text{ m}^3/\text{sek}$
Rrezja hidraulike R_H	2.18 m	-

Vlera e Rrezes tregon aftësi të mira përcjellëse të kanalit, por në raste prurjesh të mëdha, për shkak të disniveleve të vogla me bankot e lumit, rrjedha kalon edhe në stad përmbytjeje. Zona është vazhdimisht nën rrezikun e përmbytjeve pasi edhe disniveli i pasqyrës së ujit me vetë shtratin është shumë i vogël.

Lumi i Matit

Lumi i Matit buron nga mali i Kaptinës së Martaneshit. Ai ka një gjatësi 144 km, sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës rreth 2 441 km² dhe lartësi mesatare të pellgut rreth 746 m. Degët kryesore të tij janë Fani dhe Uraka. Brigjet e lumit ndërtohen nga depozitimet aluvialo-proluviale të vetë lumit të Matit. Stratigrafia e luginës së lumit të Matit është e lidhur ngushtë me stratigrafinë e zonës së Mirditës dhe atë të Krasta-Cukalit. Vlerësimi i prurjeve në lumin Mat është kryer në 3 stacione Ura e Darsit, Ura e Fanit dhe Ura e Zogut.

Stacioni Ura e Darsit

Matjet në stacionin Ura e Darsit, pellgu i Matit



Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Ma3	Ma3
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	6.0 m	5.55 m
Temperatura e ujit	15.9°C	10.8°C
Numri i nënseksioneve të ndara	6	6
Sasia e prurjeve	2.766 m³/sek	9.55 m³/sek
Rrezja hidraulike R_H	0.52 m	-

Sasitë e vogla të prurjeve në fazën e parë janë rezultat i thatësisë së zgjatur. Shtimi i prurjeve në fazën e dytë është ndikim direkt i reshjeve të shkurtra. Në këtë segment nuk ka ekzistuar më parë rreziku i përmbytjeve, por vitin e fundit niveli i ujit kaloi atë të urës duke përmbytur pjesërisht nivelin e terracës së parë, kjo e konfirmuar nga banorët e zonës.

Stacioni Ura e Fanit

Matjet në stacionin Ura e Fanit, lumi i Fanit të Vogël



Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Ma1	Ma1
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	7.6 m	7.45 m
Temperatura e ujit	24.0°C	23.6°C
Numri i nënseksioneve të ndara	5	7
Sasia e prurjeve	0.3992 m³/sek	3.07 m³/sek
Rrezja hidraulike R_H	0.16 m	-

Sasi e ulët e ujit në shtrat lidhet kryesisht me kushtet e motit, por edhe me regjimin e HEC-eve të ngritura mbi lumin e Fanit. Pjesa më e madhe e rrjedhës gjatë matjeve në fazën e parë janë ujëra të zeza. Disniveli i madh i terracës së shtratit me vetë shtratin është si rezultat i uljes së vazhdueshme të nivelit të shtratit për shkak të shfrytëzimit të inerteve lumore. Nuk ka asnjë rrezik përmbytje, aq më tepër pas ndërtimit të digës së HEC-it në Qafë Mollë.

Stacioni Ura e Zogut**Matjet në stacionin Ura e Zogut, lumi i Matit**

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Ma5	Ma5
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	-	-
Temperatura e ujit	18.0° C	18.4° C
Numri i nënseksioneve të ndara	18 (11+7)	15 (10+5)
Sasia e prurjeve	10.75 m³/sek	20.827 m³/sek
Rrezja hidraulike R_H	Degëzimi i djathtë 0.85m Degëzimi i majtë 0.22 m	-

Sasitë e ujit në këtë stacion janë funksion i rreshjeve stinore dhe regjimit të HEC-eve mbi lumenjtë e Fanit dhe Matit. Nuk ka asnjë rrezik për përmbytje në këtë segment të lumit. Kjo kryesisht për shkak të kapacitetit të madh të shtratit i cili lejon lëvizje të mëdha të masave ujore në drejtim të detit. Rreziku për përmbytje është gjithmonë i pranishëm në pjesët poshtë Urës së autostradës deri në det, sidomos në rastin e prurjeve të menjëhershme në periudhë të shkurtër kohore.

Lumi i Ishmit

Lumi i Ishmit formohet nga bashkimi i ujërave të lumit të Tiranës, Tërkuzës dhe Zezës. Sipërfaqja e përgjithshme e pellgut ujëmbledhës është 673 km². Lumi i Ishmit, ushqimin kryesor e ka nga rreshjet në formë shiu. Sipas rajonizimit klimatik të Shqipërisë, ky rajon përfshihet pjesërisht në nënzonën qendrore të Zonës mesdhetare kodrinore dhe pjesërisht në nënzonën qendrore të Zonës mesdhetare fushore, e cila zë dhe pjesën më të madhe të këtij rajoni. Në njësinë fushore rreshjet lëkunden nga 920-1200 mm/vit. Në njësinë kodrinore, rreshjet kanë një shpërndarje të njëtrajtëshme 1100-1300 mm/vit. Stratigrafia e luginës së lumit të Ishmit është e lidhur ngushtë me stratigrafinë e zonës Kruja. Vlerësimi i prurjeve në lumin Ishëm është kryer në 2 stacione Ura e Brarit (lumi i Tiranës) dhe Salme –Shetaj (lumi Ishmit).

Stacioni Ura e Brarit**Matjet në stacionin Ura e Brarit, lumi i Tiranës**

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	T1	T1
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	13.7 m	13.8 m
Temperatura e ujit	23.6° C	16.3° C
Numri i nënseksioneve të ndara	4	6
Sasia e prurjeve	0.7355 m³/sek	1.419 m³/sek
Rrezja hidraulike R_H	0.53 m	-

Nuk ka prani të rrezikut të përmbytjes së zonës, pasi shtrati është i thellë dhe përballon prurjet e lumit në kohë plotash ekstreme.

Stacioni Ura Shetaj, lumi i Ishmit

Sasia më e madhe e ujit kalon në krahun e dhjathtë të shtratit. Rreziku i përmytjes së zonës dhe objekteve që gjenden pranë saj është evident, pasi shtrati i ngushtë në kohë plotash ekstreme, rrezikon të mos përballojë sasinë e ujit.

Matjet në stacionin Salme-Shetaj, lumi i Ishmit.



Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Ish3	Ish3
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	10.6 m	10.4 m
Temperatura e ujit	26.3 ^o C	17.8 ^o C
Numri i nënseksioneve të ndara	9	8
Sasia e prurjeve	3.2012 m³/sek	4.328 m³/sek
Rrezet hidraulike R_H sipas seksioneve	$R_{H1} = 0.33$ m; $R_{H2} = 0.56$ m;	-

Lumi i Erzenit

Pellgu i lumit të Erzenit shtrihet tërësisht në zonën e mesme të Shqipërisë dhe ka një sipërfaqe prej 853km² dhe lartësi mesatare 448m mbi nivelin e detit. Gjatësia e lumit është 109 km. Si rezultat i ndryshimeve të relievit, reshjet kanë larmi të theksuara dhe niveli i tyre arrin 900-1400 mm/vit. Formacionet gjeologjike, që ndërpriten nga rrjeti hidrologjik i lumit të Erzenit, u përkasin zonave tektonike të Mirditës, Njësisë së Ostrenit, Nënzonës së Krastës, Zonës Kruja, Zonës Jonike dhe Ultësirës Adriatike. Vlerësimi i prurjeve në lumin Erzen është kryer në 2 stacione, Pëllumbas dhe Sallmone

Stacioni i Pëllumbasit

Matjet në stacionin Pëllumbas, lumi Erzen



Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Er1	Er1
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	-	-
Temperatura e ujit	23.9 ^o C	15.1 ^o C
Numri i nënseksioneve të ndara	6	7
Sasia e prurjeve	0.543 m³/sek	2.106 m³/sek
Rrezja hidraulike R_H	0.18 m	-

Sasia e ujit në këtë stacion është funksion i rreshjeve stinore dhe regjimit të rezervuarit të Skoranës në hyrje të kanionit të Pëllumbasit. Rreziku i përmytjes së zonës dhe objekteve që gjenden pranë është thujse inekzistent pasi rezervuari i Skoranës shërben si rregullator i prurjeve ujore.

Stacioni Ura e Sallmones

Matjet në stacionin Sallmone, lumi Erzen



Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Er3	Er3
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	13.7 m	13.5 m
Temperatura e ujit	24.4 ^o C	16.9 ^o C
Numri i nënseksioneve të ndara	5	5
Sasia e prurjeve	0.906 m³/sek	4.31 m³/sek
Rrezja hidraulike R_H	0.24 m	-

Sasia e ujit në këtë stacion është funksion i rreshjeve stinore. Rreziku i përmblyjes së zonës dhe objekteve që gjenden pranë saj është evident, pasi shtrati i ngushtë në kohë plotash ekstreme, rrezikon të mos përballojë sasi të e ujit.

Lumi i Shkumbinit

Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës të këtij lumi është 2445 km², lartësia mesatare e pellgut rezulton 753 m, gjatësia 181,4 km,

gjatësia mesatare e pellgut 30‰. Prurjet ujore dallohen për pjerrësi të lartë të pellgjeve ujëmbledhëse dhe për mbulesë të pakët bimore. Në këto kushte ato dallohen për vlera të larta të prurjeve të lëngëta dhe të ngurta sidomos në stinën e pranverës. Formacionet gjeologjike që ndërtojnë pellgun e Shkumbinit, përbëhen, si nga llojet sedimentare ashtu edhe nga ato magmatike e metamorfike. Vlerësimi i prurjeve në lumin Erzen është kryer në 3 stacione, Proptisht, Labinot dhe Ura e Vjetër, Rrogozhinë.

Stacioni Proptisht



Matjet në stacionin e Proptishtit, lumi i Shkumbinit.

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Sh6	Sh6
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	3.8 m	3.8 m
Temperatura e ujit	20.2° C	12.9° C
Numri i nënseksioneve të ndara	5	5
Sasia e prurjeve	0.797 m³/sek	0.896 m³/sek
Rrezja hidraulike R_H	0.19 m	-

Sasia e ujit në këtë stacion është funksion i rreshjeve stinore. Pranë urës ekzistuese prej hekuri është ndërtuar një urë e re betoni në nivel më të poshtëm se ura e vjetër. Kjo urë ka pësuar thyerje në mes të saj dhe niveli i saj

në momentin e matjes është thuhajse i njëjtë me atë të nivelit të ujit në shtrat. Nëse reshjet intensifikohen kjo urë përmblytet nga ujrati e Shkumbinit.

Stacioni Labinot



Të Matjet në stacionin e Labinotit, lumi i Shkumbinit.

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Sh5	Sh5
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	7.8 m	7.7 m
Temperatura e ujit	20.3° C	12.7° C
Numri i nënseksioneve të ndara	8	Degëzimi i majtë 8 Degëzimi i djathtë 6
Sasia e prurjeve	5.9 m³/sek	16.161 m³/sek
Rrezja hidraulike R_H	0.27	-

Terraca ndërtohet nga aluvione dhe deluvione. Disniveli i terracës me shtratin është 1,2m.

Në këtë stacion kemi dhe prurjet e përroit të Gurës, dhe të kanalit vaditës. Shuma e dy prurjeve për fazën e parë është 0.55 m³/sek

dhe për fazën e dytë 3.4 m³/sek . Rreziku i përmblyjes së zonës dhe objekteve që gjenden pranë saj është evident. Po ashtu, i rrezikuar është niveli i terracës për shkak të disnivelit të vogël me shtratin.

Stacioni Ura vjetër, Rrogozhinë



Matjet në stacionin e Rrogozhinës, lumi i Shkumbinit

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Sh4	Sh4
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	14.1 m	15.8 m
Temperatura e ujit	14.6 ^o C	15.4 ^o C
Numri i nënseksioneve të ndara	11	13
Sasia e prurjeve	3.24 m³/sek	14.578 m³/sek
Rrezet hidraulike R_H sipas seksioneve	$R_{H1} = 0.21$ m; $R_{H2} = 0.3$ m; $R_{H3} = 0.86$ m.	-

Sasia më e madhe e ujit në këtë stacion kalon në krahun e djathtë të shtratit. Prurja është funksion i reshjeve stinore dhe regjimit të digës në rezervuarin ujëmbledhës në Çengelaj. Rreziku për përmbytje është gjithmonë i pranishëm sidomos në rastin e prurjeve të menjëhershme në kohë të shkurtër pasi edhe seksioni tërthor i kanalit të rrjedhës në këtë stacion është zvogëluar në mënyrë të ndjeshme 20-22% për periudhën e viteve 2011-2020 duke ulur kapacitetin përcjellës të prurjeve për në det. I rrezikuar është niveli i terracës në krahun e djathtë të rrjedhës. Kjo ndodh për shkak se aftësia përcjellëse e kanalit nga Rrogozhina deri në det është e ulët dhe nuk mundet të përballojë rritjen e prurjeve mbi mundësitë e veta. Pjerrësia e ulët e kanalit të rrjedhës dhe mbushja e fundit të tij me sedimente të imta aluviale janë arsyet kryesore se përse uji akumulohet në këtë segment. Kur kanali mbushet, ajo që ndodh me siguri është përmbytja e zonës përreth.

Stacioni Bilisht, lumi i Devollit



Matjet në stacionin e Bilishtit, pellgu i Semanit.

Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Dv2	Dv2
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	8.1 m	8.0 m
Temperatura e ujit	18.6 ^o C	15.1 ^o C
Numri i nënseksioneve të ndara	5	7
Sasia e prurjeve	0.473 m³/sek	0.481 m³/sek
Rrezja hidraulike R_H	0.17 m	-

Lumi i Semanit

Pellgu i lumit të Semanit, shtrihet në zonën e mesme, jugore dhe juglindore të Shqipërisë. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës të këtij lumi është 5949 km², lartësia mesatare e pellgut rezulton 863 m, gjatësia e tij 281 km. Ai formohet nga bashkimi i Devollit me Osumin. Në sipërfaqen ujëmbledhëse të lumit Seman bien mesatarisht 1030 mm shi në vit. Ujrat e shirave, duke kaluar në shpatet me pjerrësi të madhe dhe me një ndërtim gjeologjik që favorizon erozionin, arrijnë shpejt në shtratin e lumit duke sjellë edhe një sasi të madhe lënde të ngurtë, duke e bërë Semanin lumin më të turbullt të vendit. Formacionet gjeologjike që ndërtojnë pellgun e Semanit, përbëhen, si nga llojet sedimentare ashtu edhe nga ato magmatike e matamorfike. Vlerësimi i prurjeve në lumin Seman është kryer në 4 stacione; Bilisht, Ura e Lapanjit, Fier dhe Ura e Mbrostarit.

Sasia e ujit në këtë stacion është funksion i rreshjeve stinore. Ky stacion ndodhet në pjesën e sipërme të rrjedhës së lumit Devoll. Vërehet qëndrueshmëri e sasisë së prurjeve midis dy matjeve të kryera.

Stacioni Ura e Lapanjit, lumi i Osumit

Matjet në stacionin Ura e Lapanjit, pellgu i Semanit



Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Os4	Os4
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	-	-
Temperatura e ujit	23.9 ⁰ C	16.4 ⁰ C
Numri i nënseksioneve të ndara	10	10
Sasia e prurjeve	2.3469 m³/sek	2.53 m³/sek
Rrezja hidraulike R_H	0.26 m	-

Sasia e ujit në këtë stacion është funksion i rreshjeve stinore. Ky stacion ndodhet në pjesën më të sipërme të rrjedhës së Osumit. Forma e thellë e kanionit lejon kalimin e sasive të mëdha të ujit. Vërehet qëndrueshmëri e sasisë së prurjeve midis dy matjeve të kryera.

Stacioni Fier, lumi i Gjanicës

Matjet në stacionin e Fierit, pellgu i Semanit



Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Gj4	Gj4
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	7.0 m	7.2 m
Temperatura e ujit	16.0 ⁰ C	19.6 ⁰ C
Numri i nënseksioneve të ndara	6	6
Sasia e prurjeve	0.154 m³/sek	0.109 m³/sek
Rrezja hidraulike R_H	0.18 m	-

Brigjet e lumit ndërtohen nga depozitime aluvionesh lumore kryesisht argjila dhe rëra të imta të cilat formojnë terracën e parë të Gjanicës dhe lumit Seman. Duhet theksuar se thuajse e gjithë sasia e prurjeve, në të dy periudhat e matjeve, janë ujëra të zeza të cilat shkarkohen fare pranë Urës në krahun e sipërm të saj.

Stacioni Ura e Mbrostarit

Matjet në stacionin e Mbrostarit, lumi i Semanit



Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Se5	Se5
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	8.5 m	8.4 m
Temperatura e ujit	25.7 ⁰ C	19.7 ⁰ C
Numri i nënseksioneve të ndara	17	18
Sasia e prurjeve	13.41 m³/sek	22.3 m³/sek
Rrezet hidraulike R_H sipas seksioneve	$R_{H1} = 0.63$ m; $R_{H2} = 0.55$ m; $R_{H3} = 1.12$ m.	-

Sasia më e madhe e ujit në këtë stacion kalon në krahun e djathtë të shtratit. Prurja është funksion i rreshjeve stinore dhe regjimit të digës në rezervuarin e Thanës. Rreziku për përmbytje është gjithmonë i pranishëm sidomos në rastin e prurjeve të menjëhershme në kohë të shkurtër.

Lumi i Vjosës

Lumi i Vjosës është lumi më i madh i Shqipërisë Jugore dhe një ndër lumenjtë më të mëdhenj të Shqipërisë, sidomos për sa i përket prurjeve të shumta ujore. Gjatësia e këtij lumi është 272km, sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës 6706km², prej të cilit, 4365km² janë brënda territorit tonë, ndërsa pjesa tjetër në territorin grek. Vjosa dhe Drinosi për shkak të mbizotërimit të gëlqerorëve në pellgun e tyre ujëmbledhës, rradhiten ndër lumenjtë më pak erozivë të Shqipërisë. Në rajonin e pellgut të Vjosës bien 1700-1800 mm shi në vit. Formacionet gjeologjike që ndërtojnë pellgun e Vjosës, përbëhen kryesisht nga karbonatet, fliшет, depozitimet mollasike dhe ato të Kuaternarit. Vlerësimi i prurjeve në lumin Vjosa është kryer në 4 stacione; Ura e Biovizhdës, Ura e Leklit, Ura e Memaliajt, Ura e Mifolit

Stacioni Tri Urat (Ura e Biovizhdës)

Matjet në stacionin e Biovizhdës (Tre Urat), lumi i Vjosës



Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Vj1	Vj1
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	10.2 m	10.03 m
Temperatura e ujit	22.4°C	13.7°C
Numri i nënseksioneve të ndara	10	10
Sasia e prurjeve	16.01 m³/sek	15.77 m³/sek
Rrezja hidraulike R_H	0.97 m	-

Sasia e ujit në këtë stacion është funksion i rreshjeve stinore. Vlera e rrezes tregon aftësi përcjellëse të mira të kanalit të rrjedhës. Nuk ka rrezik për përmbytje. Vërehet qëndrueshmëri e sasisë së prurjeve midis dy matjeve të kryera.

Stacioni Ura e Leklit, lumi i Drinosit

Matjet në stacionin Ura e Leklit, pellgu i Vjosës



Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Vj3	Vj3
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	10.2 m	10.0 m
Temperatura e ujit	20.0°C	17.3°C
Numri i nënseksioneve të ndara	10 (8+2)	16 (8+8)
Sasia e prurjeve	5.38 m³/sek	3.198 m³/sek
Rrezet hidraulike R_H sipas seksioneve	$R_{H1} = 0.3$ m; $R_{H2} = 0.15$ m;	-

Lumi e ndërton luginën e tij mes depozitimeve karbonatike në krahun e majtë të rrjedhës dhe atyre flishore në krahun e djathtë të saj. Sasia e ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore. Nuk ka rrezik për përmbytje.

Stacioni Ura e Memaliajt

Matjet në stacionin e Memaliajt, lumi i Vjosës.



Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Vj4	Vj4 Vj4
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	16.3 m	16.6 m
Temperatura e ujit	21.3° C	16.3° C
Numri i nënseksioneve të ndara	10	11
Sasia e prurjeve	40.0 m³/sek	38.16 m³/sek
Rrezja hidraulike R_H	1.08 m	-

Sasia e ujit në këtë stacion është funksion i rreshjeve stinore. Vlera e Rrezes Hidraulike tregon aftësi përcjellëse të mira të kanalit të rrjedhës. Nuk ka rrezik për përmbytje. Vërehet qëndrueshmëri e sasisë së prurjeve midis dy matjeve të kryera.

Stacioni Ura e Mifolit

Matjet në stacionin Ura e Mifolit, lumi i Vjosës.



Të dhënat	Faza e parë	Faza e dytë
Kodi i stacionit	Vj5	Vj5
Disniveli i urës nga pasqyra e ujit	7.4 m	7.2 m
Temperatura e ujit	26.7° C	17.8° C
Numri i nënseksioneve të ndara	15	19
Sasia e prurjeve	49.9255 m³/sek	84.756 m³/sek
Rrezet hidraulike R_H sipas seksioneve	$R_{H1} = 1.06$ m; $R_{H2} = 1.13$ m; $R_{H3} = 2.54$ m; $R_{H4} = 1.19$ m; $R_{H5} = 2.02$ m.	-

Vlerat më të larta të R_H janë në seksionin e mesit të shtratit dhe atë të krahut të djathtë ku janë edhe prurjet më të mëdha të rrjedhës ujore. Rreziku i përmbytjes së zonës dhe objekteve që gjenden pranë saj është evident, sidomos në rastin e prurjeve të mëdha në periudhë të shkurtër kohore.. Të rrezikuara janë të gjitha objektet inxhinierike të ndërtuara dhe ato të banimit që gjenden në të dy anët e lumit.

Tabela 26. Vlerësimi përmbledhës i prurjeve për vitin 2022

Sasia më e madhe e prurjeve për vitin 2022 është në stacionin Murriqan, lumi Bunë me 754 m³/sek duke vijuar me stacionin Bahçallëk, lumi Drin me 616 m³/sek , stacioni Ura e Bunës, lumi Bunë me 170 m³/sek dhe stacioni Ura Mifolit, lumi Vjosë me 135 m³/sek.

Nr	Stacionet e matjes	Kodi i stacionit	Lumi	Koordinatat		Prurjet (m ³ /sek)	
				N	E	Faza e I	Faza e II
1	Ura e Topojanit	D1	Drin	41° 34' 50,00"	20° 26' 2,49"	10.786	18.805
2	Ura e Lumës	D3	Drin	42° 04' 3,66"	20° 27' 50,74"	0.6	0.327
3	Bahçallëk	D2	Drin	42° 02' 31,79"	19° 29' 32,48"	280.94	334.8
4	Ura e Mesit	D4	Lumi Kir, Drin	42° 06' 50,00"	19° 34' 29,00"	0	1.482
5	Ura e Bunës	Bu2	Bunë	42° 03' 3,17"	19° 29' 28,16"	77.89	92.454
6	Murriqan	Bu1	Bunë	42° 00' 30,20"	19° 24' 14,78"	368.97	384.78
7	Ura e Darsit	Ma3	Pr i Darsit, Mat	41° 30' 23,91"	20° 04' 58,52"	2.766	9.55
8	Ura e Fanit	Ma1	Fani i Vogël, Mat	41° 46' 32,40"	19° 51' 34,10"	0.399	3.07
9	Ura e Zogut	Ma5	Mat	41° 41' 57,50"	19° 43' 33,62"	10.744	20.827
10	Ura e Brarit	T1	Ishëm	41° 22' 47,72"	19° 51' 34,27"	0.736	1.419
11	Salme-Shetaj	Ish3	Ishëm	41° 32' 29,39"	19° 36' 37,98"	3.2	4.328
12	Pëllumbas	Er1	Erzen	41° 14' 43,24"	19° 56' 9,32"	0.543	2.106
13	Sallmone	Er3	Erzen	41° 21' 39,55"	19° 32' 56,85"	0.906	4.31
14	Proptisht	Sh6	Shkumbin	40° 58' 57,86"	20° 30' 38,39"	0.797	0.896
15	Labinot	Sh5	Shkumbin + Gurrë + kanali vaditës	41° 08' 53,77"	20° 9' 58,47"	6.5	19.543
16	Rrogozhinë	Sh4	Shkumbin	41° 03' 52,14"	19° 39' 13,13"	3.24	14.578
17	Bilisht	Dv2	Devoll, Seman	40° 39' 17,53"	20° 57' 17,82"	0.473	0.481
18	Ura e Lapanjtit	Os4	Osum, Seman	40° 25' 42,55"	20° 17' 13,47"	2.347	2.53
19	Fier	Gj4	Gjanicë, Seman	40° 44' 2,83"	19° 34' 19,86"	1.154	0.109
20	Ura Mbrostarit	Se5	Seman	40° 49' 44,72"	19° 54' 38,85"	13.41	22.3
21	Tri Urat	Vj1	Vjosë	40° 06' 44,08"	20° 32' 23,96"	16.01	15.77
22	Ura e Leklit	Vj3	Drinos, Vjosë	40° 15' 33,19"	20° 03' 19,86"	5.38	3.198
23	Memaliaj	Vj4	Vjosë	40° 21' 05,61"	19° 58' 22,19"	40.0	38.16
24	Ura Mifolit	Vj5	Vjosë	40° 38' 4,26"	19° 27' 39,08"	49.93	84.756

Tendenca e prurjeve referuar viteve të mëparshme

Tabela 27. Sasia e prurjeve (m³/sek) për vitet 2016, 2018, 2019 dhe 2022, fazat e para.

Nr	Stacionet e matjes	Kodi i stacionit	Lumi	Viti 2016	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2022
1	Ura Topojanit	D1	Drin	20.9	156.9	20.7	10.786
2	Ura e Lumës	D3	Drin	14,3	39.0	7.6	0.6
3	Bahçallëk	D2	Drin	656,4	466.0	196.4	280.94
4	Ura e Mesit	K1	Kir	-	-	11.4	0
5	Ura e Bunës	Bu2	Bunë	76,5	457.8	236.0	77.89
6	Murriqan	Bu1	Bunë	777.0	1049.3	441.3	368.97
7	Ura e Darsit	Ma3	Pr i Darsit	35.5	45.1	8.6	2.766
8	Ura e Fanit	Ma1	Fani Vogël	6.7	2.4	10.0	0.399
9	Ura e Zogut	Ma5	Mat	126.4	180.5	143.3	10.744

10	Ura e Brarit	T1	Ishëm	5.4	1.9	3.4	0.736
11	Salme-Shetaj	Ish3	Ishëm	29.9	6.1	10.6	3.2
12	Pëllumbas	Er1	Erzen	8.3	6.5	2.8	0.543
13	Sallmone	Er3	Erzen	14.3	16.8	7.66	0.906
14	Proptisht	Sh6	Shkumbin	27.3	18.8	16.2	0.797
15	Labinot	Sh5	Shkumbin	144.9	125.0	101.1	6.15
16	Rrogozhinë	Sh4	Shkumbin	98.2	105.4	133.1	3.24
17	Bilisht	Dv2	Devoll	-	5.0	2.6	0.473
18	Ura Lapanjit	Os4	Osum	-	23.7	10.7	2.347
19	Fier	Gj4	Gjanicë	2.1	3.7	3.2	1.154
20	Ura Mbrostarit	Se5	Seman	60.2	231.4	151.5	13.41
21	Tri Urat	Vj1	Vjosë	74.2	85.4	58.4	16.01
22	Ura e Leklit	Vj3	Drinos	105.5	47.3	18.8	5.38
23	Memaliaj	Vj4	Vjosë	-	135.5	78.0	40.0
24	Ura Mifolit	Vj5	Vjosë	247.6	234.7	125.4	49.93

Tabela 28 . Sasia e prurjeve (m³/sek) për vitet 2016, 2018, 2019 dhe 2022, fazat e dyta.

Nr	Stacionet e matjes	Kodi i stacionit	Lumi	Viti 2016	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2022
1	Ura Topojanit	D1	Drin	15.4	50.9	8.93	18.805
2	Ura e Lumës	D3	Drin	0.7	6.2	0.62	0.327
3	Bahçallëk	D2	Drin	231.9	278.2	70.27	334.8
4	Ura e Mesit	K1	Kir	-	-	-	1.482
5	Ura e Bunës	Bu2	Bunë	64.4	66.2	93.27	92.454
6	Murriqan	Bu1	Bunë	341.2	360.0	202.22	384.78
7	Ura e Darsit	Ma3	Pr i Darsit	7.7	2.2	1.8	9.55
8	Ura e Fanit	Ma1	Fani Vogël	0.5	2.3	0.25	3.07
9	Ura e Zogut	Ma5	Mat	26.9	16.1	14.24	20.827
10	Ura e Brarit	T1	Ishëm	1.5	0.4	0.46	1.419
11	Salme-Shetaj	Ish3	Ishëm	7.1	5.1	4.44	4.328
12	Pëllumbas	Er1	Erzen	1.3	1.2	1.21	2.106
13	Sallmone	Er3	Erzen	5.0	3.8	4.08	4.31
14	Proptisht	Sh6	Shkumbin	4.9	1.4	0.94	0.896
15	Labinot	Sh5	Shkumbin	26.0	12.4	4.08	19.543
16	Rrogozhinë	Sh4	Shkumbin	41.8	20.9	4.45	14.578
17	Kuçovë	Dv1	Devoll	44.1	-	-	-
18	Bilisht	Dv2	Devoll	-	0.5	0.27	0.481
19	Ura Lapanjit	Os4	Osum	-	0.9	3.03	2.53
20	Fier	Gj4	Gjanicë	0.3	1.5	0.74	0.109
21	Ura Mbrostarit	Se5	Seman	40.2	29.9	14.26	22.3
22	Tri Urat	Vj1	Vjosë	29.8	14.9	20.86	15.77
23	Ura e Leklit	Vj3	Drinos	0.6	6.9	7.05	3.198
24	Memaliaj	Vj4	Vjosë	-	37.4	44.81	38.16
25	Ura Mifolit	Vj5	Vjosë	59.6	41.6	115.69	84.756

3.3 Vlerësimi i gjendjes

3.3.1 Ujërat sipërfaqësore






Duke vlerësuar të dhënat e marra nga ekspeditat e kryera është vlerësuar se në rrjedhën e sipërme ujërat janë të një cilësie shumë të mirë por duke zbritur afër zonave urbane vihet re një impakt shumë i lartë i shkarkimeve që shkojnë direkt në lumë pa asnjë lloj trajtimi paraprak si pasojë e shkarkimeve urbane, industriale e bujqësore duke ndikuar në cilësinë e ujërave sipërfaqësore.

Lumenjtë më të ndotur në Shqipëri janë Lumi i Tiranës me stacionet e monitorimit më të ndotura Ura – Kthesa e Kamzës, Lanabregas dhe Yrshek – Ish Dogana, Lumi Ishëm me të tre stacionet e monitorimit Ura Rinas, Ura e Gjolës dhe Ura Salmer, si dhe në Lumin Erzen – Ura e Beshirit. Ndërsa në Basenin e Semanit Lumi Gjanica i klasifikuar në Klasën V – Gjendje e keqe ku duhet të merren masa.

Ky vlerësim i situatës së lumenjve kryesorë të Shqipërisë ka impaktin e vet në cilësinë e ujërave nëntokësore, në cilësinë e deteve dhe në ekosistemet ujore dhe përmirësimi i tyre lidhet me:

1. Shfrytëzimi i inerteve pa kriter në zona të caktuara
2. Mënjanimi i shkarkimeve urbane
3. Ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të zeza
4. Ndërgjegjësimi i qytetarëve për mos-përdorimin e lumenjve si vend-depozitime




Vlerësimi i cilësisë i referohet klasifikimit të cilësisë sipas Direktivës Kuadër të Ujit

Cilësi e keqe	
Cilësi e varfër	
Cilësi e mjaftueshme	
Cilësi e mirë	
Cilësi e shkëlqyer	

Vlerësimi i cilësisë së baseneve për parametrat fiziko-kimik, 2022

	Baseni Drini - Bunë	Baseni Ishëm - Erzen	Baseni i Shkumbinit	Baseni i Semanit	Baseni i Vjosës	Baseni i Matit
Klasa I – Gjendje e lartë						
Klasa II – Gjendje e mirë					II	II
Klasa III – Gjendje e moderuar	III		III			
Klasa IV – Gjendje e varfër						
Klasa V – Gjendje e keqe		V		V		




Vlerësimi i cilësisë së liqeneve , 2022









Eutrofik	
Mezotrofik	
Oligotrofik	

Liqenet		
Liqeni i Shkodrës		
Liqeni i Ohrit		
Liqeni i Prespës së Madhe		
Liqeni i Prespës së Vogël		

Referuar rezultateve, vlerësohet se statusi i toksicitetit të metaleve të rënda nuk është shumë i dëmshëm për ujërat e lumenjve dhe liqeneve, por duhet theksuar se ekziston mundësia e kontaminimit në këto ujëra.

Vlerësimi i cilësisë së baseneve dhe liqeneve për metalet e rënda , 2022

Cilësi e keqe	
Cilësi e mjaftueshme	
Cilësi e mirë	

Basenet	Vlerësimi	Shënime
Baseni Drini - Bunë		
Baseni Ishëm - Erzen		
Baseni i Shkumbinit		
Baseni i Semanit		
Baseni i Vjosës		
Baseni i Matit		
Liqenet		
Liqeni i Shkodrës		
Liqeni i Ohrit		
Liqeni i Prespës		

3.3.2 Ujërat nëntokësore

Stacionet e pompimit të ujës jellësave Vidhas fshat, Peqin dhe Rrogozhinë, Çermë pusi 286,2 puse të Konjatit kanë fortësinë e përgjithshme mbi parametrat maksimal të lejuar për ujë të pijshëm, prandaj rekomandohet zbutja e këtij uji deri në parametrat e lejuar të ujit të pijshëm.

Pranë stacioneve të Konjatit dhe pusit 281 Çermë, vërehet prezenca e amonjakut (NH₄) në mënyrë të vazhdueshme mbi parametrat maksimalë të lejuar (PML) të

ujit të pijshëm. Për shkak të shfrytëzimit të zhavoreve në shtratin e lumenjve në zonën e ushqimit të akuiferit kuaternar janë prishur ekuilibrat hidrodinamike dhe hidrokimike të ushqimit të akuiferëve ujëmbajtëse. Sot këto ekuilibra në akuiferin Tiranë - Laknas dhe ato të Erzenit janë prishur. Janë ulur nivelet e ujërave nëntokësore, kolmatuar shtresat dhe si rrjedhojë janë ulur prurjet e shpimeve të shfrytëzimit si dhe është prishur cilësia e ujit. Stacioni i pompave të Pish - Poros të mos përdoret për furnizim me ujë të pijshëm

të popullsisë, pasi uji i tij nuk plotëson standardin për ujë të pijshëm. Furnizimi me ujë të pijshëm i fshatrave Poro, Pish Poro, Darëzezë, Qarri etj. të furnizohen me ujë të pijshëm nga ujësjellësi i Kafarajt.

Vlerësimi i cilësisë së ujërave nëntokësore, 2022

Jashtë normave për ujë të pijshëm
Brenda normave për ujë të pijshëm

Baseni	Vlerësimi	Shënime
Drin		Rezulton se ujërat në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira . Janë ujëra të ëmbla, të buta dhe të tipit alkalin të dobët Takohet përmbajtje e rritur e NH ₄ në Akuiferi i Mbishkodrës në zonën e Nënshkodrës si Blinisht dhe Velipojë, si dhe në zonën Hot i Ri dhe Grudë Fushë - Koplík Shkodër. Kjo situatë ka lidhje me mos zbatimin e zonave sanitare dhe përmbytjet.
Mat		Ujërat nëntokësore në përgjithësi janë të mira. Janë ujëra të ëmbla, të buta e mesatarisht të forta dhe të tipit alkalin të dobët. Vihet re prezenca e NO ₂ , në shpimet Patok dhe Hoteli i Gjuetisë e cila vjen nga mos zbatimi i zonave të rreptësisë sanitare. Në akuiferin poroz të Milot - Fushë-Kuqes, takohet vlerë e lartë e klorit në shpimin 177 dhe 502 Patok për arsye se këto shpime janë pikat më ekstremale në drejtim të perëndimit dhe në breg të detit Adriatik.
Erzen-Ishëm		Ujërat nëntokësore të këtij baseni në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira. Janë ujëra të ëmbla, të fortë deri në shumë të fortë dhe alkalin të dobët. Takimet e joneve NH ₄ , NO ₂ , NO ₃ , në ujë tregojnë që janë ndotje lokale dhe lidhen me moszbatimin e zonave të rreptësisë dhe mbrojtjes sanitare.
Shkumbin		Rezulton se ujërat në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira. Janë ujëra të ëmbla deri në të freskëta, mesatarisht të forta deri në shumë të forta dhe të tipit alkalin të dobët. Shfaqja e përmbajtjes së NO ₂ , NO ₃ dhe NH ₄ lidhet me moszbatimin e zonave të rreptësisë dhe mbrojtjes sanitare të shpimeve.
Seman		Ujërat në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira. Janë ujëra të ëmbla, të buta dhe të tipit alkalin të dobët. Nuk ka ndotje masive të akuifereve ujëmbajtëse. Në ndonjë rast vihet re prezenca e NO ₂ , por në vlera të ulëta, e cila vjen nga mos zbatimi i zonave të rreptësisë sanitare.
Vjosa		Rezulton se ujërat nëntokësore në akuiferët e basenit Vjosë kanë veti fiziko - kimike të mira. Janë ujëra të freskëta, të tipit alkalin të dobët, mesatarisht të forta. Nuk ka ndotje masive të akuifereve ujëmbajtëse. Përgjatë bën shpimi në Pish - Poro ku në të dyja fazat e monitorimit për të tre vitet, vlerat eMp, Fp, Na, NH ₄ , NO ₂ janë mbi normën e lejuar për ujë të pijshëm.
Zona Jonike		Ujërat nëntokësore janë ëmbla e të freskëta, të tipit alkalin të dobët, mesatarisht të forta. Nuk kanë përmbajtje të NH ₄ , NO ₂ , NO ₃ .

3.3.3 Matja e prurjeve në lumenj

Nga rezultati i matjeve të kryera, rezulton se në përgjithësi kemi patur sasira të vogla të prurjeve ujore në të gjitha stacionet ku janë kryer këto matje, referuar edhe stinës aktuale dhe sasisë tepër të kufizuar të reshjeve në vendin tonë. Jemi në periudhë thatësire ndaj dhe këto rezultate janë të pritshme.

Lumenjtë e Shqipërisë paraqesin një potencial ujqor të larmishëm i cili mund të kontrollohet, disiplinohet dhe menaxhohet duke u vënë në dispozicion të bujqësisë, industrisë dhe drejtimeve të tjera të ekonomisë në dobi të komunitetit. Në faktorët natyrorë që ndikojnë në sasinë e prurjeve ujore, rëndësi parësore kanë:

- faktorët hidrometeorologjikë (reshjet dhe intensiteti i tyre),
- ndërtimi gjeologjik i rajonit (shkalla e përshkueshmërisë së formacioneve),
- pjerrësitë e relievit në brigjet e shtretërve, shkalla e pyllëzimit (koeficienti i rrjedhës),

- pjerrësitë e vetë shtratit (gradienti i shtratit dhe i rrjedhës),

- sedimentimi apo erozioni i aluvioneve në shtratin e lumit (ulje-ngritjet e bazamentit),

- shkalla e zhveshmërisë së pellgut ujëmbledhës (mbulesa bimore), etj.

Rreziku i përmbytjeve mbetet gjithmonë evident në rrjedhjet e poshtme të lumenjve, por edhe në sektorë të tjerë të cilët kanë filluar të evidentohen në vitet e fundit. Kjo tregon shtrirjen në rritje të këtij fenomeni drejt pjesëve më të sipërme të pellgut. Një nga shkaqet kryesore të këtij fenomeni është ulja e pjerrësisë së shtratit në rrjedhën e poshtme, mbushja e tabanit të kanalit të rrjedhës dhe prurjet e shpejta me intensitet të lartë.

Në tabelën e mëposhtme jepet vlerësimi mbi shkallën e rrezikut për përmbytje sipas stacioneve, ku:

- Rrezik përmbytje 

- Nuk ka rrezik përmbytje 

Nr	Stacionet	Lumi	Shkalla e rrezikut për përmbytje		Prurjet (m ³ /sek)	
			Rrezik përmbytje	Nuk ka rrezik përmbytje	Faza e I	Faza e II
1	Ura e Topojanit	Drin			10.786	18.805
2	Ura e Lumës	Drin			0.6	0.327
3	Bahçallëk	Drin			280.94	334.8
4	Ura e Mesit	Lumi Kir, Drin			0	1.482
5	Ura e Bunës	Bunë			77.89	92.454
6	Murriqan	Bunë			368.97	384.78
7	Ura e Darsit	Pr i Darsit, Mat			2.766	9.55
8	Ura e Fanit	Fani i Vogël, Mat			0.399	3.07
9	Ura e Zogut	Mat			10.744	20.827
10	Ura e Brarit	Ishëm			0.736	1.419
11	Salme-Shetaj	Ishëm			3.2	4.328
12	Pëllumbas	Erzen			0.543	2.106
13	Sallmone	Erzen			0.906	4.31
14	Proptisht	Shkumbin			0.797	0.896

15	Labinot	Shkumbin + Gurrë + kanali vaditës			6.5	19.543
16	Rrogozhinë	Shkumbin			3.24	14.578
17	Bilisht	Devoll, Seman			0.473	0.481
18	Ura e Lapanjit	Osum, Seman			2.347	2.53
19	Fier	Gjanicë, Seman			1.154	0.109
20	Ura Mbrostarit	Seman			13.41	22.3
21	Tri Urat	Vjosë			16.01	15.77
22	Ura e Leklit	Drinos, Vjosë			5.38	3.198
23	Memaliaj	Vjosë			40.0	38.16
24	Ura Mifolit	Vjosë			49.93	84.756

3.4 Forcat shtytëse presioni, ndikimi, gjendja, reagimet



3.5. Kuadri ligjor dhe strategjik

- ✓ Direktiva Kuadër të Ujit (DKU) (75/440/EEC) të Bashkimit Evropian (BE),
- ✓ VKM nr.379, datë 25.05.2016 Për miratimin e rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm".
- ✓ Ligji nr. 10431 datë 09.06.2011, "Për

mbrojtjen e Mjedisit".

- ✓ Ligji nr. 111/2012 për "Menaxhimin e integruar të burimeve ujore".
- ✓ Ligj nr. 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".
- ✓ VKM nr. 1189 datë 18.11.2009 për "Rregullat dhe procedurat për

- hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit"
- ✓ Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit 2022.
 - ✓ VKM nr 73 datë 7.2.2018 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027.
 - ✓ Direktiva Kuadër e Ujit e Bashkimit Europian 2000/60.
 - ✓ VKM nr. 267, datë 7.5.2014 "Për aprovimin e listës së substancave prioritare për mjedisin ujor".
 - ✓ VKM nr. 246, datë 30.4.2014 "Mbi përkufizimin e normave të cilësisë mjedisore për ujërat sipërfaqësore".

Objektivat strategjik

- ✓ VKM nr 73 datë 7.2.2018 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027.

Vizioni dhe qëllimet strategjike

Vizioni për Menaxhimin e Integruar të

Burimeve Ujore pohon se deri në vitin 2027, Shqipëria do të jetë një vend me efikasitet në përdorimin e ujit, me menaxhim të integruar e funksional të burimeve ujore që përfshin edhe një sistem të plotë monitorimi dhe menaxhimi të rreziqeve nga përmbytjet dhe pamjaftueshmeria e burimeve ujore. Përdorimi i burimeve ujore bazohet në parimin e barazisë dhe qëndrueshmërise për përfitime të barabarta socio-gjinore-ekonomike, dhe drejtësi mjedisore për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Strategjia Kombëtare MIBU mund të shihet si një kuader i përgjithshëm që përmbledh të dyja politikatat e Bashkimit Evropian për ujin dhe mjedisin, ndërsa integron njekohësisht edhe përqasjet dhe objektivat e Politikave Kombëtare për menaxhimin e ujit për **katër shtyllat strategjike** (për njerëzit, për ushqim, për industrinë dhe për energjinë).

Objektivat

Strategjia MIBU përcakton 5 objektivat strategjike që kërkojnë një vëmendje të veçantë

Objektivi	Treguesit	Viti i ndërmjetëm 2024	Afati i synuar 2027
Sasia e ujit Sigurimi i një përdorimi të drejtë dhe të qëndrueshëm të të gjitha burimeve ujore	Rritet efikasiteti i përdorimit të ujit në të gjithë sektorët dhe sigurohet thithje, riciklim dhe ripërdorim i qëndrueshëm <ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimi i përqindjes së efikasitetit të përdorimit të ujit • Përqindja e pasurisë ujore totale të disponueshme që përdoret 	55% 43%	60% 40%

<p>Cilësia e ujit</p> <p>Sigurimi i statusit gjendje e mirë e ujit deri në vitin 2027 për të gjitha burimet ujore.</p>	<p>Përmirësohet cilësia e ujit duke ulur ndotjen, duke eleminuar derdhjet dhe duke zvogëluar hedhjen e materialeve dhe kimikateve të rrezikshme</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përqindja e ujërave të ndotura të trajtuara plotësisht • Përqindja e trupave ujqorë me statusin e ujit me cilësi të mire 	<p>60%</p>	<p>75%</p> <p>100%</p>
<p>Rreziqet nga uji</p> <p>Ulja e rreziqeve nga përmytjet dhe thatësira përmes menaxhimit dhe investimeve duke aplikuar aktet dhe nënaktet ligjore të cilat transpozojnë</p>	<p>Përforcohet rezistenca dhe kapaciteti për tu përshtatur me rreziqet klimatike dhe katastrofat natyrore.</p> <p>Numri i planeve të zvogëlimit të rrezikut nga katastrofat dhe mbrojtja e integruar ndaj klimës së burimeve ujore</p>	<p>Plan kombëtar i përditësuar</p>	<p>6 Plane të përditësuar për basenet</p>
<p>Informacioni për ujin</p> <p>Sigurimi i të dhënave dhe modeleve të besueshme për ujin dhe klimen.</p>	<p>Zgjerohet njohuria e nevojshme shkencore, zhvillohet kapaciteti kërkues, hartohet dhe organizohet këshillimi për politikë</p> <p>Plotësohen të dhënat në kadastrën e ujit dhe bëhen të disponueshme</p>	<p>90%</p>	<p>95%</p>
<p>Administrimi i ujit</p> <p>Menaxhimi i ujit në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithpërfshirëse. Sigurohen përfitime të barabarta ujore sociale dhe ekonomike dhe përfshirje në vendim marrje për burrat dhe gratë</p>	<p>Zbatimi i legjisllacionit dhe rregulloreve përkatëse</p> <p>Funksionimi i mekanizmave të bashkërendimit institucional</p> <p>Konsolidimi i përgjegjësive institucionale (planifikimi, vlerësimet, shpërndarja, monitorimi, zbatimi)</p> <p>Përfaqësimi proporcional i grave dhe burrave në organet vendimmarrese të ujit dhe në konsultimet me publikun për menaxhimin e ujit.</p>	<p>Per tu vendosur</p>	

Rezultatet e pritshme

- Rritje në efikasitetin e përdorimit dhe shpërndarjes së ujit me qëllim shfrytëzimin, riciklimin dhe ripërdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore.
- Ulje të ndotjes nëpërmjet moslejimit të shkarkimeve të paligjshme dhe kufizimin e shkarkimeve të lëndëve të rrezikshme në trupat ujor.
- Rritjen e qëndrueshmërisë dhe aftësinë për tu përshtatur ndryshimeve klimatike dhe katastrofave.
- Një njohje të thellë të të gjitha burimeve ujore në vend duke ofruar kështu një bazë njohurish lidhur me menazhimin e integruar të burimeve ujore.

3.6 .Rekomandime

❖ Cilësia e ujërave sipërfaqësore

- Rekomandojmë marrjen e masave nga organet e Pushtetit Vendor apo edhe në nivel Kombëtar për të minimizuar shkaktarët e ndotësve pasi impakti kryesor janë shkarkimet urbane dhe ato industriale të cilat derdhen direkt në lumenj, liqene apo edhe në zona bregdetare.
- Përmirësimi i situatës mjedisore të ujërave sipërfaqësore kërkon realizimin e investimeve në trajtimin të shkarkimeve të lëngëta urbane, sidomos në Tiranë, Fier pasi gjendja dhe cilësia e tyre vazhdon të jetë në të njëjtën situatë.
- Të respektohen standartet e përcaktuara nga Legjislacioni Shqiptar për shkarkimet e lëngëta nga subjektet prodhuese në ujërat pritës sipërfaqësore. Nga ana tjetër kontrolli i vazhdueshëm në zbatimin e ligjit do të luante një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.

❖ Metalet e rënda në ujërat sipërfaqësore

- Vlerësimi i këtyre ujërave sipërfaqësore ofron informacion kritik

në lidhje me rëndësinë e ndotjes nga metalet e rënda dhe udhëzon specialistët e mjedisit drejt strategjive specifike të riparimit.

- Po kështu, një informacion i tillë do të ndihmojë qeveritë, politikëbërësit dhe aktivistët e mjedisit për të fituar njohuri mbi marrëdhëniet midis zhvillimit të ujërave sipërfaqësore dhe menaxhimit të qëndrueshëm të tij për të mbrojtur brigjet nga ndotja e metaleve të rënda.

❖ Ujërat nëntokësore

- Kalimi i domosdoshëm i monitorimit me katër faza për çdo akuifer poroz të basenit të Drinit pasi nga ky akuifer furnizohen shumë qytete e zona të banuara me ujë të pijshëm.
- Të shtohet numri i shpimeve që shërbejnë vetëm për monitorimin e ujërave nëntokësore dhe të vendosen në to sonda multiparametrike për matje niveli dhe të parametrave fiziko - kimik.
- Të studiohen mundësi të reja furnizimi me ujë për ato zona në të cilat stacionet e tyre i kanë vlerat e elementeve kimike mbi normën e lejuar.
- Të vlerësohen përmbajtja e elementëve mbi normë si Na, Cl në basenin e Matit
- Rekomandojmë zbatimin e zonave të rreptësisë dhe mbrojtjes sanitare rreth shpimeve të shfrytëzimit për mbrojtjen e ujërat nëntokësore nga ndotjet sipërfaqësore.
- Rekomandojmë ndalimin e shfrytëzimit të zhavorreve në shtratin e lumenjve në zonën e ushqimit të akuiferit kuaternar për ruajtjen e ekuilibrave hidrodinamike dhe hidrokimike të ushqimit të akuiferëve ujëmbajtëse. Sot këto ekuilibra në akuiferin Tiranë - Laknas dhe ato të Erzenit janë prishur. Janë ulur nivelet e ujërave nëntokësore, kolmatuar shtresat dhe si rrjedhojë janë ulur prurjet e shpimeve të shfrytëzimit si dhe është prishur cilësia e ujit.
- Rekomandojmë kryerjen e inventarizimit të shpimeve pa leje në akuiferët kuaternarë, për të patur mundësi të

- kryerjes së bilancit të shfrytëzimit të akuiferëve.
- Marrja e sasive të mëdha të ujit (mbi ato që merren aktualisht) nuk duhet të bëhet pamiratimin e specialistëve (të SH.GJ.SH) sepse do të aktivizonte rrymat e mineralizuara dhe mund të kishim një prishje të cilësisë së ujërave që aktualisht janë të pijshëm.
 - Të regjistrohen, shpimet e kryera nga bizneset në zonën industriale Tiranë – Laknas – Rinas -Fushë Krujë, si dhe të pajisen me matës uji. Në këtë mënyrë do të ulet shfrytëzimi pa kriter i këtij akuiferi që shfrytëzohet për furnizim me ujë të pijshëm të Tiranës, Kamzës, Fushë Krujës dhe Shijakut
 - Rekomandojmë që ujësjellësat e akuiferit të basenit Shkumbin të funksionojnë si ujësjellës i centralizuar, duke furnizuar me ujë të pijshëm së pari Lushnjën dhe Divjakën pastaj Kavajën dhe Golemin, ose të ulet shfrytëzimi i ujit në stacionin e Çermës nga 300 – 350 l/s në maksimumi 200 l/s në mënyrë që të përmirësohen sadopak kushtet në stacionin e Konjatit.
 - Të sistemohen kanalet e shkarkimit të ujërave të përziëra që kalon pranë stacioneve të Konjatit dhe pusit 281 Çermë, pasi vërehet prezenca e amonjakut (NH_4) në mënyrë të vazhdueshme mbi parametrat maksimalë të lejuar (PML) të ujit të pijshëm.
 - Të ndalohet hedhja e mbeturinave në lumin Shkumbin pasi pusët në shfrytëzim janë afër zonës së ushqimit dhe ndotja e ujit të lumit mund të shkaktojë ndotje edhe në pusët që shfrytëzohen.
 - Klorinimi i ujit duhet të jetë i vazhdueshëm në stacionet e pompimit si dhe mbajtja nën monitorim të vazhdueshëm.
 - Stacioni i pompave të Pish - Poros të mos përdoret për furnizim me ujë të pijshëm të popullsisë, pasi uji i tij nuk plotëson standardin për ujë të pijshëm. Furnizimi me ujë të pijshëm i fshatrave Poro, Pish Poro, Darëzezë, Qarri etj. të furnizohen me ujë të pijshëm nga ujësjellësi i Kafarajt.
 - Të informohen dhe t'u rekomandohet organeve të pushtetit qendror dhe atyre lokale Vlorë, Sarandë, Karahaxh, Ksamil dhe Mursi për marrjen e masave të mënjanimin të infiltrimit të ujërave të ndotura urbane, që shkarkohen mbi zonën e drenimit të ujërave nëntokësor në zonën e burimeve karstike Uji i Ftohtë – Vlorë dhe Burimi i Syrit të Kaltër, si dhe të shpimeve në Vrion, Çukë, Karahaxh dhe Mursi.
- ❖ **Matja e prurjeve në lumenj**
- Të vazhdojë procesi i monitorimit në të ardhmen. Kjo do t'i shërbejë nxjerrjes së të dhënave krahasuese dhe dhënies së rekomandimeve përkatëse të lidhura me to.
 - Të kryhen matjet edhe në stacionet e tjera ekzistente (janë rreth 40 gjithsej në të gjithë rrjetin lumor) pasi kjo do t'i shërbente rritjes së shkallës së informacionit për të gjithë lumenjtë.
 - Marrjen e masave për mbrojtjen nga erozioni lumor, mbrojtjen e objekteve inxhinierike të rrezikuara në shtrat të lumit nga energjia e rrjedhës, mbrojtjen e tokave bujqësore dhe ndërtimeve të popullatës nga rreziku i përmbytjeve, etj.

KAPITULLI 4

AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE



KAPITULLI 4

AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

4.1 Çështjet që trajtohen

Burimet kryesore të ndotjes në ajër janë aktivitetet njerëzore si dhe sektorë të ndryshëm si zhvillimi urban, industria, transporti, bujqësia etj. Cilësia e lëndës djegëse është një nga faktorët që ndikon në ndotjen e ajrit për shkak të emetimeve të gazeve që shkarkohen në ajër.

Gjithashtu ky kapitull përshkruan përshtatjen e Raportit Dyvjeçar të Përditësuar për Shqipërinë dhe përpjekjet e bëra për të trajtuar përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Raporti përbëhet nga dy pjesë:

- Vlerësimi i cënueshmërisë dhe analiza e përshtatjes
- Përpjekjet e bëra pas Komunikimit të Tretë Kombëtar për të përballuar ndikimet e ndryshimeve klimatike përmes trajtimit të masave të përshtatjes.

Analiza e cënueshmërisë dhe përshtatjes fokusohet në basenin e lumit Vjosa (BLV), i cili është sistemi i dytë më i madh ujqor në Shqipëri dhe mbulon një sipërfaqe prej 6784 km². Lumi i Vjosës është një nga lumenjtë më të gjatë ndërkuftar në zonën e Ballkanit.

Gjithashtu paraqet informacion mbi efektet e ndryshimeve klimatike në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

4.2 Gjendja dhe tendenca

4.2.1 Burimet e ndotjes së ajrit

Bujqësia kontribuon dukshëm në emisionet e gazeve me efekt serë dhe ndotës të tjerë, veçanërisht amoniakut NH₃. Ndotja më e madhe nga amonjaku vjen si rezultat i plehut të krijuar nga blegtoaria. Ndotësit kryesor që shkarkohen në ajër nga aktivitetet njerëzore janë oksidet e squfurit dhe oksidet e azotit. Oksidet e squfurit vijnë kryesisht nga burimet pikësore në industrinë e prodhimit dhe ndërtimit, nga mineralet jo metalike, ndërsa në oksidet e azotit kontribuojnë edhe

bujqësia me anë të peshkimit kombëtar si dhe makinave bujqësore, banimi rezident si dhe burimet pikësore për prodhimin e produkteve ushqimore dhe pijeve joalkoolike.

Aktiviteti kryesor i cili ndikon në sasinë e emetimeve në ajër në vendin tonë është kryesisht prodhimidhepërpunimi i mineraleve jo metalike si stacionet rezidenciale, por nuk mund të lemë pa përmendur edhe menaxhimin e plehut nga mbarështimi i kafshëve si lopë për qumësht, dele, dhi dhe pularitë.

Aktivitetet që ndikojnë në ndotjen e ajrit urban janë:

- ✓ Infrastruktura rrugore, transporti i automjeteve dhe cilësia e karburanteve.
- ✓ Djegiet e pakontrolluara të mbetjeve urbane.
- ✓ Emetimet nga ndërtimet dhe konstruksionet urbane.
- ✓ Djegia e lëndës djegëse në shtëpi

- **Zhvillimi urban**

Aktivitetet e ndërtimore janë kontribuesit kryesorë në përqendrimin e lartë të grimcave në ajër. Në zonat e ndërtimit, përveç aktivitetet e ndërtimore, që natyrisht kanë kontributin e tyre, një kontribues i rëndësishëm mund të jetë edhe trafiku, rrugët dhe zonat e pashtuara, si dhe më së shumti qëndrimi pezull i grimcave të ngurta. Meqë përqendrimi i këtyre grimcave është i lartë në të gjithë Shqipërinë, duhet të merret parasysh sa i madh është "kontributi natyror".

- **Industria**

Zonat industriale kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në ndotjen e ajrit. Matjet e cilësisë të ajrit kanë treguar probleme serioze për grimcat në Elbasan të shkaktuara nga industria metalurgjike, fabrika e çimento dhe nga depozita të hapura. Në zonën e Fierit matjet indikative kanë regjistruar probleme serioze të shkaktuara nga industria prezente dhe e mëparshme e naftës. Në afërsi të industrive të mëdha mund të ekzistojnë probleme me cilësinë e ajrit, por monitorimi i një burimi të vetëm nuk është

një mjet eficient për strategjitë e pakësimit/ zvogëlimit. Një monitorim i përshtatshëm i shkarkimeve duhet t'i prezantohet kontrollit të shkarkimeve nga burime pikësore. Dampat dhe depozitat e krijuara nga aktivitetet të mëparshme industriale mund të kontribuojnë, gjithashtu, në shkarkimet dhe formimin e pezullive të grimcave. Depozitat në Elbasan konsiderohen si kontribues në ndotjen grimcore. Shumë "pellgje vajrash" në zonën e Fierit kontribuojnë në një emetim të konsiderueshëm të hidrokarbureve.

• Transporti

Transporti rrugor është një burim kryesor i shumë ndotësve të ajrit, në veçanti në zonat urbane. Dendësia e trafikut, moshë mesatare e parkut të automjeteve, si dhe mungesa e kontrollit të shkarkimeve të gazta nga automjetet, çojnë në rritjen e shkarkimeve duke reduktuar cilësinë e ajrit të mjedisit. Problemet janë identifikuar në shumë programe monitorimi të realizuara gjatë viteve. Përqendrime të larta të grimcave dhe të oksideve të azotit NO₂ janë regjistruar në stacionet monitoruese të vendosura afër rrugëve me trafik të dendur në Tiranë. Deri më 2013-ën nuk ka pasur ndonjë monitorim automatik në "kanionet rrugore" në zonat e mbipopulluara dhe më shumë trafik. Por në vlerësojmë që ndotja e ajrit e shkaktuar nga trafiku është domethënëse në zonat me shumë trafik në Shqipëri. Bllokimet nga trafiku për shkak të menaxhimit joeficient të tij rrisin shkarkimin e këtyre ndotësve. Menaxhimi i trafikut mund të japë një kontribut të rëndësishëm për të ndihmuar në reduktimin e shkarkimeve të ndotësve nga automjetet, si për shembull: skema që ndalojnë ose përjashtojnë makina më pak të pastra nga rrugë ose zona të veçanta, ose reduktojnë bllokimin nga trafiku rrugor duke zgjidhur probleme të parkimit, pasi kapaciteti i rrugëve mund të rritet në mënyrë të konsiderueshme, në qoftë se makinat e parkuara në mënyrë ilegale dhe parkimi paralel i dyfishtë do të reduktohej duke përforcuar zbatimin e legjislacionit mbi trafikun, si dhe duke rritur numrin e vendeve të disponueshme të parkimit.

• Bujqësia

Ndotja nga aktivitetet bujqësore ndikon negativisht në cilësinë e ajrit. Kimikatet dhe nënproduktet e agroindustrisë janë shumë të dëmshme ndaj mjedisit natyror dhe, gjithashtu, mund të përbëjnë një problem edhe për njerëzit. Pesticidet e përdorura për të vrrarë insektet që ushqehen me të korra mund të shkaktojnë një dëm të madh në mjedis nëse nuk përdoren në mënyrën e duhur. Metani i çliruar nga "proceset e keqtretjes së ushqimit", si pasojë e kequshqyerjes së lopëve është gjithashtu, një lloj gazi serë, duke e shndërruar kështu pjesërisht në një përgjegjës për ngrohjen globale. Shkarkimet nga përdorimi i karburanteve nga traktorët dhe pajisje të tjera të fermave të përdorura në bujqësi, gjithashtu, kontribuojnë në ndotjen e ajrit. Zjarret, të cilët nuk janë të pazakonshëm në ferma, mund të jenë shumë të dëmshëm për mjedisin nëse plehrat dhe mbetjet që vijnë nga ky sektor digjen në mënyrë të pakontrolluar.

• Cilësia e lëndëve djegëse

Autoriteti përgjegjës për kontrollin dhe monitorimin e respektimit të standardeve për cilësinë e lëndëve djegëse është Inspektoriat Shtetëror Teknik Industrial. Kontrolli për respektimin e standardeve shtetërore për cilësinë e lëndëve djegëse realizohet në zbatim të pikës 2 te nenit 23 të ligjit Nr.8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, VKM, nr.429, datë 26.06.2019 "Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil dhe industrial, si edhe për përdorim në mjetet e transportit ujqor" dhe Udhëzimit nr.3492, datë 30.04.2015 "Për koordinimin ndër institucional të procedurave standarde të kontrollit cilësor dhe fiskal të naftës bruto dhe nënproduktet e saj në Republikën e Shqipërisë".

Në lëndët djegëse që përdoren për përdorim industrial dhe mjetet e lundrimit detar, inspektimi dhe testimi kanë patur si objektiv, që lëndët djegëse të jenë në përputhje me:

Direktivën e Sqfurit të BE 1999/3, standardin S SH UNI 6571: 2011 dhe S SH ISO 8217. Për

shkak të kufizimeve . Për shkak të kufizimeve të përcaktuara në terminale dhe portet shqipëtare nuk janë shitur lëndë djegëse të rënda por ato janë zëvendësuar me lëndë djegëse detare në përputhje me këto kufizime.

Me daljen e direktivës 802/2016 janë përcaktuar limite të reja për përmbajtjen e sqfurit në lëndët djegëse që përdoren për qëllime rezidenciale dhe ato të tipit "heavy fuel oil" që përdoren për mjetet e lundrimit në zonat e mbrojtura detare. Në zbatim të kësaj direktive qeveria shqipëtare ka miratuar Vendimin nr.429, datë 26.06.2019 që përcakton llojet e lëndëve djegëse të lëngëta dhe vlerat kufi të përmbajtjes së sqfurit në të; treguesit fiziko-kimike të lëndëve djegëse të cilat duhet të përmbushen përpara tregtimit të tyre; kushtet e përdorimit të lëndëve djegëse të lëngëta nga anijet në portet, ujërat territorial të Shqipërisë; mënyrën e përcaktimit dhe monitorimit të treguesve tekniko cilësorë të lëndës djegëse si dhe metodat për reduktimin e shkarkimeve të lëndëve, ndotësve në ajër dhe raportimin e përputhshmërisë me vlerat kufi të të përmbajtjes së ndotësve.

Qëllimi i këtij vendimi është reduktimi i shkarkimeve të dioksidit të sqfurit, që vjen nga djegia e lëndëve djegëse të lëngëta, të prodhuara nga hidrokarburet, duke përmirësuar cilësinë e tyre, të zvogëlojë efektet e dëmshme të njeriu dhe mjedisit.

Me anë të tij synohet që reduktimi i shkarkimeve të dioksidit të sqfurit, që vjen nga djegia e lëndëve djegëse të lëngëta të prodhuara nga hidrokarburet, arrihet duke përmirësuar cilësinë e tyre, nëpërmjet vendosjes së kufizimeve për përmbajtjen e sqfurit në këto lëndë djegëse, si kusht për përdorimin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, ujërat territoriale të Shqipërisë, zonat ekskluzive ekonomike dhe zonat e kontrollit të ndotjes.

Metodat e marrjes së mostrave që zbatohen janë në përputhje me standardin S SH EN ISO 3170:2005, ndërsa kryerja e analizave është realizuar në laboratorin e këtij institucioni i cili funksionon sipas S SH ISO/IEC 17025:2017.

Në lidhje me të dhënat për treguesit e analizuar në Laboratorinë e Naftës dhe Gazit sipas tabelave të raportuara vihet re se janë analizuar treguesit e mëposhtëm:

- Viskoziteti
- Pika e flakërimit
- Hiri
- Uji
- Sqfuri
- Fuqia Kalorifike

Në lidhje me matjen e pikës së flakërimit vihet re se në të gjitha mostrat e mara në analizim vlerat janë brenda normave të lejuara (>80) ku variojnë nga 104 – 140 °C , viskoziteti gjithashtu i matur në mm²/s (>12) dhe °E (>2) është gjithashtu brenda normave të lejuara ku vlerat variojnë nga 20.6-25.2 mm²/s dhe 3.01-.3.58 °E.

Hiri matet me metodën SSHENISO 6245, ku vihet re që edhe për këtë tregues normat janë brenda vlerave të lejuara(≤0.2) dhe variojnë nga 0.065-0.088 % mase.

Uji dhe Sqfuri gjithashtu janë të matura sipas standardeve të përcaktuara dhe janë brenda normave të lejuara.

Mbledhja dhe ruajtja e të dhënave për lëndët djegëse është raportuar për 3 mujin e parë, të tretë dhe të katërt ndërsa gjatë tremujorit të dytë të vitit 2022 nuk janë marrë mostra për këto produkte pasi nuk janë importuar në doganat detare dhe tokësore, gjithashtu nuk janë prodhuar nga rafineritë e vendit tone.

Burimi i informacionit për cilësinë e lëndës djegëse është Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial.

1.1.2 Efektet në shëndet nga ndotja e ajrit

Lënda grimcore (PM-PM10 dhe PM2.5)

Lënda grimcore(pluhurat) kategorizohet në bazë të madhësisë së grimcave PM10 dhe PM2.5 që janë grimca me diametër më të vogël se 10 dhe 2.5m dhe çlirohet në atmosferë nga burime të ndryshme. Përqendrime të PM-ve përfshijnë grimca primare të emetuara direkt në atmosferë nga burimet e djegies dhe grimca dytësore të formuara nga reaksione kimike në ajër. Burime të PM-së janë si

aktivitetet njerëzore, ashtu edhe ato natyrore (si stërkalat e detit dhe pluhuri i Saharasë).

Në Shqipëri burimet më të mëdha të ndotjes së ajrit nga PM10 dhe PM2.5 janë transporti i automjeteve, cësia e lëndës djegëse ndërtimet, ngrohja e banesave, gjithashtu dhe nga ato natyrore si kripa e detit etj.

Pluhurat me diametër të ndryshëm (PM10, PM2.5) kanë efekt të dëmshëm në shëndet sepse depertojnë thellë në mushkëri sidomos PM2.5 duke shkaktuar përkeqësime të frymëmarrjes tek moshat e mëdha, sëmundjet e zemrës, goditje në zemër dhe aritmi. PM mund të demtojë sistemin nervor qendror, sistemin prodhues dhe mund të shkaktojë kancer. Një nga rezultatet e ekspozimit të PM mund të shkaktojë vdekje të parakohshme.

Grimcat të dytësore të pluhurave përfshijnë sulfate, nitrate dhe amonium të formuara nga: SO₂, NO_x dhe NH₃ që janë faktorët kryesorë të acidifikimit dhe eutrofikimit.

Oksidet e Azotit (NO_x)

Dyoksidi i azotit (NO) dhe monoksidi i azotit (NO) janë okside të azotit dhe të dy së bashku referohen si (NO_x). Burimi kryesor i dioksidit të azotit (NO₂) është transporti rrugor, i cili emeton NO₂ afër tokës, kryesisht në zona me popullsi të dendur, duke kontribuar në ekspozimin e popullsisë. Burime të tjera të rëndësishme janë proceset e djegies së lëndës së djegshme në industri dhe prodhimi i energjisë elektrike bazuar në djegen e lëndës së djegëse.

Nivelet e larta të NO₂ shkaktojnë efekte të padëshiruara në shëndet, ky mund të dëmtojë mëllçinë, shpretkën, gjithashtu mund të përkeqësojë sëmundjen e mushkërive duke krijuar problem respirator. Ashtu si dhe SO₂, NO₂ ndikon në formimin e shiut acid dhe në eutrofikimin e tokës dhe ujit duke dëmtuar habitatet, dhe humbjen e biodiversitetit.

Ozoni (O₃)

Ozoni nuk emetohet direkt nga ndonjë burim njerëzor. Ai është produkt i reaksioneve kimike që ndodhin ndërmjet ndotësve të ndryshëm të ajrit, kryesisht NO_x dhe përbërjet organike të avullueshme (volatile) VOC, të iniciuar nga

rrezatimi i fortë diellor.

Meteorologjia luan një rol të rëndësishëm në formimin e ndotjes së ajrit dhe ky efekt është veçanërisht i rëndësishëm për ozonin.

Niveli i lartë i ozonit mund të shkaktojë problem të shëndetit respirator duke zvogëluar funksionimin e mushkërive, përkeqësimin e astmës dhe sëmundje të tjera të mushkërive deri në vdekje të parakohshme. Ozoni gjithashtu është gaz me efekt serë duke kontribuar në ngrohjen e atmosferës.

SO₂ (Dioksid Squfuri)

Ka për origjinë djegien e karburanteve që përmbajnë sqfur, si qymyri dhe vajra të rëndë nga rafineritë. SO₂ është një ndotës që shkakton probleme serioze në shëndetin e popullatës si përkeqësimin e astmës si dhe redukton funksionin e mushkërive dhe irriton aparatit respirator. Kjo mund të shkaktojë dhimbje koke, shqetësim dhe ankth. SO₂ ndihmon në formimin e shiut acid impakti i të cilit mund të jetë i dukshëm duke shkaktuar dëmtimin e pyjeve dhe ekosistemin e liqeneve dhe lumenjve.

Benzeni

Ka një shumëllojshmëri burimesh, por mënyra kryesore është përfitimi nga djegiet shtëpiake dhe industriale, si dhe nga transporti rrugor. NMVOCs përfshijnë kimikate të ndryshme si benzene (C₆H₆) dhe 1,3 butadiene rrezikojnë direkt shëndetin njerëzor, gjithashtu janë dhe pararendës të ozonit të nivelit të ulët të atmosferës. Benzeni avullon shumë shpejt në ajër dhe transportohet në distanca të largëta.

CO (monoksidi i karbonit)

Monoksidi i karbonit (CO) është një gaz toksik pa ngjyrë, jo irritues, pa erë dhe pa shije. Burimi kryesor i ndotjes së ajrit nga CO është djegia jo e plotë e karburanteve që përmbajnë karbon si p.sh dru, benzinë, qymyr, gaz natyror dhe vajguri dhe emetohet në ajër nga transporti rrugor, djegja nga sektori shtëpiak dhe industrial.

Monoksidi i karbonit (CO) është një ndotës që në nivele të larta mund të shkaktojë probleme në zemër dhe të demtojë sistemin

nervor. Ky gjithashtu mund të shkaktojë dhimbje koke, marramendje dhe lodhje.

Metalet e rënda në ajër

- Përmbajtja e metaleve të rënda përfshirë dhe Plumbin mbi vleren limite të përcaktuar nga direktivat e BE kanë ndikim negativ në shëndetin e popullatës. Të miturit dhe fëmijët e vegjël janë veçanërisht të ndjeshëm edhe ndaj niveleve të ulëta të plumbit.
- Burimet kryesore të ndotjes së ajrit nga metalet e rënda janë transporti rrugor, sektori i furnizimit me energji, sektori rezidencial.

Burimi i informacionit për efektet në shëndet është raport i Agjencisë Europiane të Mjedisit. "Air quality in Europe 2022", <https://www.eea.europa.eu/publications/air-quality-in-europe-2022>

Agjencia Kombetare e Mjedisit si pjesë e rrjetit EIONET raporton çdo vit në Agjencine

Europiane të Mjedisit të dhënat për cilësinë e ajrit .

Bazuar në të dhënat e raportuara për periudhën 2016-2020, Agjencia Europiane e Mjedisit në vitin 2022 ka botuar një raport ku paraqitet një vlerësim mbi përqindjen e popullsisë së ekspozuar nga ndotja e ajrit, ku përfshihet edhe Shqipëria për treguesit PM2.5, NO₂ dhe O₃.

Nga ky vlerësim rezulton se numri i vdekjeve të parakohshme të ekspozuar ndaj PM2.5 është 3646, ndaj NO₂ është 325 dhe ndaj Ozonit është 31

Tabela 1. Numri i vdekjeve të parakohshme ndaj ndotjes së ajrit 2016-2020

Burimi: "Air Pollution country profile" Albania, European Air Quality Portal, aqportal.discomap.eea.europa.eu

	Popullsia x 1000	Mesatare vjetore e PM2.5 µg/m ³	Vdekje të parakohshme	Mesatare vjetore e NO2 µg/m ³	Vdekje të parakohshme	Mesatare vjetore e O3 µg/m ³	Vdekje të parakohshme
Shqipëria	2.845	15.6	3 646	12.8	325	5,678	313
EU27	442 850	11.3	237 810	14.1	48 555	4,182	24 109

4.2.3 Ndryshimet klimatike

Ditë të ngrohta me diell në janar që u ngjajnë pranverës apo mungesa e reshjeve masive të borës krijon idenë se e gjithë kjo nuk është fort normale. Me verën e temperaturave të larta, thatësirave të zgjatura, zjarret e shumtë, reshjeve që bien në mënyrë intensive në një hark kohor të shkurtër, përmbytjet e shumë e shumë tregues të tjerë. Institucionet ndërkombëtare kanë rritur vëmendjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke u kërkuar vendeve të jenë aktivë dhe vigjilentë për të reaguar dhe për të minimizuar pasojat.

Po Shqipëria, në çfarë faze është ?

Sot, vendi ynë ka miratuar një ligj të veçantë "Për ndryshimet klimatike". Bëhet fjalë për ligjin 155, i datës 17 dhjetor 2020, i cili rendit

si qëllime të tij pesë pika kryesore:

1. Ulja e shkarkimeve të efekteve serrë.
2. Përshtetimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutja e efekteve të dëmshme.
3. Të kontribuojë në përpjekjet globale ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet plotësimit të detyrimeve të Republikës së Shqipërisë ndaj Konventës.
4. Të krijojë një kuadër gjithëpërfshirës ligjor dhe ndërinstitucional për ndërmarrjen e veprimeve ndaj klimës në nivel kombëtar, në përputhje me legjislacionin e BE-së për ndryshimet klimatike.
5. T'u bashkohet shteteve që njohin

emergjencën klimatike, sipas vendimit të Parlamentit European të 28 nëntorit 2019.

Në fillim të vitit 2022, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka ndërmarrë nismën "Për promovimin e zgjidhjeve të transportit alternativ miqësor me mjedisin". Bazuar në Udhëzimin e Ministres së Turizmit dhe Mjedisit, nr.1, datë 24.3.2022, "Për nevoja të mbrojtjes së mjedisit, parandalimin e ndotjes në mjedis dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, caktimin e ditës pa makina" nga data 24 mars e 2022, e diela e parë e çdo muaji në Shqipëri është caktuar si "Dita pa Makina" dhe qarkullimi i të gjitha kategorive të automjeteve private është i kufizuar përkohësisht në zonat e banuara.

Me qëllim mbrojtjen e shtresës së ozonit, kuota vjetore e lejuar e importit të substancave ozonholluese për vitin 2022 për Republikën e Shqipërisë, u reduktua në 55 Ton nga 60 Ton që ishte në 2021.

Përdorimi i substancave që dëmtojnë shtresën e ozonit dhe emisionet e tyre është një tregues i presionit që ushtrohet në mjedis duke ndikuar në cilësinë e ajrit dhe ndryshimet klimatike..

Në zbatim të VKM nr. 10, datë 9.1.2019 "Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substanca", përcaktohen kuotat vjetore për importin e substancave ozonholluese të kontrolluara. Në tabelën e mëposhtme paraqitet sasia totale e importuar e substancave ozonholluese për periudhën 2019-2022.

2019	2020	2021	2022
98 Ton	70.8 Ton	60 Ton	55 ton

Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Në kuadër të projektit "Republika e Shqipërisë: Aktivitete mundësuese për përgatitjen e Komunikimit të Katërt Kombëtar dhe Raportit të Parë Dyvjeçar të Përditësuar, në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve

të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike" të zbatuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PKBZH), me mbështetjen financiare të Fondit Global për Mjedisin (FGM), është përgatitur në korrik 2021, Raporti i Parë Dy vjeçar i Përditësuar për Shqipërinë në lidhje me ndryshimet klimatike.

Në këtë raport përfshihet analiza mbi cënueshmërinë dhe përshtatjen duke marrë në konsideratë sektorët/sistemet e Basenit të Lumit Vjosë që paraqitet në seksionin e mëposhtëm:

1.1.1.1 Vlerësimi i cënueshmërisë dhe përshtatjes për Basenin e Lumit Vjosë

Analiza mbi cënueshmërinë dhe përshtatjen merr në konsideratë sektorët/sistemet e BLV-së: burimet ujore, bujqësinë, tokën, shëndetin dhe kanalizimet, reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, biodiversitetin dhe pyjet, turizmin dhe vendbanimet. Në Shqipëri, ujëmbledhësi i Vjosës ka një lartësi mesatare prej rreth 855 m dhe shtrihet në shtatë rrethe: Ersekë, Përmet, Gjirokastër, Tepelenë, Mallakastër, Fier dhe Vlorë (në qarqet e Vlorës dhe Gjirokastrës). Trupat kryesorë ujorë janë lumenjtë e Vjosës, Drinos dhe Shushicës, liqeni i Butrintit, si dhe lagunat e Nartës dhe Orikumit.

Tendencat klimatike

Tendenca e temperaturës mesatare për 1930-2006, krahasuar me mesataren e periudhës 1961-1990 për zonën e ujëmbledhësit të Vjosës, tregon se gjatë periudhës 1931-1970 ka pasur një anomali pozitive pasuar nga një anomali negative mes viteve 1971 dhe 2000 (shihni figurën e mëposhtme). Pas vitit 2000, ka pasur një periudhë me anomali pozitive nga viti 2001 e deri më sot. Kjo ka ardhur si pasojë e rritjes së temperaturave maksimale dhe minimale ditore, veçanërisht gjatë periudhës së verës. Temperatura mesatare vjetore në vitin 2010 ka arritur tashmë vlerat e parashikuara për vitin 2020.

Analiza e anomalive të tendencës së reshjeve vjetore për periudhën 1931-2008, në zonën

e rrjedhës së poshtme të Vjosës (shihni figurën e mëposhtme) tregon se ndryshimi i vlerave normale (1961-1990) mund të ndahet në nënperiudha të ndryshme: një periudhë shumë e lagësht gjatë një periudhë e lagësht viteve 1935-1945, e ndjekur nga një periudhë e lagësht gjatë viteve 1951-1980 deri në 40% mbi vlerën normale, një periudhë e thatë gjatë viteve 1981-2000 deri në 45,3% nën vlerën normale, ndërsa që nga viti 2000 ka pasur një periudhë me rritje të nivelit të reshjeve.

Projeksionet për klimën


Projeksionet e ndryshimeve klimatike janë reduktuar nga "Trajektoret e përqendrimeve përfaqësuese" (TPP-të) përvlerësimin e klimës nga pikëpamja shkencore dhe janë kalibruar për sipërfaqen e BLV-së. Të gjithë skenarët për BLV-në sugjerojnë se temperatura në zonë ka gjasa të rritet. Po kështu, priten tendenca në rritje të temperaturave vjetore

dhe sezonale, si në vlerat minimale edhe në ato maksimale. Temperaturat maksimale mesatare parashikohet të arrijnë deri në 1,1°C brenda vitit 2050 dhe të mbeten në nivele të pandryshuara në vijim. TPP8.5 (ngrohja globale 4°C) shfaq projeksionet më negative me rritje të temperaturave maksimale mesatare deri në 2,0°C dhe 4,7°C, përkatësisht brenda vitit 2050 dhe 2100

Niveli vjetor bazë	2050
2100	Temp (°C)

Figura : Shpërndarja vjetore e Tmaks, TPP8.5 në horizonte të ndryshme kohore

Skenarët e ndryshimeve klimatike parashikojnë rritje në nivele më të ulëta të **temperaturave maksimale** gjatë dimrit dhe pranverës krahasuar me rritjet gjatë verës dhe vjeshtës.



Temperaturat minimale mesatare dhe kufijtë e luhatjeve të tyre ka gjasa të rriten. **Temperaturat ekstreme** parashikohet gjithashtu të rriten sipas të gjithë skenarëve TPP.

Analiza e projeksioneve të reshjeve sipas TPP-ve të ndryshme tregon se në të gjithë skenarët parashikohet një tendencë e lehtë negative për të gjitha stinët dhe horizontet kohore. Skenarët parashikojnë një tendencë disi më pozitive të reshjeve gjatë dimrit, për të gjitha horizontet kohore. Këto tendenca pozitive mund të shfaqen si pasojë e temperaturave më të larta gjatë dimrit, të cilat çojnë në sasi më të larta të reshjeve të shiut krahasuar me ato të dëborës. Reduktimi i reshjeve të dëborës do të çojë në rënie të prurjeve të lumenjve gjatë pranverës.

Sektorët e Basenit të Lumit Vjosë që ndikohen nga ndryshimet klimatike

Burimet ujore Burimet ujore janë një nga faktorët mjedisorë më të cënueshëm për sa i përket ndikimit të ndryshimeve klimatike. Ulja e prurjeve të lumenjve varet kryesisht nga ndryshimet në nivelin total të reshjeve, nga shpërndarja e tyre brenda vitit dhe nga fakti nëse reshjet bien në formën e borës apo të shiut. Të gjithë këta faktorë ndikohen nga ndryshimet klimatike. Temperatura është veçanërisht e rëndësishme në basenet ku mbizotëron bora. Rritja e mesatare vjetore të temperaturës, veçanërisht gjatë verës, do të ndikojë në procesin e avullimit në basen, i cili ndikon gjithashtu në prurjet e lumenjve edhe në nivelin e ujëmbledhësit. Për shkak të këtyre temperaturave më të larta ka

gjithashtu shumë të ngjarë që të rritet avullimi potencial në të gjitha zonat. Këto rritje do të jenë më të mëdha në stinët me ulje të nivelit të reshjeve. Në të gjitha qasjet e përdorura, ulja e reshjeve mesatare vjetore shkakton një rënie në prurjet mesatare vjetore në BLV

Ndryshimet e pritshme të reshjet dhe temperaturat do të ndikojnë jo vetëm në hidrologjinë e basenit ujëmbledhës, por edhe në kërkesën për ujë. Kërkesa për ujë në sektorin industrial dhe familjar tregon ndryshime të ngjashme në të gjithë skenarët klimatikë. Vetëm kërkesa për ujë për vaditje po ushtron presion shtesë mbi një sistem në ndryshim.

Bujqësia Disa rezultate kryesore që lidhen me ndikimet e ndryshimeve klimatike në rendimentin e kulturave janë: •Rritja e shpeshtësisë dhe intensitetit të thatësirave si pasojë e reduktimit të burimeve ujore shkakton stres të rëndë fiziologjik te bimët dhe kafshët •Rritja e shpeshtësisë së përmytjeve si pasojë e shpeshtësisë dhe intensitetit të reshjeve të dendura të shiut, për një periudhë të caktuar kohore, shkakton stres fiziologjik dhe stres të drejtpërdrejtë fizik te bimët dhe kafshët Koha e disponueshmërisë së ujit kur nuk ka mungesë të theksuar ose sasi të tepërt uji, por disponueshmëria e tij gjatë vitit ndryshon në mënyrë të tillë që nuk është më e përshtatshme për praktikatat aktuale bujqësore, për kulturat apo për kafshët . Ndryshimet e mundshme në nivelin e detit do të kenë ndikim të konsiderueshëm të bujqësia në zonat e rrafshëta (kryesisht zonat bregdetare që përfshijnë fushat e Fierit, të Vlorës dhe të Xarës në Sarandë), për shkak të përmytjeve, depërtimit të ujit të kripur në tokat bujqësore, humbjes së sipërfaqes tokësore nga erozioni bregdetar etj.

Toka Ndikimi i ndryshimeve klimatike në erozionin e tokës vlerësohet duke përdorur metodën e erozionit potencial (MEP). Kjo metodë vlerëson sasinë potenciale të materialit të gërryer dhe të depozituar për vitet 2035 dhe 2050.

Analiza tregon se: •Sasia potenciale e materialit të gërryer për periudhën aktuale është 3 976 382 m³/vit, dhe rrjedhimisht sasia mesatare e materialit të gërryer për

hektar është 6,14 m³/ha/vit. Kjo vlerë tregon se fenomeni i erozionit të tokës është në nivele të moderuara në zonën e BLV-së. •Fenomeni i erozionit të tokës në BLV do të vazhdojë të jetë i pranishëm gjatë viteve të ardhshme, duke regjistruar një rritje graduale të sasisë së materialit të gërryer.

Menaxhimi i rrezikut të fatkeqësive (MRF) Analiza statistikore e të dhënave të DesInventarAlbania tregon një numër në rritje të ngjarjeve të fatkeqësive gjatë tre dekadave të fundit, kur merren parasysh përmytjet, përmytjet e shpejta, zjarret në pyje, rrëshqitjet e tokës, stuhitë, stuhitë e dëborës dhe reshjet e dendura të shiut). Bashkitë më të prekura janë Fieri me 45% të totalit të ngjarjeve, Vlora me 19%, Gjirokastra me 19%, Përmeti me 7%, Mallakastra me 5%. Më tepër se 98% e të gjitha ngjarjeve, duke përfshirë zjarret në pyje shkaktohen nga kushtet meteorologjike, dhe periudha më problematike për sa i përket katastrofave të përmytjeve është tetor deri në mars, periudhë në të cilën regjistrohen edhe nivelet maksimale të reshjeve në zonë, si dhe nivelet maksimale të shkarkimeve të lumenjve. Duke marrë në konsideratë rezultatet e skenarëve të ndryshimeve klimatike (SNK), numri i katastrofave pritet të rritet. Një nga fatkeqësitë më të rëndësishme në BLV janë përmytjet, veçanërisht në rrjedhën e poshtme të tij. Harta e mëposhtme tregon zonën në rrjedhën e poshtme të BLV-së ku ekziston një rrezik i konsiderueshëm potencial për përmytje.




Figura 28: Identifikimi i zonës me rrezik të konsiderueshëm potencial për përmbytje në rrjedhën e poshtme të BLV-

Biodiversiteti dhe pyjet. Ndikimi i ndryshimeve klimatike të biodiversitetit dhe ekosistemet e pyjeve identifikon cenueshmëritë kyçe që lidhen me ndryshimet klimatike në BLV, me fokus të zonat e mbrojtura. Në veçanti, ai identifikon ndikimin e hidrocentraleve dhe hidrocentraleve të vegjël të biodiversitetit dhe pyjet, në kushtet e ndryshimeve klimatike, siç përshkruhet më poshtë. Duke supozuar një rritje të temperaturës me 1-2°C, parashikohet që ekosistemet pyjore të zëvendësohen nga ekosistemet e livadheve (Raporti i Parë Dy vjeçar i Përditësuar për Shqipërinë). Rritja e temperaturës do të sjellë kushte të ndryshme të tokës, duke e bërë të pasigurt mbjelljen e pyjeve të qëndrueshëm në brezin tokësor të livadheve malore deri në 1900 m mbi nivelin e detit, në malet e Murganas, Kardhiqit, Çajupit, Çikës, Shelegurit, Dhëmbanit, Zhulatit dhe Nemerçkës. Me rritjen e temperaturave do të ketë një përzierje më të madhe të pyjeve. Pyjet tipike mesdhetare (*querus* sps., *arbutus* sps dhe *carpinus orientalis*) dhe pyjet që i rezistojnë temperaturave të larta, të ekspozuara në shpatet jugore dhe jugperëndimore në zonën përreth BLV-së, do të përzhihen me pyjet e lisit. Bimësia kserofite në pyje do të ndikohet nga mungesa e ekuilibrit të rezervave ujore dhe do të penetrojë në mënyrë aktive ekosistemet e pyjeve duke çuar në ulje të prodhimit të pyjeve (biomasës) dhe rritje të degradimit të ekosistemeve tokësore. Ndikim të

konsiderueshëm do të ketë edhe në ligatinat me rëndësi kombëtare në deltën e Vjosës dhe në Lagunën e Karavastasë. Habitatet do të ndryshojnë si pasojë e rritjes së nivelit të detit dhe temperaturës së mjedisit ujor.

Ndërtimi i hidrocentraleve do të ketë ndikim të rëndë në faunën e egër. Mund të shkaktohet humbje e përhershme e habitatit dhe biotopeve të veçanta si pasojë e përmbytjeve, luhatjes së niveleve të ujit, përhapjes së specieve ekzotike dhe pengesave ndaj migrimit të peshkut.

Njollat e zeza (*Cerostitis Platenea*) të pemëve të rrapit bëjnë pjesë në sëmundjet kërpudhore që po infektojnë *Platanus orientalis*. Në luginën e Vjosës kjo sëmundje është shfaqur gjatë dhjetë viteve të fundit dhe po përhapet me ritme të shpejta.

Turizmi dhe vendbanimet. Për zonën bregdetare të BLV-së, rritja e parashikuar e temperaturës pritet të zgjasë periudhën e turizmit të diellit dhe të detit. Deri në vitin 2030, periudha tetor-maj do të mbetet e papërshtatshme për turizmin e diellit dhe atë detar, ndërsa periudha tjetër e vitit do të vazhdojë të ofrojë nivele të plota komforti. Të dhënat për vitin 2050 e përcaktojnë prillin si një muaj të pranueshëm, qershorin si ideal, ndërsa muajin maj, korrik, gusht, shtator dhe tetor si muaj të shkëlqyer për veprimtari turistike. Numri i vizitorëve parashikohet të rritet. Rritja e parashikuar e temperaturës

në seksionin e sipërm të basenit (në rajonet kodrinore dhe malore por edhe në Parkun Kombëtar të Llogarasë, mali i Gramozit) parashikohet të ketë efekte negative për turizmin dimëror dhe mjedisin në përgjithësi. Pritet një rritje e konsiderueshme e nevojës për ujë dhe energji. Kërkesa për ujë do të rritet për shkak të rritjes së numrit të turistëve dhe kërkesës së tyre për ujë. Si rezultat i rritjes së parashikuar të nivelit të detit dhe rritjes së shpeshësisë dhe intensitetit të reshjeve të dendura të shiut, rrezikohen zonat e mëposhtme në BLV:

- Zona të banuara me rrezik potencial për t'u përmbytur: Seman-Vlorë: Tepelenë, Memaliaj, Selenicë, Mallakastër, Fier (vetëm në këtë zonë rrezikohen nga përmbytja pothuajse 60 ha), Vlorë
- Rrugët e rrezikuara nga përmbytjet: rreth 25 km ndërmjet Fierit dhe Vlorës

Duke pasur parasysh ndryshimet e parashikuara në temperaturat minimale dhe ato maksimale, pritet rënie e gradë-ditëve të ngrohjes dhe rritje e gradë-ditëve të ftohjes. Kjo tregon kërkesën në rritje për energji për ftohje, veçanërisht në pjesën bregdetare të BLV-së, Konispol.

Sektori i shëndetësisë dhe kanalizimeve.

Analiza konsiston në vlerësimin e ndikimeve shëndetësore të ngjarjeve ekstreme (për shembull përmbytjet dhe thatësitat). Sëmundjeve që lidhen me temperaturat ekstreme (probleme kardiovaskulare dhe sëmundjet e tjera kronike). Stresit të shkaktuar nga nxehtësia, i cili mund t'i bëjë të papërballueshme kushtet e jetesës dhe punës, si dhe mund të rrisë rrezikun e sëmundjeve kardiovaskulare, respiratore dhe renale. Rreziku parashikohet të jetë veçanërisht i lartë në prani të ndotjes së ajrit. Sëmundjeve me prejardhje nga insektet dhe zoonozave. Ndryshimet klimatike zgjasin sezonin e transmetimit dhe rrisin shtrirjen gjeografike të shumë sëmundjeve. Sëmundjeve që lidhen me ujin (sëmundjet gastrointestinale, shpërthimet e sëmundjeve, sëmundjet parazitare si leptospiroza). Shumë sëmundje infektive, duke përfshirë ato me prejardhje nga uji, janë mjaft të ndjeshme ndaj ndryshimeve klimatike. Ndotjes së ujit të pijshëm, të ujërave sipërfaqësore dhe ujërave për qëllime argëtimi (monitorim bakterial). Sigurisë ushqimore (patogjenët dhe toksinat që rrezikojnë sigurinë ushqimore) dhe veçanërisht në lidhje me përmbytjet dhe thatësitat.

Vlerësimi i gjendjes së sektorëve në Basenin e Lumit Vjosë

Burimet ujore

•Përdorimi industrial dhe shtëpiak i ujit dhe ujitja ndikohen nga ndryshimet e reshjeve dhe të temperaturës.

Shëndeti

•Ndryshimet në stinën e polenit dhe në cilësinë e ajrit do të përkeqësojnë astmën dhe sëmundjet pulmonare. Rritja e nxehtësisë do të shtojë çmueshmërinë ndaj sëmundjeve kardiovaskulare, infektive dhe parazitare.

Biodiversiteti

•Sipërfaqet e ligatinave dhe pyjeve të ndjeshme do të ndikohen në një masë të madhe nga ndryshimet klimatike. këtu përfshihen sëmundjet kërpudhore që prekin pemët e rrapit. Hidrocentralet e reja do të kenë gjithashtu ndikim në faunën e egër.

Menaxhimi i rrezikut

•Numri i përmbytjeve, zjarreve në pyje, stuhive, stuhive të dëborës, rrëshkitjeve të tokës dhe reshjeve të dendura të shiut është rritur gjatë tre dekadave të fundit

Rreziku klimatik

- Parashikohet rritje e temperaturave si dhe e rrezikut të reshjeve intensive, që do të çojë në përmbytje. Niveli i detit parashikohet të rritet.

Bujqësia

- Rendimenti i kulturave do të ndikohet nga rritja e thatësirave, përmbytjeve dhe ndryshimet në periudhën e disponueshmërisë së ujit, si dhe nga rritja e nivelit të detit në zonat e rrafshta bregdetare.

Turizmi

- Turizmi dimëror parashikohet të pësojë rënie ndërsa ai veror të rritet. Parashikohet rritje e kërkesës për ujë dhe energji.

Që nga Komunikimi i Tretë Kombëtar, Shqipëria ka vazhduar përpjekjet për të trajtuar përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në strategjitë dhe planet kombëtare dhe sektoriale, në legjislaionin e saj, në planet e menaxhimit etj.

4.2.4 Ndryshimet klimatike gjatë vitit 2022

Sipas Institutit të Gjeo-Shkencave, reshjet kanë një rënie me 20% në dy dekada të fundit, dhe rritje të temperaturave mesatare vjetore.

Klima e Shqipërisë nga monitorimet e viteve të fundit ka ndikime të klimës subtropikale, pra klimë më e ngrohtë. Dimrat janë më të ngrohtë dhe më të shkurtër, ndërsa stina e verës është më e gjatë dhe me temperatura më të larta. Ashtu si me shumicën e problemeve socio-ekonomike në botë, ndryshimi i klimës është një çështje që do të prekë më shumë shtresat në nevojë dhe me probleme ndaj përshtatjeve të menjëhershme. Askush nuk është imun ndaj ndryshimeve klimatike – duke e bërë atë një problem me të vërtetë global. Gjatë vitit të shkuar 2022, u vu re një rritje e numrit të ditëve me temperaturë mbi 40 Gradë Celsius. Në Korrik dhe Gusht jemi përballur me vlera të temperaturave mesatare maksimale përkatësisht: korriku +3.6 °C dhe gushti +2.6 °C (referuar të dhënave IGJEO). Muaji korrik u karakterizua me tre valë të të nxehtit, të cilat shkaktuan ditë të njëpasnjëshme me temperaturë të lartë dhe për pasojë thatësira. Nëse flasim për periudhën e ftohtë të vitit, dimri u shoqërua me

situata përmbytjesh. Ajo çfarë vihet re është se sasia e reshjeve që duhej të shpërndahej në harkun kohor të një muaji, tani rezulton që bie në 4-5 ditë dhe ka intensitet të shtuar.

Lidhur me treguesit kryesorë, si temperatura dhe reshjet, konstatohet se temperatura mesatare vjetore në vitin e fundit ka shënuar rritje prej 1.8 °C, ndërsa sasia vjetore e reshjeve në formë bore dhe shiu, në dy dekadat e fundit ka pësuar rënie rreth 20%.

Sektorët që preken më shumë nga ndryshimet klimatike janë:

Bujqësia, Akuakulturë, Agrokultura , Sektori i Energjisë, Turizmit, Ekonomisë.

Bujqësia, nën ndikimin e çrregullimeve termike, erozionit dhe sëmundjeve

Ndër vite, studime të ndryshme kanë treguar se një numër i madh sektorësh jetikë do t'i ndiejnë pasojat. Një prej tyre është bujqësia, ku toka bujqësore po pëson dëme të mëdha nga erozioni. Një element tjetër me ndikim negativ është çrregullimi i shpërndarjes së temperaturave ditore gjatë muajve dhe stinëve. Çrregullimi i regjimit termik dhe hidrik prek direkt bujqësinë, veçanërisht në zonat e ulëta gjatë përmbytjeve, apo në zonat mbi ujë në periudhën e nxehtë, ku për shkak të zvogëlimit të kapacitetit akumulues të tokës për ujë, vështirësohet mbijetesa e bimëve.

Ndikimi tjetër negativ në bujqësi lidhet me erozionin. Gjatë reshjeve intensive, ulet

depozitimi i ujit në tokë dhe shtohet rrjedha sipërfaqësore, duke larguar nga tokat një sasi të konsiderueshme të lëndës organike dhe të elementeve ushqyese. Kohëzgjatja e periudhave të thata si efekt i ndryshimeve klimatike prek veçanërisht tokat mbi ujë (pa sistem vaditës) dhe e gjithë kjo ndikon në uljen e prodhimit. Përgjithësisht këto toka shtrihen në rajonet kodrinore dhe malore në gjithë territorin e Shqipërisë. Kulturat bujqësore që dominojnë këto toka janë foragjeret, drufrutoret, vreshtat dhe ullishtat. Rendimentet e marra në këto toka janë relativisht të ulëta dhe të lidhura shumë ngushtë me reshjet. Më të ndjeshme ndaj thatësirave të zgjatura janë bimët njëvjeçare dhe shumëvjeçaret e reja, pasi sistemi i tyre rrënjor shfrytëzon vetëm ujin në shtresat sipërfaqësore të tokës

Ngricat, nga ana tjetër, që në vite të veçanta janë regjistruar në zonën e ulët në vend, në Janar-Shkurt kanë krijuar shqetësime për bimët në serrat me ngrohje diellore apo temperaturat relativisht të larta të Janarit, pasi mund të kemi çelje të parakohshme të luleve të pemëve frutore, dëmtimit të tyre të mëvonshëm.

Kushtet e reja të mjedisit kanë ndikim edhe te sëmundshmëria dhe aktiviteti i patogjenëve që shkaktojnë. Nga përvoja e deritanishme, temperaturat e larta dhe pranvera e thatë (Mars-Prill) ka ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin e popullatave dhe agresivitetin e karkalecave ndaj bimëve bujqësore.

Lagështia e tepërt ka ndikuar në rritjen e dinamikës së popullatës së kribave tel, në përhapjen dhe agresivitetin e sëmundjeve që janë të pranishme në tokë (verticilioza, fuzarioza phytophthora)

Në rastet e përmbytjeve, fenomeni që po shfaqet shpesh këto vitet e fundit po favorizohen sëmundjet e qafës së rrënjës dhe të rrënjës. Ndërkohë, jo në të gjitha rastet këto rritje temperaturash kanë sjellë efekt negativ. Temperaturat e larta gjatë këtyre viteve, për muajt Korrik dhe Gusht mbi 29°C kanë kufizuar dhe sjellë për pasojë mosçeljen e vezëve të mizës së ullirit. Këto temperatura

kanë ndikuar drejtpërdrejt në ndaljen e çeljes së vezëve dhe si rezultat në mospraninë e larvave si stad biologjik që dëmton frutën e ullirit.

Harta bujqësore, modifikime të kufizuara, agrumet "ngjiten" më në Veri

Ndryshimi i regjimit termik dhe hidrik, sipas ekspertëve, do të kërkojë që edhe harta e rajonizimit të bimëve bujqësore, të pësojë disa ndryshime, edhe pse këto të kufizuara.

Kjo hartë në vetvete tregon se cilat janë kulturat më të përshtatshme për çdo rajon të vendit, sipas tipareve të tokës dhe klimës.

Kërkesa të tilla të bimëve si: temperaturë minimale e mbirjes, shumat e temperaturave aktive dhe temperaturat optimale për çdo fazë të vegjetacionit, janë treguesit bazë që merren në konsideratë për të përcaktuar rajonet më të përshtatshme për kultivimin e bimëve. Meqenëse një nga efektet kryesore të ndryshimeve klimatike lidhet me ndryshimet termike, atëherë është e qartë që harta e shpërndarjes së kulturave bujqësore do të pësojë modifikime.

Projeksionet në terma afatmesëm dhe afatgjatë të ndryshimeve termike tregojnë se zhvendosjet do të jenë të kufizuara dhe do të lidhen kryesisht me bimësi të zonave të ngrohta që do të ngjiten më shumë drejt veriut dhe lartësive. Këtu mund të përmendim rajonet e përhapjes të agrumeve, ullirit, pjeshkës, luleshtrydhes, serrave me ngrohje diellore etj. Suksesi i bujqësisë do të varet nga kombinimi i duhur i faktorit termik, pra temperaturave dhe sigurimit të ujit të nevojshëm për periudhën deficitare. Në këtë kontekst, për të mirëadministruar ato burime ujore në dispozicion, duhet të ketë një qasje më të mirë ndaj metodave më eficiente të ujitjes. Për sa i përket periudhës afatshkurtër, problem themelor që duhet të zgjidhet është siguri i rezervave të mjaftueshme ujore dhe përdorimi i metodave që mirëadministrojnë ujin, siç janë ujitja me pika apo me shihedhje. Kjo ndërhyrje do të zbushte efektet e mundshme të ndryshimeve klimatike, që mund të shfaqen me thatësira të zgjatura.

Efektet në sektorin e Bujqësisë

- Ndryshimi i regjimit të reshjeve sjell rritje të erozionit dhe shpëlarje të tokës gjatë përmbytjeve.
- Nga përmbytjet janë të rrezikuara tokat fushore veçanërisht të Ultësirës Perëndimore në mënyrë të veçante ato që lidhen me lumenjtë e Drinit, Bunës dhe Vjosës.
- Temperaturat e nxehta shkaktojnë zjarre të cilat shkretojnë vegjetacionin.
- Ndryshimi i kushteve klimatike mund të ndikojë pozitivisht apo negativisht në shumimin e popullatave të patogjeneve specifike në një rajon të dhënë.
- Nga përvoja e deritanishme temperaturat e larta dhe pranvera e thatë (Mars-Prill) ka ndikuar drejtpërdrejtë në zhvillimin e popullatave dhe agresivitetin e karkalecave ndaj bimëve bujqësore
- Temperaturat e larta të shfaqura gjatë këtyre viteve për muajt Korrik dhe Gusht mbi 29°C kanë bërë të mundur kufizimin dhe mos çeljen e vezëve të mizës së ullirit.
- Lagështia e tepërt ka ndikuar në rritjen e dinamikës së popullatës së kribave tel, në përhapjen dhe agresivitetin e sëmundjeve që janë të pranishme në tokë (verticilioza, fuzarioza phytophthora).
- Ndryshimet klimatike kanë ndikuar tek shfaqja e patogjeneve të rinj në rajone ku nuk kanë qenë prezent më parë.
-

• **Sektori i Agrokulturës (Kantinat e verës)**

Kantinat anekënd botës, prej vitesh kanë ngritur alarmin mbi efektin e ndryshimeve klimatike në aktivitetin e tyre. Kantinat shqiptare gjithashtu shfaqin shqetësimin për situatën e re dhe të pashmangshme ku do të gjenden në afatmesëm apo afatgjatë, duke e parë këtë si një sfidë që nuk varet shumë në dorë të politikëbërjes vendase. Parashikohet sfida ekonomike, të cilat nuk varen vetëm nga politikat e vendit tonë, por edhe ato ndërkombëtare, një sfidë që lidhet me ndryshimet klimatike, të cilat po sjellin efekte negative në industrinë e verës. Ndryshimet drastike të temperaturës përcaktojnë se cilat varietete rrushi mund të rriten, si dhe formësojnë cilësinë dhe rendimentin e lëndës së parë, produktit rrush. Fenomeni i ngrohjes globale dhe efektet në këtë industri janë bërë temë diskutimi nga shumë specialistë të fushës, të cilët hulumtojnë më gjerë mbi këtë problematikë. Rritja e temperaturave ka ndryshuar jo vetëm karakteristikat e rrushit, por edhe kohën e pjekjes së tij apo sezonin kur është gati për t'u vjelë. Çdo vit, është identifikuar rritje e nivelit të sheqerit dhe janë prodhuar verëra pak më të larta me alkool dhe për këtë arsye, stilet e verës kanë ndryshuar.

Të gjitha këto ndryshime sigurisht do të vënë në pikëpyetje të ardhmen e prodhimit të verës,

pasi do të ndikojnë në kostot e prodhimit, të ardhurat dhe fitimet e prodhuesve të verës, të cilët duhet të gjejnë strategji të menaxhimit të rrezikut dhe të përshtatin biznesin e tyre të prodhimit të verës për një botë më të ngrohtë. Sfidat e një sektori si pija e verës është reale dhe tashmë kantinat anekënd botës po kërkojnë zgjidhje të kultivimit të varieteteve më rezistentë ndaj ndryshimeve klimatike kudo.

• **Akuakultura, drejt specieve "më tolerante", duhet monitorim ndaj invazivëve**

Peshkimi, akuakultura detare po ndikohen dhe do të preken edhe më shumë në afatgjatë nga kushtet e reja që po sjellin ndryshimet klimatike, ku përballja e sektorit me këto ndryshime është reale. Ndryshimet e klimës edhe në vend tonë janë bërë më të dukshme. Në dhjetor kemi pasur temperatura si në pranverë, ndërsa thatësira nuk është ndier aq si në vendet fqinje si Greqia dhe Italia.

Në sektorët e peshkimit dhe akuakulturës, pritshmëritë për rritje të efekteve të ndryshimeve klimatike janë ende të mëdha, edhe pse për fat të mirë ne kemi burime të ujërave të brendshme që na ndihmojnë për akuakulturën e ujërave të brendshme. Kurse

në atë detare, efektet janë ndier disi më pak. Në këtë kontekst të ri, sektori duhet që të ketë qasje drejt përshtatjes më të mirë, çka do të thotë se në akuakulturë duhet të ketë një tranzitim ndaj modeleve më të qëndrueshëm dhe kultivimit të llojeve të peshkut më rezistentë ndaj temperaturave. Në sektorin e akuakulturës, një problem me të cilin po përballet dy vitet e fundit edhe me akuakultura e brendshme, jo vetëm ajo detare.

Rritja e temperaturave ka efekt direkt në këtë sektor, pasi imponon servirjen e një ushqimi në sasi më të madhe për peshqit. Rasti më freskët është ai i Vaut të Dejës, ku bëhet rritja e troftës së ylbertë. Shpenzimet e fermerit për të ushqyer me ushqim të përgatitur importi janë rritur ndjeshëm. Sa herë që temperatura rritet mbi 20 gradë ka një tendencë për të dhënë më shumë ushqim, pasi ulet ritmi i metabolizimit dhe ushqimi shërben për ta mbajtur gjallë peshkun. Në akuakulturën detare duhet një përshtatje drejt llojeve që tolerojnë temperaturat e larta. Lloje si levreku, që nuk janë përshtatur kaq mirë ndaj temperaturave të larta, do kenë probleme. Levreku ka probabilitet më të lartë sëmundshmërie, ndaj duhet që kjo industri të kanalizohet të kultivimi i kocës.

Një pikë e rëndësishme që duhet të mbahet në vëmendje, është monitorimi i specieve invazive që nën efektin e ndryshimeve klimatike nuk po mungojnë as në ujërat tona. Stabilizimi i popullatave nga këto specie mund të ketë pasoja jashtëzakonisht të dëmshme për peshkimin. Ekziston një lloj peshku si **Lagocephalus sceleratus** që është i dëmshëm i cili është parë në ujërat tona në vitin 2020. Ky u raportua se një individ i vetëm që u kap, por sesa ka avancuar ai sot, nuk ka të dhëna. Po kështu peshku luan, apo "Lionfish", në vitin 2020 që u raportua në Sarandë për herë të parë, është parë edhe në Veri. Nga raportimi i fundit ai është peshkuar edhe në Kune-Vain-Tale, çka tregon për zgjerim të mëtejshëm të habitatit të tij në ujërat territoriale të Shqipërisë.

Kjo është një specie që ende nuk ka stabilizuar popullatat, por është jashtëzakonisht i

dëmshëm për peshqit e tjerë, pasi ushqehet jo vetëm me peshqit e rritur, por edhe me larvat apo juvenilët, duke shkaktuar dëme të jashtëzakonshme. Ky peshk grabitqar shkatërron ekosistemet që popullohen nga peshqit dhe ka pasoja në peshkimin industrial dhe atë artizanal.

Një rast tjetër i peshkut invaziv, është ai i **peshkut diell**. Ky është hasur në liqenet e Belshit dhe konsumon vezët e familjes së llojeve të krapit dhe shfaros peshqit që janë subjekt i akuakulturës.

Efektet në sektorët e Akuakulturës dhe Peshkimit

- Në strukturën e ekosistemeve ujore, ndikimi më i madh ka qenë në pjesën bregdetare apo detare.
- Vit pas viti në det janë raportuar specie të ndryshme invazive (specie pushtuese konsiderohet një organizëm që nuk është vendas apo tipik në një zonë të caktuar).
- Me rritjen e temperaturave kemi edhe rritjen e incidencës së sëmundjeve. Kjo do të thotë që sëmundshmëria është më e lartë në këto raste e sidomos kur behet fjale për salmonidet, si trofta e ylberte.
- Duhet një përshtatje drejt llojeve që tolerojnë temperaturat e larta.
- Peshku Levrek ka probabilitet më të lartë sëmundshmërie, ndaj duhet që kjo industri të kanalizohet tek kultivimi i kocës.

Sektori i Energjisë

Energjia cilësohet si një nga sektorët e lidhur drejtpërdrejt me ndryshimet klimatike. Në vendin tonë, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare është prodhuesi më i madh i energjisë nga hidrocentralet në kaskadën e Drinit. Për sasinë e reshjeve në basenin e Lumit Drin parashikohet një rënie e lehtë. Për të ardhmen afatmesme, rënia e pritit është në nivelin 5%, me një reduktim të reshjeve pothuajse në të gjitha stinët. Si rezultat i rritjes së temperaturës, gjatë sezonit të dimrit do të bjerë më pak reshje dëbore dhe më shumë reshje shiu, gjë që do të çojë në një

reduktim të ndjeshëm të akumulimit të borës.

Rënia e parashikuar e reshjeve dhe rritja e pritshme e humbjeve të ujit, nga evapotranspirimi i shkaktuar nga temperaturat më të larta të ajrit, do të rezultojë në uljen e prurjeve mesatare vjetore prej rreth 5% në terma afatshkurtër dhe deri në 10% në terma afatmesëm.

Korporata, duke pasur si referencë prodhimin mesatar vjetor të 10 viteve të fundit (4400 GWh), ka përllogaritur se reduktimi i pritshëm i prurjeve është i barabartë me një humbje në prodhimin mesatar vjetor prej përafërsisht 220 GWh (afatshkurtër) deri në 440 GWh (afatmesëm).

Ndërsa vlerat mesatare vjetore të reshjeve dhe prurjeve pritet të ulen, frekuenca e ngjarjeve me reshje maksimale ka gjasa të rritet. Kjo mundësisht do të çojë në ndodhjen më të shpeshtë të prurjeve maksimale (lokale), e cila është e rëndësishme veçanërisht për operimin e rezervuarit të Komanit.

Gjithashtu, ndryshime të tjera priten në kushtet hidrologjike për të ardhmen afatshkurtër dhe afatmesme, duke përfshirë rritjen e shkallës së erozionit dhe depozitimit të sedimenteve në rezervuare. Por prodhimi nga burimet hidro nuk është i vetmi në vend. Fotovoltaikët do të ndikohen gjithashtu nga ndryshimet klimatike. Rritja e temperaturave mund të ulë eficiencën e paneleve diellore me 10-25%. Studime tregojnë se për çdo gradë Celsius të rritjes së temperaturës, efienca e një paneli diellor bie me 0.5%.

Nxehtësia bën që një numër i madh i elektroneve të panelit – ata që janë përgjegjës për shndërrimin e energjisë nga dielli në energji elektrike – të lëvizin, duke reduktuar përfundimisht tensionin e gjeneruar të panelit dhe efikasitetin e tij.

Efektet në sektorin e Energjisë

- Energjia (ndikimi tek kaskada e Drinit). Për sasinë e reshjeve në basenin e Lumit Drin parashikohet një rënie e lehtë.
- Për të ardhmen afatmesme,

rënia e pritshme është në nivelin 5% me një reduktim të reshjeve pothuajse në të gjitha stinët.

- Si rezultat i rritjes së temperaturës, gjatë sezonit të dimrit do të bjerë më pak reshje dëborë dhe më shumë reshje shiu, gjë që do të çojë në një reduktim të ndjeshëm të akumulimit të dëborës.
- Rënia e parashikuar e reshjeve dhe rritja e pritshme e humbjeve të ujit nga evapotranspirimi i shkaktuar nga temperaturat më të larta të ajrit, do të rezultojë në uljen e prurjeve mesatare vjetore prej rreth 5% në terma afatshkurtër dhe deri në 10% në terma afatmesëm.
- Duke përdorur prodhimin mesatar vjetor të 10 viteve të fundit si referencë (4400 GWh), ky reduktim i prurjeve është i barabartë me një humbje në prodhimin mesatar vjetor prej përafërsisht 220 GWh (afatshkurtër) deri në 440 GWh (afatmesëm);
- Vlerat mesatare vjetore të reshjeve dhe prurjeve pritet të ulen, frekuenca e ngjarjeve me reshje maksimale ka gjasa të rritet.

Sektori i Turizmi

Turizmi është një tjetër sektor që po vuan pasojat e ndryshimeve klimatike. Në vendin tonë, turizmi dimëror mbetet ende me një peshë të ulët dhe mungesa e resorteve me shërbime të integruara nuk e ka ngritur alarmin për mungesën e borës.

Turizmit dimëror përkufizohet kryesisht nga vizitat në Veri të vendit në rajonin e Bogës, ku kohëve të fundit janë bërë investime në struktura akomoduese cilësore, në Valbonë, por edhe në Juglindje si në Korçë dhe rrethinat e saj Dardhë e Voskopojë. Si rezultat i rritjes së temperaturës, gjatë sezonit të dimrit do të bjerë më pak reshje dëborë dhe më shumë reshje shiu, gjë që do të çojë në një reduktim të ndjeshëm të akumulimit të borës.

Në Shqipëri, turizmi veror fokusohet kryesisht në plazhe. Deti Adriatik ka përjetuar një rritje mesatare të nivelit të detit prej rreth 15 cm gjatë shekullit të kaluar, duke çuar në një lëvizje tërheqëse të vijës bregdetare për çdo cm të rritjes mesatare të nivelit të detit.

Duke i shtuar këtij fenomeni edhe erozionin aktiv detar të shkaktuar nga abuzimi i ndërhyrjeve të njerëzve në menaxhimin e derdhjeve të lumenjve, atëherë mund të themi se çdo vit në Shqipëri zhduken qindra metra katrorë plazhe dhe thahen e shkatërrohen qindra pisha.

Efektet në sektorin e Turizmit

- Në Shqipëri turizmi nuk është një sektor imun ndaj ndryshimeve klimatike, por pasojat janë më të lehta kur bie fjala tek turizmi dimëror për shkak të mungesës së resorteve të mëdhenj dhe pistave të skive.
- Në pjesën bregdetare ka disa rajone ku deti ka fituar terren duke zhdukur zonën e rërës e në të tjera është tërhequr duke krijuar hapësira të reja.
- Disa destinacione që janë të rëndësishëm për aspektin turistik por edhe ekosistemin në tërësi siç janë lagunat janë të rrezikuara deri në zhdukje.


Konkluzionet e përgjithshme mbi ndryshimet klimatike në vendin tonë

- **Agrumet do të mund të kultivohen edhe në Veri;**
- **Akuakultura mund të tranzitohet nga levreku te koca;**
- **Incidentat e sëmundjeve po rriten;**
- **Reshjet po shkojnë drejt sasive më të ulëta, intervaleve të shkurtra, por intensitetit të lartë;**
- **Temperaturat mesatare vjetore në vitin e fundit shënuan rritje +1.8 Gradë Celsius;**
- **Sasia vjetore e reshjeve në formë dëbore dhe shiu, në dy dekadat e fundit, ka pësuar rënie prej rreth 20%;**

Të gjitha këto janë ndikimet që ndryshimet klimatike do të sjellin në Shqipëri, të cilat në afat të mesëm dhe afat të gjatë do të jenë më të dukshme.

Referenca për ndryshimet klimatike 2022: <https://www.monitor.al/efekti-domino-i-ndryshimeve-klimatike-si-po-rrezikohet-shqiperia/>

4.3 Forca shtytëse, presioni, ndikimi, gjendja, reagimi



Ajri

- VKM nr. 594, datë 10.09.2014, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Cilësinë e Ajrit të Mjedisit".
- VKM nr.412 datë 19.06.2019 "Për miratimin e Planit Kombëtar për menaxhimin e Cilësinë e Ajrit".
- Ligji nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit të Mjedisit".
- VKM nr. 162, datë 19.02.2020 "Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve në ajër".
- Ligj nr 9425, datë 06.10.2005, "Aderimi në konventën e CLRTAP"
- VKM nr. 154, datë 27.2.2019 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 633, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete".
- VKM nr 352/, datë 29.4.2015 "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të".
- VKM 435/2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër"
- VKM nr. 907, datë 21.12.2016, "Për kufizimin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa bojëra, llaqe dhe produkte për lustrimin e mjeteve".
- VKM nr. 908, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e masave për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i

tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime".

- VKM nr. 909, datë 21.12.2016 "Për rikuperimin e avujve të benzinës në fazën e dytë, gjatë mbushjes së mjeteve motorike në stacionet e shitjes së karburanteve".
- VKM nr.429, datë 26.06.2019, "Për cilësinë e disa karburanteve të lëngshëm, për përdorim termik, civil dhe industrial si dhe për përdorim në transportin ujor (detar, lumor dhe liqen).
- Udhëzimi i përbashkët i MTM dhe MIE nr. 6529/2, datë 6.10.2020 "Për mbledhjen, ruajtjen, marrjen e mostrave dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e benzinës, diezELIT, gazit të lëngët të naftës (gln), lëndëve djegëse të lëngëta të mesme-rënda, lëndëve djegëse të lëngëta të rënda, lëndëve djegëse të lëngëta detare dhe furnizuesit e këtyre lëndëve djegëse të lëngëta".

Ndryshimet klimatike

- Vendimi Nr. 889 datë 27.12.2022 për "Miratimin e rregullores për monitorimin, raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe të informacioneve të tjera, që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar".
- Ligji nr.155 datë 17.12.2020 "Për Ndryshimet Klimatike".
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI-II).
- Strategjia Ndërsektoriale për Mjedisin 2015-2020 (SNM).
- Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit për periudhën 2016-2020.
- Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore (SKMIBU).
- Strategjia dhe Plani Kombëtar për Ndryshimet Klimatike (SPKNK).
- Plani i Përgjithshëm Kombëtar,

- Shqipëria 2030 (PPK).
- Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin 2030.
- Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit Qershor 2019
- Kontributi Kombëtar i Percaktuar (KKP) i rishikuar për Shqipërinë.
- Komunikimi i Parë Kombëtar i Republikës së Shqipërisë drejtuar Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike Korrik 2002.
- Komunikimi i Dytë Kombëtar i Republikës së Shqipërisë drejtuar Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike 2016.
- Komunikimi i Tretë Kombëtar i Republikës së Shqipërisë drejtuar Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike, 2019.
- Komunikimi i Katërt Kombëtar i Republikës së Shqipërisë drejtuar Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike 2022

teknologjisë prej 2.5%.

Transporti: Reduktimi i shkarkimeve ndotëse (CO₂) deri në vitin 2030 me 60%, investimeve në teknologji, inovacionit dhe ndërtimit të kapacitetit në përputhje me objektivin evropian për vitin 2030.

4.5 Objektivat strategjik

Dokumenti i Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Ndryshimet Klimatike për pjesën e zbutjes, merr në konsideratë objektivat afatgjata deri në vitin 2050, që kërkojnë reduktime afatgjata të shkarkimeve dhe shtimin e përthithësve në sektorët përkatës, në përputhje me objektivat e Bashkimit Evropian, për të reduktuar me kosto efektive shkarkimet në 95% deri në vitin 2050.

Energjia: Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar sipas Marrëveshjes së Parisit, Shqipëria shpreh angazhimin e saj për uljen e shkarkimeve CO₂ krahasuar me skenarin bazë deri në 2030 në masën 11.5%. Kjo ulje nënkupton ulje 708 kt CO₂ deri në vitin 2030. Sipas dokumentit, kjo është në përputhje me normën vjetore për frymë të shkarkimit të gazit të 2 ton CO₂, deri në vitin 2050.

Bujqësia: Zbatimi i masave konkrete kërkon kohë të gjatë, vlerësohet një periudhë kohore deri në vitin 2050, me një rritje vjetore të

KAPITULLI 5
MENAXHIMI
I MBETJEVE



KAPITULLI 5

MBETJET

5.1 Çështjet që trajtohen

Në vendin tonë të dhënat nga sektori i menaxhimit të mbetjeve shërbejnë për tre qëllime:

- Për gjenerimin e statistikave për zhvillimin e Planeve të Integruara të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Strategjisë Kombëtare.
- Për vendim marrjen për hapjen e një venddepozitimi të ri në zone.
- Për përditësimin e përgjithshëm të statistikave të mbetjeve për bashkinë, duke dhënë informacion për përmirësimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve për komunitetin lokal.

Bashkitë i mbështesin të dhënat e tyre vetëm tek numri i popullsisë, i shumëzuar me një koeficient të mbetjeve të prodhuara për frymë, i cili ndryshon midis bashkive të mëdha dhe atyre të vogla si dhe midis zonave urbane dhe atyre rurale. Situata aktuale në Shqipëri me raportimin e të dhënave parashikon vetëdeklarim drejtpërdrejt nga bashkitë në AKM (bazuar në VKM nr. 687/2015, e ndryshuar me VKM nr. 538/2021). Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) ka një bazë të konsoliduar të dhënash për menaxhimin e mbetjeve të mbledhura nga bashkitë si dhe nga bizneset që kanë ndikim mbi prodhimin e mbetjeve në mjedis, përfshirë përpunimin dhe trajtimin të cilat përfshihen në sistemin e Regjistrimit të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve (RSHTN).

5.2 Gjendja dhe tendenca

Në zbatim të VKM-së nr.538 datë 22.09.2021, për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave numër 687, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve". Njësitë e qeverisjes vendore kanë detyrimin të dorëzojnë të dhënat mbi rrymat e mbetjeve të gjeneruara në territorin

që ato administrojnë deri më 31 janar të çdo viti. Në bazë të këtij vendimi kanë respektuar detyrimin ligjor të raportimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për vitin 2022, kanë raportuar gjithsej 46 bashki nga 61 që është numri total i tyre. Bazuar në formatin e kërkuar të raportimit të vetdeklarimit, bashkitë japin informacion në lidhje me sasi të mbetjeve të grumbulluara sipas këtyre rrymave:

- Sasia e mbetjeve organike (shtëpiake)
- Sasia e mbetjeve inerte
- Sasia e mbetjeve spitalore
- Sasia e mbetjeve plastike
- Sasia e mbetjeve të qelqit
- Sasia e mbetjeve metalike
- Sasia e mbetjeve të drurit
- Sasia e mbetjeve të letrës dhe kartonit
- Sasia e mbetjeve të dala jashtë përdorimit
- Sasia e mbetjeve të vajrave të përdorura
- Sasia e mbetjeve nga produktet e kafshëve
- Sasia e mbetjeve të produkteve të tekstit
- Sasia e mbetjeve elektrike dhe elektronike
- Sasia e mbetjeve të depozituara në landfill
- Sasia e mbetjeve të depozituara në incinerator

5.2.1 Mbetjet bashkiake

Gjatë fundit të vitit 2020 deri në vitin 2022, AKM-ja, së bashku me GIZ-in/DKTI-në, ka mbështetur peshimin e mbetjeve të hedhura në vendgrumbullimet bashkiake për 61 bashki. Kjo ka rritur ndjeshëm njohjen për situatën mjedisore në lidhje me mbetjet bazuar në të dhënat e matura mbi sasi të mbetjeve bashkiake për të gjithë vendin.

Tabela 1. Peshimi i mbetjeve të grumbulluara nga bashkitë

Bashkitë / Viti	2020	2021	2022
Numri i bashkive që peshojnë mbetjet në vend-depozitim përfundimtar + ponderuar nga AKM	18	45	61
Numri i bashkive që nuk peshojnë mbetjet në vend-depozitim përfundimtar	43	16	0
Pjesa e bashkive që peshojnë mbetjet në vendin përfundimtar të depozitimit në %	30 %	74%	100%

Burimi: Raport i GIZ/DKT. Të dhëna të sakta për mbetjet bashkiake si bazë për zhvillimin e politikave dhe përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve për qytetarët

Bazuar në peshimin e mbetjeve, nga projekti i GIZ/DKT, vlerësohet se i gjithë vendi gjeneron dhe grumbullon 705,435 ton mbetje në vit. Ndërsa norma e grumbullimit (kilogram/person) është e ndryshme nga njëra njësi administrative në tjetrën në bazë të karakteristikave të territorit lokal dhe

popullsisë.

Shërbimi bashkiak i grumbullimit dhe transferimit të mbetjeve organizohet ose nëpërmjet vetë bashkisë në bazë të strukturave teknike të tyre ose shërbimi u nënkontraktohet kompanive private në bazë të një kontrate 3-vjeçare. Numri i bashkive që administrojnë vetë grumbullimin e mbetjeve është 27 dhe 34 bashki nënkontraktjnë kompani private.


Tabela 2. Gjenerimi i mbetjeve bashkiake për vitin 2022

Nr.	Bashkitë	Popullsia	Sasia e mbetjeve Ton	Grumbullimi kg/person/ditë
1	Kukës	47,985	6,624	0.61
2	Has	16,874	898	0.39
3	Tropojë	21,093	3,963	0.64
4	Shkodër	150,611	33,314	0.62
5	Malësi e Madhe	36,339	2,974	0.24
6	Pukë	11,945	1,966	0.57
7	Fushë Arrëz	8,290	445	0.33
8	Vau i Dejës	35,329	3,475	0.28
9	Lezhë	75,909	18,690	0.72
10	Kurbin	52,717	6,462	0.34
11	Mirditë	25,408	2,974	0.46
12	Krujë	71,355	8,435	0.32
13	Shijak	35,807	4,236	0.32
14	Durrës	234,226	55,306	0.65
15	Kavajë	59,526	15,930	0.75
16	Rrogozhinë	31,323	3,668	0.34
17	Vorë	33,633	14,407	1.17
18	Kamzë	129,385	24,886	0.53

19	Tiranë	721,656	244,787	0.95
20	Mat	27,763	3,447	0.41
21	Klos	16,396	651	0.17
22	Bulqizë	31,210	1,278	0.16
23	Dibër	61,621	5,102	0.37
24	Vlorë	139,377	37,228	0.74
25	Selenicë	23,009	235	0.06
26	Sarandë	33,091	9,273	0.77
27	Finiq	17,610	640	0.15
28	Delvinë	11,401	1,172	0.44
29	Konispol	10,336	730	0.28
30	Himarë	14,178	3,983	1.32
31	Pogradec	67,690	11,807	0.56
32	Pustec	3,723	457	0.34
33	Kolonjë	12,861	735	0.19
34	Maliq	41,757	7,700	0.51
35	Devoll	26,716	4,224	0.43
36	Korca	75,994	19,129	0.69
37	Lushnjë	94,486	13,320	0.39
38	Divjakë	39,206	4,530	0.32
39	Patos	28,021	3,438	0.34
40	Mallakastër	30,674	1,931	0.17
41	Rroskovec	24,238	3,910	0.44
42	Fier	140,329	48,221	1.18
43	Gramsh	26,442	2,352	0.49
44	Perrenjas	26,189	2,935	0.31
45	Peqin	28,556	3,082	0.32
46	Cerrik	27,445	3,047	0.26
47	Librazhd	31,892	2,410	0.19
48	Belsh	19,503	2,410	0.29
49	Elbasan	141,714	27,596	0.49
50	Berat	62,632	6,995	0.39
51	Kuçovë	35,707	3,021	0.30
52	Dimal	28,715	2,535	0.36
53	Poliçan	28,301	1,127	0.42
54	Skrapar	12,782	846	0.33
55	Permet	11,680	1,669	0.57
56	Tepelenë	10,069	1,297	0.45
57	Memaliaj	12,415	643	0.38
58	Libohovë	4,279	657	0.47
59	Dropull	8,899	1,020	0.32
60	Kelcyrë	7,888	433	0.41

61	Gjirokastrër	32,708	4,648	0.47
	Total		705,455	

Burimi: Raport i GIZ//DKT. Të dhëna të sakta për mbetjet bashkiake si bazë për zhvillimin e politikave dhe përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve për qytetarët



Gjatë këtij peshimi u arrit të mblidheshin të dhëna mbi mbulimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, të cilat bazohen në perceptimin e ekipit teknik dhe intervistën e mbledhjes së mbetjeve në vend. U vu re një përqindje e lartë e mbetjeve organike dhe të kopshtarisë rreth 55%. Disa prej tyre me një profil të lartë rural si Selenice, Libohovë, Divjakë janë vërejtur edhe deri në 70% që tregojnë potencialin e rëndësishëm të kompostimit për të reduktuar depozitimin e mbetjeve në landfill dhe emetimin e metanit. I gjithë vendi mesatarisht tregon se vetëm 78% e popullsisë është e mbuluar me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve.



Tendenca e gjenerimit të mbetjeve

Kemi një tendencë në ulje të gjenerimit të mbetjeve bashkiake gjatë vitit 2022 krahasuar me vitet e mëparshme. Kjo vjen si rrjedhojë e peshimit të mbetjeve nga të gjitha bashkitë duke siguruar të dhëna më të sakta për mbetjet dhe mirëmenaxhimit të tyre.




Tabela 3. Sasia vjetore e mbetjeve bashkiake në vite sipas Qarqeve (në kg)

Qarku	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Shkodër	44,228,580	46,250,000	31,790,750	40,738,000	42,021,840	42,175,000
Lezhë	4,288,000	24,118,250	-	21,593,000	33,182,600	28,126,000
Kukës	9,698	10,138,000	-	14,009,000	27,031,000	11,485,000
Dibër	7,200,000	18,946,000	-	18,833,000	22,994,000	10,479,000
Tiranë	226,584,000	514,003,950	465,152,779	341,849,671	367,721,200	303,678,000
Durrës	152,940,640	114,924,000	10,299,000	72,576,000	83,065,096	67,977,000
Elbasan	42,161,000	38,847,870	43,645,393	48,190,780	42,048,900	42,290,000
Fier	33,016,450	200,000	20,513,731	120,053,661	89,525,650	75,350,000
Berat	15,855,400	41,587,000	-	35,216,000	24,518,829	17,678,000
Korçë	46,598,000	16,960,000	80,471,859	48,813,840	47,800,860	44,299,000
Vlorë	70,921,260	171,860,510	73,087,884	75,522,710	93,977,910	51,533,000
Gjirokastrër	2,537,000	4,467,000	-	19,342,900	14,130,500	10,365,000
TOTAL	646,340,028	1,002,302,580	792,519,781	856,738,562	888,018,385	705,435,000

5.2.2 Impiantet e depozitimit përfundimtar të mbetjeve

Nr.	Bashkia/Qarku	Vendgrumbullimi i mbetjeve
Qarku i Gjirokastrës		Vend-depozitimi i Bajkajt
1	Përmet	Brackoll
2	Tepelenë	Majkoshë
3	Memaliaj	Nogila
4	Libohovë	Bulo
5	Dropull	Glinë
6	Kelcyrë	Vorri i Bobit
7	Gjirokastrër	Gërhot
Qarku i Beratit		Vend-depozitimi i Beratit
1	Berat	Shesh Orizaj
2	Kuçova	Rreth Tapi
3	Dimal	Sqepur
4	Poliçan	Zona F
5	Skrapar	Pilispigë
Qarku i Elbasanit		Incineratori i Elbasanit
1	Gramsh	Incineratori i Elbasanit
2	Përrenjas	Krastë

3	Peqin	Varrezat
4	Cerrik	Incineratori i Elbasanit
5	Librazhd	Incineratori i Elbasanit
6	Belsh	Incineratori i Elbasanit
7	Elbasan	Incineratori i Elbasanit
Qarku Fier		Inceneratori i Fierit
1	Lushnje	Sarave
2	Divjakë	Guri Gomares
3	Patos	Sheqishte
4	Mallakastë	Kash
5	Rroskovec	Marinzë
6	Fier	Incineratori i Fierit
Qarku Korçë		Venddepozitimi Maliq
1	Pogradec	Venddepozitimi Maliq
2	Pustec	Gorricë e Madhe
3	Kolonjë	Paçomene ST
4	Maliq	Venddepozitimi Maliq
5	Devoll	Venddepozitimi Maliq
6	Korcë	Venddepozitimi Maliq
Qarku Vlorë		2 venddepozitime sanitare: - Vlorë veri = venddepozitimi i Vlorës - Vlorë jug = Venddepozitimi i Bajkajt
1	Vlorë	Kanali motorit
2	Selenicë	Hambaret Fermes
3	Sarandë	Venddepozitimi i Bajkajt
4	Finiq	Venddepozitimi i Bajkajt
5	Delvinë	Venddepozitimi i Bajkajt
6	Konispol	Venddepozitimi i Bajkajt
7	Himarë	Venddepozitimi i Bajkajt
Qarku Dibër		Nuk është zhvilluar ende një vend-depozitim rajonal
1	Mat	Komsi
2	Klos	Kalbac
3	Bulqizë	Lucan
4	Dibra	Lasen
Qarku Tiranë		Vend-depozitim i Sharrës
1	Kavajë	Venddepozitimi Sharrë
2	Rrogoshinë	Varezat Peqin (Venddepozitimi ilegal)
3	Vora	Venddepozitimi Sharrë
4	Kamëz	Venddepozitimi Sharrë
5	Tiranë	Venddepozitimi Sharrë

	Qarku Durrës	Vend-depozitim i Sharrës
1	Krujë	Venddepozitimi Kodër Dollane
2	Shijak	Venddepozitimi Sharrë
3	Durrës	Venddepozitimi Sharrë
	Qarku Lezhë	Vend-depozitim i Bushatit
1	Lezhë	Venddepozitimi Bushat
2	Kurbin	Venddepozitimi Gurëz
3	Mirditë	Venddepozitimi Geziq
	Qarku Shkodër	Vend-depozitim i Bushatit
1	Shkodra	Venddepozitimi Bushat
2	Malesi e Madhe	Venddepozitimi Bader e Mehajve
3	Puka	Venddepozitimi Fushë Qarrë
4	Fushe Arrëz	Venddepozitimi Kthesa e Karbit
5	Vau i Dejës	Venddepozitimi Bushat
	Qarku Kukës	Nuk është zhvilluar ende një vend-depozitim rajonal
1	Kukës	Myçmames
2	Has	Qafe Barak
3	Tropojë	Koj

Burimi: Raport i GIZ//DKT. Të dhëna të sakta për mbetjet bashkiake si bazë për zhvillimin e politikave dhe përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve për qytetarët

5.2.3 Mbetjet nga aktivitetet industriale

Në mbështetje të VKM Nr. 229, datë 23.04.2014, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit", të ndryshuar, VKM Nr. 371, datë 11.06.2014, "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre", të ndryshuar, si dhe Urdhërit të Ministrit të Mjedisit Nr. 135 datë 16.04.2015 "Për Miratimin e Mënyrës së Administrimit të Formatit të Rregjistrimit të Transfertave Individuale dhe të Rregjistrimit Kombëtar të Transfertave si dhe Mënyrën e Administrimit të tyre", Agjencia Kombëtare e Mjedisit mban dhe përditëson rregjistrin e transfertave të mbetjeve të rrezikshme dhe të parrezikshme të kompanive që janë të pajisura me Kod Unik.

Tabela 4. Transferimi i mbetjeve të rrezikshme, 2022

Nr	Kodi i mbetjes	Sasia e transportuar në kg
1	20 01 33 * Bateritë dhe akumulatorët të përfshirë në 16 06 01, 16 06 02 ose 16 06 03 dhe bateritë e akumulatorët e pandarë 20 01 34 Bateritë dhe akumulatorët e tjerë nga ato të përmendur në 20 01 33	37

2	10 04 Mbetje nga metalurgjia termike e plumbit	17725
3	18 01 01 Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)	17130
4	18 01 03 Mbetje spitalore	175691.2
5	01 05 06 * Baltë dhe mbetje të tjera nga shpimet që përmbajnë substanca të rrezikshme	2868800
6	16 06 04 Bateri alkaline (përveç 16 06 03)	1888827
7	16 06 01 * Bateri plumbi	663.133
8	17 05 08 Çakëll, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 07	11500
9	Mbetje te tjera te paspecifikuara 13 08 03*	4060
10	16 05 08 * Kimikate të skaduara organike, që konsistojnë ose përmbajnë substanca të rrezikshme	12320
11	13 04 03 * Vajra të ndotura nga lundrime të tjera	3633726
12	13 02 06 * Vaj sintetik motori, ingranazhi dhe lubrifikues	259830
13	20 01 21 * Mbetje të tubave fluoreshente dhe mbetje të tjera që përmbajnë merkur	52
14	13 05 08* (Perzierje mbetjesh nga seperatoret ujë/naftë)	7410067
15	19 12 11* Të tjera mbetje (përfshirë materiale të përziera) nga trajtimi mekanik i mbetjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme	900
16	18 01 01/18 01 03 Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03) /18 01 03 * Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet	828111.37
17	18 01 01/18 02 02 Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)/Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet	4
18	18 01 02 Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset e gjakut dhe rezervat e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)	38087.88
19	18 01 07 Kimikate të tjera nga ato të përmendura në 18 01 06	198
20	18 01 08 *Medikamente citostatike dhe citotoksike	3736.85
21	13 01 Mbetje vajrash hidraulike	43400
22	15 01 10* Mbetje ambalazhi që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme	5876
23	15 02 02* Absorbente, material filtrues (duke përfshirë filtra naftë të paspecifikuar) dhe rroba mbrojtëse të kontaminuara nga substanca të rrezikshme	265
24	16 01 07* Filtra vaji, naftë	700
25	01 05 05* Baltë dhe mbetje të tjera nga shpimet për naftë hidrokarbure	111500

26	18 02 01/18 02 02 Bisturi, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 02 02) / Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksione	471.6
27	18 02 01 Bisturi, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 02 02)	16380.9
28	18 02 02* Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet	16415.9
29	13 02 05* Vajra motori, ingranazhesh dhe lubrifikues të paklorinuar me bazë minerale	291181
30	11 01 06* Acide të tjera të paspecifikuara	37985
31	18 01 09 Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 08	57247.4
32	18 01 04 Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet (p.sh. fasha, gips, çarçafë, veshje njëpërdorimëshe, pelena etj.)	11621.7
33	18 01 04/18 02 01 Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet (p.sh. fasha, gips, çarçafë, veshje njëpërdorimëshe, pelena etj.)/ Bisturi, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 02 02)	82893.63
TOTALI		17 847 405

Tabela 5. Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme 2022

Nr.	Mbetje jo të rrezikshme	Sasia e transferuar në kg
1	15 01 01 Mbetje ambalazhi letre dhe kartoni (kg)	4167530.1
2	20 01 39 Plastikët (kg)	4897983.1
3	15 01 07 Mbetje ambalazhi qelqi (kg)	19747
4	15 01 04 Mbetje ambalazhi metalike (kg)	3880
5	20 01 25 Vajra dhe dhjamëra ushqimore (kg)	359941
6	20 01 38 Mbetje druri të tjera nga ato të përmendura në 20 01 37 (kg)	4096627
7	04 01 08 Mbetje të lëkurës së regjur (preje, kanale, mostrime, pluhura nga përpunimi) që përmbajnë krom (kg)	300480
8	20 03 01 Mbetjet e përziëra urbane(kg)	78691378.8
9	04 02 09 Materiale të përziëra (tekstile të imprenjuara, elastomere, plastomere) (kg)	424060
10	Materiale te perziëra 04.02.09/02.03.04/04.01.08 -KG (D5-landfil) (kg)	750500
11	20 03 06 – Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza(kg)	258000

12	20 01 01 Letër dhe karton(kg)	4106247
13	20 03 04 Llumra nga gropat septike (kg)	4916587
14	16 01 03 Goma jashtë përdorimit(kg)	23140
15	Kodi 20 01 01 Kodi 03 03 08 / 20 01 39 Letër, karton për riciklim(kg)	4012009
16	17 04 02 Alumini (kg)	5552667
17	19 03 05 Mbetje të stabilizuara të tjera nga ato të përmendura në 19 03 04 (kg)	31400
18	19 01 11* Hira fundore dhe numra që përmbajnë substanca të rrezikshme (kg)	1918
19	17 05 04 Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03 (kg)	483830
20	20 01 40 Metalet(kg)	1721014
21	15 01 02 Mbetje ambalazhi plastike (kg)	5880
22	20 01 11 Tekstilet (kg)	542200
23	18 01 03 Mbetje spitalore (kg)	205380
24	20 02 02 Dhera dhe gurë (kg)	29172049
25	04 02 22 Mbetje të fibrave tekstile të përpunuara(kg)	91600
26	20 02 03 Mbetje të tjera të pabiodegradueshme(kg)	227540
27	17 04 01 Bakër, bronz, tunxh (kg)	7375506
28	17 04 05 Hekur dhe çelik (kg)	103515
29	17 05 08 Çakëll, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 07(kg)	242630
30	10 02 02 Skorie e papërpunuar (kg)	15996
31	16 01 19 Plastika (kg)	4040
32	18 01 01/18 01 03 Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03) /18 01 03* Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet (kg)	101841.03
33	18 01 02 Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset e gjakut dhe rezervat e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03) (kg)	8298.37
34	18 01 09 /18 02 08 Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 08/Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 07) (kg)	1090.1
35	20 03 99 Mbetjet urbane të paspecifikuara (kg)	4646535.5
36	18 01 09 Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 08 (kg)	496.4
37	18 01 04 Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave nuk u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet (p.sh. fasha, gips, çarçafë, veshje njëpërdorimëshe, pelena etj.) (kg)	5201.1
38	19 12 01 Letër e karton (kg)	1300004.2

39	08 03 18 Mbetje nga boja e printit, të tjera nga ato të përmendura në 08 03 17 (kg)	32
40	20 01 36 Pajisjet e skaduara elektrike dhe elektronike, të tjera nga ato të përmendura në 20 01 21, 20 01 23 dhe 20 01 35 kg	5963
41	Zinc Kodi 17 04 04 (kg)	3359367
42	20 03 Mbetje të tjera urbane (kg)	334720
43	20 01 Fraksionet e ndara (përveç 15 01) (kg)	539980
44	19 01 Mbetje nga iceneratorët ose piroliza e mbetjeve (kg)	4780
45	19 03 Mbetje të stabilizuara të ngurtësuara (kg)	485380
46	20 01 02 Qelq (kg)	1142493.14
47	02 03 Mbetje që vijnë nga përgatitja dhe përpunimi i frutave, perimeve, drithërave, vajrave ushqimore, i kakaos, kafesë, çajit, duhanit, të prodhimit të konservave, të prodhimit të majasë dhe të ekstrakteve të majasë, të përgatitjes dhe të fermentimit të melasës (kg)	60956.2
48	15 01 05 Mbetje ambalazhi të përbëra (kg)	520
49	Mbetje hekuri Kodi 10 02(kg)	78105
50	19 12 04 Plastik dhe gomë(kg)	1043231
51	19 12 02 Metale ferore, 19 12 03 Metale joferore (kg)	181436.9
52	17 08 02 Materiale ndërtimi me gips, të tjera nga ato të përmendura në 17 08 01(kg)	4760
53	Mbetje nga përpunimi i lekurve, rrjepjet dhe prerjet 04 01 01 (kg)	56968.88
54	Lloji i Mbetjes Balte dhe mbetje të tjera nga shpimet të cilat përmbajnë klorure, të tjera nga ato të përmendura në 01 05 06. Kodi i mbetjes; 01 05 08 (kg)	761720
55	Lloji i Mbetjes Baltë dhe mbetje të tjera nga shpimet të cilat përmbajnë kripëra të bariumit, të tjera nga ato të përmendura në 01 05 05 dhe 01 05 06. Kodi i mbetjes; 01 05 07 (kg)	609600
56	17 09 04 Mbetje të përziera nga ndërtimi dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03 (kg)	42504840
57	16 01 09 * Komponentë që përmbajnë PCBs	3040
58	10 03 05 Mbetje të aluminit (kg)	8998083
59	19 02 04 Mbetje të përziera paraprakisht, kompozuar nga të pakten njëra e rrezikshme	12803.6
TOTALI		219 057 521.4

Për vitin 2022 raportohet se janë krijuar, përpunuar apo transferuar rreth 237 mijë tonë mbetje të parrezikshme dhe të rrezikshme.

5.2.4 Mbetjet spitalore

Bazuar në Vendimin nr.798, datë 29.9.2010 "Për Miratimin e Rregullores "Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore", "**Institucion shëndetësor**" është çdo vend ku krijohen mbetjet spitalore duke përfshirë: spitale, poliklinika, qendrat shëndetësore, kabinete mjekësore, qendra

mjekësore, kabinete dentare, klinika dentare, laboratorë dentarë, qendra diagnostike, depo farmaceutike, farmacitë, qendra kozmetike, qendra të tatuazhit, qendra të rehabilitimit nga droga, laboratorët e shëndetit publik, institucionet kërkimore shkencore, banka e gjakut, morget, shërbimet funerale, klinikat veterinare si dhe shërbimet ambulatorë të infermierisë që vizitojnë pacientë në banesa.

Tabela 6. Mbetjet spitalore në vitet 2019-2022

Të dhënat e informacionit	Kodi i Katalogut Shqiptar	Vitet			
		2019	2020	2021	2022
Mbetje Spitalore në kg	18 01 03	6,612,117	54,000	932,886	1,247,990

Përgjatë vitit 2022 janë grumbulluar për trajtim 1247990 kg mbetje spitalore nga subjektet të cilat janë të liçencuara për transportimin e mbetjeve spitalore.

5.2.5 Eksporti i mbetjeve


Sipas të dhënave rezulton se për vitin 2022 janë eksportuar rreth 52,240 kg mbetje nga të cilat sasia më e madhe i përket mbetjeve të metaleve. Mbetjet e rrezikshme janë në sasi të vogël

Tabela 7. Sasia e mbetjeve të eksportuara , 2022

Lloji i mbetjeve	Sasia e eksportuar gjatë vitit 2022 (në kg)
Druri	1157
Vaj vegjetal	10575.352
Mbetje metale	34064.015
Letër/karton	6431.775
Mbetje të rrezikshme (absorbente, lecka të kontaminuara, paketime të kontaminuara, filtra naftë, mbetje materiale shpërthyes etj)	3712
Total	52240.262

Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Rezulton se sasia e mbetjeve të eksportuara për vitin 2022 është më e madhe se sasia e mbetjeve të eksportuara gjatë vitit 2021.



5.3 Gjetjet kryesore:

Në disa bashki është vërejtur prania e mbetjeve të gjelbra si degë, gjethe, bar, veçanërisht në pranverë p.sh. në Përmet, Libohovë, Lushnje, Selenicë etj. Pjesa organike e mbetjeve bashkiake duhet t'i frymëzojë bashkitë të përdorin kompostimin si metodë trajtimi. Kjo do të zvogëlojë sasinë e mbetjeve të përziera të depozituara në pikat fundore të depozitimit, të tilla si venddepozitimet dhe inceneratorët.

Gjatë stinës së pranverës identifikohen mbetje të lagështa. Për këto bashki duhet të mendohet mundësia e përpunimit të mëtejshëm të të dhënave si, për shembull, një peshim i dytë gjatë sezonit të verës.

Bizneset tregtare të tilla si dyqane, tregje, supermarkete etj. në zonat urbane janë mësuar që t'i hedhin mbetjet e thata të riciklueshme (kryesisht karton) brenda kazanëve të mbetjeve të bashkisë, jo në kazanë të dedikuara. Kjo shkakton mbushje të shpejtë të kazanëve që në orët e para të ditës. Në disa raste, kutitë e kartonit hidhen përbrinj kazanëve, gjë që e bën më të lehtë punën për grumbulluesin dhe që çon në mos mbushjen e shpejtë të kazanit.

Në disa bashki përdoret grumbullimi "derë më derë". Është e rëndësishme të theksohet se në këtë rast nevojitet kohë më e shkurtër për grumbullimin e mbetjeve. Gjithashtu, higjiena ishte më e mirë (kamioni nuk mbante erë, nuk kishte mbetje të lëngjeve të dekompozimit etj. punëtorët ishin më të kënaqur me kushtet

e punës).

Vihet re se pothuajse të gjithë kamionët gjatë lëvizjes kanë derdhje të lëngjeve, të cilat shkaktohen nga hapja e thaseve të paketimit të mbetjeve nga grumbulluesit informalë të lëndëve të riciklueshme.

Në disa venddepozitime të mbetjeve bashkiake janë vërejtur zjarre, si në Libohovë, Dropull, Tepelene.

Fatkeqësisht, në shumicën e rasteve, automjetet që përdoren për grumbullimin e mbetjeve bashkiake janë kamionë të dëmtuar (të amortizuar), kryesisht të hapur. Nuk ka dallim sa i takon modalitetit të ofruesit të shërbimit (shërbimi i ofruar nga bashkia ose nga një kompani private nënkontraktore). Shoferët e kamionëve ankoreshin për konsumin e lartë të karburantit të kamionëve për grumbullimin e mbetjeve, etj.

Të dhënat e vetëdeklarimit nga shoferi i kamionit të mbetjeve ose përfaqësuesi i bashkisë lidhur me numrin e kazanëve të mbledhur nga kamioni përkatës nuk konsiderohen të sakta. Kjo tregon se shërbimit të monitorimit në bashki i mungojnë të dhënat konkrete të menaxhimit, të cilat janë të rëndësishme për mbikëqyrjen e kontratës së shërbimit me kompaninë private apo menaxhimin më të mirë të shërbimit të ofruar nga vetë bashkia.

Shpesh mbetjet e ngurta bashkiake përzihehin me mbetje inerte. Në këto raste, shifrat janë më të larta në krahasim me ditët normale.

5.4 Forcat shtytëse, presioni, gjendja, ndikimi, reagimi



5.5 Kuadri ligjor

- VKM Nr. 418, datë 27.05.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
- Dokumenti i politikave strategjike për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe plani i veprimit 2020-2035.
- Ligj nr. 8216 dt.13.05.1997 Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bazelit "Për kontrollin e lëvizjeve ndërkontinentale të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre".
- Ligj nr 10463 dt 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".
- Ligji nr. 156 date 10.10.2013 për disa ndryshime në ligjin nr.10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar.
- VKM nr.442, datë 26.6.2019 "Për miratimin e rregullave të ndalimit të eksportit të merkurit metalik, komponimeve dhe përzierjeve të caktuara të merkurit, ruajtjes së sigurt të merkurit metalik dhe kriteret specifike të ruajtjes së merkurit metalik të konsideruar si mbetje".
- VKM nr. 660, datë 31.10.2018 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve të metaleve".
- VKM nr 232 datë 26.04.2018 për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 177, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre".
- VKM nr 319, datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve".
- VKM nr 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
- VKM nr 608 17.09.2014 "Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre".
- VKM nr 652 datë 14.09.2016 "Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura".
- VKM nr. 52, datë 5.2.2014 Për disa ndryshime në Vendimin nr. 117, datë 13.2.2013 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qeni

- mbetje”
- VKM nr. 117 datë 13.02.2013 “Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipa të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje”
 - VKM nr. 127 datë 11.02.2015 “Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura”
 - VKM nr. 229 datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”
 - VKM nr. 333 datë 26.01.2011 “Për administrimin e vend-depozitimeve rajonale të mbetjeve urbane”
 - VKM nr. 360 datë 29.05.2015 “Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre”
 - VKM nr. 371 datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”
 - VKM nr. 387 datë 06.05.2015 “Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura”
 - VKM nr. 389, datë 27.6.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, “për lëndfillet e mbetjeve”
 - VKM nr. 418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim
 - VKM nr. 452 datë 11.07.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve”
 - VKM nr. 641 datë 01.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”
 - VKM nr. 687 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”
 - VKM nr. 765 datë 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”
 - VKM nr. 798 date 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”
 - VKM nr. 957 datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”
 - VKM nr. 967 datë 25.10.2013 “Për mënyrën e organizimit të funksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”
 - VKM nr. 1104 date 28.12.2005 “Për miratimin e kërkesave për parandalimin e shkarkimit të mbetjeve, të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat, në det”
 - VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”
 - VKM nr. 99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve”
 - VKM nr. 1189 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”
 - VKM nr. 705, datë 10.10.2012 “Për automjetet e dala jashtë përdorimit”
 - VKM nr. 866 datë 04.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”
 - Udhëzim nr. 1738 datë 12.03.2015 “Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane”
 - Ligj nr. 28/2022 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

Rekomandime

- Peshimi i mbetjeve nga bashkitë e mbetura është i domosdoshëm për të krijuar një pamje të plotë në lidhje me grumbullimin e mbetjeve të bashkive në Shqipëri. Kërkesa e AKM-së për të raportuar në bazë të rezultateve të

peshimit janë kyçe për konsolidimin e raportimit të të dhënave të sektorit.

- Bashkitë shqiptare mbledhin mbetje organike në një pjesë shumë të madhe të mbetjeve të përgjithshme, sasia e të cilave varion nga 55% deri në 70% të mbetjeve të përgjithshme të grumbulluara. Kjo duhet t'i bëjë planet vendore të drejtohen drejt aktiviteteve të kompostimit. Kjo do të sjellë një ndikim të lartë mbi uljen e mbetjeve të hedhura në pikën fundore të venddepozitimit. Duhet të theksohet që përbërja e mbetjeve është vetëm një vlerësim i përafërt i grupit të peshimit, ndërkohë që nuk bazohet në ndonjë matje apo vërtetim, prandaj të dhënat duhet të merren vetëm si të dhëna me natyrë indikative.
- Grumbullimi i mbetjeve sipas llojit të tyre është nevojë urgjente për të nxitur riciklimin, për përmirësimin e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve për të gjithë komunitetin dhe uljen e sasive të mbetjeve të depozituara në venddepozitimin fundor. Bashkitë duhet të fillojnë të zhvillojnë plane/aktivitete konkrete dhe buxhet për infrastrukturën e grumbullimit të mbetjeve sipas llojit të tyre.
- Të dhëna më të sakta për grumbullimin e mbetjeve duhet të kontribuojnë për rishikimin e kontratave të shërbimit me kompaninë private nënkontraktore. Përfitimet përkatëse nga përmirësimi i marrëveshjeve kontraktuale, për shkak të të dhënave konkrete mbi sasinë e mbetjeve dhe jo për llogaritjet e përafërta (më pak mbetje për t'u menaxhuar) do të duhet të kontribuojnë për investimet për grumbullimin e mbetjeve, transportin, riciklimin, infrastrukturën e kompostimit, etj. Kjo është rruga drejt përmirësimin të shërbimit, qoftë duke rritur mbulimin e popullsisë totale dhe/ose duke mbështetur riciklimin.
- Së fundi, por jo më pak e rëndësishmja,

të dhëna më të sakta duhet të kontribuojnë për një llogaritje më të mirë të kostos së shërbimit si edhe për përcaktimin e nivelit të tarifës së menaxhimit të mbetjeve.

- Bashkitë duhet të përdorin normat që dolën nga ushtrimi i peshimit për llogaritjen e ardhshme të mbetjeve të prodhuara për banor në vit. Kjo shifër rezultoi të jetë shumë e afërt me normat e parashikuara nga Strategjia Kombëtare dhe Metodologjia 358/2021.

KAPITULLI 6

PYJET

DHE

BIODIVERSITETI



KAPITULLI 6

PYJET DHE BIODIVERSITETI

Pyjet ne Shqiperi zune 46% te sipërfaqes totale, dhe se bashku me kullotat zune 65% te sipërfaqes kombëtare ekuivalente me 0.65 ha/frymë, vlerë kjo më e madhe se mesatarja e sipërfaqes pyjore në vendet e Bashkimit European e cila arrin 0.36 ha/frymë. Burimi i informacionit për Inventarin Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave (IKPK) është Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

Vlerësimi i gjendjes shëndetësore dhe vitalitetit është kryer nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve në llojet kryesore që përbëjnë fondin pyjor të vendit tonë dhe është përqëndruar në treguesit e parametrave të fenomenit të ç'ngjyrosjes (tjetërsimit të ngjyrës së halave ose gjetheve), ç'halëzimit (rënies së halave) dhe ç'gjethezimit (rënies së gjetheve), evidentimin e dëmtuesve dhe sëmundjeve kryesore të llojeve kryesore pyjore etj. Vlerësimi i specieve drunore dhe bimëve aromatike-mjekësore të kërcënuara dhe në rrezik është kryer nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura të cilat kanë një rëndësi të veçantë vëzhgohen dhe vlerësohen nga Agjencia Kombëtare e

Zonave të Mbrojtura.

Gjendja dhe tendenca

6.2.1 Forma e menaxhimit të fondit pyjor

Sipas IKPK 2021, fondi pyjor shtrihet në një sipërfaqe prej 1,197 000 ha (sipërfaqe të mbërritshme) dhe llogaritet të ketë një volum në këmbë prej 57.7 milion metër kub. Në raport me sipërfaqen pyjore, cungishtet zënë 46% të sipërfaqes së fondit pyjor, por në raport me volumin në këmbë zënë vetëm 18% (10 milion metër kub). Pyjet trungishte megjithëse zënë 32% të sipërfaqes pyjore kanë peshën kryesore të volumit në këmbë me rreth 73%, ekuivalent me një volum në këmbë prej 42.4 milion metër kub. Ndërsa shkurret, të njohura për diversitetin e tyre llojor, zënë 21% të sipërfaqes totale pyjore dhe në raport me volumin kanë një peshë më të vogël se dy format e tjera të menaxhimit duke zënë vetëm 9% të volumit në këmbë, ekuivalent me 5.3 milion metër kub.

Tabela 1. Shpërndarja e sipërfaqeve dhe volumit në bazë të formës së qeverisjes (pyje të mbërritshëm)

Sistemi i qeverisjes	Sipërfaqia		Volumi	
	(1000 ha)	Përqindja	(milion m ³)	Përqindja
Trungishte	388	33	42.4	74
Cungishte	553	46	10.0	17
Shkurre	256	21	5.3	9
Totali i përgjithshëm	1197	100	57.7	100

Tabela 2. Shpërndarja e sipërfaqeve dhe volumeve bazuar në përbërjen e llojeve të pyllit

Përbërja llojore	Sipërfaqia		Volumi	
	(1000 ha)	Përqindja	(milion m ³)	Përqindja
Halorë	135	11	11.5	22
Shoqërimet pyjore të dominuara nga halorët	49	4	3.9	7
Shoqërime pyjore të dominuara nga fletorët	57	5	4.0	7
Fletorë/gjethegjerë	956	80	38.4	64
Totali i përgjithshëm	1197	100	57.7	100

Pyjet e Shqipërisë dominohen si në sipërfaqe ashtu edhe në volum nga pyjet fletorë dhe kjo është e lidhur ngushtësisht me pozicionin gjeografik dhe ekologjik të vendit. Kështu me shumë se 80% e pyjeve të vendit tonë kanë në përbërjen e tyre llojet fletore të cilët kanë mbi 70% të volumit drusor.

Fondi pyjor sipas tipeve të pyllit

Klasifikimi i pyjeve sipas tipeve është shumë i rëndësishëm për raportimin dhe monitorimin lidhur me menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve".

Tabela 3. Shpërndarja e sipërfaqeve/zonave pyjore sipas tipit të pyllit

Tipi i pyllit (1000 ha)		Sipërfaqia	
		Përqindja	
Pyje qarri, pyje shparthi, pyje bunge	THO	261	22
Pyje bunge, pyje shkoze	SOH	158	13
Pyje malorë ilirikë ahu	IMB	125	10
Pyje të tjerë termofilë gjetherënës	OTD	118	10
Pyje të tjerë sklerofitë, karakterizuar nga një vegjetacion me mbizotërim dafine(<i>lauriphyllus</i>)	MSO	95	8
Pyje me pishë të zezë mesdhetarë dhe të Anadollit	MAP	87	7
Pyje të tjera mezofitë gjetherënës	OMD	73	6
Pyje Moezianë malorë ahu	MMB	64	5
Pyje me dushqe mesdhetarë përherë të blertë	MEO	58	5
Pyje dëllinjash mesdhetare	MJU	29	2
Pyje me pishë mesdhetare	MPF	28	2
Tipe të tjera pyjesh (ASP, BE, TD, MAF, PNS, RIF, FLF, SAM, PNN, CM, FP, AC)		103	10
Totali i përgjithshëm		1197	100

Analizimi i klasave të moshës ndarë sipas formës së qeverisjes është shumë interesante për tu analizuar mbasi ky tregues ka të bëjë me shpërndarjen diametrike të drurëve në pyje sipas formës menaxhuese

Shpërndarja e sipërfaqes pyjore dhe volumit sipas klasave të moshës

Nga sipërfaqia totale rreth 387.900 ha janë trungishte, 66% e trungishteve janë pyje të rinj (më pak se 81 vjeçarë) dhe vetëm 34% janë pyje të pjekur/të arrirë (më të vjetër se të 80 vjeçarë).



Nga sipërfaqia totale e rreth 553.00 ha pyje cunqishte, 96% janë më të reja se 40 vjeç dhe vetëm 4% e tyre janë pyje cunqishte të pjekur/të arrirë.



Nga sipërfaqia totale e rreth 256.300 ha shkurre, 88% janë më të reja se 20 vjeç dhe vetëm 12% janë më të pjekura/të arrira.

Tabela 4. Shpërndarja e sipërfaqeve dhe volumeve për klasat e moshës për shkurret

Sistemi i qeverisjes	Klasat e moshës	Sipërfaqja		Volume	
		(1000 ha)	Përqindje	(milion m ³)	Përqindje
Shkurre	0 - 5 vite	5	2	0	1
	6 - 10 vite	37	14	0.4	4
	11 - 15 vite	93	37	1.9	13
	16 - 20 vite	91	35	2.1	60
	21 - 25 vite	23	9	0.8	15
	26 - 30 vite	2	1	0	1
	>30 vite	6	2	0.1	6
	Grand Total	256	100	5.3	100

Kullotat, zënë një sipërfaqe totale që është rreth 506.300 ha, e shpërndarë siç paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5. Shpërndarja e tokave kullimore sipas kullotave verore dhe dimërore

Sistemi i qeverisjes	Sipërfaqja 1000 ha	Përqindja
Kullotat verore	439	86
Kullotat dimërore	67	14
Totali	506	100

Kullotat verore janë një burim i rëndësishëm të ardhurash nëse ato përdoren në një mënyrë të qëndrueshme kur bëhet shtegëtimi i bagëtive në këto kullota gjatë verës, siç është bërë tradicionalisht vite më parë.

Volumi i lëndës drusore, rritja mesatare dhe volumi mesatar për ha

Vlerësimi i vlerës dhe përdorimi i mundshëm i volumit të lëndës drusore dhe biomasesë ishte një pjesë e rëndësishme e një kuadri të gjërë informacioni të kërkuar për IKPK-n për të mbështetur ekosistemet.

Tabela 6. Sipërfaqe, volum, rritje mesatare dhe volumi mesatar për ha për klasat e moshës për trungishtet

Klasat e moshës	Sipërfaqja (1000 ha)	Volumi (milion m ³)	Rritja mesatare në volum (1000 m ³)	Volumi mesatar për ha (m ³ /ha)
0-20 vite	13	0.0	4	3.3
21 - 40 vite	77	4.0	132	51.3
41 - 60 vite	93	6.8	136	73.4
61 - 80 vite	75	8.4	121	112.8
81 - 100 vite	65	8.7	97	133.0

101 - 120 vite	34	6.2	56	179.6
121 - 140 vite	13	3.0	23	238.7
141 - 160 vite	7	2.1	14	277.2
>160 vite e vjetër	10	3.2	20	314.8
Totali i përgjithshëm	388	42.4	603	109.3

Tabela 7. Sipërfaqe, volume, rritja mesatare dhe volumi mesatar për ha për klasat e moshës për pyjet cungishte



Klasat e moshës	Sipërfaqja (1000 ha)	Volumi (milion m ³)	Rritja mesatare në volum (1000 m ³)	Volumi mesatar për ha (m ³ /ha)
0 -10 vite	33.4	0.0	9	1.3
11 -20 vite	247.	1.7	112	6.8
21 -30 vite	180.4	4.0	160	22.2
31 - 40 vite	70.1	3.0	86	43.2
41 - 50 vite	16.5	1.0	23	61.7
>50 vite	5.3	0.3	5	49.2
Totali i përgjithshëm	553	10.0	395	18.1

Tabela 8. Sipërfaqja, rritja mesatare, dhe volume mesatar për ha për klasat e moshës për shkurret



Klasat e moshës	Sipërfaqja (1000 ha)	Volumi (million m ³)	Rritja mesatare në volum (1000 m ³)	Volumi mesatar për ha (m ³ /ha)
0 - 5 vite	5	0.0	0	0
6 - 10 vite	37	0.4	54	11.1
11 - 15 vite	93	1.9	151	20.1
16 - 20 vite	91	2.1	118	23.3
21 - 25 vite	23	0.8	34	34.1
26 - 30 vite	2	0.0	1	25.0
>30 vite	6	0.1	2	10.4
Grand Total	256	5.3	360	20.6

Rritja në volum dhe mundësia vjetore e shfrytëzimit

Të dhënat e strukturës së moshës në raport me volumin në këmbë treguan se në të tre format e menaxhimit kemi një dominim të grumbujve të rinj. Llogaritja e rritjes sipas formave të menaxhimit shërben për të llogaritur edhe mundësinë vjetore të shfrytëzimit ose prerjen e lejuar vjetore të pyjeve në Shqipëri. Rritja vjetore totale e pyjeve në shkallë kombëtare nga llogaritjet rezultoi 1,36 milion metër kub në vit. Nëse bëjmë një bilanc midis rritjes vjetore të pyjeve (1,36 milion m³) dhe sasisë vjetore prej 2.48 milion m³ /vit të materialit drusor që nevojitet për dru zjarri, rezulton se nevojat për dru zjarri në shkallë kombëtare janë 1.82 herë më të mëdha sesa rritja vjetore e pyjeve e llogaritur nga IKPK 2021

.Trungishte**Cungishte****➤ Shkurre****Pyjet si përthithës të karbonit**


Pyjet janë ekosistem i madh i përthithjes së karbonit. Sasia e karbonit përthithet jo vetëm në pyll, tokë, por edhe në produktet drusore. Nga llogaritjet rezultoi se sasia e C e përthithur në pyjet në Shqipëri është 100.9 milion ton C dhe 80% e kësaj sasive ekuivalente me 81 milion ton C përthithet në tokat pyjore dhe 20% (19.9 milion ton C) në biomasën pyjore.




Nga grafiku shikojmë së pyjet trugishte japin kontributin kryesor në përthithjen e C me 78% e ndjekur nga cungishtet me rreth 14% të sasisë së C dhe vetëm 8% e C përthithet nga shkurret. Pyjet trugishte fletorë kontribojnë me 51% (10 milion ton) në përthithjen e karbonit, kurse pyjet trugishte halorë përthithin 27% të C (5.4 milion ton).

- **Shëndeti i pyjeve në Shqipëri**

Rreth 26% e pyjeve në Shqipëri janë të dëmtuar nga erërat, zjarret, sëmundjet apo insektet. Por me ndryshimet klimatike, pritet një rritje e dëmtimeve nga insektet dhe zjarret në pyje, prandaj në të ardhmen duhet të merren masa adaptuese ndaj ndryshimeve klimatike në lidhje më shëndetin e pyjeve. Rezultatet e IKPK 2021 treguan se 11% e sipërfaqes pyjore ose 132,000 janë përshkruar dhe prekur nga zjarret, ku 5% e kësaj sipërfaqe ka një shkallë prekje nga të moderuar deri në shumë të dëmtuar. Shqetësim përbëjnë sipërfaqet pyjore dhe kullimore që janë dëmtuar shumë nga zjarret që në total është një sipërfaqe prej 25 553 ha.







- **Sipërfaqet pyjore të djegura nga zjarret**

Te dhënat e sipërfaqeve të prekura nga zjarret për vitin 2022 janë grumbulluar nga bashkitë nëpërmjet informacionit statistikor dhe vlerësimeve të specialistëve të sektorit të pyjeve.

Në fondin pyjor/kullosor në administrimin e Bashkive ka pasur në total 350 raste, nga të cilat:

- 266 në fondin pyjor
- 84 në fondin kullosor





Sa më sipër, nga i gjithë informacioni i mbledhur rezulton se gjatë vitit **2022** nga strukturat përgjegjëse në Bashki dhe Zonë të Mbrojtur, janë raportuar gjithsej **407 raste zjarri**, nga të cilat 350 kanë rënë në fondin pyjor kullor, 266 prej tyre janë në pyje dhe 84 në kullota. Ndërsa nga strukturat përgjegjëse në Zonat e Mbrojtura ka pasur 57 raste zjarri. Nga tërësia e rasteve, rezulton se sipërfaqja e përkohshme është **5639 ha**, ndërsa sipërfaqja e djegur **2334 ha**.

Një nga projektet e shumta të BE-së në monitorimin e mjedisit është dhe Sistemi Evropian i Informacionit të Zjarreve në Pyje (SEIZP), i krijuar nga Komisioni Evropian (KE) për të mbështetur shërbimet përgjegjëse për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret në BE dhe vendet fqinje, si dhe për të ofruar KE dhe Parlamentit Evropian informacione të harmonizuara për zjarret në pyje, në Evropë. Sistemi Evropian i Informacionit të Zjarreve në Pyje, jep të dhëna të detajuara përmes programit COPERNICUS (një program i nisur që nga viti 1990).

- **Tendenca e zjarreve dhe sipërfaqeve të djegura**

Të dhënat statistikore për 14 vitet e fundit marrë nga SEIZP jepen në tabelën e mëposhtme

Viti	Sipërfaqe e djegur ne ha	Numri zjarreve
2008	18715	68
2009	7555	27
2010	8114	35
2011	54370	203
2012	53459	149
2013	1233	9
2014	431	3
2015	3768	18
2016	5038	21
2017	41822	220
2018	3281	14
2019	11302	90
2020	19909	129
2021	28972	124
2022	17399	122

1.1.2 Gjendja shëndetësore e llojeve kryesore në pyjet e vendit tonë.

Vlerësimi i gjendjes shëndetësore dhe vitalitetit për vitin 2022 është kryer në llojet kryesore që përbëjnë fondin pyjor të vendit tonë dhe është përqëndruar në treguesit e parametrave të fenomenit të ç'ngjyrosjes (tjetërsimit të ngjyrës së halave ose gjetheve), ç'halëzimit (rënies së halave) dhe ç'gjethëzimit (rënies së gjetheve), evidentimin e dëmtuesve dhe sëmundjeve kryesore të llojeve kryesore pyjore etj. Sipërfaqet e Përherëshme të Monitorimit (SPM) janë ngritur 400 m² rrethore (me rreze 11.28m), të konturuara për t'u dalluar

nga grumbulli rrethues. Vlerësimi i gjendjes shëndetësore është përqëndruar në bashkitë me sipërfaqe më të madhe të fondit pyjor, ku dhe është ngritur rrjeti i sipërfaqeve provë, si dhe në masive që nuk përfshihen në këto sipërfaqe. Konkretisht në bashkitë: Berat, Poliçan, Skrapar, Dibër, Bulqizë, Mat, Klos, Krujë, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Prenjas, Belsh, Peqin, Divjakë, Lushnje, Mallakastër, Gjirokastrë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë, Pogradec, Korçë, Maliq, Pustec, Kolonjë, Kukës, Has, Tropojë, Lezhë, Mirditë, Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë, Fushë-Arrëz, Vau i Dejës, Tiranë, Kavajë, Vlorë, Selenicë, Himarë, Delvinë, Finiq, etj

Tabela 9 . Shkalla e fenomeneve të gjendjes shëndetësore e vlerësuar në 5 klasa.

Klasat	Shkalla e ç'gjethëzimit (ç'halëzimit)	Ç'ngjyrosja	Dëmtuesit	Sëmundjet	Përqindja
0	Të pa ç'halëzuara	Nuk ka ç'ngjyrosje	Nuk janë prekur	Nuk janë prekur	0-10 %
1	Lehtësisht të ç'halëzuara	Ç'ngjyrosje e lehtë	Prekje e lehtë	Prekje e lehtë	11-25%
2	Mesatarisht të ç'halëzuara	Ç'ngjyrosje e mesme	Prekje e mesme	Prekje e mesme	26-60 %
3	Shumë të ç'halëzuara	Ç'ngjyrosje e shkallës së lartë	Prekje e shkallës së lartë	Prekje e shkallës së lartë	61-99%
4	Komplet të ç'halëzuara	Komplet e ç'ngjyrosur	Komplet të prekur	Komplet të prekur	100%

Rënia e halave-gjetheve dhe ç'ngjyrosja e tyre

Vëzhgimet e kryera ndaj fenomenit të rënies së halave për llojet e halorve dhe rënia e gjetheve për llojet fletorë, tregojnë se ka rritje të përqindjes së klasës së parë dhe të dytë gjatë këtij viti, këto janë argument për të treguar një përkeqësim në gjendjen e kurorave të drurëve. Ky fenomen është takuar më së shumti në masivet e pyllëzuar jashtë arealit të vet dhe në terrene të eroduar e që janë shumë të cekëta. Faktor tjetër që ka ndikuar në këtë gjendje është edhe shkalla e lartë e prekjes së llojit pishë e zezë edhe nga dëmtuesi i proçesonaries së pishës. Për llojin gështënjë fenomeni i ç'gjethëzimit është i lidhur jo vetëm me kushtet e stacionit,

dhe kushtet klimatike, por edhe në varësi të shkallës së prekjes nga kanceri i gështënjës dhe sëmundja e bojës, të cilat ndikojnë në fenomenin e ç'gjethëzimit. Gjithmonë ndaj faktorëve të ndryshëm gjethet dhe halat e drurëve pyjor reagojnë, ndaj kushteve klimatike dhe ekstremet e motit, ata reagojnë gjithashtu edhe nga shkalla e ekspozimit të drurëve pyjor ndaj nivelit të prekjes prej sëmundjeve kërpudhore dhe dëmtimeve nga insektet.

Dëmtimi nga insektet dhe sëmundjet

Insektet si dëmtues të pyjeve dhe fitopatogjenet (bakteret, viruset, kërpudhat) gjatë fenomenit të prekjes së drurëve shkaktojnë ndikime të mëdha, duke çuar

në një dobësim të shëndetit dhe vitalitetit të tyre, për rrjedhojë pasohen me zvogëlim të rritjes vjetore dhe humbje ekonomike. Dëmtuesit dhe sëmundjet, kanë të ngjarë të reagojnë gjatë proceseve të ndryshime afatgjata siç është ndryshimi i klimës, për më tepër, dëmtimi prej tyre mund të ndikojë në përkeqësimin e gjendjes së drurëve, jo vetëm në vitin e shfaqjes, por edhe në vitet e mëvonshme.

Shkaqet kryesore që kanë ndikuar në gjendjen shëndetësore të fondit pyjor janë:

1. Faktorët klimatikë si temperaturat ekstreme të ulta dhe të larta kanë patur ndikimin e tyre në fenomenin e ç'ngjyrosjes dhe të ç'halëzimit si dhe atë të zjarreve të rëna para fillimit të vegjetacionit.

2. Shkalla e prekjes nga dëmtuesit dhe sëmundjet ka qenë në varësi të ciklit biologjik të zhvillimit të tyre ku dëmtuesi i procesonaries së pishës është shfaqur gjatë gjithë vitit, kanceri i gështenjës ka qenë i pranishëm gjatë gjithë vitit. Hiri i dushkut ka qenë prezent deri në muajin korrik.

Nga vrojtimit e kryera rezulton që dëmtuesi i procesonaries së pishës (*Thaumetopoea pityocampa*, Den and Schiff), ka prekur thuajse të gjithë grumbujt e pishës së zezë në të gjithë territorin e vendit.

Dëmtuesi i procesonaries së pishës së zezë, është prezent në masivet e pyjeve me pishë në territoret e bashkive: Kukës, Tropojë, Pukë, Shkodër, Malësi e Madhe, Fushë-Arrëz, Vau i Dejës, Mirditë, Dibër, Bulqizë, Korçë, Pogradec, Prenjas Kolonjë, Elbasan, Gramsh. Në këto masive shkalla e përhapjes është mbi 50% dhe shkalla e prekjes mesatarisht është rreth 35% , me një numër (1-3) qeska

për dru.

Bazuar në gjendjen problematike që është parë vitet e fundit për llojin rrap (*Platanus orientalis*), në shtretërit e lumenjve Shkumbin, Mat, Vjosë dhe Drino, janë kryer verifikime në terren të gjendjes së llojit rrap që shtrihet përgjatë brigjeve të këtyre lumenjve.

Në këto basene ujëmbledhës fenomeni i tharjes së llojit rrap ka disa vite që është shikuar fenomen.

Kjo tharje vërehet gjatë gjithë gjatësisë së shtretërve të lumenjve, ku janë të pranishëm drurë të tharë komplet, drurë të tharë rreth 50% të masës së tyre dhe drurë tek të cilët ka nisur tharja.

Fenomeni vërehet edhe në drurët që janë shumë pranë njëri tjetrit një është i tharë kurse tjetri është në gjëndje të mirë vëgjetative.


Dëmtues më kryesor të konstatuar në këtë sipërfaqe monitoruese do të përmendim, Minuesja e gjetheve të rrapit (*Lithocolletis platania*. Stainton), Anekroza e rrapit (*Gnomonia veneta*.Kleb), (*Genomonia platani*. Kleb) dhe (*Gloeosporium platania*).

Një sëmundje tjetër e hasur në llojin bush është tharja e këtij lloji. Gjatë monitorimeve të kryera në terren, pothuajse në të gjithë arealin e përhapjes së llojit bush, është takuar tharja e këtij lloji. Ky fenomen është gjerësisht i përhapur në territoret e bashkisë Gramsh, Shkodër, Burrel, Vlorë, Maliq, Librazhd, etj.


Tendenca 2021-2022

Krahasimi i rezultateve dhe përfundimeve mes viteve 2021 dhe 2022 jepet në paraqitjet grafike të mëposhtme :



• Fenomeni i Ç'halëzimit për llojet halorë





- Fenomeni i Ç'gjethtëzimit për llojet fletorë





- Fenomeni i Ç'ngjyrosjes (tjetërsimit të ngjyrës së halave), për llojet halorë





Fenomeni i Ç'ngjyrosjes (tjetërsimit të ngjyrës së gjetheve), për llojet fletorë





- **Shkalla e prekjes sipas llojeve nga dëmtuesit kryesorë të llojeve halorë.**




- Shkalla e prekjes sipas llojeve nga dëmtuesit kryesorë të llojeve fletorë.



- Shkalla e prekjes sipas nga sëmundjet kryesore të llojeve halorë



- **Shkalla e prekjes sipas nga sëmundjet kryesore të llojeve fletorë**



6.2.3 Vlerësimi i specieve drunore dhe bimëve aromatike-mjekësore të kërcënuara dhe në rrezik

Pyjet janë ekosistemet më të përparuara natyrore dhe kanë rëndësi shumë të madhe sepse ato janë ekosisteme me biodiversitet shumë të pasur. Shqipëria karakterizohet nga një larmi e madhe biologjike dhe natyrore. Në veçanti, zonat malore të saj përfaqësojnë habitate të rëndësishme për llojet aromatiko-mjekësore të rralla, disa prej të cilave gjenden vetëm në vendin tone.

Faktori kryesor që ka shkaktuar kërcënime serioze për ekzistencën e shumë llojeve bimë dhe shtazore padyshim është faktori njeri dhe aktivitetet e tij, ndërkaq shpyllëzimet masive, zjarret pyjore, shfrytëzimi intensiv i tokës, tharja e moçaleve, ndotja e tokës, ajrit dhe ujit dhe gjuetia e pakontrolluar janë vetëm disa nga faktorët që vazhdojnë të rrezikojnë dhe përkeqësojnë gjendjen e biodiversitetit në vendin tonë. Shumë nga llojet pyjore dhe bimët aromatiko-mjekësore duke qenë se janë të kërcënuara për zhdukje, kërkojnë një kujdes të veçantë, në mënyrë që këto lloje të kemi në vazhdimësi dhe në të ardhmen.

Vlerësimi gjatë vitit 2022, i referohet vëzhgimit në terren të sipërfaqeve të përhershme të monitorimit ku përfshihen masivet e grumbujve pyjorë me llojet e pishës së zezë, pishave mesdhetare hartinës, hormoqit, arnenit, bredhit të bardhë, rrobullit, ahut, dushkqeve, gështenjës si dhe fletorëve të tjerë.

Tabela 10. Rrjeti i monitorimit të llojeve drunore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukjeje

Statusi	Lloji pyjor	Bashkia	Ekonomia Pyjore	Vlerësimi
Vu D2	Rrobull	Bulqizë Dibër Gramsh Mat Maliq Kukës Skrapar	Liqeni i Zi Lurë Sogor, Mali i Grabovës, Holtë- Lukovë Masdejë Strelcë, Mesmal Bicaj-Kolesjan Devriteroll	Rrobulli ka një gjendje shumë të mirë vegetative. Në përgjithësi në të gjitha sipërfaqet e monitorimit, lloji ka një gjendje të mirë fitosanitare dhe vegetative.
EN A1b	Arnen	Tropojë Dibër Gramsh Mat Maliq	Çerem Dragobi Lurë Sogor, Mali i Grabovës Masdejë Strelcë	Grumbulli ka një gjendje shumë të mirë vegetative. Duhet theksuar se përveçse lloji arne është në gjendje të mirë fitosanitare dhe vegetative, ka një ripërtëritje natyrale me filizëri të instaluar.
EN A1b	Ilqe	Berat Gramsh Vlorë Mirditë	Hija e Roshnikut Lubinjë-Tunjë Llogara Gziq	Grumbulli është në gjendje shumë të mirë vegetative.
Vu A1b	Rrenjë	Fier Lezhë	Kunorë Kune - Vain	Loji paraqitet në gjendje të mirë vegetative dhe fitosanitare.
EN A1b	Lajthi e egër	Kukës Pustec Has Libohovë	Arrën Parku i Prespës Tej drini i bardhë Çajup	Gjendja vegetative e drurëve është mesatare dhe nuk është dëmtuar.
Vu	Caraca e Kaukazit	Pustec	Parku i Prespës	Numri i drurëve është shumë i vogël. Gjendja vegetative e këtij lloji duket e mirë
CR 1b	Venja	Pustec Libohovë	Parku i Prespës Çajup	Lloji paraqitet në gjendje të mirë dhe mesatare vegetative.
Vu A2b	Drunakuqja	Përmet	Petran – Çarshovë, Petran-Zavalan	Gjendja vegetative e grumbullit të drunakuqes është e mirë, gjithashtu lloji ka gjendje të mirë fitosanitare.

CR B2e	Mështekën	Dibër Korçë Kukës	Kastriot-Silovë Dardhë Shishtavec-Zapod	Lloji i mështeknës është në gjendje të mirë vegetative si në grumbujt pyjor të formuar natyralisht që gjendet si lloj i vetëm, por edhe në grumbujt natyror ku gjendet e përzier me lloje të tjera drunore.
CR A1a	Gështenjë e Kalit	Librazhd Tepelenë	Stravaj Kurvelesh	Drurët janë të rrallë dhe të shpërndarë duke formuar grup drurësh. Drurët janë në gjendje të mirë vegetative dhe fitosanitare.
CR A1b	Hartina	Peshkopi Maliq Tropojë	Lurë Lenie Cerem-Dragobi	Gjendja vegetative e grumbullit është shumë e mirë.
Cr A1c	Bliri	Përmet Libohovë Vlorë Shkodër	Bredhi i Hotovës Çajup Llogara Theth	Gjendja vegetative e grumbullit është shumë e mirë.
VU A1b	Tisi	Tiranë Dibër	Bizë Lurë	Druri i Tisit gjendet mbi një tokë shkëmbore. Lloji Tis bashkëshoqërohet nga lloji Ah.
CR A1b	Valanidhi	Vlorë	Himarë Vlorë	Gjendja vegetative është shumë e mirë, gjithashtu ka një gjendje të mirë fitosanitare.

Llojet si Caraca e Kaukazit (*Celtis Tournefortii*), Rrenja (*Quercus robur L*), Gështenja e kalit (*Aesculus hippocastanum*), Lajthia e egër (*Corylus colurna L*) janë në kufijtë ekstrem të rrezikimit. Për ruajtjen e tyre është e nevojshme ngritja e rrjetit të konservimit 'in-situ' dhe "ex-situ" për këto lloje. (Raport vjetor i AKP- së. „Monitorimi i burimeve gjenetike pyjore ne habitatin e pishës së zezë dhe halore të tjerë, gjendja e shëndetit, vitalitetit në pyjet e vendit tonë, vlerësimi i specieve drunore dhe bimëve aromatiko-mjekësore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukje")

Nga vëzhgimi në terren rezulton se shkaktarët për kërcënimin për zhdukje për llojet e mësipërme janë të ndryshëm dhe kryesisht si pasojë e ndryshimeve të treguesve klimatike apo prishjes së habitatit të tyre. Kërcënimi vjen edhe si pasojë e shfrytëzimit pa kriter të ndodhura në vitet e mëparshme apo zjarreve

të shfaqura në arealin e vendndodhjes së tyre

Sensibilizimi i komunitetit rural për llojet e kërcënuara dhe në rrezik zhdukjeje, në vendet ku takohen këto lloje duke propoganduar vlerat e tyre dhe rrezikun që u kanoset, do të ishte tepër i nevojshëm, pasi do të ndikonte tek komuniteti për të treguar më tepër kujdes ndaj këtyre llojeve.

Ndikimet e shumta të njeriut mbi botën e gjallë mund të ulin ose rrisin shumllojshmërinë e specieve në një zonë të caktuar. Duke patur parasysh rëndësinë që kanë këto lloje drunore, si dhe të rrezikuar për zhdukje, duhet në përkujdesje e veçantë për këto lloje drunore.

Monitorimi i bimëve aromatiko-mjekësore të kërcënuara ose të rrezikuara për zhdukje është bërë përmes ekspeditave të bëra në terren në sipërfaqe dhe potencial të madh

prodhues në shkallë vendi si: Berat, Poliçan, Fushë-Arrëz, Malësi e Madhe, Vlorë, Himarë, Skrapar, Gjirokastër, Libohovë, Dropull, Sarandë, Finiq, Konispol, Delvinë. Sipërfaqet e monitorimit shtrihen në territoret e 25 bashkive të vendit..

Tabela.11 Vlerësimi i Sherebelës (*Salvia officinalis*), statusi i kërcënimit VU A1b

Zona e monitoruar	Rrethi	Përshkrimi i gjendjes
Qafa e Muzinës,	Delvinë	Gjendja vegjetative dhe fitosanitare e sherebelës në këtë sipërfaqe monitoruese (50 m ²) paraqitet më e mirë se ajo e viteve të kaluara. Numri i bimëve brenda sipërfaqes është rritur.
Qafa e Llogaras, 50 metra poshtë lokal Sorkadhe	Vlorë	Gjendja vegjetative dhe fitosanitare e sherebelës në këtë sipërfaqe monitoruese (50 m ²) paraqitet shumë e mire. Duke qenë se është afër rrugës, sipërfaqja është e ndotur me mbeturina urbane të ndryshme (kanaçe dhe plastika të hedhura).
Qafa e Llogaras	Vlorë	Gjatë verifikimit të kryer, gjendja vegjetative e kulturës së sherebelës në këtë sipërfaqe (50 m ²) paraqitet e dobët.
Leskovik	Kolonjë	Gjendja e kulturës së sherebelës në këtë sipërfaqe paraqiteshe e mirë dhe jo e dëmtuar. Numri i bimëve brenda sipërfaqes monitoruese rezultonte të kishte një rritje të lehtë me atë të viteve paraardhëse.
Mali Partizan	Berat	Gjendja vegjetative dhe fitosanitare është mesatare. Si pasojë e grumbullimit të bimëve të sherebelës gjendja e saj paraqitet disi e dëmtuar.
Tërpan Lapidari i qafës së Tërpanit	Berat	Gjendja vegjetative dhe fitosanitare është e mire.
Kallmet , Lugina e Manhatisë	Lezhë	Gjendja vegjetative është e mirë. Gjendja fitosanitare është mesatare.
Mali i Miçanit	Skrapar	Gjendja e kulturës së sherebelës në këtë zonë me sipërfaqe (50 m ²) po shkon drejt degradimit si rezultat i grumbullimit të saj. Gjendja vegjetative është e mire ndërsa ajo fitosanitare është e dëmtuar.
Krastë	Martanesh	Gjendja vegjetative dhe fitosanitare është e mirë .Përsa i përket numrit të bimëve brenda kësaj sipërfaqeje (50 m ²) vihet re një rritje e lehtë në krahasim me atë të vitit paraardhës për shkak të mos grumbullimit.
Fushe Arrëz	Shkodër	Nga verifikimet e bëra në këtë sipërfaqe(50 m ²) , lloji sherebelë ka një gjendje të mirë vegjetative dhe fitosanitare. Nuk kishte grumbullim masiv në këtë sipërfaqe dhe si rezultat ishin shfaqur dhe bimë të tjera brenda sipërfaqes duke pësuar një rritje.

Tabela 12. Vlerësimi i Çajit të Malit (*Sideritis raeseri*), statusi i kërcënimit EN A1c

Zona e monitoruar	Rrethi	Përshkrimi i gjendjes
Zonën e Prespës, Qafa e Bigllës	Pustec	Nga kontrolli dhe verifikimi i numrit të bimëve brenda kësaj sipërfaqeje (50m ²) rezultoi se ka gjendje të mirë vegjetative dhe fitosanitare.
Dropull, Dervican	Gjirokastrë	Numri i bimëve brenda sipërfaqes (50 m ²) është i lartë dhe përsa i përket gjendjes fitosantare dhe vegjetative, paraqiten shumë mirë.
Pepellash	Kolonjë	Gjendja e kulturës së Çajit të malit në këtë sipërfaqe (50 m ²) paraqitet e mirë.

Tabela 13. Vlerësimi i Salepit (*Orchiss. Sp*) statusi i kërcënimit VUA1b

Zona e monitoruar	Rrethi	Përshkrimi i gjendjes
Zonën e Prespës, Llofka e kuqe	Pustec	Në sipërfaqen e ngritur (25 m ²) rezultoi se lloji salep ka gjendje mesatare vegjetative dhe gjendje të mirë fitosanitare.
Kepi i Rodonit (pas kishës)	Durrës	Nga verifikimi brenda sipërfaqes (25 m ²) rezulton se gjendja fitosanitare është e mirë ndërsa ajo vegjetative është mesatare.
Erind	Libohovë	Rezulton se ka një gjendje të mirë vegjetative dhe fitosanitare.

Tabela 14. Vlerësimi i Xhrokull (*Colchicum autumnale*) statusi i kërcënimit EN A1b

Zona e monitoruar	Rrethi	Përshkrimi i gjendjes
Zona e Ballabanit	Përmet	Bimët kanë një gjendje të mirë vegjetative dhe gjendje të kënaqshme fitosanitare.

Tabela 15. Vlerësimi i Boronicës (*Vaccinium myrtillus*) statusi i kërcënimit VUA2b

Zona e monitoruar	Rrethi	Përshkrimi i gjendjes
Bjeshkët e Çeremit	Tropojë	Gjendja vegjetative dhe fitosanitare e boronicës në këtë sipërfaqe monitoruese (50 m ²) paraqitet shumë e mirë.
Lurë	Dibër	Gjendja vegjetative dhe fitosanitare është e shkëlqyer kjo si pasojë e ndërhyrjes së ulët të faktorit human dhe klimës së përshtatshme.
Shpellë e Lushkës	Pogradec	Gjendja vegjetative dhe fitosanitare është e mirë .

6.2.4 Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura

Lista e kuqe e florës dhe faunës së egër shqiptare është miratuar me Urdhër të Ministrit të Mjedisit Nr 1280, date 20.11.2013 "Për miratimin e Listës së Kuqe të Florës dhe Faunës së Egër" dhe përmban 402 lloje florë dhe 575 lloje faunë. Gjithashtu është në fuqi edhe VKM Nr. 760, datë 9.12.2021 "Për miratimin e listës së llojeve të mbrojtura të bimëve/florës dhe kafshëve/faunës të vendit"

Censusi ndërkombëtar i shpendëve ujqorë dimërues

Numërimi Ndërkombëtar i Shpendëve Dimërues, në Shqipëri u organizua në Janar

2022, me përfshirjen e Administratave të Zonave të Mbrojtura në të 12 qarqet me mbështetjen e ekspertëve ornitolog dhe specialistëve e vullnetarëve. Censusi i vitit 2022 mbuloi 31 ligatina (lumenj, liqene, rezervuare, ekosisteme bregdetare etj) në të gjithë Shqipërinë. Për vitin 2022 në total u regjistruan 64 lloje (specie) shpendësh, me një numër total individësh prej 138494.

Lloji me numër më të madh të individëve, është bajza (*Fulica atra*).

Në RNM "Liqeni Shkodrës" është evidentuar numri më i madh i shpendëve me 29259 individë, më pas vjen PK "Divjakë – Karavasta", me 25670 individë.

Vendnumërimet	Individë	Specie
Divjakë - Karavasta	25670	50
Kune-Vain	14429	36
Liqeni i Shkodrës	29259	24
Prespa e Madhe	11736	26
Ohër	12354	24
Narta	14407	36
Thana	11442	27
Butrinti	4269	29
Lalzi	4103	31
Orikum	1213	17
Buna-Velipojë	1570	20
Patok	1199	25
Fierza	1179	12
Liqeni i Tiranës	403	6
Vau i Dejës	1044	12
Prespa e Vogël	79	8
Shëna-Vlash	219	7
Karpen	138	7
Seman	352	10
Banja	140	9
Belshi	389	11
Liqeni i Farkës	121	4
Rezervari i Bulos	127	11

Syri i Kaltër	53	5
Liqeni i Ulzës	86	4
Rezervuari i Kasharit	28	2
Rezervuari i Paskuqanit	227	4
Liqeni i Tapizës	27	6
Liqeni i Bovillës	-	-
Rezervuari i Kujanit	560	10
Këneta e Roskovecit	1	1
Rezervuari i Kusit	3	2
Rezervuari i Gjançit	126	6
Rezervuari Shtyllës	-	-
Rezervuari Thumanës	-	-
Totali	138494	64

Inventarizimi i faunës së egër në zonat e mbrojtura mjedisore

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), që nga 6-mujori i dytë i vitit 2017 e në vazhdim është përfshirë në kryerjen e punës, për ndjekjen permanente të Vëzhgim-Monitorimit të Faunës së Egër, në territoret e sistemit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore, sipas specieve të përcaktuara për këtë qëllim. Në Vëzhgim - Monitorim janë gjithsej 40 specie si më poshtë vijon:

1. Ariu i Murmë (*Ursus arctos*),
2. Mace e Egër (*Felis silvestris*),
3. Rrëqebulli (*Lynx lynx balcanicus*),
4. Lundërza (*Lutra lutra*),
5. Dhia e Egër (*Rupicapra rupicapra*),
6. Kaprolli (*Capreolus capreolus*),
7. Baldosa (*Meles meles*),
8. Ujku (*Canis lupus*),
9. Çakalli (*Canis aureus*),
10. Derri i Egër (*Sus scrofa*),
11. Lepuri i Egër (*Lepus europaeus*),
12. Dhelpra (*Vulpes vulpes*),
13. Zardafi/Kunadhja Gushëverdhe (*Martes martes*),
14. Shqarshi/Kunadhja Gushëbardhe (*Martes foina*),
15. Kryekuqe e Madhe (*Anas penelope*),
16. Kryekuqe Qafëgjelbër (*Anas platyrhynchos*),
17. Grilla (*Anas crecca*),
18. Rosa Bishtëgjelë (*Anas acuta*),
19. Rosa e Përhime (*Anas strepera*),

20. Sqepluga (*Anas clypeata*),
21. Marsatorja (*Anas querquedula*),
22. Shapka e Ujit (*Gallinago gallinago*),
23. Bajza (*Fulica atra*),
24. Thëllënxa e Malit (*Alectoris graeca*),
25. Pëllumb i Egër (*Columba livia*),
26. Shapka (*Scolopax rusticola*),
27. Turtulli (*Streptopelia turtur*),
28. Shkurta (*Coturnix coturnix*),
29. Lauresha (*Alauda arvensis*),
30. Pelikani Kaçurrel (*Pelecanus crepus*),
31. Kryekuqja e Mjeme (*Aythya ferina*),
32. Kryekuqja e Vogël (*Aythya nyroca*),
33. Zhytraku i Madh (*Mergus merganser*),
34. Karabullaku Madh (*Phalacrocorax corba*),
35. Karabullaku me Çafkë (*Phalacrocorax aristotelis*),
36. Pelikani Rozë (*Pelecanus onocrotalus*),
37. Çafka e Përhime (*Ardea cinerea*),
38. Karabullaku i Vogël (*Phalacrocorax pygmeus*),
39. Murrçaku (*Netta rufina*),
40. Dallandyshja Faqebardhe e Detit (*Chlidonias hybrida*).

Nga këto specie 13 janë gjitarë dhe 27 prej tyre janë shpendë. Speciet e gjitarëve grupohen në gjitarë të mëdhenj, të mesëm dhe gjitarë të vegjël, sikundër shpendët grupohen në ujqorë e jo ujqorë.

Nga këto 40 specie 17 prej tyre janë shpallur objekt gjuetie, kurse 23 të tjerat konsiderohen specie kryesore të faunës së egër, ndaj janë

përcaktuar për vëzhgim dhe monitorim.

Procesi realizohet nëpërmjet punës së përditëshme të Rangers-ave (Rojeve Mjedisore), sipas AdZM-ve në të 12-të qarqet e vendit.

Bazuar në Direktivën e Këshillit të Europës nr. 92/43/EEC e dates 21 maj 1992, mbi ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës e florës së egër (Direktiva e Habitaveve), dhe gjithashtu në Direktivën e Këshillit të Europës nr. 79/409/EEC e datës 2 prill 1979 mbi ruajtjen e shpendëve të egër (Direktiva e Shpendëve), AKZM ka krijuar një Sistem të Monitorimit të Faunës së Egër "AKZM-SiMF", si sistem kombëtar i monitorimit, i njehsuar me sistemin e BIONNA-s, si sistem ndërkombëtar i monitorimit. Vazhdon të praktikohet hedhja online e të dhënave nëpërmjet aplikimit të këtij sistemi të ri, në mënyrë të përditësuar.

Evidentimi i specieve dhe identifikimi i tyre realizohet sipas këtyre mënyrave: Kamera Kurth, Vrojtim direkt, Jashtëqitje, Gjurmë, Tjetër (Pupla, Qime etj). Përveç këtyre, në tërësinë e të dhënave të Rangers-ave, në bashkëpunim me specialistët e AdZM-së përkatëse, janë plotësuar edhe informacioni për datën, orën, koordinatat në gradë Decimal, pra jo në UTM dhe vendin e identifikimit (zonë e mbrojtur apo jo dhe emri popullor), konfliktet e ndodhura, lloji i dëmit të shkaktuar dhe koha e kryerjes së tij, ngordhjet e konstatuara në F. Egër (koha, shkaku, mënyra e ngordhjes dhe gjinia e mosha për specien e ngordhur), pa përjashtuar këtu shënime apo sqarime të tjera specifike për çdo rast, sipas zonave të mbrojtura ku është kryer Vëzhgim-Monitorimi.

➤ Rrjeti kombëtar i zonave të mbrojtura mjedisore

Në Republikën e Shqipërisë, zonat e mbrojtura mjedisore janë shpallur, me VKM-të përkatëse, bazuar në aktet ligjore dhe në ligjen nr.8906 "Për zonat e mbrojtura", datë 06.06.2002, (të ndryshuar) me ligjin nr. 81/2017, datë 04.05.2017 "Për zonat e mbrojtura". Në vitin 2022 dy kategori Park Kombëtar dhe Rezervat Natyror i Menaxhuar/ Park Natyror, u shpallën me VKM nr. 59, datë 26.01.2022 "Për Miratimin e Ndryshimit të Statusit dhe Sipërfaqes së Ekosistemeve Natyrore "Park Kombëtar" (Kategoria II) e zonave të mbrojtura mjedisore" dhe VKM nr. 60, datë 26.01.2022 "Për shpalljen e Ekosistemeve Natyrore Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror (Kategoria IV), si dhe Miratimin e Ndryshimit të Statusit e të Sipërfaqeve ekzistueset të Zonave të Mbrojtura Mjedisore", me VKM nr. 557, datë 29.07.2022 "Për shpalljen e ekosistemit natyror detar-bregdetar të Gjirit të Porto-Palermos "Park Natyror" dhe VKM-në 694, datë 26.10.2022 u shpall "Ndryshimi i statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemit natyror/ligatinor "Pishë Poro-Nartë" nga Rezervat Natyror i Menaxhuar në Peizazh i Mbrojtur dhe heqjen e statusit zonë e mbrojtur të sipërfaqes së pakësuar".

I gjithë sistemi i zonave të mbrojtura mjedisore, që përfshinë aktualisht rreth 21.3% të territorit të vendit, është përcaktuar sipas kriterëve të IUCN -së, në gjashtë kategori dhe konkretisht:

Tabela 12 Kategoritë e Zonave të Mbrojtura dhe sipërfaqet respektive

Nr.	Emërtimi i kategorisë së zonës së mbrojtur mjedisore	Nr.	Kategoria	Sip. në Ha
1	Park Kombëtar	11	II	301196.77
2	Monument Natyre	723	III	1550.00
3	Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror	24	IV	224014.18
4	Peizazh i Mbrojtur	10	V	81922.68
	Totali	768		608683.63

Referuar VKM nr. 31, datë 20.1.2016 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit", sistemi i vetëm i Kodeve për Sistemin e Zonave të Mbrojtura Mjedisore është ai sipas Rrjetit të Zonave Emerald për Shqipërinë duke identifikuar 25 Zona të Mbrojtura si potenciale për tu përfshirë në Rrjetin Emerald. Të dhënat e detajuara jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 13. Rrjeti i Zonave Emerald për Shqipërinë

Kodi	Emri	Kategoria sipas IUCN	Territori
AL0000001	Parku Kombëtar Llogara	II	1.010
AL0000002	Parku Kombëtar Pisha e Divjakës	II	1.250
AL0000003	Parku Kombëtar Prespë	II	27.750
AL0000004	Parku Kombëtar Butrint	II	2.500
AL0000005	Rezervë Strikte Natyrore Allamani	I	1.650
AL0000006	Parku Kombëtar Tomorr	II	4.000
AL0000007	Parku Kombëtar Dajt (i zgjeruar)	II	29.347
AL0000008	Peisazh i Mbrojtur Vjosë - Nartë	V	19.412
AL0000009	Rezervat Natyror i Menaxhuar, Liqeni Shkodrës	IV	26.535
AL00000010	Parku Kombëtar i Alpeve (i propozuar)	II	77.458
AL00000011	Parku Kombëtar Kurora e Lurës - Kunorë - Valmore - Zall Gjoçaj (i propozuar)	II	16.596
AL00000012	Parku Kombëtar Bredhi i Hotovës-Dangëlli	II	14.973
AL00000013	Peizazh i Mbrojtur i Moravës (i propozuar)	V	29.155
AL00000014	Parku Kombëtar Karaburun - Orikum - Dukat (i propozuar)	II	33.036
AL00000015	Peizazh i Mbrojtur Bizë - Brosh - Bërdhet (i propozuar)	V	4.594
AL00000016	Parku Kombëtar Karavasta (i propozuar)	II	19.677
AL00000017	Rezervat Natyror i Menaxhuar Shëngjin - Ishëm (i propozuar)	IV	30.000

AL00000018	Rezervat Natyror i Menaxhuar Kuturman - Qafë Bush	IV	4.210
AL00000019	Peizazh i Mbrojtur Pogradec	V	24.350
AL00000020	Parku Kombëtar Gërmenj - Shelegur - Leskovik - Piskal (i propozuar)	II	30.421
AL00000021	Peizazh i Mbrojtur Lumi Buna	V	22.479
AL00000022	Parku Kombëtar Rajcë - Shebenik	II	33.927
AL00000023	Parku Kombëtar Korab	II	31.360
AL00000024	Rezervat Natyror i Menaxhuar Rrushkull - Ishëm (i propozuar)	IV	2.030
AL00000025	Rezervat Natyror i Menaxhuar Berzanë	IV	1.298

Monumentet e natyrës sipas VKM Nr. 187, datë 25.03. 2021

Nr.	Qarku	Bashkia	Numri i MN
I	Berat	Berat	8
		Skrapar	27
		Poliçan	2
	Totali		37
II	Dibër	Dibër	42
		Bulqizë	18
		Mat	23
	Totali		83
III	Durrës	Durrës	5
		Krujë	11
		Shijak	2
	Totali		18
IV	Elbasan	Elbasan	15
		Librazhd	22
		Gramsh	19
		Prrenjas	11
		Belsh	4
		Peqin	5
	Totali		76

V	Fier	Fier	4
		Lushnje	5
		Divjakë	9
		Patos	3
		Mallakastër	13
	Totali		34
VI	Gjirokastrë	Gjirokastrë	12
		Përmet	21
		Libohovë	17
		Dropull	13
		Tepelenë	14
		Memaliaj	4
		Këlcyrë	4
	Totali		85
VII	Korçë	Korçë	11
		Pogradec	17
		Devoll	9
		Maliq	10
		Pustec	7
		Kolonjë	23
	Totali		77
VIII	Kukës	Kukës	15
		Has	7
		Tropojë	25
	Totali		47
IX	Lezhë	Lezhë	10
		Mirditë	18
		Kurbin	12
	Totali		40
X	Shkodër	Shkodër	57
		Vau Dejës	3
		Fushë Arrëz	9
		Pukë	12
		Malësi e Madhe	34
	Totali		115
XI	Tiranë	Tiranë	14
		Rrogozhinë	2
		Kavajë	7
	Totali		23


XII	Vlorë	Vlorë	20
		Sarandë	3
		Selenicë	10
		Himarë	28
		Delvinë	12
		Finiq	8
		Konispol	5
	Totali	86	
	Shuma Total (MN)	721	

Me VKM-në nr. 187, datë 25.3.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 303, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare", janë shpallur gjithsej 721 monumente natyre me koordinata (MN).

Sqarojmë se, në tabelën e mësipërme (në total), përfshihen edhe 2 (dy) monumente natyror (MN), të cilët janë shpallur me VKM nr. 102, datë 15.01.1996 me sipërfaqe dhe konkretisht janë:

- 1- Zheji (qarku Gjirokastrë): 1500.0 ha
- 2- Vlashaj (qarku Dibër): 50.0 ha.

6.3 Forcat shtytëse, presioni, ndikimi, gjendja, reagimi



6.4 Kuadri ligjor

Biodiversiteti

- Ligj nr. 60/2022 "Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji "për disa ndryshime në ligjin nr.9867, datë 31.1.2008, "përpërcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër", të ndryshuar
- VKM "për ndryshimin e statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemit natyror/ligatinor "Pishë Poro-Nartë" nga "rezervat natyror i menaxhuar" në "peizazh i mbrojtur" dhe heqjen e statusit "zonë e mbrojtur" të sipërfaqes së pakësuar
- VKM nr.59, datë 26.1.2022 "për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore park kombëtar (kategoria ii) të zonave të mbrojtura mjedisore
- VKM nr. 60, datë 26.1.2022 "për shpalljen e ekosistemeve natyrore rezervat natyror i menaxhuar/park natyror (kategoria iv), si dhe miratimin e ndryshimit të statusit e të sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura mjedisore, që i përkasin kësaj kategorie"
- VKM nr. 154, datë 13.3.2023 "për shpalljen e habitatit të tulipanit shqiptar "monument natyror"
- VKM nr. 557, datë 29.7.2022 "për shpalljen e ekosistemit natyror detar - bregdetar të gjirit të porto-palermos "park natyror", kategoria IV"
- VKM Nr. 302, datë 10.5.2019 "Për kriteret e ushtrimit, të miratimit e monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura mjedisore"
- Ligji nr. 41/2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar"
- Ligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër", të ndryshuar.
- Dokumenti mbi Politikën Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit 2016-2020.
- Projektligj Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër", të ndryshuar.
- Urdhër nr 148, dt 21.2.2013 "Miratimi Strukturës Standarte Plani Menaxhimit ZM".
- Ligj 7 /2014 30.01.2014 "Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë".
- Ligj 68/2014 03.07.2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit".
- Ligj 81 2017 04.05.2017 "Për zonat e mbrojtura".
- Ligj nr. 6/ 2015 amendimi ligjit CITES.
- Suplementi i Trashëgimisë Botërore i Planit të Menaxhimit për Peizazhin e Mbrojtur të Pogradecit 2017-2027.
- Udhëzim nr. 1, 11.2.2016 "Manuali inventarizimit të llojeve të faunës së egër objekt gjuetie".
- Udhëzim nr. 1, 11.2.2016 "Për metodikat e inventarizimit të llojeve të faunës së egër objekt gjuetie".
- Udhëzimi inventarizimit faunës egër Fletore Zyrtare 27-2016.
- Urdhër Ministri 62, 4.4.2016, lista e shpendëve vulnerabël.
- Urdhër Ministri 182 datë 20 09 2016 Trajtimi i Faunës në Zooparqe.
- Urdhër Ministri 750, 24.11.2015 miratimi PM Karaburun-Sazan.
- Urdhër Ministri 782, 30.12.2015 miratim Plani i Menaxhimit Divjakë-Karavasta.
- Urdhër Ministri CITES 726, 26.10.2015.
- Urdhër ministri miratimi planit veprimit pelikani 120-2017.
- Urdhër Ministri miratimi suplementit TB te PM PMP 8.9.2017.
- Urdhër Ministri plani veprimit pelikanit.

- Urdher Ministrit parqet zoologjike.
- VKM 31, 20.1 2016 DPSBM Janar 2016.
- Strategic Document of Biodiversity Policy Albania.
- VKM nr. 901, 11.11.2015 amendimi i ligjit të gjuetise
- VKM listat 866 10 12 2014.
- VKM nr.57, datë 6.2.2019 "Për kriteret dhe mënyrën e zonimit të territorit të një zone të mbrojtur mjedisore"
- VKM nr.414, datë 19.6.2019 "Për rregullat, kriteret dhe procedurat përpërdorimin e shpellave për qëllime turistike"
- VKM nr.302, datë 10.5.2019 "Për kriteret e ushtrimit, të miratimit e monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura mjedisore"
- VKM nr.369, datë 29.5.2019 "Për miratimin e rregullave për shpalljen e zonave të veçanta të ruajtjes"
- VKM nr.303, datë 10.5.2019 "Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës Shqipëtare"
- VKM nr. 661, datë 31.10.2018 "Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar "Lura" dhe krijimin e parkut kombëtar "Lurë-Mali i Dejës."
- VKM nr. 593, datë 9.10.2018 "Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve të Menaxhimit të zonave të mbrojtura mjedisore"
- VKM nr. 467, datë 26.7.2018 "Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar "Mali i Tomorit"
- VKM nr.468, datë 26.07.2018 "Për shpalljen e ekosistemit natyror Krastë-Verjon "peizazh i mbrojtur."
- VKM nr.354, datë 2.05.2018 "Për zgjerimin dhe kthimin e Parkut Rajonal Zagori në Park Natyror.
- VKM nr. 570, datë 17.7.2019 "për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të pyjeve"
- Vendim nr. 888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre"
- Vendim nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike dhe prodhimet drusore e jodrusore pyjore, si dhe mënyrën e procedurën e mbledhjes së tyre"
- VKM Nr. 558 Date 29.07.2022 "Per përcaktimin e kriterëve për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda dhe sanksionet financiare, në fondin pyjor kombëtar"
- VKM Nr. 284 Date 29.04.2022 "për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave"
- VKM Nr. 171 Date 18.03.2022 "për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullor, përcaktimin e strukturës, kriterëve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve"
- VKM Nr. 829, date 24.12.2021 "Për miratimin e kriterëve të ushtrimit dhe të monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në fondin pyjor kombëtar"
- VKM Nr. 761, date 09.12.2021 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), ruajtjen dhe trajtimin e pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër, si dhe kalimin e tyre në

Pyjet

- Ligji 57/2020 "Per Pyjet"

- konservim të plotë"
- VKM Nr. 537 date 22.09.2021 "Per përcaktimin e Kostove te perlllogaritura per pyllzim kompenues ne rastet e ndryshimit te destinacionit te fondit pyjor
 - VKM. Nr. 297 date 17.05.2023 "Per miratimin per kryerjen e veprimtarive te shfrytezimit ne fondin pyjor kombetar nga individe apo subjekte te licensuar
 - Ligji nr. 5/2016 "Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë".
 - Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për Fondin Kullosor", i ndryshuar me Ligjin Nr. 49/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007, "Për Fondin Kullosor""; të ndryshuar.
 - VKM nr. 814, datë 31.12.2018 "Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019-2030".
 - VKM nr. 591, datë 9.10.2018 "Për disa ndryshime në vendimin nr.1353, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor".
 - VKM nr. 592, date 9.10.2018 "Për disa ndryshime në vendimin nr.1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor".
 - Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave"".
 - Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1353, date 10.10.2008, "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor".
 - Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1374, datë 10.10.2008, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor" i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 435, datë 8.6.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor"".
 - Udhëzim i Ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 26.01.2017 "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar".
 - Udhëzim i Ministrit të Mjedisit nr. 2, datë 3.3.2017 i Ministrit të Mjedisit "Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje".
 - Udhëzim i Ministrit të Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, te shqyrtimit e të miratimit te kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".
 - Udhëzim i Ministrit të Mjedisit Nr. 2, datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për

kullotje e kositje bari”

6.5.Rekomandime

Bazuar në gjëndjen shëndetësore të fondit pyjor me llojin pishë e zezë, rekomandohet:

- Mbajtjen nën kontroll të sëmundjeve dhe dëmtuesve, ku shkalla e prekjës është më e madhe se kufijtë kritikë të lejueshëm.
- Identifikimi i të gjitha sipërfaqeve të llojeve të pishave të prekura nga dëmtuesi i procesonaries së pishës si dhe marrja e masave për mbajtjen nën kontroll të këtij dëmtuesi.
- Aplikimi i luftimit të integruar (metoda mekanike me atë biologjike, i kombinuar kjo me ruajtjen e parazitëve dhe larvave të dëmtuesit. Në këtë rast, do të priten vetëm qeskat me larva, të cilat dallohen qartë nga ngjyra e bardhë karakteristike e gjendjes së tyre.
- Nisur nga dëmi që ka shkaktuar dëmtuesi i procesonaries së pishës, sugjerojmë se duhet të ndërhyhet me metodën biologjike të luftimit të këtij dëmtuesi.
- Në këto kushte del e nevojshme riprodhimi në masë të insektit që ushqehet me larvën e dëmtuesit (koleopterit *Calosoma sycophanta*), në kuadrin e luftës biologjike ndaj procesionares.

Bazuar në speciet drunore dhe bimët aromatiko-mjekësore të kërcënuara rekomandohet:

- Kufizimi i grumbullimit të tyre, në mënyrë që këto bimë ti kemi në vazhdimësi edhe në të ardhmen.
- Sensibilizimi i komunitetit ku grumbullohen këto bimë, përmes vendosjes së tabelave në vendet ku rriten këto bimë për rëndësinë e tyre dhe shkallën e kërcënimit për zhdukje.
- Hartimi i një strategjie për ruajtjen dhe përdorimin e burimeve bimore lokale në shkallë kombëtare dhe sidomos i atyre specieve që janë në rrezik

zhdukjeje. Nëpërmjet kësaj strategjie duhet të parashikohet grumbullimi, mbrojtja, studimi, ruajtja in situ dhe përdorimi i burimeve gjenetike bimore. Në këtë drejtim merr rëndësi kombinimi i teknikave të ruajtjes së burimeve gjenetike: në bankat gjenetike (ex situ) dhe në vëndorigjinë (in situ).

Biodiversiteti

- Të kryhet inventarizimi i florës dhe faunës.
- Të zbatohet udhëzuesi për metodikat e inventarizimit të florës dhe faunës.
- Monitorimi brenda territorit të Zonave të Mbrojtura ka disa vite që kryhet. Rekomandohet të realizohet monitorimi edhe jashtë territorit të Zonave të Mbrojtura.
- Në zbatim të Urdhërit të Ministrit nr 1280, date 20.11.2013 “Për miratimin e Listës së Kuqe të Florës dhe Faunës së Egër”, sugjerojmë që të ketë monitorim të këtyre llojeve nga AKZM për territorin brenda Zonave të Mbrojtura dhe kontrata monitorimi me ekspertë dhe institucione të fushës për llojet e listës së kuqe, për të mundësuar grumbullimin e të dhënave dhe trendin e popullatave të këtyre llojeve ndër vite.

KAPITULLI 7
TOKA



KAPITULLI 7

TOKA

7.1 Çështjet që trajtohen

Gjeokimia Mjedisore studion bashkëveprimin e përbërjes kimike natyrore të Litosferës, Hidrosferës dhe Atmosferës me botën e gjallë të Biosferës, bashkëveprim ky që formon ekosistemin natyror gjeokimik që është objekt i studimit të Gjeokimisë Mjedisore. Prishja e ekuilibrit të këtij ekosistemi, shkaktohet nga faktor të ndryshëm natyrorë ose nga veprimtari njerëzore, prishje që mund të sjellë ose jo ndotje të mjedisit, që rrezikojnë të tashmen dhe të ardhmen tonë. Studimi gjeokimik mjedisor i zonës bregdetare Kanali i Hoxharës - Porti i vjetër Vlorë është realizuar nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, në një shtrirje për rreth 35 km/l vijë bregdetare, për elementet: Na, K, Ca, Mg, Fe, Mn, Ni, Co, Cr, Cu, Zn, Pb, Cd, Li, S si dhe matja e pH.

Gjithashtu nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar është kryer vlerësimi mbi mbi gjëndjen e shtretërve të lumenjve Erzen dhe Ishëm. Dinamizmi i zhvillimit gjeologjik të rajonit dhe veprimtaria humane në lugina ka stimuluar krijimin e shumë ndikimeve mjedisore. Çështje të tjera që trajtohen janë dhe mbulesa tokësore dhe sipërfaqet me bujqësi organike

7.2 Gjendja dhe tendenca

Shqipëria është një vend me një diversitet të madh të llojeve të tokës për shkak të formave të ndryshme të materialeve mëmë dhe zonat klimatike që variojnë nga Mesdheu tipik përgjatë brigjeve deri në pothuajse të buta në malësitë, veçanërisht në pjesën lindore duke kulmuar me Alpet Shqiptare në veri. Toka është një burim natyror i kufizuar dhe disponueshmëria e saj është në rënie. Tokat janë të ndjeshme ndaj presioneve për shkak të rritjes së kërkesës për ushqim dhe si rezultat i përdorimit të ekosistemit nga një popullsi në rritje. Kuadri gjeomorfologjik i Shqipërisë me sipërfaqe të gjera të vendosura në zona të pjerrëta i bën ato natyrshëm të prekshme ndaj erozionit. Toka është nën presionin e kërcënimeve të ndryshme. Për shembull, ndryshimi i përdorimit të tokës mund të ndikojë në cilësinë e tokës dhe të gjithë mjedisin. Ndryshimet në tokë mund të ndodhin spontanisht, por kohët e fundit ato kanë ndodhur për shkak të një sërë presionesh antropogjene.

7.2.1 Mbulesa tokësore

Tabela 1. Shpërndarja për klasat e mbulesës së tokës

Burimi: Agjencia Kombëtare e Pyjeve

Për vitin 2021 sipërfaqja e egër organike është 619583 ha, sipërfaqe e kultivuar organike në total janë 1097 ha, nga të cilat plotësisht organike 912.6 ha dhe në kalim 184.4 ha.

Kategoria e përdorimit të tokës	Sipërfaqja	
	Sip. ha	Sip. %
Pyll	1309767	46
Kullotë	547682	19
Zonë urbane	66337	2.3
Sipërfaqe ujore	78013	2.7
Toka bujqësore	702646	24
Të tjera	170355	6
Total	2874800	100

Tabela 2 Kërcënimet e tokës në Shqipëri

Kërcënimet e tokës		Shqipëria
Marrja dhe zënia/mbyllja e tokës	Në pjesët me popullsi të dendur zënia e tokave është një nga më dukuritë kërcënuese	↑↓
Ndotja	Ndotësit kryesor janë metalet e rënda	↑↓
Ndryshimi i karbonit organik	Humbja e karbonit organik është evidente në shumicën e tokave bujqësore.	=
Erozioni i tokës	Erozioni ujor është aktiv në zonat malore të kultivuara dhe erozioni me erë në zonat fushore.	

Burimi: *State of the art of soil management in the Western Balkans, 2021*

E ndryshueshme ↑↓

E qëndrueshme =

E përkeqësuar

7.2.2 Vlerësimi gjeokimik mjedisor i zonës bregdetare Kanali i Hoxharës - Porti i vjetër Vlorë.

Pozicioni gjeografik, relievi, klima

Ultësira bregdetare përfaqëson krahinën më të madhe të Shqipërisë dhe të gjithë bregut lindor të Adriatikut. Si në të kaluarën ashtu edhe sot, ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në jetën ekonomike të vendit tonë. Ky rol kushtëzohet nga pasuri të mëdha natyrore, nga dendësia e popullsisë dhe e qendrave të banuara. Në këtë krahinë banon afër gjysma e popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë, duke zënë gati ¼ e sipërfaqes së përgjithshme dhe pjesën dërmuese të tokave bujqësore. Këtu gjenden gati të gjitha rezervat e naftës dhe të gazit, rezervat e bitumit natyror. Këtu ndodhen disa nga plazhet më të bukura të vendit. Vetë ultësira bregdetare zë pothuajse gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë, nga Hani i Hotit në veri deri në qytetin e Vlorës në jug, me një gjatësi rreth 200 km.

Relievi në përgjithësi kushtëzon një farë

uniformiteti në kushtet klimaterike të Ultësirës. Për skajet në lindje e jug të saj influencojnë grykat e lumenjve, format e ndryshme të relievit, shpatet malorë dhe vargmalet, të cilët nga vet pozicioni i tyre ndikojnë ndjeshëm në vlerat klimaterike, si në drejtimet mbizotërues të erërave, në dobësimin ose në fuqizimin e puhive detare e tokësore si dhe në sasinë e reshjeve që kanë ndryshime të theksuara sasiore.

Klima e rajonit në përgjithësi është mesdhetare dhe temperaturat gjatë gjysmës së ftohtë të vitit karakterizohet nga reshje të shumta, sidomos muajt Nëntor dhe Dhjetor. Gjysma e ngrohtë e vitit karakterizohet nga reshje të pakta.

Koha e kthjellët me diell arrin në rreth 240 ditë. Në Ultësirën bregdetare ndikim kanë erërat e nxehta dhe të thata. Drejtimi i erërave gjatë vitit është i ndryshëm, por në përgjithësi mbizotërojnë erërat lindore e juglindore.

Bimësia natyrore në Ultësirën bregdetare është e përbërë kryesisht nga makje mesdhetare dhe më rrallë masive pyjore, që gjenden në disa sektorë të vegjël dhe sidomos në brezin buzë detit, nga Shkumbini deri në Vjosë dhe në kurrizoret kodrinore. Gjithashtu, në rripin bregdetar gjenden kallamishte.

Ndërtimi gjeologjik

Rajoni në studim përfshihet në pjesët përbërëse të Ultësirës Adriatike. Në ndërtimin

gjeologjik të këtij rajoni do të trajtohen shkurtimisht stratigrafia e depozitimeve që janë takuar në këtë rajon, përfshirë dhe ato të Kuaternarit si të vetmet depozitime që dalin në sipërfaqe, si dhe njësitë strukturore që ndërtojnë këto formacione.

Depozitimet e Pliocenit (N_2)

Këto depozitime si dhe depozitimet e nënshtrira, nuk dalin në sipërfaqe, por janë takuar në gjithë trashësinë e tyre nga të gjithë pusët e shpuar në rajonin përreth. Në sipërfaqe këto depozitime i takojmë më në lindje, të cilat ndërtojnë brahiantiklinalin e Ardenicës ku Formacioni "Rrogozhina" me mbizotërim të shkëmbinjve me litologji trashamane si konglomeratë, ranorë e më pak të atyre argjilore e alevrolitorë, ka një përhapje të gjerë, ndërsa Formacioni "Helmësi" me mbizotërim të shkëmbinjve argjilor dhe më pak të atij alevrolitor dhe ranor, ka përhapje të vogël në formë pullash. Ato në sipërfaqe takohen edhe më në jug të Ardenicës, në Fier e më në lindje të tij, në Patos, si dhe më në veri, në Divjakë, Lushnjë, etj. Këto dy formacione tregojnë për facie të ndryshme dhe, rrjedhimisht, edhe për kushte depozitimi të ndryshme njëra nga tjetra, ku nga facia më e thellë (Formacioni Helmësi) kalohet gradualisht në një facie më të cekët (Formacioni Rrogozhina).

Depozitimet e pliocenit të poshtëm (N_1^2h)

Pako argjilore me ndërthurje alevrolitoranore. Në bazë të të dhënave të sipërfaqes dhe atyre të marra nga pusët e shpuar në këtë zonë, depozitimet e kësaj suite vendosen në mospajtim stratigrafik e këndor mbi depozitimet e Mesinianit nëpërmjet një niveli të fuqishëm konglomeratik. Ai përfaqësohet nga material i trashë ranor-konglomeratik kompakt në përbërje të të cilit takohen konglomeratë të përbërë nga zaje me diametër 2-3 deri në 4-5 cm me përbërje magmatike dhe sedimentare të çimentuar me çimento karbonatike dhe përmbajtje të konsiderueshme materiali ranor që vende - vende bëhen predominues.

Depozitimet e Pliocenit të sipërm (N_2^{2rr})

Formacioni "Rrogozhina", zhavorre,

konglomeratë, argjila-alevrolitore. Këto depozitime si dhe depozitimet e nënshtrira të sipër përshkruara nuk dalin në sipërfaqe, por ato janë takuar nga të gjithë pusët e shpuar në rajonin përreth dhe shoqërojnë depozitimet e formacionit të Helmësit në të gjithë Ultësirën Adriatike. Në strukturën e Povelçë-Semanit depozitimet e formacionit Rrogozhina nuk dalin në sipërfaqe pasi mbulohen nga depozitimet e Kuaternarit. Në drejtim të Semanit prerja behet më e ashpër ku vihet re shtimi i elementit ranor-konglomeratik në krahasim me strukturën e Povelçës.

Depozitimet e Kuaternarit (Q)

Këto depozitime kanë përhapje në gjithë sipërfaqen që përfshin Ultësira Adriatike dhe planshetin e Levanit, si dhe gjatë shtratit të lumit të Semanit dhe në zonën pranë bregore të detit Adriatik. Në plan regional, stratigrafikisht këto depozitime vendosen me mospërputhje mbi depozitimet e nënshtrira nga të Pliocenit. Në studimet e kryera kryesisht për zonën bregdetare, veçohen depozitime të Pleistocenit dhe Holocenit. Litologjikisht këto depozitime përbëhen nga argjila, rëra, zhavorre, brekçie, suargjila, surëra, torfa.

Pleistocen i sipërm (Qp_2)

Këto depozitime kanë përhapje të gjerë në veri të lumit Vjosa e drejt veriut, deri në lumin Seman. Sipas të dhënave të puseve, depozitimet e Pleistocenit të sipërm ndryshojnë facien e tyre. Në pjesën jugore të rajonit, prerja përfaqësohet me sedimente rërash të alternuar me thjerrëza argjilash dhe zhavorresh e deri konglomeratë të çimentuar dobët. Drejt veriut dhe perëndimit trashësia e depozitimeve të Pleistocenit të sipërm rritet gradualisht, ndërsa litologjikisht fillon të predominojë facia argjilo-alevrolitore e ndërthurur me nivele thjerrëzash e shtresash të zhavorreve, veçanërisht në pjesën lindore.

Holoceni (Qh)

Ka përhapje të gjerë sipërfaqësore dhe në bazë të kushteve të formimit përfaqësohet me të dy nënseksionet e tij, atij të poshtëm dhe Holocenit të sipërm, me formime detare

dhe formime kontinentale. Depozitimet e Holocenit të poshtëm në rajonin e studiuar mund të veçohen nga prania e faunës detare të ujërave të cekta të kripura të përfaqësuar nga *Cyprideis* sp., *Laxoconcha* sp., (Ostracoda) dhe foraminifere si *Ammonia* tepida, *A. beccari*, *Nonion* sp., etj. të përziera me faunën liqenore (kontinentale) të përfaqësuar nga Ostracoda siç janë *Ilocupris* sp., *Candona* sp., etj. Në disa kampione që janë marrë afër vijës bregore të detit Adriatik të tanishëm siç janë ato të Semanit, Shtyllë, Hoxharë, etj. mundet që depozitimet e Holocenit të poshtëm e të sipërm të jenë detare të përfaqësuar nga *Cyprideis* sp.sp., *Cytheridea acuminata neapolitana* dhe me foraminifere si *Ammonia papillosa*, *A. tepida*, *Elphidium deciprens*, etj.

Holoceni i poshtëm (Qh₁)

Në sipërfaqe pozicionohen në lindje të Pleistocenit të sipërm dhe zhvillimin më të madh e kanë në veri të lumit Vjosa. Krahas takimit në sipërfaqe, këto depozitime takohen dhe në thellësi nëpërmjet interpretimit të puseve të shpuar. Kufiri i poshtëm i tij në sipërfaqe është trasuar me interpretim në bazë të të dhënave të kampioneve të analizuar si dhe të karakterit litologjik të prerjes. Në veri të lumit Vjosa, në sipërfaqe, bazuar në zhveshjet e përshkruara, prerja më e poshtme e tyre, që përbën dhe kalimin nga Pleistoceni i poshtëm, përfaqësohet nga argjilat gri në kaltëroshe të çelët me copëra dhe guacka makrofaunash. Rrallë takohen ndërfitje rëre gri në bezhë kokërrvogël. Këto argjila janë shfrytëzuar nga vendasit për përgatitje tullash për ndërtim.

Holoceni i sipërm (Qh₂)

Këto depozitime vendosen kudo me mospajtim dhe përfaqësohen nga depozitimet e aluvioneve, rërave bregdetare dhe ato aluvion-deluvion-preluvioneve.

Depozitimet e rërave bregdetare (Qh₂)

Përhapen në pjesën perëndimore të rajonit, shtrihen paralel me vijën e bregut e të plazhit të detit, në formë të një brezi me gjerësi që ndryshon shtrirjen në brendësi të tokës nga 500-1000 m deri në 3000 m. Depozitimet e rërave bregdetare në përgjithësi formojnë plazhet e sotme si dhe zonat e ngritura të dunave. Ato përbëhen nga rëra ngjyrë gri në bezhë të çelur, kryesisht me kokrriza të vogla, shpesh me copëra guacka bivalvorësh. Më tepër predominojnë grimcat e karbonateve, pa përjashtuar edhe kokrriza të mineraleve të rëndë e të rralla si të kromitit, ilmenitit, rutili etj. Këto depozitime duke i menduar të formuara në kushte detare e lagunore i konsiderojmë me origjinë detare.


Depozitimet aluviale (Qh_{2al})

Kanë një përhapje të konsiderueshme sipërfaqësore dhe takohen në të dy anët e rrjedhjes së lumenjve Seman në veri dhe Vjosa në jug. Në luginën e Vjosës, pranë derdhjes së saj në det, depozitimet aluviale mbulojnë nga rërat bregdetare. Pranë sipërfaqes së tokës, prerje më të pastra të depozitimeve aluviale janë takuar në shtretërit e lumenjve Vjosa dhe Seman.

Depozitimet aluviale-deluviale-proluviale (Qh_{2del})

Përhapen kryesisht në pjesët lindore të rajonit dhe zënë pjesët pranë shpateve, kodrave dhe pjesën me lindore të fushës, gjithashtu edhe në përrenjtë e vegjël që përshkojnë kodrat. Këto depozitime takohen edhe në rajonin Levan-Pojan e përreth depozitimeve pliocenike të zhveshura në sipërfaqe. Këto depozitime përfaqësojnë copa të shkëputura të shkëmbinjve rrënjësore që ndërtojnë kodrat lindore të rajonit për shkak të veprimtarisë së agjentëve atmosferike të cilat ngelen në vend.

Zona bregdetare Kanali Hoxharës - Porti i vjetër Vlorë




Përcaktimi i ndikimit gjeogjen dhe antropogjen

Ndikimi në mjedis në zonën bregdetare bazohet në interpretimin e anomalive gjeokimike duke pasur parasysh vlerat e raportit të përmbajtjes mesatare të elementëve me S.Gj.N përkatës të tyre. Për të gjykuar mbi ndikimin e aktivitetit të veprimitarisë njerëzore nga shfrytëzimi i kësaj zone, llogariten përmbajtjet **antropogjene** të elementëve mbi vlerat normale. Përcaktohet që në fillim **Sfidi Gjeokimik Natyror (S.Gj.N.)** për llogaritjen e përmbajtjes **gjeogjene** (natyrale) të elementëve në toka.

Vlerësimi kryhet për provat e marra mbi 3-5 km larg zonës bregdetare, në thellësinë 50-60 cm nga sipërfaqja (thellësi kjo që shmang në një masë të konsiderueshme ndotjen antropogjene), pra përfaqëson një mjedis të pastër,

Harta skematike e materialit faktik gjeokimik për zonën bregdetare gjatë viteve 2021-2022.

Përmbajtjet mesatare të elementeve kimike në provat e S.Gj.N



Në tabelën e faktorëve gjeokimik për provat e marra për thellësinë 50 - 60 cm, rezulton se vlerat > 0.7 i konsiderojmë si vlera që ndikojnë fuqimisht në faktorët e llogaritur. Vëmë re se peshën më të madhe me vlerë pozitive në **faktorin 1** e kanë elementët **Ni, Zn, Fe dhe K**. Ndërsa tek **faktori 2** janë në përgjithësi vlera ulta, peshën më të madhe me vlerë pozitive e kanë elementët Cr, Cu, Na. Nga analiza

Elementët	Faktor 1	Faktor 2
Cr	-0.24	0.79
Ni	0.88	0.34
Co	0.48	-0.18
Cu	0.34	0.78
Pb	-0.10	-0.50
Zn	0.73	0.44
Mn	0.61	0.56
Fe	0.87	-0.44
K	0.76	-0.24
Na	-0.58	0.65

faktoriale janë nxjerrë bashkëshoqërimet e mëposhtme: **Ni - Fe - Zn - (K)**. **Natyra e tyre është me origjinë gjeogjene**, te formuara nga formacionet gjeologjike që ndërtojnë rajonin.


Peshat e elementëve në faktorët gjeokimikë, për provat e sfondit gjeokimik natyror paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Nga rezultatet e përpunimit të të dhënave analitike të këtyre provave të S.Gj.N (të mara në thellësinë 50-60 cm), me anën e analizës korrelative, kemi disa bashkëshoqërimet si më poshtë:

1. Cr-Cu-Mn-Na
2. Ni-Co-Cu-Zn-Mn-Fe-K
3. Co-Pb-Mn-Fe
4. Cu-Zn-Mn-Na
5. Pb-Fe
6. Zn-Mn-Fe-K
7. Mn-Fe-Na
8. Fe-K

Këto bashkëshoqërimet gjeokimike të elementëve në toka janë krijuar në një mjedis të pastër, të pa ndikuar nga faktori njeri. Pra janë me origjinë natyrore (gjeogjene), të ardhura nga formacionet gjeologjike përkatëse, të cilat nevojiten për ti krahasuar me bashkëshoqërimet gjeokimike në rëra, të provave në zonën bregdetare (të marra në thellësinë 10-15 cm).

Përmbajtja mesatare e elementëve kimikë në provat 10-15 cm, Kanali i Hoxharës – Porti i vjetër Vlorë jepen në grafikun e mëposhtëm.



Faktorët gjeokimike të provave për thellësinë deri në 15cm.

Elementët	Faktor 1	Faktor 2
Cr	0.01	-0.75
Ni	0.62	0.29
Co	0.40	-0.36
Cu	0.71	-0.12
Pb	0.06	-0.06
Zn	0.75	-0.02
Mn	0.26	-0.76
Fe	0.72	-0.23
K	0.63	0.47
Na	0.25	0.54

Shohim që me “peshë” më të madhe në **Faktorin 1**, paraqiten elementët **Cu, Zn dhe Fe**. Ndërsa tek **Faktori 2** janë në përgjithësi vlera ultra dhe negative. Çka tregon se kemi të bëjmë me një mjedis me origjinë gjeogjene (natyrore). Nga të dhënat analitike të provave të radhës të marra në thellësinë 10-15 cm, në zonën së bregdetare kemi këtë bashkëshoqërim gjeokimik karakteristik: **Zn - Fe - Cu - Ni - (K)**.


Rezultatet e analizës korrelative, të provave të S.Gj.N të mara në thellësinë 15 cm tregojnë që kemi disa bashkëshoqërime si më poshtë:

1. Cr-Mn-Fe
2. Ni-Cu-Zn-Fe-K-Na
3. Co-Cu-Zn-Mn-Fe
4. Cu-Pb-Zn-Mn-Fe-K
5. Zn-Mn-Fe-K-Na
6. Mn-Fe
7. Fe-K
8. K-Na

Përcaktimi i ndikimit antropogjen me normalizimin me sfondin.

Normalizimi i përmbajtjeve mesatare të elementëve me sfondin gjeokimik natyror, në Zonën bregdetare Kanali i Hoxharës - Porti i vjetër Vlorë.

Normalizimi i përmbajtjeve mesatare i ndikimit në mjedis është bërë sipas vlerave të raportit të përmbajtjeve **mesatare të elementëve kimikë** të provave të radhës (në thellësinë 10-15cm), me sfondin gjeokimik natyror përkatës.



Normalizimi i përmbajtjeve mesatare të elementëve me S.Gj.N, në zonën bregdetare Kanali Hoxharës - Porti i vjetër Vlorë.

Nga grafiku më sipër shohim që elementët Ca, Mn, Cr, Pb, Cd, pH dhe S, kanë vlera që luhaten nga 1.1 deri në 3 herë mbi sfondin gjeokimik natyror, ndërsa elementët e tjerë janë me vlera poshtë sfondit gjeokimik.

Vlerësimi i riskut

Vlerësimi i riskut është paraqitur duke u bazuar në vlerat e llogaritura të raportit të përmbajtjeve mesatare të elementëve të analizuar, me normat e lejuara përkatëse si dhe në vlerat e raportit të përmbajtjeve të këtyre elementëve për secilën provë, me normat e lejuara përkatëse, bazuar në listë Holandën, (Holand liste-2014), të ndërtuara me anë të programit Surfer, duke paraqitur të dhënat e marra për SRC_{njërëz} dhe duke i përshkruar elementët Cr, Ni, Co, Cu, Zn etj, në trajtë grafike.

Elementët	SRC njerëz	SRC eco	SRC integr.
As	576	85	85
Ba	934	890	890
C	28	13	13
Cr total	-	220	220
Cr i tretshëm	276	220	220
Cr+6	78	220	78
Co	43	180	43
Cu	86	96	96
Hg	210	-	-
Hg inorganik	210	36	36
Hg organik	-	4	-
Pb	622	58	58
Mo	131	190	190
Ni	147	140	140
Zn	461	350	350

Vlerat e normave të përmbajtjeve të elementëve në Toka, sipas Lijzen JPA

Vlerësimi i riskut është bërë bazuar në krahasimin e përmbajtjeve mesatare të elementëve të metaleve të rënda Ni, Co, Cr, Cu, Pb, Zn me normat e List Holanda (2014). Nga të dhënat e marra në zonën bregdetare Kanali i Hoxharës – Plazhi i vjetër Vlorë, duke i krahasuar me normat e list Holandës vëmë re që elementet **Cr** dhe **Ni** janë më të larta se norma. Elementët Cu, Pb, Zn, Co, janë me vlerë nën norma për elementin **Ni** dhe **Cu** rezultojnë me vlerë pak më të larta se norma dhe **Cr** deri 4 herë mbi normë për SRC_{njërëz}. Këto vlera duke qenë disi në përgjithësi të ulta nuk përbëjnë risk për njerëzit dhe ekosistemin përjashtim bën vetëm **Cr** i cili duhet të monitorohet në vazhdimësi.

Elementët	SRCnjërez	Mesatarja e provave 10-15 cm, Kanali i Hoxharës - Porti i vjetër Vlorë	Vlera mbi normë SRC njërez
Ni	147	187.6	1.2
Co	43	14	0.3
Cr	276	1127.8	4
Cu	86	115	1.3
Zn	461	52.1	0.1
Pb	622	16.3	0.03

Tabela 1. Ndryshimet në profilet e monitorimit në degët e lumit Erzen. Vlerat e mesatare të provave gjeokimike të marra në thellësinë 10-15 cm krahasuar me list Holand (2014), për SRC njërez¹

Vlerësimi i gjendjes

Nga të dhënat statistikore rezultojnë se faktori gjeokimik i llogaritur në zonën bregdetare është me origjinë gjeogjore (natyrore). Kemi krijuar bashkëshoqërime të reja gjeokimike ndërmjet elementeve të analizuar.

Nga llogaritjet e të dhënave statistikore të përmbajtjeve mesatare të elementeve kimike në toka në thellësinë 10-15 cm për zonën bregdetare Kanali i Hoxharës - Porti i vjetër Vlorë duke i krahasuar me përmbajtjet mesatare të sfondit gjeokimik natyror rezultojnë se përmbajtjet mesatare të elementeve kimik janë të ulta, përjashtim bëjnë elementët e **Ca** (1.9), **Cr** (1.7) **Pb** (3) dhe **S** (2.9) herë, mbi Sfondin gjeokimik natyror.

Duke i krahasuar përmbajtjet mesatare të elementeve kimik në toka në thellësinë deri në 15 cm për zonën në studim me normat e List Holand për SRC njërez rezultojnë se në zonën bregdetare Kanali i Hoxharës - Porti i vjetër Vlorë, përmbajtjet mesatare të elementeve kimik sipas SRC njërez janë nën norma, përjashtim bëjnë elementët e **Ni** (1.2), **Cu** (1.3) dhe **Cr** (4) herë mbi normë. Elementi i Kromit (**Cr**) është në nivele të larta duke shkaktuar ndotje të vijës bregdetare, prandaj duhet monitoruar në vazhdimësi. Ndikimi i këtyre elementeve në mjedis në përgjithësi është i

papërfillshëm.

Ndër faktorët kryesorë mendojmë se është influenca e ndikimit të përhershëm në këtë zonë, e prurjeve të lumit Vjosë si dhe të Kanalit të Hoxharës. Ndikimi i mikrorelievit gjatë vijës bregor bën të mundur përqëndrimet e metaleve të rëndë në pjesët negative të tij, nga aftësia e këtyre elementeve për të migruar së bashku Mbrotjtja e mjedisit dhe e ruajtjes së pastërtisë së rërës të plazhit shërben për të mbrojtur ekosistemet nga ndotjet e ndryshme.

7.2.3 Gjendja e shtretërve të lumenjve Erzen dhe Ishëm

Lumenjtë Ishmi dhe Erzeni, janë nga lumenjtë më të prekur nga presionet e jashme që vijnë nga aktiviteti i njerëzor, ku shkaku më kryesor, është shfrytëzimi i inerteve lumore. Reagimet e rrjedhës nën efektet e këtyre presioneve varen gjithashtu nga aftësia e sistemit lumor (shtrat + rrjedhë ujore) për t'a përballuar atë. Karakteristikat fizike dhe gjeomorfologjike të secilit shtrat, determinojnë edhe shkallën e ndryshimeve dhe modifikimeve që vijnë pas. Kjo ka shkaktuar vazhdimësi të procesit të erozionit duke rrezikuar seriozisht edhe vepra të rëndësishme me interes publik. Gjatë vitit 2021, janë evidentuar të gjitha proceset gjeologjike kryesisht të karakterit eroziv që

kanë ndodhur në shtratin e lumit të Ishmit dhe Erzenit .

- **Lumi i Erzenit.**

Në këtë lumë kemi aktivë 6 profile monitorimi.

Profili i Dobreshit, Fortuzajt dhe Pezë Helmësit janë të tipit eroziv, ndërsa profilet në Pëllumbas, Bërzhitë dhe Ndroq rezultojnë në gjëndje të qëndrueshme ekulibri me tendenca shumë të lehta akumulimi.

Nr	Lumi	Vendi i profilit	Periudha e monitorimit	Ndeshimi total	Ndryshimet për periudhën 2018-2021
1	Erzeni	Pëllumbas	2017-2021	+ 1.5 cm	+ 3.0 cm
2		Bërzhitë	2005-2021	+ 56.3 cm	+ 3.9 cm
3		Dobresh	2004-2021	- 171.9 cm	- 44.2 cm
4		Fortuzaj	2009-2021	+ 19.1 cm	- 8.3 cm
5		Pezë-Helmës	2005-2021	- 29.6 cm	- 10.6 cm
6		Ndroq	2009-2021	+ 26.3 cm	+ 2.3 cm
7		Jubë	2015-2016	- 2.3 cm	Ska matje

➤ **Evidentimi i fenomeneve të pranishme në shtratin e lumit Erzen**



Foto1. Ulje e re e shtratin në në Ibë dhe erozion anësor . Foto 2. Dalje e rrënjësorëve në shtrat të lumit, Dobresh



Foto 3. Erozion anësor në Dobresh. lumit, Pezë Helmës.



Foto 4. Dalje e rrënjësorëve në shtrat të

Problematikat e shtratit të lumit Erzen, 2018-2021

- ❖ Ulje intensive e shtratit në pjesë të caktuara të tij për shkak të erozionit fundor si rezultat i tentativës së rrjedhës për të rishpërndarë materialin e mbetur në shtrat apo atë pak që vjen nga përroi i Murdharit. Më e theksuar vërehet në Dobresh dhe më pak në Pezë Helmës (fotot 1, 2, 3 dhe 4).
- ❖ Erozion anësor i terracës së shtratit dhe tokës bujqësore kryesisht në rrjedhën e mesme dhe të sipërme (fotot 1, 3).
- ❖ Pjesë të konsiderueshme të shtratit të lumit Erzen kanë ruajtur një gjëndje ekuilibri për disa vite duke pasqyruar dhe ruajtur ende pasojat e shfrytëzimit dhe pamundësisë së rigjenerimit të tij (tabela 1).
- ❖ Prishje dhe rrezikime të objekteve inxhinjerieke, si ura, vepra mbrojtëse në brigje dhe në shtrat, vepra të marrjes së ujit (të gjitha veprat e marrjes janë

jashtë funksioni, përveçse asaj në Ndroq), ndërtime civile, etj.

- ❖ Ulje e nivelit të ujërat nëntokësore në një pjesë të pellgut ujëmbajtës të Tiranës pranë zonës së ndikimit të lumit Erzen dhe dalje e një pjese të madhe të puseve të ujit për përdorime të ndryshme jashtë funksionit.
- ❖ Kënetizimi i shtratit në zona të caktuara (foto 4).
- ❖ Degradim dhe shkatërrim i strukturës së kanalit të rrjedhës thujse në të gjithë gjatësinë e tij nga Pëllumbasi e deri në afërsi të Rromanatit (fotot 2 dhe 4).
- ❖ Ndotje masive inerte dhe urbane në shtrat dhe pranë tij, ndotje baktoreologjike e ujrave, ndotje estetike, shkatërrim i pejsazhit lumor dhe bimësisë së shtratit, shkatërrim i faunës ujore, etj.
- ❖ Zvogëlim i aftësisë përcjellëse të kanalit lumor në rrjedhën e poshtme të Erzenit dhe pranë grykëderdhjes për pasojë rritje e frekuencës së përmytjeve.

• Lumi i Ishmit

Në këtë lum janë vendosur 7 profile monitorimi, tre në lumin e Tërkuzës, tre në lumin e Zezës dhe një në Ishëm. Në Çerkezë-Zgafnore dhe Çerkezë-Morinë kemi ulje të shtratit ndërsa në Zall Herr, Kurcaj, Verjan dhe Zezë vërehet akumulim i sedimenteve. Në profilin e Verjanit vërehet gjëndje ekuilibri për këtë periudhë

Tabela 2. Ndryshimet në profilet e monitorimit në degët e lumit Ishëm.

Nr	Lumi	Vendi i profilit	Periudha e monitorimit	Ndryshimi total	Ndryshimet për periudhën 2018-2021
1	Ishmi	Zall Herr	2004-2021	- 563.7 cm	+ 10.8 cm
2		Çerkezë-Zgafnor	2007-2021	- 10.8 cm	- 9.1 cm
3		Çerkezë-Morinë	2004-2021	- 82.6 cm	- 21.6 cm
4		Kurcaj	2004-2021	- 38.5 cm	+ 18.1 cm
5		Verjan	2004-2021	- 294.3 cm	- 2.6 cm
6		Zezë	2015-2021	- 176.5 cm	+ 16.1 cm
7		Bilaj	2015-2016	+ 0.5 cm	Ska matje

Krahas ndikimit direkt të heqjes së inerteve, është veprimtaria natyrore e rrjedhës ujore ajo që, duke synuar rishpërndarjen e materialit të mbetur në shtratin e lumit, ka intensifikuar diku erozionin dhe diku tjetër e ka zbutur atë. Diga e Bovillës ka hequr mundësinë e rehabilitimit të shtratit të Tërkuzës për shkak të ndërprerjes së prurjeve të inerteve.

Evidentimi i fenomeneve të pranishme në shtratin e lumit të Ishmit.

Fenomene të erozionit anësor.



Foto 1. Likmetaj.



Foto 2. Pranë fshatit Zezë.

Fenomene të erozionit thellësinor.



Foto 3. Pranë fshatit Bilaj.



Foto 4. Pranë fshatit Verjan.

Erozion në të dy drejtimet



Foto 5. Pranë fshatit Verjan.




Foto 6. Pranë fshatit Pinar

Zona të shtratit nën shfrytëzim

Foto 7. Çerkezë.



Foto 8. Çerkezë, Morin

Rrëshqitje të brigjeve të lumit.

Foto 9 dhe 10. Likmetaj

**Objekte të dëmtuara apo të rrezikuara në shtrat të lumit**

Foto 11. Vepër shuarje, Arameras.



Foto 12. Ura e Fshatit Zezë

Prita të shkatërruara


Kënetëzime të shtratit



Foto 13. Çerkezë

Problematikat e shtratit të lumit Ishëm, 2018-2021

- ❖ Vijimësi e shfrytëzimit të inerteve, për pasojë ulje e shtratit në zona të caktuara për shkak të fuqizimit të erozionit fundor në të dy degët e lumit.
- ❖ Erozion i terracës së shtratit dhe tokës bujqësore thuajse në të gjithë gjatësinë e shtratit.
- ❖ Dinamikë migruese e kanalit të rrjedhës në pjesën e poshtme të saj. Shembje e brigjeve.
- ❖ Objekte inxhinierike të dëmtuara dhe të tjera nën rrezik potencial.
- ❖ Ndotje e shtratit, terracës së shtratit, ujërave rrjedhëse dhe vijës bregore.
- ❖ Ulje e nivelit të ujërave nëntokësore në një pjesë të pellgut të Tiranës pranë ndikimit të lumit të Ishmit dhe dalje jashtë funksionit e një pjese të madhe të puseve të ujit për përdorime të ndryshme.
- ❖ Kënetizimi i shtratit në zona të caktuara.
- ❖ Frekuencë në rritje e përmbytjeve në rrjedhën e poshtme dhe në pjesë të caktuara të rrjedhës së mesme (Fushë Krujë, Arameras).
- ❖ Hedhje e mbeturinave inerte dhe urbane në shtretërit dhe brigjet e degëve të Ishmit .



7.3 Forcat shtytëse, presioni, gjendja , ndikimi, reagimi

7.4 Kuadri ligjor

- Ligji nr.8752, date 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës"
- Ligj nr.9244, date 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore"i përditësuar.
- Ligjin nr. 69/2013, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore"
- Ligjin nr. 131/2014 "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar.
- Ligj nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"
- VKM Nr. 709, datë 29.10.2014 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020"

7.5 Rekomandime

Vlerësimi gjeokimik në zonën Kanali i Hoxharës-Porti i Vlorës

- Të sensibilizohen organet vendimmarrëse nëpërmjet dërgimit të rezultateve të studimeve të kryera për dinamikën e hapësirës bregdetare Shqiptare për ti shërbyer menaxhimit të integruar të kësaj hapësire duke ndihmuar strukturat përkatëse të administratës shtetërore për të hartuar masterplane zhvillimore të sektorëve jetik sipas standarteve të BE dhe në përshtatje me kushtet e reja mjedisore.
- Në rajone të veçanta të bëhen studime më të thelluara për identifikimin e burimeve ndotëse të mjedisit, për elementet e rende dhe vlerësimin e cilësisë së ujërave me analiza komplekse duke përfshirë dhe elementet biologjike, ndotësve nga nafta dhe herbicidet.

- Ndërgjegjësimin e publikut lidhur me mirëmenaxhimin e **mbetjeve sezonale** në zonën bregdetare.
- Rekomandojmë, të bëhen monitorime të zonave të ndikuara nga ndotja, të paktën çdo pesë vjet, që të bëhen vlerësime të mjedisit dhe të shëndetit të banorëve që jetojnë pranë këtyre zonave.
- Pushteti lokal duhet të investojë që gjatë kohës të sezonin turistik, këto zona bregdetare të pastrohen rregullisht nga mbetjet e ndryshme sezonale.
- Për të zbutur zhvillimet negative të turizmit është e nevojshme marrja e masave për mbrojtjen e detyrueshme të ambientit nga ndotjet natyrore dhe ato humane.
- Rekomandojmë heqjen e çdo lloj mbeturine në zonën bregdetare pranë grykëderdhjes së lumit Vjosë dhe kanalit të Hoxharës, groposjen e tyre në vende të sigurta dhe të studiuara nga ana gjeologjike-mjedisore.
- Përgatitja e politikave mbrojtëse e rehabilituese nga institucionet përgjegjëse, për turizmin, industrinë, bujqësinë, mjedisin dhe shëndetësinë.

Gjendja e shtretërve të lumenjve Erzen dhe Ishëm

Për të ndaluar përkeqësimin e gjëndjes dhe përmirësimin e pjesshëm të saj rekomandohet:

- Të zbatohet Vendimi nr 1 i KKKU i datës 21.06.2006 dhe Vendimi nr.1 dt.13.01.2010 "Për ndalimin e përkohshëm të dhënies së lejeve të reja për shfrytëzimin e zhavorreve në shtretërit e lumenjve". Vërehet shfrytëzim në disa sektorë të shtratit të lumit Ishëm.
- AMBU të përdorë informacionin e marrë nga Shërbimi Gjeologjik për rezultatet e monitorimit në shtretërit e lumenjve për t'i përdoruar ato në hartimin e planeve të menaxhimit të baseneve ujore të Shqipërisë si një nga kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit të dhënë nga BE për morfologjinë

- e shtretërve dhe të trupave ujqorë.
- Të ndërtohen vepra tërthor shtratit për të shuar energjinë e rrjedhës sidomos në kohë vërshimesh me qëllim eliminimin e erozionit të mëtejshëm të brigjeve, rehabilitimin e mundshëm të tij në zonat e dëmtuara, mbrojtjen e urave dhe rrugëve automobilistike.
 - Të rehabilitohet shtrati në zonat problematike me qëllim frenimin e veprimtarisë erozive të rrjedhës, përmirësimin vizual dhe estetik të zonës, natyralizimin e mundshëm të parametrave të rrjedhës dhe promovimin e turizmit lumor në këto zona. Të zbatohen politika promovuese dhe nxitëse në këtë drejtim.
 - Të ndërpritet hedhja e mbeturinave urbane dhe inerte, të eliminohet derdhja e ujrave të zeza në shtrat si dhe të shihet mundësia për pastrimin dhe sistemimin e tyre. Sasitë e inerteve të imta urbane që merren dhe transportohen lehtësisht nga rrjedhat lumore, përbëjnë një potencial të shtuar për mbathjen e shtratit pranë grykëderdhjeve dhe uljen e kapacitetit përcjellës të kanalit ujo

KAPITULLI 8
**AKTIVITETET
INDUSTRIALE**



KAPITULLI 8

AKTIVITETET INDUSTRIALE

8.1.Çështjet që trajtohen

Zhvillimi i aktiviteteve industriale në vendin tonë po vjen në rritje. Industria prodhuese jep një kontribut të rëndësishëm në mirëqenien ekonomike dhe zhvillimin e tij, por nga ana tjetër aktivitetet industriale mund të jenë një burim kryesor i ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës.

Operatorët të cilët janë të pajisur me leje mjedisore për zbatimin e kushteve të vendosura në lejen mjedisore dhe të legjislacionit në fuqi, kanë detyrimin për monitorimin e përputhshmërisë si dhe plotësimin e formularit të deklarimit të të dhënave për shkarkimet dhe për transferimin e ndotësve.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit menaxhon sistemin e informacionit mjedisor me të dhënat e grumbulluara nga operatorët ekonomik të pajisur me leje mjedisore të tipit A dhe B.

8.2. Gjendja dhe tendenca

Gjatë vitit 2022 kemi një rritje të numrit të dorëzimit të raporteve të vetmonitorimit nga Operatorët të cilët janë të pajisur me leje mjedisore. Numri i operatorëve të cilët kanë raportuar **për vitin 2022 është rreth 1813 nga të cilat 61 janë operator të pajisur me Leje Mjedisori Tipi A dhe 1752 operator të pajisur me Leje Mjedisori Tipi B.**

Numri i operatorëve të cilat kanë realizuar vetmonitorimin për lejet e mjedisit të tipit A dhe B të ndara përkatësisht në secilin qark, për vitin 2022 paraqitet si mëposhtë.

Tabela 1. Numri i operatorëve që kanë kryer vetmonitorimin

Qarku	Viti 2022		
	Leje Tipi A	Leje Tipi B	Total
Tiranë	7	489	496
Durrës	11	222	233
Lezhë	5	107	112
Gjirokastrë	1	52	53
Vlorë	2	144	146
Berat	7	88	95
Fier	9	179	188
Kukës	0	45	45
Shkodër	2	97	99
Dibër	1	105	106
Elbasan	13	106	119
Korçë	3	118	121
Totali	61	1752	1813



Grafiku 1. Numri i operatorëve të cilat kanë realizuar vetmonitorimin për lejet e mjedisit të tipit A dhe B të ndara përkatësisht në secilin qark, për vitin 2022.

Numri më i lartë i subjekteve që realizojnë vetmonitorimin për lejet e tipit A dhe B në total është në qarkun Tiranë duke vijuar në qarkun Durrës dhe Fier. Vihet re që në të gjitha qarqet ka një numër shumë më të madh të subjekteve që kanë realizuar vetmonitorimin për lejet e mjedisit të tipit B duke krahasuar me lejet e mjedisit të tipit A.

Tabela 2. Aktivitetet që ushtrojnë operatorët sipas qarqeve

Qarku	Aktivitetet që kryhen
Qarku i Tiranë	Subjekte që operojnë në fushën e industrisë prodhuese si industria minerare, industria kimike dhe ajo hidrokarbure dhe më pak të përmendura janë industria e drurit, industria e peshkut, industria e mishit, industria teknologjike, industria e prodhimit të birrës etj.
Qarku Elbasan	Subjekte që operojnë në fushën e industrisë kimike dhe industrisë metalore dhe më pak në industrinë minerare, industrinë e menaxhimit të mbetjeve dhe industrive të tjera.
Qarku Durrës	Subjekte që operojnë në fushën e industrisë hidrokarbure, industrisë minerare, industrisë metalore, industrisë së lehtë dhe ushqimore. Në qarkun e Durrësit vihen re se operojnë edhe subjekte të tjera që ushtrojnë aktivitetin e tyre në industrinë elektronike, industrinë e pi-jeve dhe ajo e bimëve medicinale, edhe pse të pakta në numër.
Qarku Dibër	Subjekte që operojnë në fushën e industrisë metalore dhe asaj minerare.
Qarku Shkodër	Subjekte që operojnë në fushën e industrisë minerare, industrisë metalore dhe industrise së përpunimit të duhanit.
Qarku Kukë	Subjekte që operojnë në fushën e industrisë minerare dhe industrisë metalore.
Qarku Korçë	Subjekte që operojnë në fushën e industrisë minerare, industrisë hidrokarbure dhe industrise kimike.
Qarku Berat	Subjekte që operojnë në fushën e industrisë minerare dhe industrisë hidrokarbure.
Qarku Gjirokastrë	Subjekte që operojnë në fushën e industrisë minerare dhe industria e përpunimit të drurit.
Qarku Vlorë	Subjekte që operojnë në fushën e industrisë hidrokarbure, industrisë minerare, industrisë metalore dhe industrisë së përpunimit të peshkut.
Qarku Fier	Subjekte që operojnë në fushën e industrisë hidrokarbure, industrisë minerare, industrisë metalore dhe industrisë së përpunimit të peshkut.
Qarku Lezhë	Subjekte që operojnë në fushën e industrisë metalore, industrisë minerare, industria e menaxhimit të mbetjeve, industria hidrokarbure dhe ajo e përpunimit të peshkut.

Mbetjet e Industrisë Kimike (siç janë mbetjet që përmbajnë substanca të rrezikshme) janë më së shumti të theksuara duke qënë se kjo lloj industrie është më e pranishme në qarkun e Elbasanit. Për këto në Raportet e Vetëmonitorimit janë paraqitur sasitë


e shkarkuara; vendgrumbullimi i këtyre mbetjeve, riciklimi, ripërdorimi, trajtimi i mëtejshëm në vendndodhje dhe subjekti i liçensuar ku dorëzohen mbetjet.

Përsa i përket shkarkimeve në ajër vihet re se

pothuajse në të gjitha subjektet është bërë matja e temperaturës, lagështisë, shpejtësia e erës, PM 10 dhe presionit atmosferik për mostrat e ajrit. Në disa subjekte janë matur më shumë parametra (përfshirë CO, CH₄, O₂, SO₂, H₂S, përqëndrimi i nivelit të pluhurit në nivele të ulëta etj). Ndërsa për mostrat ujore pothuajse në të gjitha subjektet kemi matje të vlerave të Nevoja Kimike për Oksigjen, Nevoja Biokimike për Oksigjen, temperaturë, konduktivitet, pH, dhe lendët në pezulli. Në disa subjekte kemi më shumë parametra të matura në mostrat ujore si p.sh: Diferenca e temperaturës, rrjedhja ditore, P-organik, N-amonikal, produkte nafte, fortësia e përgjithshme, As, Cd, Zn, Cr, Pb, Cianid i lire, Cianid total etj.

Referuar raporteve të vetmonitorimit të subjekteve rezulton se nuk kemi tejkalime të vlerave të matura sipas legjislacionit në fuqi.

Përsa i përket tendencës së numrit të operatorëve që kryejnë vetmonitorimin dhe dorëzojnë raportet në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, mund të themi se kemi një tendencë në rritje gjatë viteve 2021- 2022 krahasuar me vitet e mëparshme. Kjo tregon rritjen e përgjegjshmërisë të operatorëve për zbatimin e kushteve të lejes mjedisore nëpërmjet monitorimit të shkarkimeve të tyre në ajër tokë dhe ujë.



Grafiku 2. Numri i raporteve ne 10 vitet e fundit.

Tab. 3 Numri i subjekteve të cilat kanë realizuar vetmonitorimin për lejet e mjedisit A dhe B ne secilin qark, për vitin 2014 – 2022:

Vitet	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Qarku									
Tiranë	49	89	188	145	227	162	232	351	496
Durrës	33	80	165	77	160	119	124	180	233
Lezhë	27	21	53	31	49	35	49	92	112
Gjirokastrë	1	9	14	15	28	13	28	30	53
Vlorë	31	50	68	38	87	63	85	102	146
Berat	15	35	91	58	82	64	60	78	95
Fier	29	75	92	67	107	131	97	124	188
Kukës	3	27	23	23	37	5	19	29	45
Shkodër	8	21	45	43	67	53	60	72	99
Dibër	49	88	41	23	126	68	59	87	106

Elbasan	29	35	29	29	62	35	68	86	119
Korçë	16	36	56	43	68	31	49	83	121
Totali	290	566	865	549	1100	779	930	1314	1813

8.3. Vlerësimi i gjendjes

Nga raportet e vetëmonitorimit të dërguara nga subjektet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për vitin 2022 rezulton se parametrat e matur të përcaktuar në lejen mjedisore të tyre janë brenda normave të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

Më poshtë jepet një vlerësim përsa i përket numrit të raporteve të vetmonitorimit mjedisor të dorëzuar gjatë vitit 2022 nga subjektet duke e krahasuar me vitin 2021.

Shumë keq		e kuqe
Moderuar		e verdhe
Mirë		blu
Shumë mirë		jeshile

Qarku	Rritja në % e raporteve të dorëzuara krahasuar me 2021	Vlerësimi për numrin e raporteve të dorëzuara	Vlerësimi për shkarkimet në ajër, ujë, tokë
Tiranë	41 %		Nuk tejkalojnë normat
Durrës	29.4 %		Nuk tejkalojnë normat
Lezhë	21.7%		Nuk tejkalojnë normat
Gjirokastër	76.6%		Nuk tejkalojnë normat
Vlorë	43%		Nuk tejkalojnë normat
Berat	21.8%		Nuk tejkalojnë normat
Fier	51.6%		Nuk tejkalojnë normat
Kukës	55%		Nuk tejkalojnë normat
Shkodër	37.5%		Nuk tejkalojnë normat
Dibër	22%		Nuk tejkalojnë normat
Elbasan	38.4%		Nuk tejkalojnë normat
Korçë	45.8%		Nuk tejkalojnë normat

Për secilin qark kemi një rritje të dorëzimit të raporteve të vetmonitorimit krahasuar me vitin 2021, gjë e cila tregon rritjen e ndërgjegjësisimit të subjekteve për vetmonitorimin e burimeve të shkarkimit të veprimtarisë së vet duke u bazuar në kushtet e lejeve dhe në afatet kohore të përcaktuara në to. Qarku Gjirokastër ka rritjen më të madhe të dorëzimit të raporteve me 76.6% duke rritur numrin nga 30 në vitin 2021 në 53 në vitin 2022, duke vijuar me qarkun Kukës me 55%, ku kemi rritje të raporteve të vetmonitorimit nga 29 në vitin 2021 në 45 gjatë 2022.

8.4. Kuadri ligjor

- Ligji nr 10 448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit"
- Ligj 60 – 2014 amendim ligji për lejet e mjedisit (Ligjit nr 10 448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit ")
- Ligj nr.10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"
- Lig nr. 52/2020 Për disa ndryshime në ligjin 10 448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar.
- Ligji nr.53/2020 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"
- VKM nr.742 datë 09.09.2016 "Për funksionimin dhe menaxhimin e regjistrit të shkarkimit e të transferimit të ndotësve, miratimin e listës së veprimtarive dhe të ndotësve, që janë subjekt i këtij regjistri, si dhe të formularit të deklarimit të të dhënave për shkarkimet dhe për transferimin e ndotësve nga operatorët"
- VKM 220/2015 (Ecolabel) "Për miratimin e procedurës dhe kriterëve për pajisjen me ekoetiketë.
- VKM 597/2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe kërkesave të hollësishme për lidhjen e marrëveshjeve vullnetare.
- VKM 597 amenduar me VKM 93/ 2018 Marrëveshjet vullnetare.
- VKM 633 – 2015 (EMAS) "Për miratimin e procedurave dhe të kërkesave për dhënien e skemave të ekomenaxhimit dhe auditimit"
- VKM 372 /2016 "Për leje mjedisi tipi A ndërkufitare"
- VKM 372 amenduar me VKM 96 /2018 Per leje mjedisi tipi A ndërkufitare.
- VKM 417/2014 Për tarifat e LM KM.
- VKM 419 /2014 "Për miratimin e kërkesave për shqyrtimin për leje mjedisi"
- VKM 419 amenduar me VKM 97/2018 "Për miratimin e kërkesave për shqyrtimin për leje mjedisi
- Ligj 10440 /2011 Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"
- Ligj 10440 amenduar me ligj 12 – Amendim ligji i VNM.
- VKM 247/2014, për "Përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore (VNM)"
- VKM 598/ 2015 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar"
- VKM 686 /2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (vnm) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisor"
- VKM 686 amenduar me VKM 95 – 2018 Për procedurat e VNM.
- VKM 912/ 2015 "Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis"

9.5. Rekomandime

- Për kompani të mëdha ose të pajisura me Leje Mjedisore të Tipit A, të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i parametrave të ajrit.
- Të gjithë operatorët që bëjnë trajtimin e peshkut si dhe të prodhimet të pijeve alkolike apo produkteve ushqimore të instalojnë impiante të trajtimit të ujërave teknologjike.
- Të merren masa për shkarkimet nga mjetet motorrike.

KAPITULLI 9
**NDIKIMI I MEGATRENDEVE
GLOBALE NE SHQIPERI**



KAPITULLI 9

NDIKIMI I MEGATRENDEVE GLOBALE NË SHQIPËRI

9.1 Çështjet që trajtohen

Sot mbarë bota, po përballlet me sfida mjedisore të shumta dhe mjaft komplekse, pavarësisht masave të marra prej vendeve dhe angazhimit të tyre si në nivel politikash mjedisore ashtu edhe aksioneve konkrete të ndërmara prej tyre. Pasojat dhe implikimet që pritet të shfaqen si rezultat i sfidave mjedisore, me të cilat po përballlet sot njerëzimi, janë të lidhura jo vetëm dhe thjesht me faktorë mjedisorë, por ato janë të ndërvaruara e ndërlidhura edhe me faktorë të zhvillimit ekonomik dhe social. Rrjedhimisht, shfaqet nevoja e një mirëmenaxhimi, që ka të bëjë me faktin se sfidat mjedisore, përballë të cilave gjithë shoqëria ndodhet, do të ekspozohen gjithnjë e më shumë në dekadat që vijnë ndaj të ashtëquajturave 'Megatrende Globale', të cilat janë të lidhura e ndikuara në vetvete nga faktorë shumë kompleks.

Nga këta të fundit mund të përmendim: ndryshimet sociale, ekonomike, mjedisore dhe teknologjike në rritje. Për këtë qëllim, shoqëritë njerëzore dhe qeveritë e vendeve të ndryshme, duhet më së pari t'i njohin dhe pranojnë këto tendenca globale dhe ndikimet që ato shkaktajnë. Si pasojë, domosdoshmërisht lind nevoja të punojnë shumë, për ti menaxhuar dhe zbutur efektet e shkaktuara prej tyre.

Pikërisht për këtë qëllim, kryhen vlerësimet e Megatrendeve globale dhe mënyra sesi, këto të fundit reflektohen dhe ndikojnë në kontekstin rajonal dhe kombëtar. Shtete të ndryshme, gjithmonë e më shumë tentojnë të kryejnë, vlerësimin e Megatrendeve globale në kontekstin kombëtar, duke përfshirë një gamë të gjerë të të ashtëquajturave faktorë nxitës të ndryshimit, të cilët ndërveprojnë gjithnjë e më shumë.

Megatrendet në vetvete, ofrojnë një pikturë të pasur të peisazhit të forcave nxitëse të ndryshimit, që me shumë gjasa, do të ndikojnë secilin vend, në dekadat që do të vijnë, duke sjellë implikime të natyrave të

ndryshme, të identifikuar më parë ose me karakter thellësisht e tërësisht lokal.

9.2 Megatrendet Globale dhe konteksti kombëtar

MTG janë trende botërore afatgjata, të cilat formohen në mënyrë relativisht të ngadaltë, por kanë një efekt madhor, në momentin që ato shfaqen. Ato janë forcat më të mëdha, që mund të afektojnë të ardhmen e të gjithë zonave anë e mbanë botës, në 10-15 vitet e ardhshme. Për më tepër, ato shpesh herë janë shumë qartazi të ndërlidhura edhe me njëra tjetrën.

Shqipëria, si gjithë vendet e tjera të Evropës, apo Ballkanit Perëndimor, edhe pse një vend me sipërfaqe dhe popullsi të vogël e një ekonomi në zhvillim e sipër, krahasuar me vendet e zhvilluara dhe të industrializuara, po përjeton në mënyrë të dukshme, efektet që vijnë nga ndryshimet mjedisore, që kanë përfshirë gjithë planetin. Këto ndryshime, janë të lidhura ngushtësisht edhe me dinamikën e fortë të ndryshimeve ekonomike, të popullsisë, shfaqjen e teknologjive e risive inovative, të cilat kane cuar në rritjen e ndërvarësisë së vendeve mes tyre, si në nivel përjetimi të presioneve mjedisore, ashtu edhe sa i takon zhvillimit të tyre ekonomik dhe shoqëror.

Edhe pse Shqipëria nuk hyn tek vendet, ku këto dinamika janë të spikatura njësoj si vendet e tjera të zhvilluara, duke pasur në këtë mënyrë një kontribut modest, sa i takon pasojave dhe efekteve në mjedisin global, pasojat e ndryshimeve të konstatuara ndihen njësoj dhe konstatohen qartësisht. Në këtë rast, mund të përmendim pasojat e lidhura me ndryshimet klimatike, cilesinë e mjedisit dhe disponueshmërinë e burimeve natyrore, vecanërisht ato që kanë të bëjnë me rezervat ujore dhe përdorimin e tyre, gjendjen e ekosistemeve etj.

Si në teori, ashtu edhe në praktikë, analiza e trendeve dhe megatrendeve globale dhe ndikimi i tyre në mjedisin kombëtar nga ana e vendeve të ndryshme, po praktikohet gjithmonë e më shumë, me qëllimin për të kuptuar më mirë pasojat, që ato sjellin në mjedisin e një vendi.

Studimi i parë në lidhje me MTG, është kryer nga Agjencia Europiane e Mjedisit finalizuar me një analizë të mirë strukturuar në Raportin e Gjendjes në Mjedis 2015 (*The European Environment State and Outlook 2015*), me qëllimin për të dhënë një metodikë, që ofron rritjen e nivelit të të kuptuarit dhe strukturimin më të mirë të njohurive dhe shkallen e ndikimit të MTG në mjediset kombëtare.




Fig. Megatrendet Globale sipas AEM

Agjencia Europiane e Mjedisit, përcakton një listë prej 11 MTG, të cilët konsiderohen mjaft të rëndësishëm, për sa i përket përcaktimit dhe parashikimit të asaj, që pritet të ndodhë në mjedis në një shtrirje periodike afatgjatë dhe sfidat mjedisore, me të cilat do të duhet të përballen vendet si pasojë e këtyre MTG.

MTG mund të përcaktohen si një paketë trendesh, që ndërveprojnë me njëri-tjetrin, në një shkallë të gjerë dhe kanë ndikim të madh, jo vetëm në nivel global, por edhe lokal. Ato përfaqësojnë, ndryshime të ndërvarura sociale, ekonomike, politike, mjedisore dhe teknologjike. Me qëllimin për ti kuptuar më mirë ndikimet dhe implikimet, që ato mund të sjellin në të ardhmen, u ndërmor edhe ky studim, në nivel kombëtar në lidhje me identifikimin e implikimeve të MTG në mjedisin shqiptar, bazuar në metodologjinë e AEM. Qasja e përdorur, është e bazuar

tek studimi i megatrendeve globale në kontekstin kombëtar, duke i vlerësuar ato në kompleksitetin dhe duke nxjerr në pah implikimet që secili prej MTG të përzgjedhur, pritet të ketë në mjedisin shqiptar.

Raporti i përgatitur dhe vlerësimi i kryer u bazua tek dy MTG, të cilët u përzgjedhën për të vlerësuar shkallën e ndikimit dhe implikimeve, që ato pritet të sjellin (disa kanë filluar) në mjedisin shqiptar. Nëpërmjet këtij procesi, ofrohet edhe gjetja e rrugëve për t'u adaptuar, ndaj këtyre trendeve globale edhe nga ana e Shqipërisë. Qeverisja shqiptare dhe shoqëria në përgjithësi, duhet të jetë në gjendje të fillojnë të veprojnë në drejtim të uljes së shkallës së rreziqeve dhe përpjekjeve të shumëanshme, për zbutjen e presioneve mjedisore dhe efekteve të tyre në të ardhmen.

9.3. Implikimet kombëtare të MTG 7

MTG 7: Rritja e konkurrencës globale për burime



Ngrohja globale, pritet të shoqërohet me një rritje domethënëse të nivelit të detit deri në 1 metër dhe deri në 2° C të temperaturave të zonave të larta oqeanike. Reduktimi akujve, shtresave akullnajore dhe deteve të akullt si dhe rritja e frekuencës së eventeve klimatike ekstreme, të tilla si thatësitrat dhe përmytjet, në shumë rajone të botes do të jenë gjithmonë e më shumë prezente. Rritja e pasojave të rënda nga ndryshimet klimatike, parashikohet të sjellë po ashtu edhe pasoja për ekosistemet natyrore, përfshirë humbjet substanciale të biodiversitetit dhe rritjen e ritmeve të zhdukjes së diversitetit natyror.

Bujqësia, është nga përdoruesit kryesorë të ujërave sipërfaqësore, dhe më pak ato

nëntokësore. Ujitja dhe kullimi kanë ndikim të drejtpërdrejt në rritjen e qëndrueshme të prodhimit të kulturave bujqësore, i cili kontribuon me rreth 19% të PBB-së. Hidroenergjinë, për nga volumi i ujit që qarkullon, mbetet përdoruesi më i madh në vend i burimeve ujore. Prodhimi i energjisë elektrike në vend, është i bazuar në prodhimin nga burimet hidrike. Burimet ujore, përdoren edhe në sektorin e industrisë, ku mund të përmendim atë ushqimore, të minierave dhe industrinë e lehtë.

Burimet ujore në Shqipëri, për shkak të përdorimit të tyre për qëllime të ndryshme, janë të ekspozuara ndaj presionit, që aktivitete apo veprimtari të ndryshme, të kontrolluara ose jo, ushtrojnë mbi regjimin hidrologjik, duke shkaktuar përkeqësim të cilësisë së ujit dhe zvogëlim të rezervave të ripërtëritshme.

Nga analiza e bërë në drejtim të identifikimit të implikimeve në nivel kombëtar, të MTG 7 "Rritja e konkurrencës globale për burime" dhe efekteve të pritshme në gjendjen dhe cilësinë e mjedisit në Shqipëri, janë identifikuar implikimet e mëposhtme, të cilësuar si potencialisht më të mundshmet për të ndodhur ose që po ndodhin.

9.3.1. Rritja e ngarkesave në mjedis

Global MegaTrend 7	Implikimi përzgjedhur	Vlerësimi propabilitetit (Lartë/ULët)	Madhësia e efekteve (Lartë/ULët)	Koha kur do shfaqet
Rritje e konkurrencës globale për burime	Rritja e ngarkesave në mjedis	Lartë	Lartë	Afat Mesëm- Afat Gjatë

Rritja e kërkesës për burime natyrore, ujore dhe ekosisteme, është një trend sa global, aq edhe kombëtar. Kjo tendencë, do të cojë pashmangshmërisht në rritjen e presioneve, jo vetëm me ndikime direkt tek to, por njëkohësisht, do të impaktojnë në mënyrë indirekte, gjithë zinxhirin e lidhur me to.

Shqipëria edhe pse një vend i konsideruar

si i pasur me burime ujore dhe ekosisteme natyrore: tetë lumenj dhe tre liqene të mëdhenj të lundrueshëm dhe ndërkuftarë, një numër të madh ligatinash të rëndësishme dhe burime të bollshme ujërash nëntokësore, parashikohet që shumë shpejt, të përballlet me efekte që lidhen, si me mënyrën e menaxhimit dhe përdorimit të burimeve ujore, ashtu edhe me ato që kanë të bëjnë me

9.3.2. Kërcënimet mbi ekosistemet dhe biodiversitetin

Shqipëria është e njohur për shumëllojshmërinë e lartë të ekosistemeve dhe habitateve. Por kjo larmi diversiteti natyror, gjithmonë e më shumë është ekspozuar ndaj rreziqeve të natyrave të ndryshme, të cilat e kanë çenuar atë seriozisht në disa raste. Gjithmonë e më shumë, ato po ekspozohen ndaj faktorëve të lidhur me: zhvillimin industrial, urbanizimin, gjuetinë ilegale, peshkimin, erozionin e tokës, zhvillimin e sektorit energjitik dhe minerar, transportin dhe turizmin, të cilat kanë ndikim në shumëllojshmërinë biologjike në mënyrë të vecantë. Faktorët kryesorë të humbjes së biodiversitetit në Shqipëri, janë më së shumti aktivitetet antropogjene dhe kërkesa në rritje e njeriut për zhvillim, nëpërmjet përdorimit të burimeve natyrore. Shpyllëzimi dhe shkretëtirëzimi i tokës së punueshme, shkatërrimi i livadheve dhe kullotave, kanë pasur një ndikim të madh në ndryshimet e habitateve në të kaluarën e afërt. Ndërtimi i rrugëve, ndryshimet në rrjedhën e ujit, ndërtimi i digave, tubacioneve, ndotja me origjina të ndryshme, zjarret dhe sëmundjet, renditen ndër faktorët me më shumë ndikim. Këtyre ju shtohen edhe faktorë të tjerë të lidhur me ndryshimet klimatike, të cilat kanë çuar në degradim dhe fragmentimit të habitateve në Shqipëri.

Gjuetia është një nga aktivitetet me ndikim të madh në gjendjen e biodiversitetit dhe të përbërësve të tij. Për shkak të faktit që, aktivitetet e paligjshme të gjuetisë për gati dy dekada nuk kanë mundur të kontrollohen në mënyrë efektive, trendet e popullatave të llojeve të egra, objekt gjuetie, sidomos shpendët, pjesa më e madhe e të cilave janë

shpendë shtegtarë, për vite të tëra kanë pësuar rënie (sipas të dhënave të INSTAT). Për këtë qëllim, në vitin 2014 parlamenti shqiptar miratoi ligjin “Për ndalimin e gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”, për një periudhë dy vjeçare, deri në mars të vitit 2016. Kjo shërbeu si masë minimizuese ndaj shqetësimeve për llojet e egra të faunës, të cilat janë të rrezikuara. Pas përfundimit të këtij ndalimi, kontrolli i gjuetisë dhe zbatimi i ligjit mbeti prioritet madhor. *Peshkimi* është një sektor tjetër i rëndësishëm për ekonominë dhe në të njëjtën kohë edhe për biodiversitetin. Peshkimi i paligjshëm dhe mbishfrytëzimi i burimeve të peshkimit, po konsiderohen përherë e më shumë si prioritet. Një vlerësim i besueshëm i aksioneve për mbrojtjen e peshqve duhet të vazhdojë, së bashku me planin e menaxhimit për lloje të peshqve në veçanti. *Pyjet* janë një tjetër sektor me ndikim të madh në biodiversitet. Humbja dhe fragmentimi i habitateve, shkaktuar nga prerjet ilegale dhe/ose mbishfrytëzimi, është elementi kryesor negativ në këtë drejtim. Për të përmirësuar këtë çështje, janë marë masa për ndalimin e eksportit të qymyr - drurit dhe eksportit të lëndëve të para drusore nga Shqipëria.

Praktikat e ndërtimit të paligjshëm në zonat urbane, shpesh për shkak të mungesës së një sistemi të qartë të drejtave të pronësisë dhe varfëria urbane, janë sfida të rëndësishme në shumë zona të vendit. Vendbanimet joformale, duket se kanë pasur ndikim të madh dhe të menjëhershëm në mjedis, më shumë edhe se ndikimet e tjera. Mbetet ende sfida dhe e vështirë, menaxhimi i mbetjeve, që prodhohen nga vendbanimet joformale. Është gjithashtu e vështirë reduktimi dhe menaxhimi i materialeve natyrore, të cilat

Global Mega Trend 7	Implikimi përgjedhur	Vlerësimi propabilitetit (Lartë/ULët)	Madhësia e efekteve (Lartë/ULët)	Koha kur do shfaqet
Rritje e konkurrencës globale për burime	Kërcënimet mbi ekosistemet dhe biodiversitetin	Lartë	Lartë	Afat Shkurtër- Afat Mesëm

në disa raste mund të çojnë në humbjen e biodiversitetit në një zonë. Përveç kësaj, vendbanimet joformale dytësore shpesh nënkuptojnë zgjerimin e pa planifikuar të zonës urbane në tokë të punueshme, të vlefshme për mjedisin. Shqipëria vijon të jetë nën kërcënim, për shkak të praktikave të papërshtatshme zhvillimore, që lidhen me *sektorin turistik* (masiv më së shumti). Njëkohësisht, sforcimi apo përdorimi tej mase i burimeve ujore në dispozicion, rritja e sasisë së mbeturinave dhe shkarkimi i ndotjeve në det, përbëjnë një problem të shtuar sa mjedisor aq edhe social-kulturor. Ndërtimi i lidhur me zhvillimin e turizmit, ka shkaktuar gjithashtu dëme të mëdha edhe në ekosistemet e brishta bregdetare dhe detare në vend.

Vëmendje e veçantë sot në Shqipëri, duhet t'i kushtohet rreziqeve potenciale për biodiversitetin, që vijnë nga *zhvillimi dhe përdorimi i teknologjive të reja*, proceseve dhe produkteve të tyre si dhe ndikimeve potencialisht negative të përdorimit të OMGJ-ve në bujqësi, pylltari dhe peshkim. *Ndryshimi i klimës*, është një faktor shtesë, që mund të shkaktojë zhdukjen e llojeve të rrezikuara me një ndikim të madh në mjedisin tonë. Ndryshimet në modelet e vegjetacionit, humbja e burimeve biologjike, rritja e papritur e llojeve të huaja dhe ndryshimet në burimet e peshkut, janë disa nga sfidat më të mëdha me të cilat po përballet globi, përfshirë edhe Shqipërinë. Përveç kësaj, ndryshimi i klimës pritet të rrisë dukshëm edhe ndikimin e specieve të huaja invasive.

9.3.3 Rritja e sasisë së ujërave të ndotura

Tendencat e vazhdueshme të lëvizjes së popullsisë në Shqipëri, nga zonat rurale drejt atyre urbane, kanë çuar në rritjen e presioneve të gjithanshme, veçanërisht ato të lidhura me kërkesën për ujë dhe shërbimet që lidhen më të. Kjo ka afektuar direkt ekosistemet ujore, për shkak të rritjes së konsumit për burime ujore, si nga popullsia (në rritje), ashtu edhe nga degë të ndryshme të ekonomisë, duke çuar kështu në gjenerimin gjithmonë e më shumë të sasisë së ujërave të ndotur. Mungesa e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura industriale, në pjesën më

të madhe të fabrikave/objekteve industriale dhe në shumë raste mungesa e sistemeve të kanalizimit për ujin e ndotur, shoqërohet me shkarkim të drejtpërdrejtë të ndotjes në trupat ujore sipërfaqësor, dhe rrjedhimish rrit presionet tek ekosistemet (ujore dhe tokësore të këtyre trupave) dhe dëmtim të mjedisit. Këto ndotje, ndikojnë edhe në shtimin e presioneve ekzistuese tek trupat ujore, duke destabilizuar ekosistemet ujore dhe humbjen e habitateve akuatike dhe specieve ujore, të cilat sa më endemike të jenë, aq më të ndjeshme bëhen. Në pjesën dërrmuese të rasteve, ato krijojnë kushte për praninë dhe jetesën komode të organizmave të dëmshëm/intruz.

Të dhënat e publikuara në Raportet Vjetore të Gjendjes në Mjedis për Shqipërinë, të bazuara në monitorimin e treguesve mjedisorë të cilësisë së ujërave, tregojnë se në dy dekadat e fundit, cilësia e burimeve ujore është përkeqësuar. Kjo si rezultat jo vetëm i shfrytëzimit pa kriter të burimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore, por edhe menaxhimit jo të mirë në përgjithësi të shkarkimeve nga aktivitetet urbane dhe industriale/bujqësore të ndotjeve. Problem serioz mbetet ndotja e ujërave sipërfaqësore (lumenj kryesisht) dhe disa pika shkarkimi të ujërave bregdetarë larës, si rezultat i shkarkimit të ujërave të ndotura urbane dhe industriale të patrajtuara. Lumi Ishëm dhe Gjanicë, rezultojnë të jenë më të ndotur në këtë drejtim.

Investimet në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura vitet e fundit dhe ndërhyrjet në infrastrukturën e kanalizimeve dhe shërbimeve të tjera në dobi të popullatës, kanë sjellë përmirësime të dukshme në cilësinë e ujërave larës, duke ulur ndjeshëm ndotjen e tyre. Aktualisht janë ndërtuar nëntë (9) impiante të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, përgjithësisht në zonën bregdetare, nga të cilët tetë (8) janë funksionale. Investimet në infrastrukturën e nevojshme dhe vëmendja e shtuar e politikëbërësve ndaj kësaj çështje, ka bërë që projeksionet në lidhje me të ardhmen të jenë positive, duke shpresuar që në periudhën 2025- 2030 dhe 2030- 2050 ndoshta problemi i gjenerimit të ujërave të ndotura urbane të zgjidhet.

Global MegaTrend 7	Implikimi përzgjedhur	Vlerësimi propabilitetit (Lartë/ULët)	Madhësia e efekteve (Lartë/ULët)	Koha kur do shfaqet
Rritje e konkurrencës globale për burime	Rritja e sasisë së ujërave të ndotura	Lartë	Lartë	Afat Shkurtër- Afat Mesëm

Sektori i bujqësisë njihet si ndotësi më i madh i burimeve ujore, e megjithatë ende nuk ka të dhëna apo vlerësime lidhur me shkallën e ndotjes, që shkaktohet nga përdorimi i pakontrolluar i pesticideve dhe kimikateve në prodhimin bujqësor.

9.3.4 Konfliktet mes përdoruesve të ujit

Burimet ujore në Shqipëri janë të shumëllojshme dhe përdoren për qëllime të ndryshme. Si të tilla, ato janë të ekspozuara ndaj presionit, që aktivitete apo veprimtari të ndryshme, të kontrolluara ose jo, ushtrojnë mbi regjimin hidrologjik duke shkaktuar përkeqësim të cilësisë së ujit dhe zvogëlim të rezervave të ripërtëritshme. Larmia e përdorimit të tyre dhe rritja e numrit të përdoruesve, për qëllime të ndryshme: nevoja të popullsisë, ekonomisë, bujqësi dhe industri, turizmit etj, pritet të sjellë presion gjithmonë e më shumë tek to. **Kjo**

situatë, nëse nuk menaxhohet siç duhet me ligje dhe akte nënligjore të qarta dhe të integruara, në lidhje me prioritizimin e përdoruesve të burimeve ujore dhe sasisë së lejuar të konsumit dhe shfrytëzimit të tyre, rrezikon të çojë në konflikte mes përdoruesve të burimeve ujore.

Konfliktet mund të përshkallëzohen edhe nga presione të tjera të tipit: rritja e nivelit të ndotjeve, sezonaliteti i prurjeve për shkak të efekteve të ndryshimeve klimatike, dhënia e lejeve të shfrytëzimit të burimeve ujore pa një strategji të qartë, që të marrë në konsideratë gjithë faktorët natyrorë dhe njerëzore etj. Ka një ndjeshmëri dhe konflikt të qartë, mes komuniteteve lokale dhe investitorëve sa i takon çështjes së ndërtimit të HEC-ve, për shkak të ndikimit që ato kanë në rrjedhën e trupit ujqor (qoftë kur e devijojnë ose e ndërpresin atë nëpërmjet digave).

Global MegaTrend 7	Implikimi përzgjedhur	Vlerësimi propabilitetit (Lartë/ULët)	Madhësia e efekteve (Lartë/ULët)	Koha kur do shfaqet
Rritje e konkurrencës globale për burime	Konfliktet mes përdoruesve të ujit	Lartë	Lartë	Afat Shkurtër- Afat Mesëm Po ndodh...

Gjithashtu, të shumta janë konfliktet/pakënaqësitë mes përdoruesve të burimeve ujore, në rastin kur ndërtohen fabrika/objekte industriale pranë trupave ujore, pasi midis banorëve të qendrave të banuara pranë, e që përdorin trupin ujqor, gjithmonë ekziston pasiguria edhe për cilësinë e ujërave të ndotur, që do shkarkohet në rastin, kur ky trup ujqor përdoret si trup ujqor pritës.

Së fundmi, sistemet e furnizimit me ujë të popullsisë, ujësjellësit, janë një tjetër subjekt shfrytëzimi i burimeve ujore, që i shtohen listës së përdoruesve, që konkurojnë për ato burime ujore. Problem është fakti që, mungesa e vlerësimeve në lidhje me parashikimet për kapacitetet shfrytëzuese të burimeve ujore, çon në dhënie të lejeve të shfrytëzimit të pabazuar në të dhëna

dhe qorrazi të lëshuara, duke vënë në rrezik disponueshmërinë e tyre në të ardhmen. Menaxhimi i fragmentuar ka sjellë edhe një mungesë llogaridhënie dhe mbivendosje kompetencash, e në disa raste të tjera mungesë të monitorimit të zbatueshmërisë së legjislacionit përkatës. Në praktikën e përditshme, të zbatimit të detyrave sipas fushës së përgjegjësive, institucionet hasin vështirësi në përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësive, veçanërisht kjo e spikatur për sektorin e ujërave.

9.3.5 Prishja e balancave ujore dhe ekosistemeve tokësore/ujore

Shqipëria, si shumë vende që tentojnë të rrisin nivelin e tyre ekonomik dhe social, manifeston një tendencë të qartë të shfrytëzimit të burimeve të saj natyrore, përfshirë këtu burimet ujore dhe ato të lidhura me ekosistemet. Rjedhimisht, kjo ka çuar edhe në rritjen e presioneve ndaj këtyre burimeve dhe në shumë raste, demtimin apo mbishfrytëzimin si rezultat i keq menaxhimit

Global MegaTrend 7	Implikimi përzgjedhur	Vlerësimi propabilitetit (Lartë/Ulët)	Madhësia e efekteve (Lartë/Ulët)	Koha kur do shfaqet
Rritje e konkurrencës globale për burime	Prishja e balancave ujore dhe ekosistemeve tokësore/ujore	Lartë	Lartë-Ulët	Afat Shkurtër- Afat Mesëm Po ndodh...

dhe përdorimit pa kriter e të pabazuar në studime shkencore dhe vlerësim të dhenash të pa integruara. Në Shqipëri, rreth 80% e ujit të pijshëm në vend sigurohet nga përdorimi i burimeve ujore nëntokësore.

Ndërkohë, që ka një tendencë në rritje të kërkesës, për shërbime që lidhen me ujin për shkak edhe të lëvizjeve të popullsisë dhe shkallën e lartë të përqendrimit të tyre në disa zona të caktuara të vendit (urbane, zonat turistike etj. Ky fenomen, ka çuar në ndërhyrjet e paautorizuara në infrastrukturën përkatëse. Informaliteti në rritje, shkakton demtim të rëndë të akuifereve, për shkak të mungesës së kontrolleve dhe dijenisë, në lidhje me gjendjen e tyre fizike, kimike, sasiore, gjeomorfologjike etj. Kjo gjë rrit presionet, magnituda e të cilave varet nga kapaciteti mbajtës i tyre, sasisa e ujërave të ekstraktuara, sezonalizeteti, prania dhe dendësia e pus- shpimeve etj.

Këto situata çojnë edhe në rritjen e presioneve për ujërat sipërfaqësore, për shkak të natyrës së tyre dinamike dhe lidhjes së trupave ujore sipërfaqësore me ato nëntokësore, duke shkaktuar demtimin serioz të funksionimit normal të ekosistemeve ujore dhe tokësore, që ushqehen prej tyre. Prishja e balancave

ujore, për shkak të informalitetit, ka çuar edhe në prishjen e sistemit të tarifimit të ujit në Shqipëri. *Bujqësia*, është nga përdoruesit kryesorë të ujit, duke përdorur kryesisht ujërat sipërfaqësore (më shumë se gjysma e nevojës për ujë), dhe më pak ato nëntokësore dhe rezervuaret artificiale (560ml.m3/ 626 rezervuare). Në të ardhmen, ky sektor është i kërcënuar përsa i përket sigurimit të sasisë së nevojshme të ujit. Kjo, si pasojë e tendencës në rritje të zhvillimit të sektorit, reduktimit të kapacitetit akumulues të rezervuarëve nga mbushja me aluvione, rritjes së normës së avullimit dhe uljes së sasisë vjetore të rreshjeve si pasojë e ndryshimeve klimatike. Hidroenergjinë, për nga volumi i ujit që qarkullon, mbetet përdoruesi më i madh në vend i burimeve ujore.

Burimet ujore përdoren edhe në sektorin e industrisë ku mund të përmendim atë ushqimore, të minierave dhe industrinë e lehtë. Shfrytëzimi i gjerë i burimeve ujore në Shqipëri për qëllim *prodhimin e energjisë*, duke shfrytëzuar ujërat e lumenjve, përbën një rrezik serioz për depozitat ujore lumore dhe mjedisin përreth tyre. Ato prishin ekuilibrat ekologjike dhe cenojnë rëndë, ekosistemet ujore dhe tokësore rreth tyre.

9.3.6 Rritja e aktivitetit ndërtues dhe efektet e tij në shfrytëzimin pa kriter të inerteve nga

Lumenjtë

Rritja e veprimtarisë të industrisë së ndërtimit, ka rritur ndjeshëm edhe kërkesën për lëndë të para, veçanërisht problematike për vendin, inertet që merren nga shtretërit e lumenjve (zhallishte/gurët e lumenjve), për shkak të performancës së lartë si material ndërtimi, eficaçës dhe kostos së volitshme. Këto përbëjnë, lëndët e para më atraktive të

sektorit të ndërtimit. Për të ekstraktuar dhe përdorur këto inerte, subjekteve të ndërtimit ju duhet të ndërhyjnë në shtretërit e lumenjve, veprimtari që ka kosto të larta mjedisore dhe kur bëhet në mënyre të paligjshme, sjell edhe dëme të pakthyeshme në mjedis dhe ekosistemet ujore dhe tokësore të lumit , ku ndërhyhet dhe në dëmtimin e parametrave cilësor, sasior dhe ekologjik të trupave ujor.

Si presion i shtuar dhe nder më të dëmshmit në trupin ujor, nxerrja e inerteve nga shtretërit e lumenjve, në kundërshtim me normat dhe

Global Mega Trend 7	Implikimi përzgjedhur	Vlerësimi propabilitetit (Lartë/Ulët)	Madhësia e efekteve (Lartë/Ulët)	Koha kur do shfaqet
Rritje e konkurrencës globale për burime	Rritja e aktivitetit ndërtues dhe efektet e tij në shfrytëzimin pa kriter të inerteve nga lumenjtë	Lartë (veçanërisht aty ku këto aktivitete zhvillohen)	Lartë	Afat Shkurtër- Afat Mesëm

kushtet e shfrytëzimit pritet të ndikojë në disponueshmerinë e trupave ujor, devijimin e rrjedhës normale të tyre, duke sjellë përmbytje dhe dalje nga rrjedha normale dhe dëmtim serioz të ekosistemeve lumore apo tokësore pranë tyre.

Konkretisht, në vendin tonë, i'u lejohet të

marrin inerte nga shtretërit e lumenjve vetëm subjekteve të cilat janë të listuara në "Listën e punimeve publike të ndërtimit të rrugëve që kanë domosdoshmëri shfrytëzimin e interteve", e cila publikohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës.

9.3.7 Konkluzione për MTG 7

- 1- Në Shqipëri e ardhura e burimeve ujore dhe disponueshmëritë që tyre bëhet e paqëndrueshme për shkak të faktorëve të ndryshëm që lidhen me shpërndarjen jo të barabartë të tyre, mungesën e shifrave të sakta në lidhje me sasitë, fakti që 1.3 e burimeve ujore buronjë nga vendet tjime etj.
- 2- Për shkak të ndryshimeve klimatike, efektet e parashikuara tregojnë se deri në vitin 2027, prurjet do të bien nga 4.5% në 20% (Driat, Matit dhe Vjosës (UNFCCC, 2011).
- 3- Rritja e presioneve urbane në përdorimin e burimeve ujore dhe gjendja e ekosistemeve natyrore në lumenjtë me të cilat lidhen domosdoshmëritë e planifikimit dhe mirëmbajtimit të tyre me qëllim përballimin e shkakëve në të ardhmen e afert, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës së trajtimit të ujërave të nxehtë, përmirësimit të cilësorisë të ujërave, trajtimit parësor të tyre në lumenjtë etj.
- 4- Niveli i dëmtimit që të ketë një ngritje të vogël, e cila do të ndikojë në akutitetin e ujërave të fusha nëpërmjet depërimit të ujit të krijuar dhe përmirësimit të deteve lumore dhe ligumave heqëditarë, duke dëmtuar ekosistemat akvatore (Hanka Hartman, 2009).
- 5- Burimet e ujërave nëntokësore, pa pakësimin vëzhguesit e do të vazhdojnë të përdoren për shkak të përdorimit të tyre për qëllime shpërndarje dhe industriale, dhe për shkak se këto skenare mbledhur pranë zonave urbane. Në rrjedhojë, ato janë më shumë të prekshme nga presionet njerëzore.
- 6- Për shkak se ndërtimi i ndërtimit dhe organikë nga mka përfundojnë në të gjitha hasenat ujore, ligumet dhe ligumet do të vazhdojnë të dependojnë dhe do të rritin britshësinë e ekosistemeve ujore dhe tokësore.
- 7- Përdorimi i përbërësve kimike në bujqësi dhe rritja e niveleve të amoniacit, nitrogjenit dhe fosforit të lumenjve ujore, ka rritur britshësinë (vulnerabilitetin) e ekosistemeve. Për këtë, duhet të merret në konsideratë rëndësia e ligumave dhe pejeve si përdorues të ujit, në proceset metalurgjike dhe planifikuese të bazuara në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.
- 8- Konsiderohet me rëndësi konsultatë hartimi i një dokumenti strategjik, për përmirësimin e performancës së sektorit hidroenergjetik dhe balancimi në të njëjtë të përdorimit të burimeve ujore si për qëllime industriale, ashtu edhe bujqësore, duke rritur nivelin ekologjik të burimeve me qëllim shpërndarje dhe ndikimeve në jetën e njerëz, prodhimin bujqësor dhe ekosistemet.

9.4. Implikimet kombëtare të MTG 9

MTG 9: Pasoja në rritje të ndryshimeve klimatike



Shqipëria si vend i pellgut të Mesdheut, konsiderohet i cënueshëm ndaj ndryshimeve klimatike dhe me risqe të larta për tu dëmtuar nga efektet e ndryshimeve klimatike, që përfshijnë njëkohësisht gjithë sektorët kryesorë të ekonomisë: turizmin, bujqësinë, pyllëtarinë, infrastrukturën, energjinë dhe shëndetin publik. Skenarët e ardhshëm klimatikë për Shqipërinë parashikojnë ndryshime në temperatura (rritjen dhe ekstremizimin e tyre), pakësim të precipitimit të rreshjeve dhe reduktim të burimeve ujore dhe tokës së punueshme etj. Zonat më të ndjeshme në Shqipëri ndaj këtyre fenomeneve, janë zonat bregdetare, ndërsa

sektorët më të cënueshëm janë burimet ujore, bujqësia, energjia dhe turizmi. Në veçanti, ndryshimet klimatike pritet të shkaktojnë një rritje të temperaturave me 0.8°C deri në 1.0 °C deri në vitin 2025, dhe nga 1.2 °C deri në 1.8 deri në vitin 2050 dhe nga 2.1 °C deri në 3.6 °C deri në vitin 2100.

Këto ndryshime të klimës, do të ndryshojnë në mënyrë të veçantë burimet ujore dhe lagështinë si dhe do të kenë një ndikim të pafavorshëm mbi bujqësinë, pyjet dhe biodiversitetin. Vlerësohet se ndryshimet e ardhshme të klimës në Shqipëri do të ndikojnë negativisht mbi rrjedhën e lumenjve, të cilët nga ana e tyre do të ndikojnë në kapacitetin gjenerues të hidrocentraleve dhe pasojat e tyre do të shtrihen edhe më gjerë. Për këto arsye, nevojitet studimi i tyre në këndvështrimin perspektiv dhe vlerësimi i implikimeve potenciale apo prezente të këtyre faktorëve në Shqipëri. Pas një analize të tillë identifikuan implikimet e mëposhtme si potencialisht më të mundshmet për tu shfaqur (disa prej tyre aktualisht prezente) në mjedisin shqiptar, si pasojë dhe të lidhura direkt me efektet e ndryshimeve klimatike.

9.4.1 Reduktimi i potencialit hidroenergjitik

Global MegaTrend 9	Implikimi përzgjedhur	Vlerësimi propabilitetit (Lartë/ULtë)	Madhësia e efekteve (Lartë/ULtë)	Koha kur do shfaqet
Pasoja në rritje të ndryshimeve klimatike	Reduktimi i potencialit hidroenergjitik	ULtë- Lartë	Lartë	Afat Mesëm - Afat Gjatë

Furnizimi kryesor i Shqipërisë me energji elektrike sigurohet thuhet se ekskluzivisht nga hidrocentralet. Kapaciteti energjitik i instaluar, në vitin 2015, në Shqipëri ishte 1.895.000MW, i dominuar nga hidrocentralet. Për këtë arsye, burimet ujore të vendit, luajnë rol vendimtar për sektorin e energjisë, duke krijuar kështu një varësi të theksuar ndaj kushteve të klimës dhe pasojat e tyre (p.sh. thatësirat), mund të cojnë në rënie të menjëhershme të prodhimit, sic ndodhi në vitet 2000 dhe 2002 dhe sërisht në vitin 2007. Po ashtu, vërehet edhe

një dukuri tjetër e lidhur me këto ndryshime, sic janë periudhat me reshje të shumta, që cojnë në rritjen e prodhimit të energjisë dhe eksportimin e saj (viti 2010). Mbështetja, pothuajse ekskluzive, për energjinë hidrike dhe furnizimin me energji elektrike, e bën prodhimin vjetor Shqiptar, shumë të varur nga ndryshueshmëria e kushteve hidrologjike.

Sektori energjitik është dukshëm përdoruesi më i madh i burimeve ujore. Edhe pse disponueshmëria e ujit të përgjithshëm

për prodhimin e energjisë, pritet të mbetet e mjaftueshme, duhen marrë masa për të menaxhuar ujin gjatë periudhës së verës, në mënyrë të tillë, që prodhimi i energjisë të mbetet i përshtatshëm, ndërkohë që përdorimet e tjera të ujit mund të rriten paksa. Kjo kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërmjet sektorit energjetik dhe përdoruesve të tjerë të ujit në sektorin e industrisë dhe bujqësisë, ndërkohë që ekosistemet e varura nga uji do të kërkojnë prurje minimale të domosdoshme. Uji i përdorur për prodhimin e energjisë mund të përdoret sërish nga sektori bujqësor nëse ai menaxhohet me efikasitet.

9.4.2 Siguria ushqimore dhe sektori bujqësor

Bujqësia në Shqipëri, vlerësohet si një prej sektorëve më shumë të ndjeshëm ndaj ndryshimeve të klimës. Ai kontribuon me 22.6% në PBB dhe është burim kryesor punësimi për popullsinë rurale të Shqipërisë. Janë të shumta fenomenet negative me impakt, në sektorin bujqësor, të lidhura me ndryshimet klimatike, shoqëruar këto me ndërhyrjet që janë bërë, të cilat kanë çuar në shpyllëzime, duke përsheptuar kështu ritmet e erozionit dhe si rrjedhim rrezikun nga përmbytjet dhe rrëshqitjet e dheut. Nga vlerësimet e bëra sot në Shqipëri, ka disa faktorë stresi dhe rreziqe, të shkaktuara nga efektet e ndryshimeve klimatike, për prodhimin bujqësor dhe sigurinë ushqimore sipas tabelës.

Global MegaTrend 9	Implikimi përzgjedhur	Vlerësimi propabilitetit (Lartë/ULët)	Madhësia e efekteve (Lartë/ULët)	Koha kur do shfaqet
Pasojat në rritje të ndryshimeve klimatike	Siguria ushqimore dhe sektori bujqësor	Lartë	Lartë	Afat Shkurtër- Afat Mesëm

Faktorët stresues dhe rreziqet e lidhura me klimën Prodhimi Bujqësor

Faktorët stresues	Rreziqet
Rritja e temperaturave në dimër dhe verë	Përsheptimi i rendimentit të të korrave dhe ndryshimet në ciklet e prodhimit
	Rritje e rendimentit të disa kulturave dhe reduktim i foregjereve për blegtorinë
Reduktimi i disponueshmërisë ujore gjatë muajve të thatë	Rritje e kripëzimit të tokave dhe shkretëtirizim
	Rritje e mortalitetit dhe reduktim i prodhimtarisë
	Rritje e rrezikut ndaj sëmundjeve dhe parazitëve

Në kushtet aktuale klimatike, bujqësia kërkon një sasi shtesë të ujit në verë duke qenë se vetëm 20% e reshjeve të përgjithshme vjetore (mesatarisht 1,485 mm/vit) bien midis majit dhe tetorit. Defiçitet e ujit, ndërmjet qershorit dhe gushtit, variojnë midis 400 dhe 500 mm, duke e bërë ujitjen të nevojshme për prodhimin efikas të kulturave. Kullimi nga ana tjetër është i rëndësishëm në dimër për të

zbutur përmbytjet, erozionin dhe mbingopjen e tokës me ujë. Prodhimi bujqësor në Shqipëri, veçanërisht i perimeve dhe frutave, është më i ndjeshëm si rrjedhojë e temperaturave më të larta si dhe thatësirave, të cilat mund të krijojnë kërkesë shtesë për ujitje. Nëse nuk merret asnjë masë përshtatëse, kjo mund të çojë në një rënie të prodhimit të kulturave me më shumë se 15%. Një faktor tjetër kritik,

që nxit cënueshmërinë në sektorin bujqësor dhe prodhimin që sigurohet prej tij, është uji i tepërt nga përmbytjet, i cili shkakton dëmtime, duke vonuar ose parandaluar mbjelljet, duke kufizuar rritjen e kulturave ose shkatërruar bimët. Vlerësohet se disponueshmëria e ujit do të jetë më se e mjaftueshme për të përmbushur kërkesën në rritje që parashikohet të vijë si rrjedhojë e rritjes së kërkesës nga bujqësia në vite. Pavarësisht

kësaj, duhet të ndërmerren masa për të ulur cënueshmërinë dhe rritur përshtatjen ndaj bujqësisë. Këto masa lidhen kryesisht me modernizimin e bujqësisë, ujitjes dhe infrastrukturës së kullimit dhe modernizimin institucional të këtyre sistemeve.

9.4.3 Ndryshimet në sasi të ujërave/ekstremet ujore/përmbytje e thatësira

Shtirja në kohë	2027		2050	
	Reshjet	Temperatura	Reshjet	Temperatura
Vjetore	-4 -3%	0.9-1.1°C	-6.9 -5.3%	1.7-2.3°C
Dimër	-1.8 -1.3%	0.7-0.9°C	-3.6 -2.8%	1.5-1.9°C
Pranverë	-1.2 -0.9%	0.7-0.9°C	-2.5 -1.9%	1.4-1.8°C
Verë	-11.5 -8.7%	1.2-1.5°C	-23.2 -17.8%	2.4-3.1°C
Vjeshtë	-3.0 -2.3%	0.8-1.1°C	-6.1 -4.7%	1.7-2.2°C

Ndryshimet klimatike, sipas gjithë studimeve ekzistuese, konkludojnë faktin që Shqipëria ka të ngjarë të ngrohet më shumë sipas skenareve të IPCC-se. Regjimi i shirave në vend, ka karakter stinor ku vetëm 14% e tyre, bien gjatë periudhës qershor-gusht. Muajt më të lagësht, janë tetori dhe dhjetori. Shpërndarja e temperaturës gjatë vitit është gjithashtu sezonale, ku temperaturat gjatë verës janë 20°C më të larta se temperaturat gjatë dimrit. Sipas skenarëve mjedisore të raportuar, në lidhje me ndryshimet klimatike dhe simulimeve të përdorura, rezulton se rritja e pritshme vjetore e temperaturës mund të jetë deri 1.1°C deri në vitin 2027, dhe 1.8°C deri në 2050.

Reshjet, priten të bien me rreth 4% deri në vitin 2027 dhe 6.1% deri në vitin 2050. Ndërkaq, temperatura pritet të rritet gjatë të

gjitha stinëve, siç edhe tregohet në tabelën e mëposhtme (skenarët e reshjeve dhe temperaturës).

Luhatjet e mëdha të sasisë së rreshjeve dhe rritja e temperaturave mesatare në dimër, ulja e sasive të borës dhe zëvendësimi i tyre me shira (shpesh të rrëmbyeshëm), do të rrisë lagështirën e tokës së bashku me erozionin dhe rrëshqitjen e saj. Ekstremitetet në regjimin e reshjeve dhe temperaturave, pritet që të kenë një ndikim të konsiderueshëm dhe direkt në zvogëlimin e burimeve ujore, që në vetvehte do të sjellë ndikime negative të drejtpërdrejta në popullsi dhe ekosisteme. Burimet ujore priten të ulen me 14% deri në vitin 2050, dhe afërsisht deri 6% në vitin 2027. Deri në vitin 2050, rrjedha e mbetur e ujërave sipërfaqësore në verë parashikohet të jetë 2-4 herë më pak se rrjedha aktuale, që

Faktorët stresues dhe rreziqet e lidhura me klimën

Burimet Ujore

Faktorët stresues	Rreziqet
Reduktimi i sasisë së reshjeve dhe kalimi nga bora tek shiu.	Ndryshimet ose uljet në prurjet e lumenjve, veçanërisht në verë
	Ujërat nëntokësore veçanërisht të ndikuara nga rënia e aftësisë filtruese dhe humbja e lagështisë së tokave.
Rritja e frekuencave të thatësirave dhe përmbytjeve	Ndryshimet në rregjimet e rrjedhjes: rënie potenciale në pranverë, rritje në dimër.
	Dëmtimet e infrastrukturës së ujërave nga përmbytjet.

do të thotë rrjedha natyrore hidro-dinamike e ujit, do të jetë në rrezik duke shkaktuar thatësira të mëdha. Lidhur ngushtë me këtë, rrjedhat mjedisore, të cilat nevojiten për të ruajtur shëndetin e ekosistemeve, janë të kërcënuara paralelisht nga efektet e ndryshimeve klimatike dhe zhvillimet social-ekonomike.

Përmbytjet janë një problem i shpeshtë në Shqipëri dhe ndodhin rregullisht (nëntor-mars), kur bien rreth 80% e reshjeve vjetore. Me shkaktimin e dëmeve të konsiderueshme në tokat bujqësore dhe ndërprerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, përmbytjet rrisin rreziqet ndaj shëndetit njerëzor dhe mund të dëmtojnë në mënyrë serioze vepra të ndryshme infrastrukturore. Rritja e nivelit të ujit të detit e parashikuar në bregdet, pritet të jetë 1 deri në 2 cm deri në vitin 2025 dhe 3 deri në 15 cm deri në vitin 2050, duke sjellë përmbytje të zonave nën nivelin e detit. Komunitetet, që jetojnë në këto zona pritet të zhvendosen më në brendësi të vendit. Disa nga plazhet në zona specifike (Shëngjin, Kune-Vain, Tale, Patok, Ishëm) do të ndikohen dhe tokat bujqësore rreth tyre do të jenë përherë më të ekspozuara ndaj përmbytjeve.

Shkalla e përmbytjeve, mund të ndikohet gjithashtu edhe nga ngjarje ekstreme të ujërave të larta bregdetare, rritja e nivelit të detit dhe stuhitë gjithmonë e më frekvente.

Këto ndikime të parashikuara të ndryshimeve klimatike, kërkojnë një kuptim më të mirë dhe njohuri më të thellë, për të qenë të aftë të parashikohen përmbytjet dhe të merren masa efikase ndaj përmbytjeve, në mënyrë që të shmangen ndikime domethënëse mbi shëndetin njerëzor, ekosistemet dhe infrastrukturën e lidhur me to. Si rezultat i ngjarjeve ekstreme, mund të ketë pasoja serioze për infrastrukturën e furnizimit me ujë dhe shërbimeve të higjienës, po ashtu. Ndërkaq, thatësitat dhe temperaturat e larta, do të rrisin kërkesën për ujë të pijshëm, ndërkohë që disponueshmëria e burimeve ujore, me shumë gjasa do të bjerë.

Përmbytjet dhe shirat e dendur mund të dërgojnë pesticidet, plehrat kimikë dhe ndotësit e tjerë tek burimet ujore. Ndërkohë, që elementët ndotës filtrojnë nën tokë, duke rrezikuar akuiferët e cekët, ato dëmtojnë gjithashtu trupat e ujërave sipërfaqësore, që përdoren për ujitje dhe veprimtaritë argëtuese, duke shkaktuar përfundimisht infeksione apo sëmundje. Epidemitë e sëmundjeve me të përhapura përmes ujit, janë të lidhura me thatësitat e ndjekura nga shirat e dendur dhe rritjet e temperaturave, kështu që një vëmendje më e madhe i duhet kushtuar veprimtarive për kontrollin e cilësisë së ujit.

9.4.4 Nevoja për rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme

Global MegaTrend 9	Implikimi përzgjedhur	Vlerësimi propabilitetit (Lartë/ULt)	Madhësia e efekteve (Lartë/ULt)	Koha kur do shfaqet
Pasojat në rritje të ndryshimeve klimatike	Nevojat për rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme	Lartë	Lartë	Afat Mesëm-Afat Gjatë

Prodhimi i energjisë elektrike në Shqipëri, është i bazuar tek burimet hidrike, duke zënë 97% të prodhimit energjistik aktual të brendshëm. Prodhimi nga hidrocentralet publike është 72.1% e prodhimit të brendshëm të përgjithshëm, ndërsa prodhimi i energjisë

nga prodhuesit e pavarur të energjisë përbën rreth 27.9%. Aktualisht, prodhimi i energjisë elektrike në vend, ka njohur luhatje dhe ndryshime të lidhura direkt me sasitë e prurjeve, si rezultat i ndryshimit në regjimin e reshjeve dhe prurjeve. Këto të fundit, më

së shumti janë të lidhura me ndryshimet klimatike dhe efektet e tyre. Një tjetër problem i varësisë së madhe të prodhimit të energjisë në Shqipëri nga burimet hidrike, shoqëruar me sezonalitetin e theksuar dhe ekstremizimin e kushteve të motit, është rritja e varësisë së sektorit, ndaj tregjeve ndërkombëtare të energjisë, për shkak të prodhimit të lartë në muajt e lagësht dhe mungesës së prodhimit në muajt e thatë të vitit.

Për këtë qëllim, Shqipëria, po punon seriozisht në drejtim të kombinimit të politikave të efikasitetit të energjisë dhe energjive të rinovueshme, duke i bërë ato pjesë të një strategjie të tërë për energjinë, bazuar në direktivat e Bashkimit Europian. Aktualisht, *Strategjia Kombëtare e Energjisë (2007-2020) dhe Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës në Republikën e Shqipërisë draft*, kanë të përfshirë jo vetëm strategjinë e zhvillimit të burimeve klasike (fosile), por edhe strategjitë për energjinë e rinovueshme dhe të efikasitetit të energjisë. Përfshirja e tyre në këto dokumenta strategjike, është e shoqëruar dhe me parashikimin e të gjitha hapave që duhet të ndërmerren për aplikimin e tyre. Qëllimi i përfshirjes së të gjitha burimeve energjitike në planifikimin e nevojave për energji, lidhet ngushtë jo vetëm me shfrytëzimin e burimeve alternative, por dhe me objektivat që ka sistemi energjistik shqiptar për zhvillimin e burimeve të pastra të energjisë

9.4.5 Ndikimet në shëndetin e njeriut

Ndryshimet klimatike gjithmonë e më shumë po shqetësojnë shoqëritë njerëzore jo vetëm për pasojat dhe efektet e tyre në mjedis por edhe në shëndetin e njeriut. Ndryshimet në përqendrimit e gazrave serrë dhe ndikues të

tjerë ndryshojnë klimën globale dhe sjellin pasojat të panumërta të shëndetit të njeriut. Pasojat mjedisore të ndryshimeve klimatike, siç janë valët ekstreme të nxehtësisë, ngritja e nivelit të detit, ndryshimet në reshjet që rezultojnë në përmbajtje dhe thatësira, uragane intensive dhe cilësia e degraduar e ajrit, ndikojnë drejtpërdrejtë dhe indirekt shëndetin fizik, social dhe psikologjik të njerëzve. Ndryshimi i klimës mund të jetë një nxitës i migrimit të sëmundjeve, si dhe të përkeqësojë efektet shëndetësore që rezultojnë nga lëshimi i ndotësve toksikë të ajrit në popullata të cenueshme si fëmijët, të moshuarit dhe ata me astmë ose sëmundje kardiovaskulare.

Disa efekte të pafavorshme të shëndetit mund të minimizohen ose shmangen me strategji zbutëse dhe përshtatje. Zvogëlimi i referohet veprimeve që ndërmerren për të reduktuar emetimet e gazrave serrë dhe për të përmirësuar gropat që kapin ose heqin karbonin nga atmosfera. Përshtatja i referohet veprimeve që merren për të zvogëluar ndikimin në shëndetin dhe mjedisin për shkak të ndryshimeve që nuk mund të parandalohen nëpërmjet zbutje. Në kuadër të proceseve adaptuese ndaj ndryshimeve klimatike në fushën e shëndetit dhe cënueshmërisë së tij në Shqipëri, janë kryer disa vlerësime teorike më së shumti dhe kjo për shkak të mungesës së të dhënave të sakta nga sektori i shëndetit publik në lidhje me këto fenomene. Megjithatë këto vlerësime teorike, kanë arritur në përfundimin se shfaqjet e ekstremeve klimatike, cilësia e ajrit dhe sëmundshmëria në rritje janë të lidhura direkt me ndryshimet klimatike dhe efektet e tyre në shëndetin në Shqipëri.

Global Mega Trend 9	Implikimi përzgjedhur	Vlerësimi propabilitetit (Lartë/ULt)	Madhësia e efekteve (Lartë/ULt)	Koha kur do shfaqet
Pasojat në rritje të ndryshimeve klimatike	Ndikimet në shëndetin e njeriut	Lartë	Lartë	Afat Mesëm-Afat Gjatë




Fig. Mënyra sesi ndryshimet klimatike ndikojnë në shëndetin e njeriut

1- Efektet në rritje të ndryshimeve klimatike, edhe në Shqipëri pritet të kenë implikime serioze tek burimet ujore dhe disponueshmëria e tyre. Kjo është ngushtësisht e lidhur me shkallën e lartë dhe përdorimin e gjere të ujit në ekonominë shqiptare (bujqësi, ushqim, industri, energjitiqë, turizëm etj) dhe varësinë e tyre të lartë. Pikërisht për këtë edhe çasja e menaxhimit të implikimeve të pritshme të lidhura me ndryshimet klimatike duhet të jetë sa më gjithëpërfshirëse.

2- Pritshmëritë për rritjen e përdorimit të burimeve ujore për qellime të ndryshme, në vecanti për prodhim energjie, kërkon marjen e masave të duhura në drejtim të menaxhimit dhe përdorimit të tyre, në varësi të sezonalitetit të prurjeve dhe rritjen e bashkëveprimit ndërmjet sektorëve të energjisë me ato të përdoruesve të tjerë të ujit e rakordimin mes tyre.

3- Prodhimi bujqësor dhe siguria ushqimore janë të ekspozuar në një shkallë të konsiderueshme, ndaj faktorëve të lidhur me klimën më së shumti, por edhe njeriun. Ka një tendencë të qarte të prishjes së ekujlibrave prodhues dhe ciklevë të vegjetacionit. Në përgjithësi, prodhimi bujqësor në 20 vitet që vijne, pritet të ulet. Kjo, do të verë në vështirësi serioze jetesën, mirëqënien dhe shëndetin e qytetarëve, vecanërisht në kushtet e rritjes së paqëndrueshmërisë së tregjeve ndërkombëtare. Për këtë nevojitet, marja e masave përshtatëse dhe adaptuese ndaj këtyre ndryshimeve, me qëllim uljen e shkallës së çënueshmërisë së prodhimit bujqësor në të ardhmen.

4- Varësia e sektorit energjitiq ndaj burimeve hidrike kombëtare, dhe rritja e pasigurive për të ardhmen e disponueshmërisë së tyre, ka theksuar nevojën e shfrytëzimit dhe kontributit të burimeve të rinovueshme për prodhimin e energjisë (energjinë e diellit dhe erës) dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, shoqëruar me nevojën për më shumë efikasitet në lidhje me përdorimin e saj.

5- Edhe pse ska të dhëna të besueshme dhe të bazuara në kërkim shkencor, në lidhje me ndikimin e efekteve të klimës mbi shëndetin e njeriut, nivelin e vëckshmërisë dhe sëmundshmërisë për shkak të tyre, vlerësohet se implikimet potenciale që pritet të shfaqen në të ardhmen janë të lidhura me shkallën e lartë të nivelit të ndotjes së ajrit, valët e të mxehtit dhe prezenca e shtuar e parazitëve. Eshhtë e domosdoshme hartimi i strategjive zbutëse dhe të përshtatjes, të lidhura me shëndetin publik ndaj këtyre ndryshimeve bazuar në të dhëna dhe statistika shkencore për këtë qëllim.

6- Përballja e suksesshme me implikimet potenciale dhe ndikimet e tyre në mjedisin shqiptar (për GMT 7& 9 objekt studimi) kërkon aplikimin e një çasje sa më të integruar e ndërsektoriale për menaxhimin dhe planifikimin e adaptimit efektiv ndaj tyre. Kjo duhet shoqëruar me një bashkëveprim dhe bashkëpunim ndërinstitucional.

9.5 Konkluzione për MTG 9

PËRMBLEDHJE

MJEDISI BREGDETAR

Bregdeti shqiptar shquhet për pasuri dhe potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit. Në brendësi ka një natyrë malore dhe të thyer e cila dukshëm tërheq vëmendjen e gjithë vizitorëve me florë dhe faunë shumë të pasur.

Numri total i parcelave ranore përgjatë vijës bregdetare që shfrytëzohen për plazh publik është **380** dhe plazh privat është **2514**. Sipërfaqja totale ranore e shfrytëzuar është **111,506 m²**. Vlerësohet se kemi një tendencë në rritje të sipërfaqeve të menaxhuar për sezonin turistik 2022, krahasuar me 2021 për bashkitë Lezhë, Kavajë, Rrogozhinë, Vlorë dhe Himarë. Përsa i përket shfrytëzimit të sipërfaqeve ranore për përdorim publik, vërehet se për vitin 2022 kemi tendencë në ulje pothuajse në të gjitha bashkitë, duke përjashtuar bashkinë Divjakë, Fier dhe Pogradec që ruajnë të njëjtën sipërfaqe.

Sipas rezultateve mikrobiologjike të ujërave bregdetare vlerësohet se 67.5 % (83 stacione) janë cilësi e shkëlqyer, 19.5% (24 stacione) janë cilësi e mirë, 4.1% (5 stacione) i përkasin cilësisë së mjaftueshme dhe 8.9% (11 stacione) janë cilësi e keqe/ masa të menjëhershme. Plazhet e Velipojës, Shëngjinit, Tales, Spilles, Semanit, Darëzezës, Divjakës, Zvërnecit, Lukovës, Borshit, Qeparoit, Livadhes, Jalës, Dhërmiut, Drimadhes dhe Palasës vlerësohen në kategorinë A- Cilësi e shkëlqyer. Problematike mbeten disa pika monitorimi në Durrës, që përfaqësojnë plazhet Zhiron, tek Plepat pas kanalit dhe Shkëmbi i Kavajës. Në Vlorë plazhet Shkolla e Marinës dhe Plazhi i Ri. Në Sarandë, zonat Plazhi i Ri, Hotel Grand, Kanali i Çukës dhe plazhi Bora Bora në Ksamil. Në Pogradec zonat Hotel Enkelana (ish Turizmi) dhe Hotel 1 Maji.

Ujërat e lagunës së Butrintit janë me cilësi mezotrofike. Kemi përmirësim të gjendjes trofike në Lagunën e Butrintit duke kaluar nga cilësi eutrofike në vitin 2021 në cilësi mezotrofike në vitin 2022. Referuar rezultateve të monitorimit të **lagunës së Butrintit, Nartës dhe Karavastasë për përmbajtjen e metaleve të rënda**, Cd, Pb, Cu,

As, Hg vlerësohet se në të gjitha lagunat kemi tejkalim të normës për parametrat **Kadmium dhe Plumb** që dëshmon një shkallë ndotjeje të lartë duke u klasifikuar në kategorinë **A3-cilësi e keqe**. Parametrat e tjerë janë brenda normave.

Në qytetin e Durrësit dhe Vlorës ujërat urbane shkarkohen nëpërmjet stacioneve të pompimit.

Në qytetin e Sarandës, ujërat urbane shkarkohen në kanalën e Çukës e më pas në det.

Referuar rezultateve, vlerësohet se stacioni në hidrovorin Vlorë-Pylli i Sodës klasifikohet me ndotje më të lartë duke vijuar me stacionin në Durrës në zonën e Porto-Romanos. Kjo tregon se ndikimi i shkarkimeve urbane në këto zona është më i lartë.

Përsa i përket cilësisë e ujërave bregdetare në Dhërmi, Borsh, Lukovë, Zvërnec dhe Ksamil për të gjithë parametrat fiziko – kimikë, vlerësohet se këto ujëra janë të cilësisë të mire. Vlerësohet përmirësim krahasuar me vitin 2021, i cilësisë të ujërave bregdetare të Dhërmiut, Himarës, Borshit, Lukovës. Ksamilit dhe Zvërnecit. Ndërkohë që vihet re përkeqësim i cilësisë të ujërave të Shëngjinit dhe Velipojës, referuar vlerave të përmbajtjes së amonjakut. Megjithatë krahasuar me vitin 2020 kemi një tendencë të përmirësimit të gjendjes gjatë viteve 2021-2022.

NDOTJA NGA ZHURMAT

Zhurma shkaktohet nga një numër i madh burimesh të cilat janë natyrore por edhe të shkaktuara nga aktivitetet e shumta njerëzore. Vlerësimi i zhurmave urbane është kryer në qytetet Tiranë, Vlorë, Fier, Gjirokastrë, Kukës, Pogradec, Sarandë, Korçë, Berat, Shkodër, Lezhë.

Për vitin 2022, kemi tejkalime standartit të OBSH dhe Ligjit Shqiptar për LAeq/Ditën në të gjitha qytetet duke përjashtuar qytetin e Kukësit ku, nuk kemi tejkalim të standartit. Tejkallimin më të lartë e ka qyteti i Shkodrës dhe Tiranës.

Përsa i përket periudhës së natës vërehet se në qytetet e Beratit dhe Kukësit nuk kemi

tejkalim të standartit të OBSH dhe Ligjit Shqiptar LAeq/Natën për vitin 2022. Qytetet e tjera vlerësohen me vlera të larta të nivelit të zhurmave. Tejkalimin më të lartë të standartit e ka qyteti i Tiranës, duke vijuar me qytetin e Shkodrës, Gjirokastrës.

Në të gjitha qytete e monitoruara nga viti 2018-2022 kemi tejkalim të standartit për LAeq ditën. Tejkalimin më të lartë ndër vite kemi në qytetet e Tiranës, Shkodrës, Vlorës dhe Lezhës. Ndërsa tejkalimet më të ulta i kemi në qytetin e Kukësit, Pogradecit dhe Beratit.

Vlerësohet se nga viti 2018-2022, në të gjitha qytetet e monitoruara kemi tejkalim të standartit për LAeq natë. Tejkalimin më të lartë ndër vite kemi në qytetet e Tiranës, Shkodrës, Vlorës dhe Lezhës. Ndërsa tejkalimet më të ulta rezultojnë në qytetet e Kukësit, Pogradecit dhe Beratit

UJËRAT

✓ *Cilësia e ujërave sipërfaqësore*

Në rrjedhat e sipërme ujërat e lumenjve karakterizohen nga temperatura më të ulëta, pasi janë ujëra që burojnë nga zonat malore. Ujërat e lumenjve vlerësohen alkaline.

Referura rezultateve të gjithë parametrave kimik të DKU për vitin 2022, vlerësojmë cilësinë e ujërave të Basenit të Drinit në Klasën III – Gjendje e moderuar, duke nënvizuar përmirësimin nga 2021 ku ky basen ka qënë në cilësi të varfër nga ndotja e vlerësuar në stacionin DLe – Drini Lezhë, si pasojë e sistemimit të Drinit në qytetin e Lezhës dhe e sistemit të kanalizimeve për qark. Ujërat e Basenit Ishëm – Erzen klasifikohen në Klasën V – Gjendje e keqe, Basenit të Matit në Klasën II – Gjendje e mirë, Basenit të Shkumbinit në Klasën e III – Gjendje e moderuar, Basenit të Vjosës në Klasën II – Gjendje e mirë, Basenit të Semanit në Klasën V- Gjendje e keqe.

Bazuar mbi të dhënat e tendencës në vite, vërehet se kemi përmirësim të cilësisë të ujërave të basenit Drinit-Bunë në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021, duke kaluar nga Klasa IV- Gjendje e varfër, në ujëra të cilësisë Klasa III- Gjendje e moderuar. Baseni i Matit nga ujëra të cilësisë së moderuar-klasa III, në

cilësi të mirë të ujërave-Klasa II. Kurse Baseni i Shkumbinit ka një përkeqësim të cilësisë së ujërave duke kaluar nga Klasa II-gjendje e mirë, në Klasa III -gjendje e moderuar. Dy basenet e tjera si ai i Ishëm-Erzen dhe i Semanit i përkasin të njejtës cilësi si në 2021 dhe në 2022 Klasa V-Gjendje e keqe.

Nga monitorimi i metaleve të rënda Cd, Pb, Cu, As, Hg rezulton se për basenet Drin, Lumi Ishëm-Erzen, Lumi i Tiranës, Baseni i Matit, Baseni i Shkumbinit, Baseni Vjosës, Lumi Vjosë dhe Seman, Lumi i Osumit, Lumi Devoll rezulton të jenë lumenj me ujëra të pastër duke u klasifikuar në Klasën A1 – Gjendje e mirë.

✓ *Tributarët (Lumi i Pogradecit, Lumi Vërdovë, Lumi Tushemisht)*

Cilësia e Tributarëve të cilët derdhen në liqen ndikon në cilësinë e liqenit të Ohrit. Temperaturat mesatare të ujërave variojnë në përputhje me ndryshimet sezonale. Ujërat e këtyre tre lumenjve vlerësohen alkaline

Ujërat e lumit të Pogradecit dhe Tushemishtit referuar rezultateve të gjithë parametrave të statusit kimik vlerësohen në Klasa II- Gjendje e mirë, ndërsa lumi i Vërdovës vlerësohet në Klasa e IV- Gjendje e varfër.

Kemi përmirësim të cilësisë të ujërave të Lumit të Vërdovë në vitin 2022 krahasuar me vitet e mëparshme. Lumi i Pogradecit ka një përkeqësim të cilësisë, nga Klasa I- Gjendje e lartë në vitin 2021, në Gjendje të mirë-Klasa II të klasifikimit të ujërave për vitin 2022. Po kështu për Lumin e Tushemishtit nga Klasa I –Gjendje e lartë, në Klasa II-Gjendje e mirë.

Referuar vlerave të metaleve të rënda, nuk kemi prani të elementëve kadmium dhe merkur në të tre lumenjtë. Përmbajtja e metaleve arsenik, bakër dhe plumb nuk tejkalon vlerat limite të DKU duke i vlerësuar ujërat e lumenjve në Klasën A1- cilësi e mirë.

✓ *Liqenet*

Ujërat e liqenit të Shkodrës janë të cilësisë mezotrofike. Përsa i përket përmbajtjes së metaleve të rënda klasifikohen si ujëra të klasës A1- Cilësi e mirë, duke përjashtuar

stacionin Zogaj, i cili referuar nivelit të Kadmiumit (Cd) klasifikohet në klasën A2 -Cilësi e moderuar.

Ujërat e liqenit të Ohrit vlerësohen me cilësi oligotrofike. Liqeni i Ohrit referuar vlerave të metaleve të rënda klasifikohet si ujëra me cilësi të mirë, Klasa A1- Gjendje e mirë.

Ujërat e liqenit të Prespës së Madhe janë të cilësisë mezotrofike, ndërsa ujërat e Prespës së Vogël të cilësisë eutrofike. Përmbajtja e metaleve të rënda është brenda normave të lejuara duke e klasifikuar këtë liqen në Klasa A1- Gjendje e mirë.

Referuar rezultateve ndër vite të parametrave kimik dhe biologjik të cilësisë së ujërave të liqeneve, vlerësohet se këto ujëra paraqesin të njëjtën cilësi mezotrofike për periudhën 2018-2022.

✓ Ujërat nëntokësore

Në **Basenin e Drinit**, rezulton se ujërat në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira. Janë ujëra të ëmbla, të buta dhe të tipit alkaline të dobët. Takohet përmbajtje e rritur e NH_4 në Akuiferin e Mbishkodrës në zonën e Nënshkodrës si Blinisht dhe Velipojë, si dhe në zonën Hot i Ri dhe Grudë Fushë - Koplik Shkodër. Kjo situatë ka lidhje me mos zbatimin e zonave sanitare dhe përmytjet.

Në Basenin e Drinit shfrytëzohen rezervat e ujërave nëntokësore për furnizimin me ujë të pijshëm të qyteteve të Shkodrës, Malësisë së Madhe, Tropojës, Pukës, Kukësit, Peshkopisë, Pogradecit si dhe të fshatrave që i përkasin këtyre bashkive Në përgjithësi për akuiferët Shkodër - Nënshkodër. Uji është brenda normës së ujit të pijshëm.

Në **Basenin e Matit** ujërat nëntokësore në përgjithësi janë të mira. Janë ujëra të ëmbla, të buta e mesatarisht të forta dhe të tipit alkaline të dobët. Vihet re prezenca e NO_2 , në shpimet Patok dhe Hoteli i Gjuetisë e cila vjen nga mos zbatimi i zonave të rreptësisë sanitare.

Në basenin e Matit shfrytëzohen rezervat e ujërave nëntokësore, për furnizimin me ujë të pijshëm të qyteteve të Lezhës, Durrës, Laç, Rrëshen, Burrel, etj. si dhe fshatrat që i

përkasin këtyre bashkive. Uji është brenda normës së ujit të pijshëm.

Ujërat nëntokësore të **Basenit Erzen - Ishëm në** përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira duke plotësuar kushtet e ujit të pijshëm. Janë ujëra të ëmbla, të fortë deri në shumë të fortë dhe alkaline të dobët. Ato përdoren për furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë dhe bizneseve. Ndotjet e ujit me jonet NH_4 , NO_2 , NO_3 , janë ndotje lokale dhe lidhen me moszbatimin e zonave të rreptësisë dhe mbrojtjes sanitare. Rrezik i ndotjes së ujërave nëntokësore janë infiltrimet e ujërave të ndotura të lumenjve Tiranë, Lanë, Tërkuçë, Erzen në shtresat ujëmbajtëse. Shfrytëzimi i shtresave zhavorrore ujëmbajtëse të tarracave lumore për materiale inerte të pellgut ujëmbajtës të Tiranës kanë **çuar** në prishjen e ekuilibrave hidrodinamike e hidrokimike.

Baseni i Shkumbinit karakterizohet nga ujëra nëntokësore me veti fiziko-kimike të mira. Janë ujëra të ëmbla deri në të freskëta, mesatarisht të forta deri në shumë të forta dhe të tipit alkaline të dobët. Ato përdoren për furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë dhe bizneseve. Shfaqja e përmbajtjes së NO_2 , NO_3 dhe NH_4 lidhet me moszbatimin e zonave të rreptësisë dhe mbrojtjes sanitare të shpimeve. Uji është brenda normës së ujit të pijshëm.

Në akuiferët e **Basenit të Semanit**, shfrytëzohen rezerva të konsiderueshme të ujërave nëntokësore për furnizimin me ujë të pijshëm të zonave të banuara si qytete ashtu edhe fshatra të ndryshme. Nga pikëpamja e vlerësimit kimik rezulton se ujërat në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira. Janë ujëra të ëmbla, të buta dhe të tipit alkaline të dobët dhe nuk ka ndotje masive të akuifereve ujëmbajtëse. Në ndonjë rast vihet re prezenca e NO_2 , por në vlera të ulëta, e cila vjen nga mos zbatimi i zonave të rreptësisë sanitare.

Ujërat nëntokësore në akuiferët e **Basenit Vjosë** kanë veti fiziko - kimike të mira. Janë ujëra të freskëta, të tipit alkaline të dobët, mesatarisht të forta. Nuk ka ndotje masive të akuifereve ujëmbajtëse.

Në akuiferët e **Basenit të Zonës Jonike** shfrytëzohen rezerva të konsiderueshme të ujërave nëntokësore për furnizimin me ujë të pijshëm të zonave të banuara, qytete dhe fshatra. Ujërat nëntokësore janë të ëmbla e të freskëta, të tipit alkalik të dobët, mesatarisht të forta. Nuk kanë përmbajtje të NH_4 , NO_2 , NO_3 dhe është brenda standartit për ujë të pijshëm.

✓ Prurjet ujore në lumenj

Vlerësimi i prurjeve ujore në lumenjtë, Drin, Bunë, Mat, Erzen, Ishëm, Shkumbin, Seman, Vjosë, është kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar në dy periudha të ndryshme stinore, në të verës (Qershor-Korrik) dhe atë të vjeshtës (Shtator-Tetor). Nga rezultati i matjeve të kryera, rezulton se në përgjithësi gjatë vitit 2022 kemi patur sasira të vogla të prurjeve ujore në të gjitha stacionet ku janë kryer këto matje, referuar edhe stinës aktuale dhe sasisë tepër të kufizuar të rreshjeve në vendin tonë.

Rreziku i përmytjeve mbetet gjithmonë evident në rrjedhjet e poshtme të lumenjve, por edhe në sektorë të tjerë të cilët kanë filluar të evidentohen në vitet e fundit. Kjo tregon shtrirjen në rritje të këtij fenomeni drejt pjesëve më të sipërme të pellgut. Një nga shkaqet kryesore të këtij fenomeni është ulja e pjerrësisë së shtratit në rrjedhën e poshtme, mbushja e tabanit të kanalit të rrjedhës dhe prurjet e shpejta me intensitet të lartë. Lumenjtë që paraqesin rrezik përmytje janë Buna, Ishmi, Erzeni, Shkumbin, Seman, Vjosë.

NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE AJRI

Aktivitetet që ndikojnë në ndotjen e ajrit janë:

- ✓ Infrastruktura rrugore, transporti i automjeteve dhe cilësia e karburanteve.
- ✓ Djegiet e pakontrolluara të mbetjeve urbane.
- ✓ Emetimet nga ndërtimet dhe konstruksionet urbane.
- ✓ Djegia e lëndës djegëse në shtëpi

Përdorimi i substancave që dëmtojnë shtresën e ozonit dhe emisionet e tyre

është një tregues i presionit që ushtrohet në mjedis duke ndikuar në cilësinë e ajrit dhe ndryshimet klimatike. Sasia totale e importuar e substancave ozonholluese për vitin 2022 është 55 ton. Kemi reduktim të sasisë totale të importuar në vitin 2022 duke e krahasuar me vitin 2021.

Efektet e ndryshimeve klimatike do të ketë këto ndikime në vendin tonë të cilat në afat të mesëm dhe afat të gjatë do të jenë më të dukshme.

Incidentat e sëmundjeve po rriten;

- Rreshjet po shkojnë drejt sasive më të ulëta, intervaleve të shkurtra, por intensitetit të lartë;
- Temperaturat mesatare vjetore në vitin e fundit shënuan rritje +1.8 Gradë Celsius;
- Sasia vjetore e reshjeve në formë dëbore dhe shiu, në dy dekadat e fundit, ka pësuar rënie prej rreth 20%;

Skenarët e ndryshimeve klimatike për Basenin e Lumit Vjosë sugjerojnë se temperatura në zonë ka gjasa të rritet. Po kështu, priten tendenca në rritje të temperaturave vjetore dhe sezonale, si në vlerat minimale edhe në ato maksimale. Temperaturat maksimale mesatare parashikohet të arrijnë deri në 1,1°C brenda vitit 2050 dhe të mbeten në nivele të pandryshuara në vijim.

MBETJET

Në vendin tonë rreth 78% e popullsisë është e mbuluar me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve. Bazuar në peshimin e mbetjeve, vlerësohet se i gjithë vendi gjeneron dhe grumbullon 705,435 Ton mbetje në vit. Kemi një tendencë në ulje të gjenerimit të mbetjeve bashkiake gjatë vitit 2022 krahasuar me vitet e mëparshme. Numri i bashkive që i administrojnë vetë grumbullimin e mbetjeve është 27 dhe 34 bashki nënkontraktajnë kompani private Sipas të dhënave rezulton se për vitin 2022 janë eksportuar rreth 52,240 kg mbetje nga të cilat sasia më e madhe i përket mbetjeve të metaleve. Mbetjet e rrezikshme janë në sasi të vogël. Sasia e mbetjeve të eksportuara për vitin 2022 është më e madhe

se sasia e mbetjeve të eksportuara gjatë vitit 2021.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit mban dhe përditëson regjistrin e transfertave të mbetjeve të rrezikshme dhe të parrezikshme të kompanive që janë të pajisura me Kod Unik. Sasia totale e mbetjeve të rrezikshme të transferuar është 17 847 405 kg ndërsa sasia totale e mbetjeve të parrezikshme është 219 057 521 kg. Përgjatë vitit 2022 janë grumbulluar për trajtim 1247990 kg mbetje spitalore nga subjektet të cilat janë të licencuara për transportimin e mbetjeve spitalore.

PYJET DHE BIODIVERSITETI

Pyjet në Shqipëri zënë 46% të sipërfaqes totale, dhe së bashku me kullotat zënë 65% të sipërfaqes kombëtare ekuivalente me 0.65 ha/frymë. Fondi pyjor shtrihet në një sipërfaqe prej 1,197 000 ha

Sipërfaqen më të madhe pyjore e zënë cungishtet me 46% duke vijuar me pyjet trungishte 32% dhe shkurre 21%. Pyjet e Shqipërisë dominohen si në sipërfaqe ashtu edhe në volum nga pyjet fletorë. Kështu me shumë se 80% e pyjeve të vendit tonë kanë në përbërjen e tyre llojet fletore të cilët kanë mbi 70% të volumit drusor. Rritja vjetore totale e pyjeve në shkallë kombëtare nga llogaritjet rezultoi 1,36 milion m³/vit. Sasia e përthithur e karbonit (C) në pyjet në Shqipëri është 100.9 milion ton C dhe 80% e kësaj sasive ekuivalente me 81 milion ton C përthithet në tokat pyjore dhe 20% (19.9 milion ton C) përthithet në biomasën pyjore. Rreth 26% e pyjeve në Shqipëri janë të dëmtuar nga erërat, zjarret, sëmundjet apo insektet.

Gjatë vitit 2022 nga strukturat përgjegjëse në Bashki dhe Zonë të Mbrojtur, janë raportuar gjithsej 407 raste zjarri, nga të cilat 350 kanë rënë në fondin pyjor kullosor, 266 prej tyre janë në pyje dhe 84 në kullota. Ndërsa nga strukturat përgjegjëse në Zonat e Mbrojtura ka pasur 57 raste zjarri. Nga tërësia e rasteve, rezultoi se sipërfaqja e përshkruar është 5639 ha, ndërsa sipërfaqja e djegur 2334 ha.

Përsa i përket gjendjes shëndetësore rezultoi se ndaj fenomenit të rënies së halave/gjethëve dhe ç'ngjyrosjes për llojet e halorëve

dhe për llojet fletorë, tregojnë se ka rritje të përqindjes së klasës së parë dhe të dytë gjatë këtij viti, këto janë argument për të treguar një përqendrim në gjendjen e kurorave të drurëve. Dëmtuesi i procesonaries së pishës (*Thaumetopoea pityocampa*, Den and Schiff), ka prekur thuajse të gjithë grumbujt e pishës së zezë në të gjithë territorin e vendit.

Dëmtuesi i procesonaries së pishës së zezë, është prezent në masivet e pyjeve me pishë në territoret e bashkive: Kukës, Tropojë, Pukë, Shkodër, Malësi e Madhe, Fushë-Arrëz, Vau i Dejës, Mirditë, Dibër, Bulqizë, Korçë, Pogradec, Prenjas Kolonjë, Elbasan, Gramsh. Në këto masive shkalla e përhapjes është mbi 50% dhe shkalla e prekjës mesatarisht është rreth 35% , me një numër (1-3) qeska për dru.

Llojet drunore si Caraca e Kaukazit (*Celtis Tournefortii*, Rrenja (*Quercus robur L*), Gështenja e kalit (*Aesculus hippocastanum*), Lajthia e egër (*Corylus colurna L*) janë në kufijtë ekstrem të rrezikimit. Për ruajtjen e tyre është e nevojshme ngritja e rrjetit të konservimit 'in-situ' dhe "ex-situ" për këto lloje.

Nga vëzhgimi i bimëve aromatiko-mjekësore të kërcënuara ose të rrezikuara për zhdukje (sherebelë, çaj mali, xhironkull, salep, boronicë) rezultoi se në përgjithësi bimët kanë gjendje të mirë vegjetative dhe fitosanitare.

Censusi i vitit 2022 mbuloi 31 ligatina (lumenj, liqene, rezervuare, ekosisteme bregdetare etj) në të gjithë Shqipërinë. Në total u regjistruan 64 lloje (specie) shpendësh, me një numër total individësh prej 138494. Zonat e mbrojtura mjedisore përfshijnë rreth 21.3% të territorit të vendit me një sipërfaqe rreth 608683 Ha. **Në vendin tonë** janë shpallur gjithsej 721 monumente natyre.

TOKA

Në tokat e vijës bregdetare Kanali i Hoxharës – Plazhi i vjetër Vlorë, elementët Cu, Pb, Zn, Co, janë me vlerë nën norma. Për elementët Ni dhe Cu rezultoi me vlerë pak më të larta se norma dhe Cr deri 4 herë mbi normë për SRC^{një rrez}. Këto vlera duke qenë disi në përgjithësi të ulta nuk përbëjnë risk

për njerëzit dhe ekosistemin. Përjashtim bën vetëm Cr i cili paraqet risk për njerëzit dhe duhet të monitorohet në vazhdimësi.

Gjendja e shtretërve të lumenjve Erzen dhe Ishëm shfaqet problematike për shkak të fenomeneve të erozionit dhe shfrytëzimit të inerteve lumore. Këto fenomene kanë ndikuar në ulje intensive të shtratit në pjesë të caktuara, kënetëzim, prishje të objekteve inxhenerike etj.

AKTIVITETET INDUSTRIAL

Numri i operatorëve të cilët kanë raportuar për vitin 2022 është rreth 1813 nga të cilat 61 janë operator të pajisur me Leje Mjedisi Tipi A dhe 1752 operator të pajisur me Leje Mjedisi Tipi B. Numri më i lartë i subjekteve që realizojnë vetmonitorimin për lejet e tipit A dhe B në total është në qarkun Tiranë duke vijuar në qarkun Durrës dhe Fier. Për secilin qark kemi një rritje të dorëzimit të raporteve të vetmonitorimit krahasuar me vitin 2021, gjë e cila tregon rritjen e ndërgjegjësimit të subjekteve për vetmonitorimin e burimeve të shkarkimit të veprimtarisë së vet duke u bazuar në kushtet e lejeve dhe në afatet kohore të përcaktuara në to.

NDIKIMI I MEGATRENDEVE GLOBALE NË SHQIPËRI

Megatrendet globale në kontekstin kombëtar, përfshijnë një gamë të gjerë të të ashtëquajturve faktorë nxitës të ndryshimit, të cilët ndërveprojnë gjithnjë e më shumë me njëri-tjetrin. Për Shqipërinë janë vlerësuar implikimet e dy MTG.

MTG 7: Rritja e konkurrencës globale për burime, implikimet e të cilës përfshijnë; rritjen e ngarkesave në mjedis, kërcënimet mbi ekosistemet dhe biodiversitetin, rritja e sasisë së ujërave të ndotura, konfliktet mes përdoruesve të ujit, prishja e balancave ujore dhe ekosistemeve tokësore/ujore, Rritja e aktivitetit ndërtues dhe efektet e tij në shfrytëzimin pa kriter të inerteve nga lumenjtë

MTG 9: Pasojat në rritje të ndryshimeve klimatike, implikimet e të cilës përfshijnë; reduktimi i potencialit hidroenergjitik, siguria ushqimore dhe sektori bujqësor, ndryshimet

në sasi të e ujërave/ekstremet ujore/përmbytje e thatësira, nevoja për rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme, ndikimet në shëndetin e njeriut.

ANEKS 1

Të dhëna për sektorë të ndryshëm

Burimet natyrore

Prodhimi i hidrokarbureve për vitin 2022

Nr.	Shoqëria	Vendburimi	Prodhim naftë [ton]	Prodhim Gazi Shoqërues [Mijë Nmi]	Prodhim Uji Teknologjik (shtresor) [Mijë mi]	Prodhim Rërë [mi]
1	Bankers Petroleum Albania l.t.d.	Patos-Marinza	542,321.2	47,008.5	5,183.5	3,361.4
2	Sherwood International Petroleum l.t.d.	Kuçovë	903.6	140.6	0.8	-
3	TerraOil Swiss sh.a.	Visokë	13,350.0	284.6	39.5	-
4	Anio Oil & Gas sh.a.	Ballsh-Hekal	27,404.2	569,263.5	251.0	-
5	Fin Pek Petroleum sh.a.	Finiq-Krane	1,176.0	≈0	0.1	-
6	Fin Pek Petroleum sh.a.	Pekisht-Murriz	1,427.2	≈0	0.1	-
7	Delvina Gas Company	Delvinë (Kondensat)	249.0	s'ka info	s'ka info	-
8	Shell Upstream Albania	Blloku 2-3 i kërkimit	8.9	903.9	1.5	-
9	Shell Albania Block 4	Blloku 4 i kërkimit	-	-	-	-
10	Eni Albania BV	Blloku Dumre i kërkimit	-	-	-	-
11	Albpetrol sh.a.	Patos, Cakran-Mollaj, Kuçovë, Gorisht-Kocul, Amonicë, Karbunarë	70,570.5	1,859.1	177.2	-
SHUMA			657,410.4	619,460.3	5,653.5	3,361.4

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

Shfytëzimi mineralar

Numri i lejeve aktive për shfrytëzim mineralar sipas llojit të mineralit

Nr.	Lloji mineralit	Numri i lejeve
1.	Krom	263
2.	Bakër	15
3.	Hekur - Nikel	31
4.	Gëlqeror	189
5.	Të tjera	60
	Total	558 Leje shfrytëzimi mineralar

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

HEC-e aktive

Nr.	Hec-i	Qarku	Pellgu	Faza në të cilën ndodhet Hec-i
1	Lenie,	Elbasan	DEVOLL	Në prodhim
2	Corovodë	Berat	Osum	Në prodhim
3	Tucep	Dibër	DRIN	Në prodhim
4	Stranik	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
5	Zall Torrë	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
6	Sasaj	Vlorë	DETI JON	Në prodhim
7	Bogovë	Berat	OSUM	Në prodhim
8	Ternova	Dibër	DRIN	Në prodhim
9	Gjanc	Korçë	DEVOLL	Në prodhim
10	Xhyrë	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
11	Smokthina	Vlorë	VJOSA	Në prodhim
12	Arras	Dibër	DRIN	Në prodhim
13	Funarës	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
14	Dukagjin	Shkodër	DRIN	Në prodhim
15	Nikolicë	Korcë	DEVOLL	Në prodhim
16	Bulqizë	Dibër	DRIN	Në prodhim
17	Lurë	Dibër	DRIN	Në prodhim
18	Orgjost	Kukës	DRIN	Në prodhim
19	Lekbibaj	Kukës	DRIN	Në prodhim
20	Velcan	Korçë	DEVOLL	Në prodhim
21	Zerqan	Dibër	DRIN	Në prodhim
22	Borsh	Sarandë	DETI JON	Në prodhim
23	Leshnicë	Sarandë	DETI JON	Në prodhim
24	Shoshan	Kukës	DRIN	Në prodhim
25	Ujanik	Berat	DEVOLL	Në prodhim

26	Kerpicë	Elbasan	DEVOLL	Në prodhim
27	Barmash	Korçë	VJOSA	Në prodhim
28	Lunik	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
29	Homesh	Dibër	DRIN	Në prodhim
30	Muhur	Dibër	DRIN	Në prodhim
31	Rajan	Korçë	VJOSA	Në prodhim
32	Marjan	Korçë	DEVOLL	Në prodhim
33	Treskë 2	Treskë 2	OSUM	Në prodhim
34	Egnatia	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
35	Tervol	Elbasan	DEVOLL	Në prodhim
36	Verbe-Selcë	Korçë	DEVOLL	Në prodhim
37	Qyteze	Korçë	DEVOLL	Në prodhim
38	Çarshovë	Gjirokastër	VJOSA	Në prodhim
39	Labinot Mal 1	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
40	Steblevë	Elbasan	DRIN	Në prodhim
41	Lapaj	Kukës	DRIN	Në prodhim
42	Lengarica	Gjirokastër	VJOSA	Në prodhim
43	Peshku	Dibër	MAT	Në prodhim
44	Stavec	Dibër	MAT	Në prodhim
45	Sllabinjë	Korçë	SHKUMBIN	Në prodhim
46	Kacni	Dibër	DRIN	Në prodhim
47	Tuçep 2	Dibër	DRIN	Në prodhim
48	Kabashi 1	Shkodër	FAN	Në prodhim
49	Stravaj	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
50	Vlushë	Berat	OSUM	Në prodhim
51	Bistrica 3	Vlorë	DETI JON	Në prodhim
52	Selishtë	Dibër	DRIN	Në prodhim
53	Lura 1	Dibër	DRIN	Në prodhim
54	Lura 2	Dibër	DRIN	Në prodhim
55	Lura 3	Dibër	DRIN	Në prodhim
56	Rapun 1	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
57	Rapuni 2	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
58	Strelca 1	Korçë	DEVOLL	Në prodhim
59	Strelca 3	Korçë	DEVOLL	Në prodhim
60	Martanesh	Dibër	MAT	Në prodhim
61	Prellë 1	Dibër	MAT	Në prodhim
62	Prellë 2	Dibër	MAT	Në prodhim
63	Holta Kabash	Elbasan	DEVOLL	Në prodhim
64	Holta Porocan	Elbasan	DEVOLL	Në prodhim
65	Bishnica	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
66	Ashta 1	Shkodër	DRIN	Në prodhim
67	Ashta 2	Shkodër	DRIN	Në prodhim
68	Darsi 1	Dibër	MAT	Në prodhim

69	Klos	Lezhë	FAN	Në prodhim
70	Gur Shpat 1	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
71	Gur shpat 2	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
72	Murdhari 1	Tiranë	ERZEN	Në prodhim
73	Murdhari 2	Tiranë	ERZEN	Në prodhim
74	Niçe	Korçë	DEVOLL	Në prodhim
75	Radovë	Korçë	VJOSA	Në prodhim
76	Lubonjë	Korçë	OSUM	Në prodhim
77	Picar 1	Gjirokastër	VJOSA	Në prodhim
78	Dishnicë	Korçë	DEVOLL	Në prodhim
79	Cernalevë 1	Kukës	DRIN, përroi I Borjes	Në prodhim
80	Cernalevë	Kukës	DRIN, përroi I Borjes	Në prodhim
81	Borje Oreshk	Kukës	DRIN, përroi I Borjes	Në prodhim
82	Belesova 1	Berat	Rezervuari Belesov	Në prodhim
83	Bele 1	Kukës	Lumi Luma, Zapod, Kukës	Në prodhim
84	Topojan 2	Kukës	Lumi Luma, Zapod, Kukës	Në prodhim
85	Orgjost I Ri	Kukës	Lumi Luma, Zapod, Kukës	Në prodhim
86	Bele 2	Kukës	Lumi Luma, Zapod, Kukës	Në prodhim
87	Topojan 1	Kukës	Lumi Luma, Zapod, Kukës	Në prodhim
88	Dragostunjë 2	Elbasan	Përroin Sheja e Hotolishtit	Në prodhim
89	Dragostunjë 3	Elbasan	Përroin Sheja e Hotolishtit	Në prodhim
90	Mollaj	Korçë	DEVOLL	Në prodhim
91	Borovë	Dibër	DRIN	Në prodhim
92	Zabzun	Dibër	DRIN	Në prodhim
93	Sebisht+ Prodan 1	Dibër	DRIN	Në prodhim
94	Prodan 2	Dibër	DRIN	Në prodhim
95	Okshtun +Ter- novë +Lubalesh 1	Dibër	DRIN	Në prodhim
96	Lubalesh 2+ Gjoricë	Dibër	DRIN	Në prodhim
97	Shemri	Kukës	Lumi i Leproit	Në prodhim
98	Mgull	Kukës	Lumi i Leproit	Në prodhim
99	Kryezi	Shkodër	MAT	Në prodhim
100	Kryezi i Eperm	Shkodër	MAT	Në prodhim
101	Hec-i i pare	Dibër	DRIN, në përroin Trebisht	Në prodhim
102	Hec-i i dyte	Dibër	DRIN, në përroin Trebisht	Në prodhim
103	Hec-i 2A	Dibër	DRIN, në përroin Trebisht	Në prodhim
104	Shtika	Gjirokastër	VJOSA	Në prodhim
105	Langarica 3	Gjirokastër	VJOSA (Lumi Gostivisht)	Në prodhim
106	Gostivisht	Gjirokastër	VJOSA (Lumi Gostivisht)	Në prodhim
107	Ura e Dashit	Gjirokastër	VJOSA (Lumi Gostivisht)	Në prodhim
108	Faqekuq 1	Berat	OSUM	Në prodhim

109	Faqekuq 2	Berat	OSUM	Në prodhim
110	Fterrë	Vlorë	DETI JON	Në prodhim
111	Fterre 1	Vlorë	DETI JON	Në prodhim
112	Koka 1	Dibër	Përroi Zalli i Liconës	Në prodhim
113	Sllabinjë 2B	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
114	Sllabinjë 2C	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
115	Sllabinjë 2D	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
116	Sllabinjë 2E	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
117	Nishova	Berat	OSUM	Në prodhim
118	Hurdhas 1	Lezhë	MAT,Vinjollë(përroi Hurdhas)	Në prodhim
119	Hurdhas 2	Lezhë	MAT,Vinjollë(përroi Hurdhas)	Në prodhim
120	Hurdhas 3	Lezhë	MAT,Vinjollë(përroi Hurdhas)	Në prodhim
121	Sotirë 1,2	Elbasan	DEVOLL	Në prodhim
122	Dardhë 1	Shkodër	DRIN, në lumin Dardhë	Në prodhim
123	Qafezezë	Korçë	Osum	Në prodhim
124	Pobreg	Kukës	Lumi Luma	Në prodhim
125	Dragobia	Kukës	Lumi Valbonë	Në prodhim
126	Cerem	Kukës	Lumi Valbonë	Në prodhim
127	Cemeric 1	Korçë	DEVOLL	Në prodhim
128	Cemeric 3	Korçë	DEVOLL	Në prodhim
129	Rapun 3,4	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
130	Lena 1	Dibër	MAT	Në prodhim
131	Lena 2	Dibër	MAT	Në prodhim
132	Lena 3	Dibër	MAT	Në prodhim
133	Vertop	Berat	OSUM, përroi Lybesh dhe Përroi To	Në prodhim
134	Spatharë	Elbasan	SHKUMBIN	Në prodhim
135	Lenie , Shalës	Korçë	DEVOLL	Në prodhim
136	Strelcë	Korcë	DEVOLL	Në prodhim
137	Devoll: Moglicë	Elbasan	DEVOLL	Në prodhim
138	Kokelit	Elbasan	DEVOLL	Në prodhim
139	Banjë	Elbasan	DEVOLL	Në prodhim
140	Shutinë	Shkodër	FAN	Në prodhim
141	Cerruja 1	Dibër	FAN	Në prodhim
142	Cerruja 2	Dibër	FAN	Në prodhim
143	Rrypë	Dibër	FAN	Në prodhim
144	Kozel,	Korcë	OSUM	Në prodhim
145	Helmes 1	Korcë	OSUM	Në prodhim
146	Helmes 2	Korcë	OSUM	Në prodhim
147	Germani 1	Dibër	MAT	Në prodhim
148	Germani 2	Dibër	MAT	Në prodhim
149	Plepi (dega 1)	Dibër	Përroi I Plepës	Në prodhim

150	Peshqesh	Lezhë	FAN	Në prodhim
151	Ura e Fanit	Lezhë	FAN	Në prodhim
152	Fangu	Lezhë	FAN	Në prodhim
153	Bisak	Lezhë	FAN	Në prodhim
154	Ostreni I vogel	Dibër	DRIN	Në prodhim
155	Cekreze 1,2	Tiranë	ISHEM	Në prodhim
156	Koxheraj	Dibër	MAT	Në prodhim
157	Lingjancë 1	Elbasan	Përroi Lingjancë	Në prodhim
158	Ujanik 2	Berat	Përroi Ujanikut	Në prodhim
159	Truen	Shkodër	Përroi I Truenit	Në prodhim
160	Llenga 1	Elbasan	Lumi Gryka e Gurit dhe Uji I Ftohtë	Në prodhim
161	Llenga 3	Korçë	Lumi Gryka e Gurit dhe Uji I Ftohtë	Në prodhim
162	Treska 2	Korçë	Lumi Treskës, Ersek	Në prodhim
163	Treska 3	Korçë	Lumi Treskës, Ersek	Në prodhim
164	Treska 4	Korçë	Lumi Treskës, Ersek	Në prodhim
165	Zerec 2	Korçë	Përroi i Dusharit	Në prodhim
166	Malla	Dibër	Lumi Malla	Në prodhim
167	Denas	Korçë	Lumi i Semericës	Në prodhim
168	Shpella Poshtë II	Korçë	Përroi Qysekut	Në prodhim
169	Driza	Vlorë	Përroi i Vrisit dhe Përroi i Pecës	Në prodhim
170	Sekë	Lezhë	Lumi i Urakës	Në prodhim
171	Zais	Lezhë	Lumi i Urakës	Në prodhim
172	Seta 1+2	Dibër	Lumi i Setës	Në prodhim
173	Seta 3	Dibër	Lumi i Setës	Në prodhim
174	Seta 4	Dibër	Lumi i Setës	Në prodhim
175	Zall Xhuxhë 1	Lezhë	Lumi Fani i Madh	Në prodhim
176	Shengjun	Dibër	Perroi i Shutrenjës	Në prodhim
177	Ballenjë	Dibër	Rezervuari i Ballenjës	Në prodhim
178	Gjadër 2	Shkodër	Lumi Drin	Në prodhim
179	Gjadër 3	Shkodër	Lumi Drin	Në prodhim
180	Gjadër 4	Shkoër	Lumi Drin	Në prodhim
181	Shëngjon 1	Lezhë	Peëroi i Kenellës	Në prodhim
182	Tomorric Dobrenj	Berat	Përroi i Hijes	Në prodhim
183	Lumzi	Shkodër	Përroin e Roshit	Në prodhim
184	VELESHICA 2	Kukës	Lumi i Shalës	Në prodhim
185	Perrollaj	Kukës	Përroi i Bexhmillës	Në prodhim
186	Kasollet e Selcës 1,2	Korçë	Lumi i Selcës	Në prodhim
187	Qarr	Korçë	Lumi Osum, rrjedha e sipërme	Në prodhim

214	Qami 1	Kukës	Drin	Në prodhim
215	Gorice	Korçë	Devoll	Në prodhim
216	Lozhan	Korçë	Devoll	Në prodhim
217	Razdoll	Korçë	Osum	Në prodhim
218	Orenjë	Elbasan	Shkumbin	Në prodhim
219	Vardar	Elbasan	Shkumbin	Në prodhim
220	Dukona	Berat	Osum	Në prodhim
221	Deni	Dibër	Mat	Në prodhim
222	Guri Zi	Dibër	Mat	Në prodhim
223	Strori	Elbasan	Devoll	Në prodhim
224	Voskopojë	Korçë	Devoll	Në prodhim
225	Dobrinjë	Shkodër	Lumi Cem	Në prodhim
226	Marjan - Gura e Veshevë	Korçë	Devoll	Në prodhim
227	Rreshen	Lezhë	Mat	Në prodhim
202	Trojet	Kukës	Drin	Në prodhim
203	Miraka	Elbasan	Shkumbin	Në prodhim
204	Kamenica	Korçë	Devoll	Në prodhim
205	Thanza	Kukës	Drin	Në prodhim
206	Pishat	Elbasan	Devoll	Në prodhim
207	Gurra	Dibër	Mat	Në prodhim
208	Muras	Shkodër	Lumi Cem	Në prodhim
209	Antena	Dibër	Mat	Në prodhim
210	Nderfushas	Dibër	Mat	Në prodhim
211	Kaparjel	Gjirokastër	Vjosë	Në prodhim
212	Eme	Lezhë	Mat	Në prodhim
213	Meshurdh	Shkodër	Fan	Në prodhim
214	Qami 1	Kukës	Drin	Në prodhim
215	Gorice	Korçë	Devoll	Në prodhim
216	Lozhan	Korçë	Devoll	Në prodhim
217	Razdoll	Korçë	Osum	Në prodhim
218	Orenjë	Elbasan	Shkumbin	Në prodhim
219	Vardar	Elbasan	Shkumbin	Në prodhim
220	Dukona	Berat	Osum	Në prodhim
221	Deni	Dibër	Mat	Në prodhim
222	Guri Zi	Dibër	Mat	Në prodhim
223	Strori	Elbasan	Devoll	Në prodhim
224	Voskopojë	Korçë	Devoll	Në prodhim
225	Dobrinjë	Shkodër	Lumi Cem	Në prodhim
226	Marjan - Gura e Veshevë	Korçë	Devoll	Në prodhim
227	Rreshen	Lezhë	Mat	Në prodhim
228	Kamican	Elbasan	Devoll	Në prodhim
229	Mivas	Elbasan	Devoll	Në prodhim
230	Prevalli	Elbasan	Shkumbin	Në prodhim
231	Drita	Kukës	Valbone	Në prodhim

232	Borie Lurë	Dibër	Drin	Në prodhim
233	Mali	Tiranë	Erzen	Në prodhim
234	Lusen 2	Kukës	Drin	Në ndërtim
235	Terfojë	Kukës	Drin	Në ndërtim
236	Jetoni	Dibër	Drin	Në ndërtim
237	Miresh	Dibër	Drin	Në ndërtim
238	Kronz	Diber	Drin	Në ndërtim
239	Polemi	Elbasan	Shkumbin	Në ndërtim
240	Daznjanë	Dibër	Mat	Në ndërtim
241	Shelli	Dibër	Mat	Në ndërtim
242	Thirrë	Lezhë	Mat	Në ndërtim
243	Mivas 1	Berat	Devoll	Në ndërtim
244	Valbonë	Kukës	Lumi Valbona	Në ndërtim
245	Bencë	Gjirokastër	VJOSA	Në ndërtim
246	Tepelenë	Gjirokastër	VJOSA	Në ndërtim
247	Domaj (ROT)	Kukës	DRIN	Në ndërtim
248	Meshanik	Gjirokastër	VJOSA	Në ndërtim
249	Guvë	Gjirokastër	VJOSA	Në ndërtim
250	Vokopola 1	Berat	Përroi Komarit	Në ndërtim
251	Vokopola 3	Berat	Përroi Komarit	Në ndërtim
252	Mesmal 1,2,3	Korçë	Lumi i Selçës	Në ndërtim
253	Selca 2	Korçë	Lumi i Selçës	Në ndërtim
254	Shutri 2	Dibër	Përroi i Shutrisë	Në ndërtim
255	Grabovë 2	Elbasan	Përroi i Grabovës	Në ndërtim
256	Gostima 5	Elbasan	Lumi Gostimë	Në ndërtim
257	Gostima 6	Elbasan	Lumi Gostimë	Në ndërtim
258	VELESHICA 1	Kukës	Lumi i Shalës	Në ndërtim
259	Tuç	Shkodër	Perroin e Roshit	Në ndërtim
260	Gjadër 6	Shkodër	Lumi Drin	Në ndërtim
261	Zall Xhuxhë 2	Lezhë	Lumi Fani i Madh	Në ndërtim
262	Sllabinjë 2D/1	Elbasan	SHKUMBIN	Në ndërtim
263	Belesova 2	Berat	Rezervuari Belesov	Në ndërtim

Projekte eolike dhe fotovoltaike

PROJEKTE EOLIKE TE PAJISURA ME MIRATIM PËRFUNDIMTAR + KONTRATE					
Nr.	Subjekti	Kapaciteti ne MW	Vendodhja	Kontrata	Statusi i Ndërtimit
1.	"GREENTECH" sh.p.k	3 MW	Zona e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier	Kontrata Nr. 919 Rep., Nr. 314 Kol. datë 10 Shkurt 2021 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse me kapacitet të instaluar 3MW, në zonën e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier	Nuk ka filluar ndërtimi. Është në fazën e matjeve të potencialit të Erës në zonën ku do të ndërtohet.
2.	"ALBANIAN GENERAL ELECTRICITY" sh.p.k	3 MW	Zona e Semanit, Fshati Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier	Kontrata Nr. 7968 Rep., Nr. 2948 Kol. datë 7 Dhjetor 2020 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse me kapacitet të instaluar 3MW, në zonën e Semanit, Fshati Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier	Nuk ka filluar ndërtimi. Është në fazën e matjeve të potencialit të Erës në zonën ku do të ndërtohet.
3.	"MAX ENERGY" sh.p.k	3 MW	Zona e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier	Kontrata Nr. 1879 Rep., Nr. 1767 Kol. datë 31 Tetor 2019 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit eolik me kapacitet të instaluar 3MW, Zona e Semanit, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier	Nuk ka filluar ndërtimi. Është në fazën e matjeve të potencialit të Erës në zonën ku do të ndërtohet.
4.	Bashkimi i shoqërive "SEMAN SUNPOWER" sh.p.k dhe "SONNE" sh.p.k	3 MW	Zona e Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier	Kontrata Nr. 7336 Rep., Nr. 2914 Kol. datë 11 Nëntor 2019 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Parkut Eolik "Topojë" me kapacitet prodhues 3MW, në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier	Nuk ka filluar ndërtimi. Është në fazën e matjeve të potencialit të Erës në zonën ku do të ndërtohet.
5.	"WINDSBAB" sh.p.k	3 MW	Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier	Kontrata Nr. 7337 Rep., Nr. 2915 Kol. datë 11 Nëntor 2019 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Parkut Eolik "Windsbab" me kapacitet prodhues 3MW, në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier	Nuk ka filluar ndërtimi. Është në fazën e matjeve të potencialit të Erës në zonën ku do të ndërtohet.

PROJEKTE FOTOVOLTAIKE TE PAJISURA ME MIRATIM PËRFUNDIMTAR + KONTRATE					
Nr.	Subjekti	Kapaciteti në MW	Vendndodhja	Kontrata	Statusi i Ndërtimit
1.	Shoqëria "AEE" Sh.p.k.	2 MW	Fshati Plug, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier;	Kontrata Nr. 2280 Rep., Nr. 1013/2 Kol., "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik "Plug" me kapacitet prodhues 2000kW, në Plug, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier".	I Përfunduar dhe në shfrytëzim
2.	Shoqëria "IN FOOD" Sh.p.k.	2 MW	Vau Dejës, Qarku Shkodër	Kontrata Nr. 9112 Rep., Nr. 3449 Kol., "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik "Gomsiqe" me kapacitet prodhues 1975kW, në Bashkinë Vau Dejes, Qarku Shkodër".	Në proces të marrjes së lejeve për ndërtim
3.	Shoqëria "SEMAN 2 SUN" Sh.p.k.	2 MW	Zona Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier	Kontrata Nr. 1172 Rep., Nr. 380 Kol., "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik "Seman - 2" me kapacitet prodhues 2000 KW, në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier".	I Përfunduar dhe në shfrytëzim
4.	Shoqëria "SONNE" Sh.p.k.	2 MW	Zona Topoje, Bashkia Fier, Qarku Fier	Kontrata Nr. 2278 Rep., Nr. 1052/2 Kol., "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik "Topojë" me kapacitet prodhues 1998 KW, në Bashkinë Fier, Qarku Fier".	I Përfunduar dhe në shfrytëzim
5.	Shoqëria "SEMAN SUNPOWER" Sh.p.k.	2 MW	Zona Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier	Kontrata Nr. 6299 Rep., Nr. 1598 Kol., "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik "Topojë" me kapacitet prodhues 2000 KW, në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier".	I Përfunduar dhe në shfrytëzim
6.	Shoqëria "OSOJA-ENERGY" Sh.p.k.	2 MW	Zona Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier	Kontrata Nr. 1163 Rep., Nr. 376 Kol., "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik "Seman - 1" me kapacitet prodhues 2000 KW, në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier".	I Përfunduar dhe në shfrytëzim
7.	Shoqëria "RTS" Sh.p.k.	2 MW	Fshati Tren, Bashkia Bilisht, Qarku Korçe	Kontrata Nr. 2156 Rep., Nr. 1152/1 Kol., "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik Tren - Bilisht, Korçë, me kapacitet prodhues 2 MW.	I Përfunduar dhe në shfrytëzim
8.	Shoqëria "AED SOLAR" Sh.p.k.	2 MW	Zona Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier	Kontrata Nr. 2608 Rep., Nr. 1227/3 Kol., "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik "Topojë" me kapacitet prodhues 1998 KW, në Bashkinë Fier, Qarku Fier".	I Përfunduar dhe në shfrytëzim
9.	Shoqëria "AGE SUNPOWER" Sh.P.K.	2 MW	Zona Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier	Kontrata Nr. 2277 Rep., Nr. 1051/2 Kol., "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik "Topojë" me kapacitet prodhues 1998 KW, në Bashkinë Fier, Qarku Fier".	I Përfunduar dhe në shfrytëzim

10	Shoqëria "SMART WATT" SH.p.k.	2 MW	Zona Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier	Kontrata Nr. 6380 Rep., Nr. 2756 Kol., "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik "Smart Watt" Sh.p.k. me kapacitet prodhues 2 MW, në zonën Sheq Marinas, Topojë, Qarku Fier".	I Përfunduar dhe në shfrytëzim
11	Shoqëria "ES 2019"	2 MW	Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier	Pajisur me kontratë	I Përfunduar dhe në shfrytëzim
12	Kompania "STATKRAFT RENEWABLES ALBANIA" Sh.p.k.	2 MW	Banjë, Bashkia Cërrik, Qarku Elbasan	Pajisur me kontratë	I Përfunduar dhe në shfrytëzim
13	Shoqëria "MALESIA SOLAR 1" SH.p.k.	2.5 MW	Malësia e Madhe, Qarku Shkodër	V.K.M Nr. 20, datë 14.01.2015 "Për miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik fotovoltaik, dhënë shoqërisë "Malësia Solar 1" Sh.P.K".	Në proces të marrjes së lejeve për ndërtim
14	Shoqëria "MALESIA SOLAR 2" SH.p.k.	2.5 MW	Malësia e Madhe, Qarku Shkodër	V.K.M Nr. 21, datë 14.01.2015 "Për miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik fotovoltaik, dhënë shoqërisë "Malësia Solar 2" Sh.P.K".	Në proces të marrjes së lejeve për ndërtim
15	Shoqëria "MALESIA SOLAR 3" SH.p.k.	2.5 MW	Malësia e Madhe, Qarku Shkodër	V.K.M Nr. 22, datë 14.01.2015 "Për miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik fotovoltaik, dhënë shoqërisë "Malësia Solar 3" Sh.P.K".	Në proces të marrjes së lejeve për ndërtim
16	Shoqëria "CONSTRUCTION ENERGY PARTS" Sh.p.k	2 MW	Fshati Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Kontratë Nr.2774 Rep., Nr. 877 Kol., datë 23 Shtator 2022 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Në proces të marrjes së lejeve për ndërtim
17	Shoqëria "SUNPOWER 2017" Sh.p.k	2 MW	Fshati Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Kontratë Nr.2772 Rep., Nr. 875 Kol., datë 23 Shtator 2022 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Në proces të marrjes së lejeve për ndërtim
18	Shoqëria "SUN AVENUE" Sh.p.k	2 MW	Fshati Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Kontratë Nr.2773 Rep., Nr. 876 Kol., datë 23 Shtator 2022 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Në proces të marrjes së lejeve për ndërtim
19	Shoqëria "HYDROPOWER" Sh.p.k	2 MW	Fshati Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Kontratë Nr.2775 Rep., Nr. 878 Kol., datë 23 Shtator 2022 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Në proces të marrjes së lejeve për ndërtim
20	Shoqëria "DIMAX ALBANIA" Sh.p.k	2 MW	Fshati Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Kontratë Nr.2776 Rep., Nr. 879 Kol., datë 23 Shtator 2022 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Në proces të marrjes së lejeve për ndërtim

21	Shoqëria "ALB SUN ENERGY" Sh.p.k	2 MW	Fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas Bashkia Fier, Qarku Fier.	Kontratë Nr.624 Rep., Nr. 139 Kol., datë 29 Korrik 2022 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Në proces të marrjes së lejeve për ndërtim
22	Shoqëria "BIG WIND" Sh.p.k	2 MW	Fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas Bashkia Fier, Qarku Fier.	Kontratë Nr. 1755 Rep., Nr. 488 Kol., datë 11 Tetor 2022 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Në proces të marrjes së lejeve për ndërtim
23	Shoqëria "NOVA PROSPECT" Sh.p.k	2 MW	Fshati Pilur, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë.	Kontratë Nr. 4330 Rep., Nr. 1983 Kol., datë 07 Nëntor 2022 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në Zonën Kadastrale 2960, Njësia Administrative Pilur, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë.	Në proces të marrjes së lejeve për ndërtim
24	Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "H&E ENERGY" Sh.p.k dhe "ALBSOLAR" Sh.p.k	2 MW	Njësia Administrative Katund i Ri, Bashkia Durrës, Qarku Durrës	Kontratë Nr. 3111 Rep., Nr. 977 Kol., datë 25 Tetor 2022 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në zonën e Bisht Kamzës, Njësia Administrative Katund i Ri, Bashkia Durrës, Qarku Durrës.	Në proces të marrjes së lejeve për ndërtim
25	Shoqëria "MAGNA SOLAR POWER" Sh.p.k	2 MW	Fshati Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier	Kontratë Nr. 10939 Rep., Nr. 4910 Kol., datë 01 Gusht 2022 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Në proces të marrjes së lejeve për ndërtim
26	Shoqëria "KORCA PHOTOVOLTAIC PARK" Sh.p.k	2 MW	Fshati Tren, Bilisht, Korçë	Kontratë Nr. 3008 Rep., Nr. 1255 Kol., datë 07 Qershor 2022 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në zonën Bitinckë, Bilisht, Qarku Korçë.	Në ndërtim
27	Shoqëria "NTSP" Sh.p.k	2 MW	Fshati Tren, Bilisht, Korçë	Kontratë Nr. 3006 Rep., Nr. 1253 Kol., datë 07 Qershor 2022 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në zonën Bitinckë, Bilisht, Qarku Korçë.	Në ndërtim
28	Shoqëria "GREEN ENERGY BILISHT" Sh.p.k	2 MW	Fshati Tren, Bilisht, Korçë	Kontratë Nr. 3009 Rep., Nr. 1256 Kol., datë 07 Qershor 2022 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në zonën Bitinckë, Bilisht, Qarku Korçë.	Në ndërtim

29	Shoqëria "ERNI SOLAR" Sh.p.k	2 MW	Fshati Tren, Bilisht, Korçë	Kontratë Nr. 4101 Rep., Nr. 1642 Kol., datë 07 Korrik 2022 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në zonën Bitinckë, Bilisht, Qarku Korçë.	Në ndërtim
30	Shoqëria "SUN BEAT SYSTEM" Sh.p.k	2 MW	Fshati Tren, Bilisht, Korçë	Kontratë Nr. 3005 Rep., Nr. 1252 Kol., datë 07 Qershor 2022 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në zonën Bitinckë, Bilisht, Qarku Korçë.	Në ndërtim
31	Shoqëria "TREN SUN SYSTEM" Sh.p.k	2 MW	Fshati Tren, Bilisht, Korçë	Kontratë Nr. 3010 Rep., Nr. 1257 Kol., datë 07 Qershor 2022 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në zonën Bitinckë, Bilisht, Qarku Korçë.	Në ndërtim
32	Shoqëria "SPV BLUE 1" Sh.p.k	50 MW	Fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier	Kontratë Nr. 2720 Rep., Nr. 2066 Kol., datë 09 Korrik 2021 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike "BLUE 1" me kapacitet të instaluar 50 MW dhe veprave ndihmëse, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Në ndërtim
33	"Shoqëria SPV BLUE 2" Sh.p.k	50 MW	Fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier	Kontratë Nr. 2721 Rep., Nr. 2067 Kol., datë 09 Korrik 2021 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike "BLUE 2" me kapacitet të instaluar 50 MW dhe veprave ndihmëse, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Në ndërtim
34	Shoqëria "EZ -5 ENERGY" Sh.p.k	10 MW	Fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier	Kontratë Nr.6913 Rep., Nr. 2278 Kol., datë 26 Korrik 2022 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike "BLUE 2" me kapacitet të instaluar 10 MW dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Zonën Kadastrale Nr. 3038, Fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.	Në ndërtim

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

➤ Përdorimi i burimeve të ujërave

Përdorimet kryesore të ujit janë klasifikuar:

- Uji për njerëzit që përfshin ujin e pijshëm dhe shërbimet e kanalizimeve.
- Uji për ushqimin që përfshin bujqësinë.
- Uji për industrinë që përfshin hidroenergjetikën, burimet hidro-termike, veprimtaritë e industrisë së lehtë dhe të rëndë, menaxhimin e mbetjeve të ngurta, peshkimin dhe zbavitjet (turizmi).
- Uji për mjedisin që përfshin zonat e mbrojtura, ligatinat, pyjet.

Në tabelat e mëposhtme paraqitet bilanci i ujit dhe një pasqyrë e përdorimit të ujit në nivel baseni.

. Bilanci i ujit për prurjet mesatare vjetore për basenet ujore

Vlerat në (10 ⁹ m ³ /vit)	N i v e l Kombëtar	Drin	Mat	Ishëm- Erzen	Shkumbin	Seman	Vjosë
Burimet totale ujore të rinovueshme	36.05	21.44	3.25	0.66	2.45	2.70	5.55
Uji i përdorur për bujqësi	0.64	0.12	0.05	0.06	0.05	0.26	0.1
Uji i përdorur për ujë të pijshëm	0.28	0.02	0.01	0.14	0.03	0.04	0.05
Bilanci i ujit	35.12	21.30	3.19	0.46	2.37	2.4	5.4

Burimi: Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore 2018-2027

Pasqyrë e përgjithshme e burimeve ujore në nivel baseni

	Drin- Bunë	Mat	Ishëm- Erzen	Shkumbin	Seman	Vjosë
Burimet ujore						
Numri i lumenjve kryesor	2	1	3	1	1	1
Rrjedhja vjetore (m ³ /s)	680	103	55.5	63.6	83.2	176
Gjatësia e lumit kryesor (km)	285	144	Ishëm- 74 Erzen-108	181	281	192
Numri i rezervuarëve bujqësore	80	40	95	85	115	95
Përdorimi i ujit						
Rezervuarët për ujitje	Përdorim i lartë	Përdorim mesatar	Përdorim i lartë	Përdorim mesatar	Përdorim i lartë	Përdorim i lartë
Numri i hidrocentraleve	4	2	-	0	2	0
Koncesionet e hidrocentraleve	148	85	4	112	104	65
Përdorimi sipas industrisë	Përdorim i lartë	Përdorim mesatar	Përdorim mesatar	Përdorim mesatar	Përdorim i lartë	Përdorim mesatar

Numri i zonave të mbrojtura	10	6	2	6	11	18
Përdorime të tjera	Transport ujqor / peshkim	Ndërtim	Turizëm	Ndërtim	Peshkim	Turizëm
Rreziku nga thatësitrat	I ulët	I ulët	Mesatar	Mesatar	Mesatar	Mesatar

Burimi: Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore 2018-2027

Përsa i përket humbjeve të ujit aktualisht ka humbje të mëdha në sistemin e shpërndarjes si nga sistemi ashtu dhe nga lidhjet pa matës. Në të ardhmen këto humbje do të kontrollohen dhe thithja për ujë të pijshëm do të zvogëlohet edhe pse sasia e furnizuar do të rritet.

Turizmi

Lëvizjet e shtetasve:

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në Shqipëri gjatë vitit 2022 është 7.743.817, duke u rritur me 32% në krahasim me vitin 2021. Numri i shtetasve shqiptarë që kanë dalë nga Shqipëria për vitin 2022 është 5.882.007 duke pësuar rritje me 40% krahasuar me vitin 2021.

Numri i shtetasve që kanë hyrë nga pikat ajrore është rritur me 71,5% krahasuar me një vit më parë. Nga pikat detare është rritur me 42,6% krahasuar me një vit më parë dhe në rrugë tokësore është rritur me 27,9% krahasuar me vitin 2021.

Periudha	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022	Ndryshimi vjetor(%)	Janar-Dhjetor 2021	Janar-Dhjetor 2022	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrja shtetasve të huaj	267.409	391.565	46,4	5.688.649	7.543.817	32,6
Personale	258.423	383.136	48,3	5.588.400	5.437.477	33,1
Pushime, vizitë tek të afërm	243.979	351.408	44,0	5.411.591	7.067.487	30,6
Trajtime shëndetësore	96	25	-74,0	1.504	2.39	59,0
Qëllime fetare	21	33	57,1	488	495	1,4
Udhëtime tranzit	14.327	31.670	121,1	174.817	367.103	110,0
Biznes,profesionale	8.86	8.429	-6,2	100.249	106.340	6,1

Turizmi kulturor dhe natyror në Shqipëri në 6-mujorin e parë të vitit 2022:

Muaji	Vizita në muze	Vizita në kala dhe monumente të tjera	Vizita në parqe arkeologjike	Vizita në zona të mbrojtura
Janar	4,307	4,797	3,797	160,489
Shkurt	5,097	2,027	3,056	145,842
Mars	9,666	1,505	6,726	171,368
Prill	13,445	4,917	11,972	202.628

Maj	29,971	11,589	34,471	
Qershor	26,846	13,098	26,382	466,213

Peshkimi

Të dhënat per 9 mujorin e vitit 2022, përsa i përket zenie peshku sipas kategorive ujore përfshirë akuakulturën dhe molusqet, janë si më poshtë:

Kategoritë ujore	Sasia e zënieve në ton
Detar	2333
Bregdetar	698.7
Laguna	76
Ujëra të brendëshme	2430.8
Akuakultura	5711.1
Molusqe	610.3
Totali	11859.9

Gjate 9-mujorit të vitit 2022, prodhimi (zenie + akuakulture) për të gjitha kategoritë ujore, është **11.859,9 ton**.

- Lidhur me vlerësimin e biomasës së fondit të peshkimit, MBZHR nuk disponon një studim të tillë, ndërsa në lidhje me kuotat e lejuara për peshkim, ju informojmë se këto kuota për të gjithë vendet anëtare pëcaktohen nga Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun (KPPM/GFCM).

Për vitin 2022, ditët e peshkimit **në total për flotën fundore janë 22.109 ditë peshkimi**, ndërsa për pelagjikët e vegjël kuota e lejuar është **jo më shumë se 3269 ton**.

Transporti

Volumi i mallrave të transportuar me ajër është 2.067.7 ton, duke u rritur me 1.4% me shumë krahasuar me vitin 2021. Volumi i mallrave të ngarkuara dhe shkarkuara në porte është 3.804.4 ton, duke pësuar ulje me 20.6 % krahasuar me vitin 2021. Volumi i mallarave transportuara me hekurudhë është 19.983 ton kilometer, duke u ulur me 20.4% krahasuar me vitin 2021.

Periudha	Me det/ton	Transporti i mallarave Hekurudhë 000/ton.km	Ajër/ton
Dhjetor 2021	374.207	16.638	200.0
Dhjetor 2022	309.084	1.739	176.6
Ndryshimi vjetor (%)	-17,4	6,2	- 11,7
Janar-Dhjetor 2021	4.839.617	25.115	2.035.8
Janar-Dhjetor 2022	3.840.418	19.983	2.064.7
Ndryshimi vjetor (%)	-20,6	20,4	1,4

Numri i pasagjereve që kanë udhëtuar gjatë vitit 2022 me linja ajrrore është 5.238.302 pasagjerë, duke u rritur me 78,9% krahasuar me vitin 2021.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja detare është 1.367.008 pasagjerë, duke u rritur me 58,4% krahasuar me vitin 2021.

Numri i pasagjereve që udhëtojnë me linja hekurudhore është 10.604 pasagjere duke u ulur me 55,8% krahasuar me vitin 2021.

Periudha	Në hekurudhë	Transporti i pasagjerëve	
		Me det	Me ajër
Dhjetor 2021	766	59.100	271.340
Dhjetor 2022	123	5.237	408.137
Ndryshimi vjetor (%)	-83,9	27,3	50,4
Janar-Dhjetor 2021	24.018	862.757	2.928.275
Janar-dhjetor 2022	10.604	1.367.008	5.238.302
Ndryshimi vjetor(%)	-55,8	58,4	78,9

Në vitin 2021 numri gjithsej i mjeteve rrugore me status "aktiv" dhe të "çregjistruara përkohësisht" rezulton 740.669 mjete, nga 676.811 mjete të regjistruara deri në vitin 2020, duke u rritur me 9%.

Mjete rrugore sipas llojit:

Nga mjetet rrugore sipas llojit përqindjen më të madhe e zënë autoveturat me 80,1%, automjetet për transport të përzier 6,7% dhe motor 5,1%.

Numri i autoveturave deri në Dhjetor të vitit 2021 është rritur me 10,0% në krahasim me vitin 2020, automjetet për transport të veçantë janë rritur me 8,0% dhe automjetet për përdorim të veçante me 5,9%.

Mjetet rrugore sipas vitit të prodhimit:

Numri i automjeteve të regjistruara deri në Dhjetor të 2021 me vit prodhimi 2011-2021 është rritur me 32,7, grupi 2000-2010 është rritur me 11,3% ndërsa grupi i autoveturave me vit prodhimi para vitit 2000 ka pësuar rënie me 1,2%.

Viti i prodhimit	2020	2021	2021/2020%
<2000	138.979	137.250	-1,2
2000-2010	353.380	393.477	11,3
2011-2021	47.138	62.553	32,7


Ne nivele më të detajuar deri në Dhjetor 2021 autoveturat me moshë 11-20 vite përbëjnë 54,2% të numrit gjithsej të autoveturave, me status "aktiv" ose të "çregjistruara përkohësisht".

Mosha	Autovetura	Autobus	Kamion
0-2 vite	3.992	7	41
0-3 vite	11.423	55	170
6-10 vite	34.560	267	285
11-20 vite	321.337	3.299	3.200
>20 vite	221.968	4.239	10.708


Energjetika

	Konsumi i energjisë sipas degëve
	2021
Konsumi final i energjisë në:	1.949
Industri	395
Transport	691
Konsumatorët familjarë, biznese, administrata publike etj	745
- nga të cilët konsumatorë familjarë	535
Bujqësi	77
Peshkim	41
Të tjera	

Prodhimi dhe konsumi i energjive parësore sipas Produkteve parësore. Disponibël për konsum final , Prodhimi dhe konsumi i energjive parësore, 2021.



Prodhimi dhe konsumi i energjive parësore sipas Produkteve parësore. Prodhim i produkteve parësore , Prodhimi dhe konsumi i energjive parësore, 2021.



Ujësjetllës -kanalizime

Mbulimi me ujësjetllës dhe kanalizime për vitin 2022

Qyteti	Mbulimi me Ujësjetllës	Mbulimi me Kanalizime	Qyteti	Mbulimi me Ujësjetllës	Mbulimi me Kanalizime
	%	%		%	%
Shkodër	57.06	45.39	Pustec	58.17	24.09
Fushë Arrëz	100	37.5	Devoll	94.36	0
Pukë	41.16	27.11	Kolonjë	100	81.58
Vau Dejës	57.3	6.24	Berat	77.04	60.29
Malësi e Madhe	57.47	1.84	Kuçovë	0	0
Lezhë	75.61	62.85	Dimal	40.41	14.63
Mirditë	55.81	39.88	Poliçan	65.48	67.81
Kurbini	45.97	37.1	Skrapar	92.98	51.34
Kukës	66.67	41.19	Fier	68.22	47.77
Tropojë	55.77	24.69	Patos	50.94	33.36
Has	69.21	0	Roskovec	50.76	31.77
Tiranë	97.21	90.74	Mallakastër	77.83	21.94
Kamëz	74.78	82.64	Vlorë	91.18	65.35
Vorë	58.07	48.5	Selenicë	74.31	26.75
Kavajë	99.58	73.98	Himarë	93.38	19.57
Durrës	96.66	58.47	Gjirokastër	82.53	36.19
Rrogozhinë	66.01	7.8	Tepelenë	78.4	48.52
Krujë	43.53	25.76	Këlcyrë	46.8	0
Dibër	92.26	41.13	Përmet	95.75	69.24
Bulqizë	54.49	16.88	Libohovë	100	0
Mat	82.43	45.88	Dropull	97.28	1.69
Klos	38.39	6.48	Memaliaj	51.41	31.92
Elbasan	71.08	57.07	Lushnjë	71.43	36.42
Librazhd	29.11	21.18	Divjakë	55.31	0
Gramsh	89.86	0	Perrenjas	0	0
Cërrik	67.54	29.85	Pogradec	85.35	52.73
Belsh	72.79	20.22	Delvinë	89.85	38.12
Peqin	45.38	17.45	Sarandë	97.43	82.41
Korçë	97.89	82.02	Finiq	44.47	0
Maliq	67.1	29.36	Konispol	100	0

Shënim: Vlerat 0 tregojnë që mbulimi me kanalizime nuk kryhet nga Shoqëria por nga Bashkia

Burimi: Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve

Implantet për trajtimin e ujërave të përdorura për vitin 2022

Emri I Shoqërisë	Emërtimi I ITUN	Vendndodhja	Sipërfaqja sipas projektit	Popullsia ekuivalente sipas projektit (Banorë)	Popullsia totale që i afrohet shërbimi i trajtimit të ujrave të ndotura (Banorë)	Lloji i impiantit të trajtimit	Kapaciteti trajtues sipas projektit (m ³ /ditë)	Volumi ujit të ndotur që hyn në ITUN (000m ³)
Sh.A UK Korçë	IMPIANTI I TRAJTIMIT TE UJIT TE NDOTUR KORÇE	Korçë	12 ha	85,000	89,000	- Uji trajtohet ne nivel sekondar - Ka shkarkim te ujrave nga fabrika burra Korça ne ITUN (ndotje ne nivel detergjentesh pastrimi) - Trupa pritese Përrua	15,000	4,274
Sh.A UK Pogradec	IMPIANTI I TRAJTIMIT TE UJIT TE NDOTUR POGRADEC	Buçimas, Pogradec	15 ha	50,000	49,188	- Uji trajtohet ne nivel: Paraprak, primar, sekondar & terciar (reduktim I fosforit) - Nuk shkarkojne ujra industriale ne ITUN - Trupa pritese Liqen	38 l/s	2,258
Sh.A UK Durrës	IMPIANTI I TRAJTIMIT TE UJRAVE TE NDOTURA DURRES	Porto Romano Durrës	70 ha	250,000	211,737	-ITUN Durrës përdor një teknologji te llumit aktiv, të avancuar me trajtim biologjik terciar, ku përftohet Biogaz për prodhimin e energjisë elektrike . Perbehet nga: linja e paratrajtit, trajtimit primar, sekondar dhe terciar (reduktim I fosforit) & (Reduktim I azotit) - Trupa pritese Det	60,000	9,233
	IMPIANTI I TRAJTIMIT TE UJRAVE TE NDOTURA LALËZ	Hamallaj Durres	1.5ha	15,000		ITUN Lalez perdor Llum aktiv (Pranim / Paratrajtim/ Oxigjenim/ Dekantues / Trashues / Qetesues/Centrifuge)	2,500	
Sh.A UK Lezhë	IMPIANTI I TRAJTIMIT TE UJIT TE NDOTUR SHENGJIN	Kune, Shëngjin	29.5ha	60,000	35,439	- Biodiversitet, trajtim biologjik deri ne nivel primar i avancuar - Nuk shkarkojne ujra industriale ne ITUN. - Trupa pritese Lumë	12,240	938
Sh.A UK Sarandë	IMPIANTI I TRAJTIMIT TE UJI TE NDOTUR SARANDE	Fshati Çukë, Sarandë	30ha	60,000	49,221	Impiant me trajtim biologjik te ujrave nepermjet pondeve te ajruara, trajtimi I ujrave deri ne nivel sekondar - Nuk shkarkojne ujra industriale ne ITUN - Trupa pritese Lumë	12,240	1,157

Sh.A UK Kavajë	IMPIANTI I TRAJTIMIT TE UJIT TE NDOTUR KAVAJE	Qerret Kavaje	18 ha	25,000	64,708	- Uji trajtohet ne nivel seko ndar. - Shkarkojne ujra industriale ne ITUN dhe jane te paratrajtuar. - Trupa pritese Det	4,500	11,664
Sh.A UK Shkodër	IMPIANTI I TRAJTIMIT TE UJIT TE NDOTUR SHKODER	Shirokë	1913 m ²	25,000	17,802	- Trajtim biologjik me llum aktiv - Nuk shkarkojne ujra industriale ne ITUN	350	255
	IMPIANTI I TRAJTIMIT TE UJIT TE NDOTUR VELIPOJE	Velipojë	2.8 ha	48,300		- Uji trajtohet me basene SBR dhe rreze ultravjolet.	15,800	
Sh.A UK Vlorë	IMPIANTI I TRAJTIMIT TE UJIT TE NDOTUR VLORE	Vlorë	25.5 ha	210,000	132,709	- Uji trajtohet me paratrajtim dhe trajtim primar. - Nuk shkarkojne ujra industriale ne ITUN - Trupa pritese Det	42,000	4,966
	IMPIANTI I TRAJTIMIT TE UJIT TE NDOTUR ORIKUM	Orikum	2ha	55,000		I perfunduar pritet te lidhet me sistemin e kanalizineve	4,000	
Sh.A UK Tiranë	IMPIANTI I TRAJTIMIT TE UJIT TE NDOTUR TIRANE	Kashar, Tiranë	53ha	335,880		<i>ITUN trajton ujin e ndotur deri ne nivelin sekondar me rruge biologjike. Linja e trajtimit te ujit te ndotur:</i> permban njesi parartajtimi si: grila mekanike e automatike dhe stacion pompimi qe dergon ujin te niveli primar i trajtimit <i>dekantuesi primar</i> ; Niveli sekondar i trajtimit eshte projektuar si filter me pikim & dekantues sekondar. Pasi uji del i trajtuar nga niveli sekondar kalon ne nje njesi dizinfektimi. Me pas uji shkarkohet ne trupen ujore me te afert. Linja e trajtimit te llumit eshte projektuar me keto elemente: Trashues llumi; Tretes llumi & shtreter tharjeje per llumin. Impjanti eshte në ndertim	75,843	

Bashkia Himare	IMPIANTI I TRAJTIMIT TE UJIT TE NDOTUR DHRALE - PALASE	Zona breg- detare Dhrale, Palase ne Bashkine Himare		Faza e pare 1500		1. Grile fine (vetpastrim); 2. Para sedimentim yndyre, vaj (FOG) vaska e mbled- hjes se llumit; 3. Rezervuari I barazimit (I ajrosur); 4. Pompim i vazhdueshem i rr- jedhes; 5. Matja e rrjedhes; 6. Trajtim biologjik; 7. Sedimentim-riciklim llumi & refuzim; 8. Klorinim - pompim te filtri mi; 9. Filtrimi i reres; 10. Mbledhja e ujit te trajtuar	450	
	IMPIANTI I TRAJTIMIT TE UJIT TE NDOTUR DRIMADHE -DHERMI	Zona bregde- tare Dri- madhe, Dhermi ne Bashkine Himare		Aktualisht 3000 banoresh/ vizitore/ dite dhe me prespek- tive ne te ardhmen maximal- isht 6000 banoresh/ vizitore/ dite		Trajtim me llum aktiv I tipit MBBR (Biologjik) Impjanti eshte në ndertim	Kapaciteti i trajtimit te llumit 10m ² / ore (240m ² / dite)	

Burimi: Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve

Shtypi u realizua në shtypshkronjën Kristalina-KH

